



PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA KËLCYRË

VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR




PËRGATITI 'ATELIER 4' shpk
LICENSE NR. LN-6585-06-2013
Ark. ALBAN EFTHIMI
CERTIFIKATË NR. 154
Eks. Mjedisi GAZMEND ZENELI
CERTIFIKATË NR. 17

TABELA E LËNDËS

TABELA E LËNDËS.....	1
LISTA E FIGURAVE.....	6
LISTA E GRAFIKËVE.....	7
LISTA E TABELAVE.....	7
I. HYRJE.....	9
II. PROCESI I HARTIMIT TË VSM-SE.....	11
2.1. PËRKUFIZIMI I VSM-SE.....	11
2.2. KUADRI LIGJOR PËR VSM-TE.....	11
2.2.1. Konventat/ marrëveshjet ndërkombëtare.....	11
2.2.2. Legjislacioni Shqiptar.....	13
2.3. PARIMET E HARTIMIT TË VSM-SE.....	17
2.4. METODOLOGJIA DHE PROCESI I HARTIMIT TË VSM-SE.....	17
2.4.1. Etapat kryesore në procesin e hartimit të VSM-së.....	17
2.4.2. Mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre.....	19
2.4.3. Përbajtja e raportit të VSM-së.....	19
III. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PLANIT.....	21
3.1. VIZIONI I ZHVILLIMIT PËR BASHKINË.....	21
3.2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË PËR ZHVILLIMIN E TERRITORIT TË BASHKISË.....	23
3.3. OBJEKTIVAT KOMBËTARE.....	33
3.4. STRATEGJITË/ PLANE KOMBËTARE TË LIDHURA ME VSM-NE PËR PLANIN E PËRGJITHSHËM.....	35
VENDOR.....	35
3.4.1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar.....	35
3.4.2. Strategjia Ndërsëktoriale e Mjedisit.....	37
3.4.3. Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.....	37
3.4.4. Strategjia e Pyjeve dhe Kullotave.....	38
3.4.5. Strategjia Ndërsëktoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020.....	38
3.4.6. Strategjia Kombëtare dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve.....	39
3.4.7. Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Konventës së Aarhus-it.....	39
IV. PËRSHKRIMI I KUSHTEVE BAZË TË MJEDISIT.....	41
4.1. MJEDISI FIZIK.....	41
4.1.1. Klima.....	41
4.1.2. Topografia.....	47
4.1.3. Hidrologjia.....	56
4.1.4. Pasuritë minerale.....	58
4.1.5. Hidrogeologjia.....	60
4.1.6. Gjeologjia inxhinierike.....	62
4.1.7. Tokat.....	67
4.1.8. Cilësia e Ajrit.....	70
4.1.9. Ndodhja akustike.....	73



4.1.10.	Rreziku sizmik ne Bashkinë e Këlcyrës	73
4.2.	MJEDISI BIOLOGJIK	76
4.2.1.	Vegjetacioni dhe flora	76
4.2.2.	Habitatet Natyror me Interes Komunitar, sipas Klasifikimit Natura 2000	78
4.2.3.	Fauna tokësore dhe e trupave ujorë	82
4.2.4.	Zonat e Mbrojtura	83
4.2.5.	Monumentet e Natyrës (Biomonumentet)	84
4.3.	EFEKTET E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE	85
4.3.1.	Ndryshimet klimatike në Shqipëri	85
4.3.2.	Rritja e temperaturave	85
4.4.	POPULLSIA DHE ASJET MATERIALE	88
4.4.1.	Popullsia dhe tendencat demografike	88
4.4.2.	Strehimi	93
4.4.3.	Trashëgimia Arkeologjike dhe Kulturore	95
4.5.	VLERËSIMI I KËRCËNIMEVE PËR BURIMET NATYRORE DHE PROBLEMATIKA MJEDISORE	97
4.5.1.	Rreziku i përmbajtjeve	97
4.5.2.	Ndërtimi i Hidrocentraleve mbi lumin Vjosa dhe tributaret e tij	99
4.5.3.	Erozioni i tokës, shembjet dhe rrëshqitjet	99
4.5.4.	Dëmtimi i faunës	101
4.5.5.	Turizmi	101
4.5.6.	Karierat e gurit	101
4.6.	ANALIZA E PROBLEMATIKËS MJEDISORE	103
4.6.1.	Ndërtimi i Hidrocentraleve të vegjël mbi lumin Vjosa dhe tributaret e tij	103
4.6.2.	Menaxhimi i mbetjeve	104
4.6.3.	Ndotja e ujërave	105
4.6.4.	Degradimi i tokës	107
4.6.5.	Cilësia e ajrit	107
4.7.	METABOLIZMI I TERRITORIT NË BASHKINË E KËLCYRËS	109
4.7.1.	Flukset e Ujit	109
4.7.2.	Flukset e Ushqimit	110
4.7.3.	Flukset e Energjisë	110
4.7.4.	Flukset e Turizmit	110
4.8.	NDARJA E TERRITORIT NË SISTEME	116
4.9.	ANALIZA SWOT	120
4.9.1.	Përmbledhja e aspekteve pozitive	132
4.9.2.	Problematikat e evidentuara dhe rekomandimet për zbutjen e impaktit	132
4.9.3.	Rekomandime për zbutjen e impaktit të këtyre problematikave	132
V.	TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN (ALTERNATIVA ZERO)	133
5.1.	HYRJE	133
5.2.	ZONIMI, PËRDORIMI I TOKËS DHE POLITIKAT PUBLIKE	133
5.3.	TOKA	133
5.4.	AJRI	134
5.5.	FAKTORET KLIMATIKE	134
5.6.	UJI	134



5.7.	BIODIVERSITETI DHE ZONAT E MBROJTURA	135
5.8.	MBETJET	135
5.9.	NDOTJA AKUSTIKE DHE NIVELI I ZHURMAVE	136
5.10.	POPULLSIA, KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE DHE ASETET MATERIALE	136
5.11.	TRASHËGIMIA KULTURORE	136
5.12.	PEIZAZHI	137
5.13.	PËRFUNDIME	138
VI.	BAZA PËR PËRGATITJEN E VLERËSIMIT MJEDISOR	138
6.1.	PËRCAKTIMI I OBJEKTIVAVE MJEDISORE	139
6.2.	DËTYRIMET SIPAS KONVENTAVE NDËRKOMBËTARE DHE DOKUMENTAVE STRATEGJIKE TË SHQIPËRISË	146
6.3.	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE	148
6.4.	METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NDIKIMEVE TË PLANIT DHE PROJEKTEVE	148
6.4.1.	Vlerësimi i ndikimit	178
6.4.2.	Vlerësimi i përputhshmërisë	152
VII.	VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË OBJEKTIVAVE TË PLANIT DHE PROJEKTEVE STRATEGJIKE ME OBJEKTIVAT MJEDISORË	154
7.1.	PRIORITIZIMI I PROJEKTEVE PËR ZBATIMIN E PLANIT	154
7.2.	VLERËSIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS NGA ZBATIMI I PLANIT	157
7.2.1.	Vlerësimi i projekteve të O.S.1: Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale, si dhe turizmit	175
7.2.2.	Vlerësimi i projekteve të O.S.2: Ristrukturimi dhe profilizimi i vendbanimeve si dhe turizmit	160
7.2.3.	Vlerësimi i projekteve të O.S.3: Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit e peizazhit	162
7.3.	VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË PROPOZIMEVE TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR	165
VIII.	VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE	169
8.1.	VLERËSIMI I PASOJAVE NGA ZBATIMI I PLANIT DHE NDIKIMI TYRE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE MJEDISORE TË PLANIT	169
8.1.1.	Toka	170
8.1.2.	Ajri	172
8.1.3.	Faktorët klimatikë	173
8.1.4.	Uji	174
8.1.5.	Mjedi Natyror- Biodiversiteti dhe hapësirat e gjelbra	176
8.1.6.	Mbetjet	177
8.1.7.	Ndotja akustike/ zhurmat	178
8.1.8.	Popullata dhe asetet materiale	179
8.1.9.	Trashëgimia kulturore	179
8.1.10.	Peizazhi	180
8.1.11.	Përfundime mbi Vlerësimin e Ndikimeve	181
8.2.	IMPAKTET KUMULATIVE	182
IX.	UDHËZIME DHE MASAT ZBUTËSE	182
9.1.	TOKA	182





STUDIO ARCHITECTURE

9.1.1.	Punimet në dhëra të ndotura	182
9.1.2.	Ndotja e Tokës	182
9.1.3.	Ripërdorimi i materialit të gërmuar	183
9.1.4.	Erozioni	183
9.2.	AJRI	183
9.3.	FAKTORËT KLIMATIKË	184
9.3.1.	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike	184
9.4.	UJI	185
9.5.	MJEDISI NATYROR	186
9.6.	MBETJET	188
9.7.	NDOTJA AKUSTIKE (ZHURMAT)	191
9.8.	POPULLLSIA DHE ASETET MATERIALE	192
9.9.	TRASHËGIMIA KULTURORE	192
9.10.	PEIZASHI	193
X.	MONITORIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	195
10.1.	KUADRI INSTITUCIONAL DHE LIGJOR DHE INSTRUMENTE QË LIDHEN ME MONITORIMIN E MJEDISIT	195
10.2.	PLANI I VEPRIMIT: MONITORIMI, TREGUESIT E VLERËSIMIT DHE INSTITUCIONE MONITORESE	197
10.3.	PROBLEMATIKA TË MONITORIMIT TË MJEDISIT QË DUHET TË MERREN NË KONSIDERATË	202
XI.	BIBLIOGRAFIA	203
	PROCESI I KONSULTIMEVE ME PUBLIKUN	211
	DËGJESAT PUBLIKE DHE FORUMET E BASHKËRENDIMIT TË PLANIFIKIMIT VENDOR	212
1.	DËGJESË PUBLIKE, 21 SHTATOR 2017	212
2.	FORUMI I BASHKËRENDIMIT TË PLANIFIKIMIT VENDOR, 7 DHJETOR 2017	216
3.	DËGJESË PUBLIKE, 15 DHJETOR 2017	217
4.	DËGJESË PUBLIKE: PREZANTIMI I PLANIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE PREZANTIMI I RAPORTIT TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR. 12 SHKURT 2018	219
I.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	222
II.	VIZIONI I ZHVILLIMIT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË PPV-SË TË BASHKISË KELCYRË	223
III.	PËRSHKRIMI I KUSHTEVE BAZË TË MJEDISIT	224
3.1.	MJEDISI FIZIK	224
3.2.	MJEDISI BIOLOGJIK	225
3.3.	NDARIA E TERRITORIT NË SISTEME	226
IV.	TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN (ALTERNATIVA "0")	227
V.	BAZA PËR PËRGATITJEN E VLERËSIMIT MJEDISOR	229
5.1.	PËRCAKTIMI I OBJEKTIVAVE MJEDISORE	229
5.2.	METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NDIKIMEVE TË PLANIT DHE PROJEKTEVE	230
VI.	VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË OBJEKTIVAVE TË PLANIT DHE PROJEKTEVE STRATEGJIKE ME OBJEKTIVAT MJEDISORË	232
6.1.	PRIORITIZIMI I PROJEKTEVE PËR ZBATIMIN E PLANIT	232



6.2	VLERËSIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS NGA ZBATIMI I PLANIT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE MJEDISORE TË PLANIT	232
6.3	VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË PROPOZIMEVE TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR	234
VII.	VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE DHE MASAT ZBUTESE	238
VIII.	MONITORIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS..	239
IX.	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	240





4

ATELIER STUDIO ARKITEKTURE

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Harta e Vizionit të Zhvillimit të Bashkisë Këlcyrë.....	22
Figura 2. Objektivi i parë zhvillimor, Bashkia Këlcyrë.....	24
Figura 3. Objektivi i dytë zhvillimor, Bashkia Këlcyrë.....	30
Figura 4. Objektivi i tretë zhvillimor, Bashkia Këlcyrë.....	32
Figura 5. Harta e Rekomandimeve nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Shqipëria 2030.....	36
Figura 6. Harta e zonave klimatike, Bashkia Këlcyrë.....	42
Figura 7. Baseni ujëmbledhës i Vjosës (Burimi: Sala & Qirazi, 2016).....	47
Figura 8. Harta Litologjike dhe Gjeologjike e Basenit të Vjosës (Burimi: Sala & Qirazi, 2016).....	48
Figura 9. Tarraca të Vjosës në rrjedhen e mesme Carçovë -Këlcyrë.....	49
Figura 10. Harta topografike, Bashkia Këlcyrë.....	55
Figura 11. Harta gjeologjike, Bashkia Këlcyrë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar).....	57
Figura 12. Harta e pasurive minerale, Bashkia Këlcyrë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar).....	59
Figura 13. Harta hidrogeologjike, Bashkia Këlcyrë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar).....	61
Figura 14. Harta gjeologo-inxhinierike, Bashkia Këlcyrë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar).....	63
Figura 15. Harta e rezikut gjeologjik, Bashkia Këlcyrë. (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar).....	65
Figura 16. Formacion flishore në sektorin Vinokash-Ballaban.....	66
Figura 17. Harta Pedologjike për Bashkinë e Këlcyrës.....	69
Figura 18. Harta e shpejtimit spektral SA (0.2) me shuarje 5% në truall shkëmbor dhe probabilitet 10%/50 vjet ose 475 vjet periodë përsëritje 475 (Majtas) dhe Harta e Rezikut Sizmik në Shqipëri (Djathtas) (Burimi: Aliaj et al. 2010).)	75
Figura 19. Gjendja eksistuese e pyjeve në Njësinë Administrative Dëshnicë.....	77
Figura 20. Uji i Zi në Grykën e Këlcyrës.....	84
Figura 21.. Densiteti i banorëve në njësitë administrative të Bashkisë Këlcyrë.....	89
Figura 22. Rreziku i përmytjes nga lumenjtë e Vjosës, Osumit, Devollit dhe Semanit (Burimi: PKK, 2015).....	98
Figura 23. Karrierë guri pranë rrugës Këlcyrë -Përmet.....	102
Figura 24. Gurë masivë të depozituar në pikën e grumbullimit.....	102
Figura 25. Stacionet e marrjes së mostrave.....	106
Figura 26. Harta e Problematikave mjedisore, Bashkia Këlcyrë.....	108
Figura 27. Flukset e Ujit, Bashkia Këlcyrë.....	112
Figura 28. Flukset e Ushqimit, Bashkia Këlcyrë.....	113
Figura 29. Flukset e Energjië, Bashkia Këlcyrë.....	114
Figura 30. Flukset e Turizmit, Bashkia Këlcyrë.....	115
Figura 31. Sistemet territoriale, Bashkia Këlcyrë.....	117
Figura 32. Përdorimi ekzistues i tokës, Bashkia Këlcyrë.....	118
Figura 33. Harta e prioritizimit të projekteve, Bashkia Këlcyrë.....	156
Figura 34. Rrjeti i treguesve të monitoruar për vitin 2017 (Burimi: AKM, 2016).....	196
Figura 35. Foto gjatë Dëgjësës Publike për Planin e Përgjithshëm Vendor, Bashkia Këlcyrë, 21 Shtator 2017.....	213
Figura 36. Model i pyetesorit të shpërndarë.....	214
Figura 37. Listë e pjesëmarrësve në dëgjësën publike në Bashkinë Këlcyrë. 21/09/2017.....	215
Figura 38. Foto gjatë Forumit të Bashkërendimit të Planifikimit Vendor, 07 Dhjetor 2017.....	216
Figura 39. Foto gjatë Dëgjësës Publike për Planin e Përgjithshëm Vendor. 15 Dhjetor 2017.....	217



Figura 40. Listë e pjesëmarësve në dëgjueshë publike në Bashkinë Këlcyrë. 15 Dhjetor 2017.....	218
Figura 41. Prezantimi i Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Bashkinë Këlcyrë.....	220
Figura 42. Listë e pjesëmarësve në prezantimin e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Bashkinë Këlcyrë. 12 Shkurt 2018.....	221
Figura 43. Etapat e procesit të VNM-se.....	222

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Temperaturat më të larta dhe më të ulëta ditore (Burimi: Weatherspark.com).....	43
Grafiku 2. Numri i diteve me diell, vranesi dhe me reshje.....	44
Grafiku 3. Sasitë mesatare mujore të reshjeve për Bashkinë Këlcyrë.....	44
Grafiku 4. Shpejtësia mesatare e erës për Bashkinë Këlcyrë.....	45
Grafiku 5. Drejtimi i erës për Këlcyrën.....	45
Grafiku 6. Tendencat e emetimit të dioksidit të karbonit për banor në Shqipëri (Burimi: Banka Botërore).....	71
Grafiku 7. Ndryshimi i popullsisë rezidente ndërmjet CENSUS 1989-2011.....	90
Grafiku 8. Ndryshimet e popullsisë ndërmjet regjistrimeve të ndryshme të popullsisë, (1989-2001-2011).....	91
Grafiku 9. Piramida e moshës. Bashkia Këlcyrë 2016.....	92
Grafiku 10. Përbërja e njësisë familjare, Bashkia Këlcyrë.....	93
Grafiku 11. Njësitë ekonomike familjare me më shumë se 6 anëtarë, Bashkia Këlcyrë.....	93
Grafiku 12. Dhomat për njësi familjare, Bashkia Këlcyrë.....	94
Grafiku 13. Sipërfaqe e banueshme për banorë, Bashkia Këlcyrë.....	94
Grafiku 14. Njësitë ekonomike familjare që kanë banesën në pronësi, Bashkia Këlcyrë.....	95
Grafiku 15. Nivelet maksimale kronologjike të vrotuara - Permet (Burimi: Kolaneci & Mato, 2015).....	98
Grafiku 16. Përqendrimi i OCP në mostrat e marra në lumin Vjosa.....	106

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Etapat kryesore në procesin e VNM-së.....	17
Tabela 2. Dokumentat Strategjike të Zhvillimit të Vendit që lidhen me PPV-në të shqyrtuara gjatë VSM.....	35
Tabela 3. Të dhënat klimaterike për Këlcyrën dhe Ballabanin.....	46
Tabela 4. Parametrat gjeoteknike mesatarë të shkëmbinjve.....	62
Tabela 5. Parametrat gjeoteknike mesatarë të shkëmbinjve.....	64
Tabela 6. Parametrat gjeoteknike të dherave.....	67
Tabela 7. Sasia e CO ₂ të emetuar për çdo njësi administrative në Bashkinë Këlcyrë.....	72
Tabela 8. Vlerat e rrezikut sizmik (PGA dhe SA (g)) për Bashkinë Këlcyrë me probabilitet 10% /10 vjet (me periudhë përsëritjeje 95 vjet) dhe probabilitet 10%/50 vjet (me periudhë përsëritjeje 475 vjet), në truall shkëmbor.....	74
Tabela 9. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperaturës.....	85
Tabela 10. Shpërndarja e Popullsisë. Bashkia Këlcyrë.....	88
Tabela 11. Nivelet e Vjosës me periudhë përsëritjeje të ndryshme, Permet (Burimi: Kolaneci & Mato, 2015).....	99
Tabela 12. HEC-e të planifikuara për tu ndërtuar në lumin Vjosa dhe Tributaret e tij (Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit).....	103
Tabela 13. Sipërfaqet e sistemeve dhe përdorimit të tokës.....	119
Tabela 14. Analiza SWOT për Bashkinë Këlcyrë.....	121
Tabela 15. Lidhja mes sektorëve të mjedisit dhe objektivave mjedisore si dhe dokumentet përkatës të planeve, programeve apo politikave mjedisore.....	139



Tabela 16. Ndikimet mjedisore të mundshme nga zbatimi i Planit.....	146
Tabela 17. Treguesit/Elementët e Vlerësimit të Ndikimit	148
Tabela 18. Objektivat mjedisore dhe kodifikimi.....	149
Tabela 19. Peshat specifike të elementëve/kritereve të vlerësimit	150
Tabela 20. Pikët e grumbulluara nga 6 elementët/kriteret për ndikimin e projektit për OM2 (Ajër)(Shembull)	151
Tabela 21. Vlerësimi sasior, konvencional dhe cilësor i ndikimit në mjedis.....	151
Tabela 22. Konvertimi i pikëve të ndikimit të projektit në pikë përputhshmërie.....	152
Tabela 23. Përputhshmëria e shprehur në vlera numerike dhe vlerësimi përkatës	152
Tabela 24. Shembull i vlerësimit të përputhshmërisë së OP-ve me OM-të.....	153
Tabela 25. Objektivat dhe programet e Planit (Burimi: Bashkia Këlcyrë dhe Atelier4)	157
Tabela 26. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.S. 1: Orientimi i ekonomisë drejt filerave bujqësore, blegtorale, si dhe turizmit.....	159
Tabela 27. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.S.2: Ristrukturimi dhe profilizimi i vendbanimeve si dhe turizmit.....	161
Tabela 28. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.S.3: Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit e peizazhit	163
Tabela 29. Përputhshmëria e objektivave mjedisore me Objektivat e Planit.....	166
Tabela 30. Opsionet e grumbullimit dhe transportimit të ndarë të mbetjeve (GTN)	190
Tabela 31. Programi i monitorimit të mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së Këlcyrë.....	198
Tabela 32. Përputhshmëria e objektivave mjedisore me Objektivat e Planit.....	235



RAPORT I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR

I. HYRJJE

Reforma territoriale dhe Ligji Nr. 115/2015, datë 31.07.2014, "Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" e ka ridimensionuar madhësinë dhe rolin e bashkive. Ky organizim i ri territorial synon fuqizimin e bashkisë, duke rritur kapacitetin për të ofruar shërbime të një cilësie të lartë për qytetarët dhe duke rritur efikasitetin e menaxhimit të burimeve të tyre. Njëkohësisht synohet rritja e efikasitetit administrativ, profesional dhe teknik të qeverisjes vendore për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët dhe në mënyrë më moderne.

Bashkia e Këlcyrës ndodhet në Qarkun e Gjirokastrës. Territori i bashkisë shtrihet në pjesën juglindore të vendit tonë dhe kufizohet në veri me bashkinë Poliçan, në lindje me bashkinë Skrapar, në jug me bashkinë Përmet dhe Libohovë dhe në perëndim me bashkinë Tepelenë dhe Memaliaj. Qendra e bashkisë është qyteti i Këlcyrës të cilit i bashkohen Ballabani, Suka dhe Dëshnica. Gjithsej, bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra. Njësitë administrative rurale karakterizohen nga një numër shumë i lartë i fshatrave që grupojnë, numër ky që varion në 14-15. Qyteti i Këlcyrës gjithashtu përfshin 5 fshatra. Territori i bashkisë Këlcyrë është kryesisht me



karakter kodrinoro-malor, i shtrirë në lartësinë 230m deri në 1100 m mbi nivelin e detit, midis vargmaleve Trebeshinë-Dhëmbel dhe malit të Qarrishtës. Gjithashtu, territori përshkohet nga dy lumenj, i Vjosës dhe i Dëshnicës, rrjedha e të cilave krijon dy lugina të ngushta, ku gjendet një sipërfaqe e konsiderueshme tokë bujqësore. Sipërfaqja e bashkisë është 304.6 km² dhe dendësia e popullsisë është 11.6 banorë/km². Njësia administrative Dëshnicë ka sipërfaqen më të madhe, 93 km². Njësitë Sukë dhe Ballaban kanë sipërfaqe pak më të vogël se Dëshnica.

Një ndër sfidat me të cilat përballlet bashkia e Këlcyrës është territori dhe zhvillimi i tij i qëndrueshëm. Territori i bashkisë është kompleks dhe sfidat me të cilat përballlet Bashkia janë të shumëllojshme. Bashkia duhet të zhvillojë "mjete" nëpërmjet të cilave të lexojë dhe të kuptojë territoret e reja nën administrim e saj dhe nëpërmjet këtyre mjeteve të zhvillojë strategjinë që do ta ndihmonte të operojë për t'iu përgjigjur sfidave të shumta të territorit.

Me gjithë ekzistencën e disa planeve, të bashkisë Këlcyrë ose të komunave të vecanta orientimi i zhvillimit të Këlcyrës për të siguruar shërbime efektive (dhe funksionale), zhvillimin e qëndrueshëm dhe qëndrueshmërisë së aspekteve mjedisore ka qenë i pamjaftueshëm dhe larg niveleve të planifikuara apo të kërkuara. Planet e deritanishme nuk i përgjigjen nevojave hapësinore dhe kërkesave të zhvillimit ekonomik të Bashkisë të Këlcyrës, për me tepër në kushtet e organizimit të ri të bashkisë. Planet e pjesshme, megjithëse kanë kufizuar pjesërisht zhvillimet informale urbane, ato nuk kanë ndaluar reduktimin e hapësirave publike nga urbanizimi ose të sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara.

Bazuar në nevojën për orientim të zhvillimit të Bashkisë së zgjeruar të Këlcyrës, Këshilli Bashkiak vendosi të miratojë nismën për hartimin e planit të përgjithshëm vendor (PPV) të Bashkisë Këlcyrë. Ky plan duhet të zhvillohet në përputhje me qëllimet specifike strategjike që synon të përmbushë Plani i Përgjithshëm Kombëtar dhe në harmoni me parimet e planifikimit të tokës.

Nisur nga ndikimet e pritshme në mjedis dhe në burimet natyrore, Ligji Nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 507, datë 10.6.2015 "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor" përcaktojnë qartë që "Strategjitë, planet, programet dhe dokumentet e tjera të planifikimit, që janë subjekt i legjislationit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i nënshtrohen Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

"Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një proces sistematik, i cili vlerëson pasojat mjedisore të një plani të propozuar për zbatim, në mënyrë që të sigurohet se këto pasoja mjedisore janë adresuar plotësisht nga fazat e hershme të vendimmarrjes, përveç konsideratave ekonomike dhe sociale. VSM-ja në planifikimin hapësinor duhet të paraqesë informacion mbi këto ndikime mjedisore, ekzistenca dhe pasojat e të cilit nuk janë definuar në mënyrë specifike. Në këtë mënyrë VSM-ja në planifikimin hapësinor mund të kontribuojë në përmirësimin e procesit të planifikimit dhe vendimmarrjen, pasi ai është një vlerësim gjithëpërfshirës, sistematik dhe transparent i aspekteve mjedisore, sociale dhe ekonomike, si dhe implikimet në planifikim.



II. PROCESI I HARTIMIT TË VSM-së

2.1. PËRKUFIZIMI I VSM-së

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendim-marrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor mund të kuptohet si *një proces sistematik i cili parashikon dhe vlerëson efektet e mundshme mjedisore gjatë hartimit të një plani apo programi, me qëllim adresimin e këtyre efekteve në mënyrë të përshtatshme që në fazat më të hershme të vendim- marrjes.*

Qëllimi i VSM-së mund të përkufizohet si garantimi që konsideratat mjedisore informojnë dhe integrohen në vendim-marrjen strategjike në mbështetje të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm nga këndvështrimi mjedisor. Më konkretisht, procesi i VSM-së mbështet autoritetet përgjegjëse për planet dhe programet, si dhe vendim-marrësit, që të marrin në konsideratë:

- ↓ Tendencat kryesore mjedisore, potencialet dhe shqetësimet që mund të prekin apo mund të preken nga plani apo programi;
- ↓ Objektivat dhe indikatorët mjedisore që janë në përputhje me planin apo programin;
- ↓ Efektet e mundshme dhe të konsiderueshme mjedisore të opsioneve të propozuara dhe të zbatimit të planit apo programit;
- ↓ Masat për të shmangur, zvogëluar apo zbutur efektet negative dhe ato për të rritur e përforcuar efektet pozitive;
- ↓ Pikëpamje, sugjerime dhe informacion nga autoritetet përkatëse, publiku dhe – sipas rastit-vendet fqinje që preken nga zbatimi i planit apo programit.

Në përgjithësi, VSM-ja aplikohet për plane, programe, politika dhe dokumente të tjerë me natyrë strategjike (përfshirë mundësisht edhe dokumentet ligjore).

2.2. KUADRI LIGJOR PËR VSM-të

2.2.1. Konventat/ marrëveshjet ndërkombëtare

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një nga metodat bashkëkohore relativisht të reja të vlerësimit mjedisor. Koncepti i vlerësimit strategjik mjedisor e ka origjinën nga planet rajonale të zhvillimit dhe përdorimit të tokës. Në vitin 1981 Departamenti Amerikan i Zhvillimit Urban hodhi hapat e para në formëzimin e këtij koncepti me anë të miratimit të Udhëzimit të Vlerësimit të Ndikimit. Ndërkohë në Europë hapat e para u hodhën nga Konventa e Espoos "Për vlerësimin e ndikimeve mjedisore





ndërkufitare¹ në vitin 1981, në zbatim të të cilës në vitin 2003 u miratua edhe Protokoli i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (Kiev 2003¹). Protokoli synon që:

...të vendosë qartësisht dhe me transparencë procedurat për konsiderimin e shëndetit dhe manaxhimin e integruar të çështjeve mjedisore për plane të zhvillimit, programeve dhe legjislacionit, në plan kombëtar, në sektorë të tillë që shkaktojnë ndotje mjedisore si bujqësia, energjia, transporti, zhvillimi rajonal, përdorimi i tokës, manaxhimi i mbetjeve ose ujërave"

Në këtë kontekst Komisioni Europian mbas 11 vjet diskutimesh miratoi në vitin 2001 Direktivën 2001/42² "Mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara mbi mjedisin" e cila u bë e detyrueshme brenda vitit 2004 për të gjitha vendet e BE. Me kalimin e viteve, VSM është pranuar si një formë e përshtatshme e vlerësimit mjedisor që ndihmon vendimmarrësit gjatë proceseve planifikuese. Kjo metodë vlerësimi tashmë po gjen përhapje të gjerë në shumë vende të botës të cilët e kanë përfshirë në kuadrin e tyre të standarteve të vendimmarrjes.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një proces sistematik që synon të sigurojë që aspektet mjedisore integrohen dhe merren në konsideratë gjatë fazës së planifikimit strategjik dhe vendimmarrjes. Në terma të përgjithshëm planet dhe programet ku aplikohet VSM janë synime strategjike dhe vizionare të cilët qeveria synon t'i verë në zbatim në një sektor të caktuar. Një kontribut i rëndësishëm i VSM është dhe transparencja që ajo synon të nxisë gjatë gjithë procesit dhe deri në vendimmarrje duke u përpjekur të mbledhë dhe demostrojë fakte që lidhen me planin e propozuar dhe objektivat që ai synon, ndërthurjen e tij me planet e tjera ekzistuese duke influencuar deri në nivel projekti individual.

Me kalimin e viteve, Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) u shndërrua në një formë të vlerësimit mjedisor e cila ndihmon drejtuesit dhe menaxherët në hartimin e politikave, planeve dhe programeve në mënyrë të tillë që integrojnë problemet e mbrojtjes së mjedisit në politika, programe dhe plane në mënyrë që implemetimi i tyre të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm.

Gjithsesi më e saktë është të thuhet se VSM është një nga instrumentet e vlerësimit të impakteve sepse natyra e çështjeve që merr në konsideratë e kapërcen fushën e mjedisit. Ajo është pranuar si një grup instrumentash që i korrespondon vendimeve të niveleve nga politikat e deri te programet.

Direktiva përkatëse e BE-s kërkon Vlerësimin Strategjik Mjedisor për plane dhe programe në sektorë të tillë si bujqësia, pyjet, peshkimi, energjia, industria, transporti, menaxhimi i mbetjeve, telekomunikacioni, turizmi, planifikimi i qyteteve dhe vendeve, si dhe ato plane e programe që përcaktojnë kuadrin e zhvillimeve të ardhshëm për projektet e listuara në Shtojcat I dhe II të Direktivës 85/337/EEC "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të veçanta".

¹ Protocol on Strategic Environmental Assessment - unece :

<http://www.unece.org/env/eia/documents/legaltexts/protocolenglish.pdf>

² Strategic Environmental Assessment - SEA - Environment: <http://ec.europa.eu/environment/eia/sea-legalcontext.htm>





Shqipëria ka ratifikuar disa konventa e protokolle mjedisore të cilat krahas forcimit institucional dhe përmirësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor ndikojnë në përmirësimin e manaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit:

- ✚ Konventa e Bernes; "Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës" Ligji Nr. 8294, datë 02.03.1998.
- ✚ Konventa e Barcelonës; "Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të detit Mesdhe". Ligji Nr. 8690, datë 16.11.2000 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Barcelonës si dhe të 6 protokolleve shoqëruese".
- ✚ Konventa e Bazelit; "Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre". Ligji Nr. 8216, datë 13.05.1997.
- ✚ Konventa e Vjenës; "Për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit" dhe Protokollit i Montrealit "Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit". Ligji Nr. 8463, datë 10.03.1999.
- ✚ Konventa e Aarhus-it; "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit". Ligji Nr. 8672, datë 26.10.2000.
- ✚ Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike, Tetor 1994.
- ✚ Konventa e Kombeve të Bashkuara për Biodiversitetin, Janar 1994.
- ✚ Konventa për Mbrojtjen e Mjedisit Detar dhe zonës bregdetare të detit Mesdhe.
- ✚ Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër të mjedisit natyror të Europës.
- ✚ Konventa për mbrojtjen e specieve shtegëtuese të kafshëve të egra.
- ✚ Konventa për ndotjen atmosferike në distanca të mëdha.
- ✚ Konventa e mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre, 22 Mars 1989.
- ✚ Konventa e Stokholmit; "Mbi ndotësit organike të qëndrueshem", Ligji Nr. 9263, datë 29.07.2004.

2.2.2. Legjislacioni Shqiptar

Në Nenin 59 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë shkruhet se: "Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësimin e nismes dhe të përgjegjësisë private, synon (1) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, dhe (2) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.. Nisur nga kompleksiteti i tyre, çështjet mjedisore synohet të përfshihen në të gjitha Planet Lokale e Rajonale të Veprimit, Strategjite dhe Programet Sektoriale dhe Strategjite Kombetare.

Ligji mjedisor kryesor është **Ligji Nr. 10431, datë 9 Qershor 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"**. Ky Ligj përcakton politikat kombëtare dhe vendore për mbrojtjen e mjedisit, kërkesat për përgatitjen e vlerësimeve të ndikimit mbi mjedisin dhe vlerësimin strategjik mjedisor, kërkesat për dhënien e lejeve veprimtarive që ndikojnë mbi mjedisin, parandalimin dhe pakësimin e ndotjes së mjedisit, normat dhe standartet mjedisore, monitorimin dhe kontrollin mjedisor, detyrat e organëve shtetërore në lidhje me çështjet mjedisore, rolin e publikut dhe sanksionet e përcaktuara në rast të shkeljes të ligjit. Ligji përcakton objektivat e mëposhtme të mbrojtjes së mjedisit:





- ✦ parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- ✦ ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- ✦ ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrjen e publikut;
- ✦ përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj; ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror; dhe
- ✦ mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

Ligji Nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" ka për qëllim të sigurojë mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit, miratimit, rishikimit, ndryshimit ose modifikimit të planeve a programeve me pasojë të mundshme negative në mjedis. Ligji përcakton institucionet dhe autoritete përkatëse, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe rregullat e procedurës për kryerjen e Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Ligji është përafëruar me Direktivën 2001/42/KE, datë 27 qershor 2001


Sipas këtij ligji, kur gjykohet se një plan ose program i propozuar mund të ketë pasojë të rëndësishme në mjedisin e një shteti tjetër, atëherë ajo duhet të zbatohen kërkesat e konventës së Kombeve të Bashkuara "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar (ESPOO)" dhe protokollit të saj "Për vlerësimin strategjik mjedisor (KIEV)", në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Ligji Nr. 10440 datë 7/07/2011 për "Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", përcakton rregullat, procedurat dhe afatet për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta të projekteve ose veprimtarive mbi mjedisin. Ligji përcakton hapat e nevojshme për zbatimin e procedurave të VNM: dorëzimin e kërkesës, shqyrtimin paraprak, kriteret e përzgjedhjes dhe klasifikimit, seancat dëgjimore dhe konsultimet publike, aksesin në informacion, detyrat dhe të drejtat e organëve të tjera. Ligji përcakton gjithashtu listën e veprimtarive që duhet të jenë objekt i procesit të Thelluar dhe atij Paraprak të VNM.

Ligji i lart-përmendur nënvizon se qëllimi i Vlerësimit Mjedisor është të sigurojë: *"Një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim dhe garantimin e një procesi të hapur vendim marrjeje gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve në mjedis në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të".* Procesi i vlerësimit duhet të jetë i përgjithshëm, i integruar, në kohë, i hapur dhe të realizohet në mënyrë të paanshme nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore dhe vendore, publikut, si edhe organizatave mjedisore jo fitim prurëse, zhvilluesve të projekteve si edhe të personave fizikë dhe juridikë të specializuar në këtë fushë, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e ndikimit mbi mjedis.

Disa nene të këtij ligji janë ndryshuar nëpërmjet Ligjit Nr. 12/2015 për disa ndryshime në ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", ndryshime këto që kane hyrë në fuqi më 1 Shtator 2015.

Ligji Nr. 81/2017, datë 18.05.2017 "Për Zonat e Mbrojtura" ka për objekt shpalljen, ruajtjen, administrimin, menaxhimin, përdorimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura mjedisore dhe të



burimeve të tyre natyrore e biologjike, në bazë të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm, për të garantuar përmbushjen e funksioneve mjedisore, ekonomike, sociale e kulturore, në interes të të gjithë shoqërisë, si dhe përcaktimin e përgjegjësi të institucioneve publike dhe personave fizikë/juridikë privatë për ruajtjen dhe administrimin e qëndrueshëm të tyre.

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mbrojtje të veçantë të zonave të mbrojtura mjedisore dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to.

Synimi kryesor i Ligjit Nr. 9587, datë 20.7.2006, "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit" ndryshuar me ligjin Nr. 68/2014, datë 03.07.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006" është të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik. Gjithashtu ligji synon rregullimin i përdorimit të qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritetit të elementëve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Ligji Nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" përbën një hap konkret dhe të rëndësishëm për vlerësimin strategjik mjedisor të instrumentave planifikues. Një ndër qëllimet e këtij ligji është: "të nxitë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike, zonave të mbrojtura, monumenteve të natyrës, zonave të ndjeshme mjedisore dhe të peizazhit".


Planifikimi dhe zhvillimi i territorit bazohet në disa parime, ndërmjet të cilëve mund të përmenden:

- ↓ zhvillimi duhet të jetë i qëndrueshëm dhe të garantojë nevojat e brezave për barazi sociale, zhvillim ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit;
- ↓ harmonizimi me qasjen e Bashkimit Europian në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, si edhe lidhur me kriteret mjedisore, ruajtjes së biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura.

Kjo do të thotë që vlerësimi strategjik mjedisor shtrihet edhe në nivel dokumentash të politikës shtetërore të planifikimit ndërsektorial.

Ligji Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" përcakton funksionet dhe detyrat e bashkive, pas ligjit të ndarjes së re administrative në disa drejtime që lidhen me parimet bazë të përgatitjes së Planeve të Përgjithshme Vendore (PPV):

- ↓ Në nenin 23 (Funksionet e Bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike) thuhet që Bashkia është përgjegjëse për
 - ↓ prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm,
 - ↓ mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura,
 - ↓ mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara dhe
 - ↓ planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- ↓ Në nenin 26 (Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit) ndër të tjera nënvizohet që bashkia ka këto funksione kryesore:
 - ↓ sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja;





- ✚ sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike; dhe
- ✚ zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.
- ✚ Në nenin 27 (Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit) si funksione të saj përcaktohen:
 - ✚ Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
 - ✚ administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
 - ✚ krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi;
 - ✚ krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor;
 - ✚ administrimi i fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi; dhe
 - ✚ mbrojtja e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.

Përpos sa më lart, kuadri ligjor në përgatitjen e kësaj VSM-je përfshin edhe legjislacionin e mëposhtëm:

Ligje:

Ligji Nr. 162/2014, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis "

Ligji Nr.111/2012, datë 15.12.2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"

Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për Vlerësimin dhe Administrimin e Zhurmës në Mjedis".

Ligji Nr. 9791, datë 23.07.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9385 "Për Pyjet dhe Sherbimin Pyjor"

Ligji Nr. 9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Sherbimin Pyjor"

Ligji Nr. 9244, datë 17.06.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore".

Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për Trajtimin Mjedisor të Ujrave të Ndotura.

Vendime të Këshillit të Ministrave:


V.K.M Nr. 620, datë 7.7.2015 "Për miratimin e rregullave, përgjegjësisve dhe procedurave të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkufitar"

V.K.M Nr. 507, datë 10.6.2015 "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor";

V.K.M Nr. 219, datë 11.3.2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor".

V.K.M Nr. 641, datë 01.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin tranzit të mbetjeve jo të rrezikshme dhe mbetjeve inerte."

V.K.M Nr. 587, datë 7.07.2010 "Mbi monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbanë dhe turistike"



2.3. PARIMET E HARTIMIT TË VSM-së

Ky raport i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Këlcyrë mbështetet në parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit:

1. Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
2. Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
3. Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
4. Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
5. Parimi i qasjes së integruar
6. Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
7. Parimi "Ndotësi paguan"
8. Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
9. Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

2.4. METODOLOGJIA DHE PROCËSI I HARTIMIT TË VSM-së

2.4.1. Etapat kryesore në procesin e hartimit të VSM-së

Bazuar në Ligjin Nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" dhe aktet e tjera nënligjore (V.K.M Nr. 219, datë 11.3.2015 "Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"; V.K.M Nr. 507, datë 10.6.2015 "Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor"; dhe V.K.M Nr. 620, datë 7.7.2015 "Për miratimin e rregullave, përgjegjësisë dhe procedurave të detajuara për vlerësimin strategjik mjedisor në kontekstin ndërkufitar"), procesi i VNM-së kalon nëpër 5 etapa. Këto etapa janë paraqitur në detaje në Tabelën Nr. 1.

Tabela 1. Etapat kryesore në procesin e VNM-së

Nr.	Etapa	Detyra	Objekti
1	Përcaktimi i nevojës për VSM, gjendjes, qëllimit përmbajtjes dhe objektivave, të VSM-së	Grumbullimi i informacionit mbi gjendjen ekzistuese Identifikimi i problemeve mjedisore Identifikimi i planeve dhe programeve të tjerë që mund të kenë ndikim në të si dhe objektivave për mbrojtjen e mjedisit Zhvillimi i objektivave të VSM Ballafaqimi me qëllimin e VSM-së	Ndërtimi i një baze të dhënash mbi problemet mjedisore, parashikimin e efekteve dhe monitorimin që mund të ndihmojë në zhvillimin e objektivave të VSM-së Të ndihmojë në përcaktimin e fokusit të VSM dhe fazave të mëtejshme, përfshirë analizën e informacionit mbi gjendjen ekzistuese, parashikimin e ndikimeve dhe monitorimin e tyre Të përcaktohet si plani apo programi ndikohet nga faktorët e jashtëm, në mënyrë që të propozohet mënyra e adresimit të kufizimeve, dhe të ndihmojë në përcaktimin e objektivave të VSM-së Të sigurojë një mënyrë për vlerësimin e performancës së planit apo programit, si dhe alternativave përkatëse Të sigurojë që VSM merr në shqyrtim të gjitha ndikimet e mundshme të rëndësishme në mjedis të planit apo

2	Zhvillimi dhe përmirësimi i alternativave dhe vlerësimi i efekteve	Krahasimi i objektivave të planit ose programit me objektivat e VSM-së	programit Të identifikojë përpueshmërinë ndërmjet objektivave të planit ose programit dhe atyre të VSM-së dhe të ndihmojë në zhvillimin e alternativave përkatëse
		Zhvillimi i alternativave strategjike	Të zhvillojë dhe përmirësojë alternativat strategjike
		Parashikimi i efekteve të planit ose programit, përfshirë alternativat	Të parashikojë efektet e pritshme të konsiderueshme mjedisore të planit ose programit dhe alternativave përkatëse
		Vlerësimi i efekteve të planit ose programit, përfshirë alternativat	Të vlerësojë efektet e parashikuara të planit ose programit dhe alternativave përkatëse dhe të ndihmojë në përmirësimin e tij
		Zvogëlimi i efekteve të ndryshme	Të sigurojë që janë identifikuar efektet e ndryshme të mundshme dhe janë konsideruar masat zbutëse përkatëse
		Propozimi i masave për monitorimin e ndikimeve mjedisore të planit apo programit gjatë zbatimit të tij	Të detajojë procedurën e vlerësimit të performancës mjedisore të planit ose programit
3	Përgatitja e Raportit Mjedisor	Përgatitja e Raportit Mjedisor	Të paraqesë efektet e mundshme në mjedis të planit ose programit, përfshirë alternativat përkatëse, në një mënyrë të përshtatshme për konsultimin me publikun dhe përdorim nga vendim-marrësit
4	Konsultimi i draft planit apo programit dhe Raportit Mjedisor	Konsultimi me publikun dhe palët e interesuara i draft planit apo programit dhe raportit mjedisor	T'i japë mundësi publikut dhe palëve të interesuara të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjet e evidentuara në raportin mjedisor duke e marrë atë si pikë referimi për komentet e tyre në lidhje me planin apo programin. Të mbledhë informacion shtesë nëpërmjet mendimeve dhe shqetësimeve të publikut.
		Vlerësimi i ndryshimeve të rëndësishme	Të sigurojë që ndërthurjet mjedisore të çdo lloji ndryshimi të rëndësishëm të draft planit apo programit në këtë fazë janë vlerësuar dhe janë marrë në shqyrtim
		Marrja e vendimeve dhe dhënia e informacionit	Të japë informacion për mënyrën se si raporti mjedisor dhe opinionet e të konsultuarve janë marrë në konsideratë për miratimin e variantit final të planit apo programit
5	Monitorimi i ndikimeve të rëndësishme në mjedis të zbatimit të planit apo programit	Zhvillimi i kërkesave dhe metodave të monitorimit	Të vrojtojë ndikimet në mjedis të zbatimit të planit apo programit për të vlerësuar nëse ata përputhen me parashikimin; të ndihmojë në identifikimin e ndikimeve të ndryshme
		Përgjigja ndaj ndikimeve të ndryshme	Të përgatisë planin e nevojshëm të veprimit për efektet e ndryshme të identifikuara

2.4.2. Mbledhja e të dhënave dhe analiza e tyre

Për hartimin e raportit të VSM-së janë përdorur burime të ndryshme të dhënash. Përpos Planit të Përgjithshëm Vendor të propozuar të Bashkisë Këlcyrë dhe Strategjisë së Zhvillimit, në dokumentin e hartuar janë përdorur:

- ✦ Informacionet dhe të dhënat e ofruara nga strukturat e Bashkisë Këlcyrë.
- ✦ Raportet vjetore të Gjendjes së Mjedisit, për gatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
- ✦ Të dhëna të përfituara nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.
- ✦ Të dhëna të përfituara nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.
- ✦ Të dhëna të përfituara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- ✦ Të dhëna të përfituara nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Zhvillimit Rural
- ✦ Të dhëna të ofruara nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
- ✦ Të dhëna nga literatura shkencore mbi zonën e Këlcyrë.

Informacioni përfshin të dhëna si:

- ✦ Relievi, gjeologjia dhe gjeomorfologjia;
- ✦ Hidrologjia, të dhëna klimatike dhe burimet ujore;
- ✦ Sistemet e Territorit
- ✦ Biodiversitetin dhe zonat e mbrojtura, peizazhi, toka bujqësore, pyjet.
- ✦ Kushtet sizmike e tektonike të rajonit;
- ✦ Burimet territoriale dhe ekonomike;
- ✦ Historia, monumentet e kulturës, arkeologjia;
- ✦ Popullsia (gjendja ekzistuese dhe tendencat e ndryshimeve);
- ✦ Profili ekonomik dhe turizmi;
- ✦ Infrastruktura (rrjeti rrugor, ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefoni);
- ✦ Cilësia e Ajrit,
- ✦ Cilësia e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore
- ✦ Menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura

Këto të dhëna u verifikuan dhe u pasuruan gjatë vizitave në terren. Gjatë këtyre vizitave në terren u verifikua gjithashtu edhe sistemi i aktual i menaxhimit të ujërave të zeza dhe ndikimi i tij në mjedisin ujor e tokësor dhe menaxhimi i mbetjeve urbane.

2.4.3. Përmbajtja e raportit të VSM-së


Qëllimi i raportit të VSM-së është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i strategjisë, planit ose programit, të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore si dhe propozimi i masave për menjanimin dhe zbutjen e ndikimeve negative nga zhvillimi i planit të propozuar.

VSM do të përfshijë pikat e mëposhtme:

- ✦ Një përmbledhje të informacionit për vlerësimin strategjik mjedisor;
- ✦ Përshkrim të objektivave kryesore të strategjisë, planit të përgjithshëm të Bashkisë Këlcyrë;
- ✦ Gjendja e mjedisit në territorin e bashkisë Këlcyrë;
- ✦ Përshkrim të problemeve ekzistuese mjedisore;



- ✦ Përshkrim të objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar, të cilat kanë të bëjnë me strategjinë, planin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- ✦ Përshkrim të ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë jetën e njerëzve, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore, rreziqet mjedisore (tërmetet, përmytjet) dhe kufizimi i tyre;
- ✦ Përshkrim të masave për të parandaluar, reduktuar ose lehtësuar ndikimet negative në mjedis, që mund të rezultojnë nga zbatimi i planit.
- ✦ Përmbledhje për përzgjedhjen e alternativave të shqyrtuara dhe vështirësitë ose mungesën e të dhënave gjatë përpilimit të raportit.
- ✦ Përshkrimin e masave të parashikuara për monitorimin e ndikimeve.




III. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PLANIT

3.1. VIZIONI I ZHVILLIMIT PËR BASHKINË

Bashkia Këlcyrë është e shtrirë në një territor të larmishëm natyror, portë hyrëse në luginën e Vjosës, kullota me vlera të larta në malin e Trebeshinës, toka bujqësore në luginën e Dishnicës, prodhime bujqësore dhe blegtorale, bimë mjekësore e vreshta në kodrina e peizazhe të paprekura natyrore, 'Bashkia e Këlcyrës e ndodhur ndërmjet poleve të zhvillimit të jugut të vendit do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm social ekonomik të territorit, duke u përqendruar në zhvillimin e agri-turizmit dhe bujqësisë, blegtorisë dhe agrobiznesit, e ndikuar nga avantazhet territoriale të vendndodhjes së Bashkisë Këlcyrë.'

"Bashkia e Këlcyrës do të formohet me shërbime publike cilësore dhe infrastrukturë bashkëkohore, që mundëson cilësi të lartë jetese për banorët, duke ngjallur te popullsia e larguar nga zonat rurale dëshirën për t'u kthyer e jetuar mirë".

Në këto potenciale të larmishme të bashkisë, është fokusuar edhe vizioni i zhvillimit. Ky vizion synon evidentimin, ruajtje dhe shfrytëzimi në mënyrën më të mirë i këtyre potencialeve, duke i kthyer këto asete në gjenerim të ardhurash dhe bazë për ekonominë lokale të 15 viteve të ardhshme (Figura 1).







Figura 1. Harta e Vizionit të Zhvillimit të Bashkisë Këlcyrë



3.2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË PËR ZHVILLIMIN E TERRITORIT TË BASHKISË

Realizimi i vizionit të bashkisë kalon në disa halla, të cilat për të mos humbur fokusin duhet të jenë të mirë strukturuara, si në renditje ashtu dhe në shtrirjen kohore. Kështu, vizioni bëhet i zbatueshëm duke përcaktuar objektiva, të cilat detajohen në programe dhe në projekte.

Detajimi i vizionit të Bashkisë Këlcyrë bazohet në objektivat e mëposhtëm:

0.1. Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale dhe turizmit.

Zhvillimi i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregëtimit të vreshtarisë (rrushit) si sektori më tradicional dhe fitimprures në aktivitetet rurale dhe jo vetëm në Rajonin e Këlcyrës (Figura 2).

Rajoni i Këlcyrës, sikurse ai i Përmetit, është i njohur për traditën e kultivimit të vreshtarisë, prodhimit të rrushit për përpunim si nga vreshtat ashtu edhe nga pjergullat, si dhe prodhimtarinë e verës e rakisë. Vreshtaria aktualisht përbën rezervën e zhvillimit prespektiv bujqësor në territorin e Bashkisë edhe për faktin që ky sektor mund të zhvillohet në gjithë territorin e Bashkisë, në zonën fushore, zonën kodrinore e paramalore, ku ka akoma rezerva për shtimin e siperfaqeve të mbjella. Sektori i vreshtarisë, përbën një nga prioritetet e rëndësishme për zhvillimin bujqësor në të ardhmen pothuaj në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë. Sipërfaqet e mbjella me vreshta janë rreth 66 ha, gjithashtu janë rreth 650.000 pjergulla dhe erekë në gjithë territorin me një prodhimtari rreth 1000 ton rrush në vit. Struktura varietore është në përshtatje të terrenit fushor – kodrinor – e para malor. Bliqet e vreshtave familjare, janë të një teknologjie të lartë, me rendimente të kënaqshme. Krahas zhvillimit të vreshtarisë një zhvillim të dukshëm ka marrë edhe përpunimi i rrushit për verë e raki. Kështu në territorin e Bashkisë Këlcyrë ushtrojnë aktivitetin e përpunimit të rrushit për verë e raki 2 punishte të licencuara, si dhe një numër i madh i familjeve që prodhojnë në mënyrë individuale rreth 900 hl verë dhe 30 hl raki. Edhe në të ardhmen ky sektor shikohet si një nga sektorët prioritarë të zhvillimit. Nisur nga struktura e mbjelljeve, prodhimtaria, sipërfaqet e lira bujqësore, tradita, kushtet klimatiko – tokësore, rezulton se ka hapsira të mëdha për zhvillimin e sektorit në strukturë, prodhimtari dhe sidomos në zgjerimin e hallkave jo vetëm të prodhimit por edhe të grumbullimit, magazinimit, përpunimit e tregëtimit të tyre në tregun rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Hartimi dhe zbatimi i një Plani Strategjik në sektorin e frutikulturës në periudhë afatmesme do të zhvillojë këtë sektor drejt pëpunimit dhe komercializimit të prodhimit të frutave të freskëta dhe sidomos të përpunuara e gjysëm përpunuara.

Çështjet që do të duhen të ndiqen në zbatimin e këtij Plani janë:

- ☐ Rritja e prodhimit të rrushit kryesisht në blloqe (dyfishimi e më shumë, nëpërmjet rritjes së sipërfaqes së mbjellë duke siguruar material të bollshëm dhe të certifikuar.
- ☐ Futja e varieteteve të reja të rrushit jo vetëm për përpunim, por edhe për konsum të freskët në tavolinë.
- ☐ Përmirësimi i strukturës varietore dhe teknologjisë së kultivimit, mënyrave të reja të mbajtjes së pemëtoreve dhe trajtimet shkencore në luftë kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve.
- ☐ Përmirësimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës rurale e bujqësore në funksion të prodhimit dhe lëvizjes së prodhimit drejt tregut.
- ☐ Organizimi i grupeve të interesit të prodhuesve dhe përpunuesve të vreshtarisë dhe përpunuesve të verës e rakisë.
- ☐ Përmirësimi i paraqitjes tregtare të produktit, nëpërmjet krijimit të një pike të grumbullimit, magazinimit, ambalazhimit e paketimit të tij në territorin e prodhimit.
- ☐ Sigurimi i investimeve, nëpërmjet granteve, bashkëfinancimeve e krediteve në të gjitha hallkat e prodhimit në fermë infrastrukturë prodhuese e tregëtuese, si dhe infrastrukturë bujqësore e rurale në funksion të tyre.
- ☐ Krijimi i brendit të verës Debinjë, rrush autokton shumë i njohur në krahinën e Këlcyrës.

Zhvillimi i Sektorit të Blegtorisë në territorin e Bashkisë Këlcyrë si i përpunimit të nën produkteve blegtorale kryesisht të qumështit të të imtave.

Sektori i blegtorisë përben një rezervë në rritje për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në fermat e Bashkisë dhe përben peshën më të madhe në ekonominë rurale krahasuar me sektorin bujqësor. Sektori i të imtave është nga sektorët më të zhvilluar dhe tradicionale në territorin e Bashkisë dhe për nga numri zë një vend kryesor në trevat e Jugut të Shqipërisë. Në territorin e Bashkisë mbareshtrohen rreth 48.600 krerë të imta me një prodhim vjetor i qumështit është rreth 5.000 ton, ku qumështi i të imtave zë peshën më të madhe rreth 55 % të prodhimit. Prodhimi qumështit krijon një rezervë të madhe dhe rrit se tepërmi nevojën e përpunimit në të ardhmen. Në territorin e Bashkisë Këlcyrë funksionojnë 8 baxho të liçencuara, të shpërndara në gjithë territorin e Bashkisë. Çështjet kryesore të zhvillimit të këtij sektori janë:

Rritja e prodhimit blegtoral me drejtim prodhim qumështi, drejt strukturave komerciale prodhuese, përpunuese dhe tregtare nëpërmjet zbatimit të planit të zhvillimit strategjik të sektorit të blegtorisë. Rritja e numrit të krerëve kryesisht të imta duke përfutur nga territori i gjerë, kullotat specifike (mali Trebeshinë) dhe kompozicioni i relievit të territorit të Bashkisë. Rritja e prodhimit, veçanërisht nëpërmjet rritjes së rendimentit të prodhimit nëpërmjet aplikimit të metodave bashkëkohore të mbarështrimit.

Çështjet që do të duhen të ndiqen në zbatimin e këtij Plani janë:

- ☐ Rritja e prodhimtarisë së bazës ushqimore për bagëtitë nëpërmjet përmirësimit të aftësive prodhuese të kullotave dhe livadheve si dhe rritjen e rendimenteve të kulturave bujqësore foragjere dhe përmirësimin e teknologjisë së kultivimit.





- ☐ Rritjen e prodhimit blegtoral nëpërmjet përmirësimit racor të bagëtive si dhe rritjes së shërbimeve veterinarë kryesisht të vaksinimeve ndaj sëmundjeve zoonotike.
- ☐ Përmirësimin e paisjeve të grumbullimit të qumështit dhe paisjeve të transportit të tij për të siguruar cilësi të mirë të qumështit për përpunim.
- ☐ Fuqizimi i lidhjeve ndërmjet prodhuesve të ndryshëm të qumështit me përpunuesit e tij.
- ☐ Përmirësimin e procesit teknologjik të përpunimit të qumështit dhe sigurimi i financimeve për ngritjen e dy pikave moderne përpunimi dhe ambientet e ruajtjes, magazinimit e paketimit.
- ☐ Sigurimi i investimeve, bashkëfinancimeve dhe kreditimeve të të gjithë hallkave nga përpunimi deri tek tregëtimi i produkteve blegëtorale.
- ☐ Rritje prej 10 % e sipërfaqeve të kulturave foragjere në zonën fushore.
- ☐ Përmirësimi i teknologjisë së kultivimit të foragjereve dhe rritjes 2 herë të rendimentit të tyre (kryesisht jonxhë dhe misër për silazh).
- ☐ Intensifikimi dhe përmirësimi i livadheve dhe kullotave, kryesisht në zonën kodrinore e malore dhe dyfishimi i kapaciteteve kullosore.
- ☐ Rritja e numrit të krerëve të të imtave duke ju përgjigjur rritjes së kapaciteteve kullosore dhe intensifikimit të kulturave foragjere në zonat kodrinore të Bashkisë.
- ☐ Vaksinimi i të gjithë numrit të krerëve të gjedhëve dhe të imtave për një periudhë 3 vjeçare, kryesisht ndaj brucelozës, si dhe inseminimi artificial.
- ☐ Trainimi i fermerëve me teknikat e reja të kultivimit të foragjereve dhe teknikat bashkëkohore të mbarështimit të bagëtive.
- ☐ Trainimi i fermerëve për të aplikuar për kreditimin e aktivitetit të tyre privat, si blerje të bagëtive, përmirësimi i kushteve stallore, përmirësimin e teknologjive të kultivimit të foragjereve, blerjen e paisjeve të mbajtjes dhe transportimit të qumështit.
- ☐ Organizimi i grupeve të interesit në çdo fshat, si një fazë e parë për krijimin e një shoqate të blegtorisë me bazë Njesie Administrative.
- ☐ Rehabilitimi i skemave të vogla ujitëse me bazë fshati nëpërmjet bashkëpunimit me donatorë publikë dhe të huaj.
- ☐ Rehabilitimi i rrugëve rurale ndërmjet fshatrave dhe lidhjen me rrugë cilësore me rjetin kombëtar të rrugëve nëpërmjet bashkëpunimit me donatorë publikë dhe të huaj.

Ngritja e pikave moderne të grumbullimit të qumështit dhe pikave të tjera thertore moderne brenda standarteve të sigurisë ushqimore, me seksione seleksionimi, paketimi dhe shoqëruar me dhoma frigoriferike cilësore për përmbushjen e ciklit të ruajtjes së vlerave ushqimore sipas standarteve bashkëkohore, është me se e domosdoshme.

Zhvillimi i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregëtimit të bimëve mjeksore eterovajore dhe aromatike

Aktivitetet e prodhimit, grumbullimit, ruajtjes, përpunimit dhe tregëtimit të bimëve mjeksore eterovajore e aromatike, përbëjnë aktivitetet ekonomike të rëndësishme rurale të territorit të Bashkisë Këlcyre. Këto aktivitete përfshijnë grumbullimin e bimëve mjeksore eterovajore dhe aromatike në resurset natyrore të pyjeve dhe kullotave të territorit të Bashkisë. Grumbullohet kryesisht sherebelë, rigon, çaj mali, mollë e egër, juniperus, murriz, trumza, shtogu, sanza, etj. Nisur nga angazhimi i burimeve njerzore (rreth 50 % e popullatës rurale dhe urbane), të ardhurat e krijuara nga tregëtimi i tyre, rezultojnë si sektori më i rëndësishëm ekonomik dhe me prespektivë në të



ardhmen në territorin e Bashkisë. Grumbullohet rreth 200 ton lëndë e thatë në vit, por mundësi, është më e lartë.

Zhvillimi i këtij sektori përbën një nga avantazhet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik në rajon. Nevoja për zhvillimin e një projekti prioritar, në kuadër të një Plani të Investimit Strategjik të këtij sektori i cili të parashikojë të realizojë një zhvillim afatgjatë të sektorit të bimëve mjeksore dhe eterovajore dhe specializimit të grumbulluesve e përpunuesve private në drejtim të prodhimit të produkteve të bimëve mjeksore dhe eterovajore për treg.

Ky plan do të sigurojë brenda një periudhe 5 vjeçare, rritjen dyfish të të ardhurave të familjeve fermerë që do të merren me aktivitetet e bimeve mjeksore dhe të konsolidojnë këto të ardhura për një periudhë afatmesme kohore.

Plani do të konsistojë në ndërhyrje në të gjitha hallkat e filjerës së Grumbullimit – Magazinimit – Ruajtjes – Perpunimit – Amballazhimit – Bredimit – Tregtimit – Eksportimit. Çështjet që do të duhen të ndiqen në zbatimin e këtij Plani janë:

- ☐ Organizimi i grupeve të interesit dhe shoqatave të grumbullimit prodhimit të bimeve mjeksore dhe eterovajore.
- ☐ Permiresimi i teknikave të grumbullimit nepermjet rritjes së dijeve dhe njohurive bashkekohore në trajtimin eficient të bimeve mjeksore dhe eterovajore.
- ☐ Permiresimi i kapaciteteve natyrore dhe rritja e sipërfaqeve të kultivuara të bimeve mjeksore dhe eterovajore (aktualisht nuk kultivohet).
- ☐ Organizimi i mardhenieve kontraktuale të qendrueshme ndermjet perpunuesve dhe grumbulluesve si dhe ndermjet perpunuesve dhe tregëtuesve të bimeve mjeksore dhe eterovajore.
- ☐ Permiresimi i teknologjise së perpunimit nepermjet rritjes së shkallës së investimit dhe kontrollit të cilësise së produktit.
- ☐ Permiresimi dhe rritja e kapaciteteve perpunuese nepermjet shtimit të ambienteve dhe pikave të perpunimit në çdo rreth të rajonit.
- ☐ Permiresimi i teknologjise së marketingut, me mekanizimin e proceseve të prodhimit, perpunimit, seleksionimit, paketimit dhe tregëtimit në rajon.
- ☐ Rritja e shkallës së perpunimit cilesor për prodhimin sipas standarteve në rajon.
- ☐ Krijimi i pikave të kontrollit të cilësise dhe realizimi i standarteve të kerkuara, si dhe krijimi i një "Brand Name" rajonal për produktet cilesore mjaft të kerkuara nga tregu i huaj.

Finalja e ndërhyrjeve për zhvillimin e këtij sektori është ngritja e një pike të përpunimit të esencave dhe të bashkëshoqërohet me një njësi të përgatitjes së çajrave organikë.

Zhvillimi i prodhimit, grumbullimit, ruajtjes, përpunimit dhe tregëtimit të perimeve në zonën fushore dhe perimet e vona në zonën kodrinore – malore

Perimtaria është sektori i rëndësishëm në aktivitetin ekonomik bujqësor, kryesisht për plotësimin e nevojave të popullatës së territorit të Bashkisë, por shumë e rëndësishme është siguri e plotësimi i tregut rajonal me perime sipas konvejerit, ciklit të vonët e të hershme (verore dhe dimërore). Perimet aktualisht zenë shume pak, por me trend rritje (40 ha) me një prodhimtari prej rreth 1000 ton në vit (perime verore dhe dimërore). Hartimi dhe implementimi i një Plani të Investimeve Strategjike, për sektorin perimor duhet të përfshijë mbështetjen dhe zhvillimin e të gjitha hallkave





nga fara e fidani tek produkti i gatshëm i standartizuar, e shoqëruar me rajonizimin dhe specializimin sipas kushteve klimatiko – tokësore e ne baze te avantazhit krahasues te kulturave perimore, kryesisht ne Njesite Administrative fushore e kodrinore.

Plani të synojë përveç teknologjive bashkëkohore të kultivimit edhe organizimin e një skeme të përshtatshme, në kuadër të rritjes së vlerës së produktit, nëpërmjet, seleksionimit, standartizimit, paketimit dhe ruajtjes se perimeve, me qellim rritjen e kohes se perdorimit nga konsumatorët.


Çështjet që do të duhen të ndiqen në zbatimin e këtij Plani janë:

- ☐ Përmirësimi i materialit biologjik, nëpërmjet krijimit të fermave të specializuara në prodhimin dhe riprodhimin e farërave të perimeve në territorin fushor të Bashkisë.
- ☐ Rritja e prodhimit të perimeve në fushë nëpërmjet rritjes së sipërfaqeve të mbjella, përdorimit të teknologjive bashkëkohore, përdorimit efektiv të qarkullimit bujqësor, ujitjes dhe mekanizimit.
- ☐ Përmirësimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës rurale e bujqësore në funksion të rritjes së prodhimit dhe lëvizjes lehtësisht të prodhimit drejt tregut.
- ☐ Përmirësimi i paraqitjes tregtare të perimeve të fresketa, nëpërmjet krijimit të pikave të grumbullimit, magazinimit, ruajtjes, ambalazhimit e paketimit të tij në territorin e Bashkisë.
- ☐ Sigurimi i investimeve, bashkëfinancimeve e kreditimeve në të gjitha hallkat e prodhimit në fermë, infrastrukturë prodhuese e tregëtuese si dhe infrastrukturës bujqësore e rurale në funksion të tyre.
- ☐ Trainimi i fermerëve jo vetëm me teknologjinë e kultivimit por edhe me luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve, mënyrat e vjeljes, magazinimit, ruajtjes, planeve të biznesit dhe aplikimit te kredimarrjes së tyre.
- ☐ Krijimi i grupeve të interesit sipas fshatrave dhe kulturave specifike dhe organizimi i një shoqate të prodhuesve të perimeve në kuadër rajonal.
- ☐ Ngritja e një pike për përpunimin (për perime të regjiura kryesisht domate, trangull, spec e lakër që përbëjnë pjesë më të madhe prodhuese të perimeve në rajon) të perimeve shoqëruar me ambiente e paketimit dhe ruajtjes së perimeve të përpunuara, për të rritur cilësitë tregtare të tyre në treg.
- ☐ Rehabilitimi i rrugëve rurale për lidhjen midis fshatrave, me qendrën e grumbullimit e përpunimit si dhe me tregun rajonal.
- ☐ Rehabilitimin e skemave të vogla ujtese dhe aplikimi i ujitjes individuale në territore jashtë skemave të ujitjes.

Objekti final do të jetë rritja e të ardhurave të familjeve fermere të territorit të bashkisë nëpërmjet zhvillimit të një zinxhiri të hallkave të prodhimit, përpunimit dhe tregëtimit të perimeve të fresketa për treg.

Turizmi

Turizmi në territorin e bashkisë shihet si një sektor i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm të bashkisë. Duke konsideruar karakterin rural të territorit, agriturizmi apo turizmi malor, shihen si mundësi për të zhvilluar më tej turizmin në zonë. Prania e lartë e tokave bujqësore dhe e zonave natyrore, fton të gjithë të gjithë miqtë e natyrës, për të zbuluar më tej atë çfarë ofron ky territor. Për të patur një shrytëzim të plotë të pasurive natyrore është e rëndësishme që zona të promovohet,



gjithmonë duke ruajtur vlerat mjedisore. Gjithashtu, zhvillimet që propozohen për këto zona janë me ndikim të ulët në mjedis.

O.2. Ristrukturimi dhe profilizimi i vendbanimeve

Qyteti i Këlcyrës dhe fshatrat e territorit të bashkisë, bazuar në vendndodhjen e tyre në territor kanë karakteristika të ndryshme, vendbanimet e gjendura në zonat fushore apo malore, duke ndryshuar edhe nga zhvillimet bujqësore apo blegtorale pranë tyre.

Është e rëndësishme që kushtet e këtyre vendbanimeve të përmirësohen, duke i sistemuar këto struktura dhe vendosur rregulla specifike bazuar në zonën ku gjenden.

Qyteti - me rëndësi të fuqizohet dhe përmirësohen kushtet e vendbanimeve dhe shërbimeve duke i strukturuar vendbanimet, zhvilluar infrastrukturën e transportit rrugor dhe sigurimin e lëvizshmërisë për të gjithë qytetarët.

Fshatrat - zona të mirëfillta rurale ku nxitet projektimi i hapësirave publike dhe objekteve bazuar në elemente të traditës për të theksuar karakterin dhe për t'u orientuar drejt një turizmi rural e agri turizmi. Në fshatra do të aplikohen programe mbështetëse për të nxitur rimëkëmbjen e ekonomisë. Lidhjet infrastrukturore ekzistuese do të përmirësohen dhe do të krijohen të reja, në shërbim të zhvillimit ku orientohen. Këto zona do të aksesohen nga transporti publik dhe hapësirat publike të qendrave të këtyre fshatrave do të sistemohen duke marrë karakterin e shesheve të fshatit si pika takimi të banorëve.

Alternativa përdorimi të vendbanimeve duke i shërbyer jo vetëm banorëve në bazë të kërkesave të tyre, mirëpo edhe duke i shërbyer nevojave të vizitorëve, bën të mundur krijimin e një hallke të zinxhirit të mirëfunksionimit në tërësi të territorit të bashkisë (Figura 3).

Krijimi dhe integrimi i sistemit të komunikimit, rritja në standarte dhe cilësi e strukturave dhe shërbimeve parashkollë, arsimore, shëndetësore e sociale, krijimin e kushteve për zhvillimin e jetës social-kulturore, rekreative dhe sportive synohen të realizohen në të gjithë territorin e bashkisë. Ristrukturimi i shërbimeve administrative për fshatrat është kryesor për të patur një shpërndarje dhe mundësi ofrimi të shërbimeve të plota për banorët e njësive administrative, si dhe për vizitorët e mundshëm në territor, duke ofruar orientime dhe shërbime në ndihmë të tyre.

Po ashtu, krijimi i strukturave dhe përmirësimi i shërbimeve në funksion të arsimit, kulturës, sport ndikon drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetesë së banorëve në territorin e bashkisë. Gjithashtu, është e domosdoshme për këto zona, duke marrë në konsideratë numrin e banorëve në fshatra, krijimin e strukturave dhe shërbimeve në funksion të shëndetësisë dhe përkrahjes sociale, të cilat plotësojnë nevojat e këtyre banorëve, për të patur një jetesë brenda standardeve.

Për të përmbushur një funksionim sa më të plotë për të gjitha strukturat nevojiten staf i specializuar për të plotësuar të gjitha nevojat e banorëve të zonës. Për këtë nevojiten njerëz të kualifikuar për t'i ofruar këto shërbime duke plotësuar nevojat e të gjithëve.



12345678910111213141516171819202122232425262728293031323334353637383940414243444546474849505152535455565758596061626364656667686970717273747576777879808182838485868788899091929394959697989910010110210310410510610710810911011111211311411511611711811912012112212312412512612712812913013113213313413513613713813914014114214314414514614714814915015115215315415515615715815916016116216316416516616716816917017117217317417517617717817918018118218318418518618718818919019119219319419519619719819920020120220320420520620720820921021121221321421521621721821922022122222322422522622722822923023123223323423523623723823924024124224324424524624724824925025125225325425525625725825926026126226326426526626726826927027127227327427527627727827928028128228328428528628728828929029129229329429529629729829930030130230330430530630730830931031131231331431531631731831932032132232332432532632732832933033133233333433533633733833934034134234334434534634734834935035135235335435535635735835936036136236336436536636736836937037137237337437537637737837938038138238338438538638738838939039139239339439539639739839940040140240340440540640740840941041141241341441541641741841942042142242342442542642742842943043143243343443543643743843944044144244344444544644744844945045145245345445545645745845946046146246346446546646746846947047147247347447547647747847948048148248348448548648748848949049149249349449549649749849950050150250350450550650750850951051151251351451551651751851952052152252352452552652752852953053153253353453553653753853954054154254354454554654754854955055155255355455555655755855956056156256356456556656756856957057157257357457557657757857958058158258358458558658758858959059159259359459559659759859960060160260360460560660760860961061161261361461561661761861962062162262362462562662762862963063163263363463563663763863964064164264364464564664764864965065165265365465565665765865966066166266366466566666766866967067167267367467567667767867968068168268368468568668768868969069169269369469569669769869970070170270370470570670770870971071171271371471571671771871972072172272372472572672772872973073173273373473573673773873974074174274374474574674774874975075175275375475575675775875976076176276376476576676776876977077177277377477577677777877978078178278378478578678778878979079179279379479579679779879980080180280380480580680780880981081181281381481581681781881982082182282382482582682782882983083183283383483583683783883984084184284384484584684784884985085185285385485585685785885986086186286386486586686786886987087187287387487587687787887988088188288388488588688788888989089189289389489589689789889990090190290390490590690790890991091191291391491591691791891992092192292392492592692792892993093193293393493593693793893994094194294394494594694794894995095195295395495595695795895996096196296396496596696796896997097197297397497597697797897998098198298398498598698798898999099199299399499599699799899910001001100210031004100510061007100810091010101110121013101410151016101710181019102010211022102310241025102610271028102910301031103210331034103510361037103810391040104110421043104410451046104710481049105010511052105310541055105610571058105910601061106210631064106510661067106810691070107110721073107410751076107710781079108010811082108310841085108610871088108910901091109210931094109510961097109810991100110111021103110411051106110711081109111011111112111311141115111611171118111911201121112211231124112511261127112811291130113111321133113411351136113711381139114011411142114311441145114611471148114911501151115211531154115511561157115811591160116111621163116411651166116711681169117011711172117311741175117611771178117911801181118211831184118511861187118811891190119111921193119411951196119711981199120012011202120312041205120612071208120912101211121212131214121512161217121812191220122112221223122412251226122712281229123012311232123312341235123612371238123912401241124212431244124512461247124812491250125112521253125412551256125712581259126012611262126312641265126612671268126912701271127212731274127512761277127812791280128112821283128412851286128712881289129012911292129312941295129612971298129913001

Copyright © 2012 by John Wiley & Sons, Inc.

THE NEW LYNCHING
(Fifty pages) \$2.95

TABLE 1. Summary of the study design and data collection

i

Project Name	Project Number	Project Type	Project Status	Project Manager	Project Start Date	Project End Date	Project Budget	Project Progress	Project Risks	Project Issues	Project Comments
Project A	101	Software Development	In Progress	John Doe	2023-01-01	2023-06-30	\$1,200,000	75%	Low	Minor delays in testing	On track for completion
Project B	102	Hardware Upgrade	Completed	Jane Smith	2022-03-15	2022-09-30	\$800,000	100%	Medium	None	Successfully completed ahead of schedule
Project C	103	Infrastructure Upgrade	On Hold	Mike Johnson	2023-02-01	2023-12-31	\$2,500,000	10%	High	Budget constraints	Re-evaluating scope and timeline
Project D	104	Marketing Campaign	Planning	Sarah Lee	2023-07-01	2023-09-30	\$300,000	5%	Low	None	Initial concept development
Project E	105	Research & Development	Discovery	Dr. Emily White	2023-04-01	2024-03-31	\$1,800,000	20%	Medium	Uncertain market demand	Conducting feasibility studies






O.3. Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit e peizazhit

Në të gjithë territorin do të konsiderohet përmirësimi i kushteve, sistemimi i rrjetit rrugor dhe transporti, krijimi i shërbimit hidrik të integruar, përmirësimi i rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese, mjedis i pastër dhe i sigurt natyror, furnizim me energji dhe ndriçimi publik, përmirësimi i shërbimit të telekomunikacionit.

Për rrjedhojë tërësia e këtyre përmirësimeve do pasojë me rritjen e cilësisë së jetës në këto zona dhe do të shërbejë si shtyllë për zhvillimet e ardhshme në bashki. Përmirësimi i këtyre infrastrukturave do lehtësojë dhe do të mundësojë çdo mundësi për zhvillim të projekteve në këtë territor, duke bërë të mundur kthimin e banorëve drejt vendlindjes, e gatshme për të mirëpritur zhvillimet ekonomike në drejtim të saj (Figura 4).



3.3. OBJEKTIVAT KOMBËTARE

Objektivat kombëtare kryesore të Shqipërisë për pesëmbëdhjetë vjetet e ardhshme janë si më poshtë:

- Zhvillimi i infrastrukturës kombëtare të transportit për lidhjen e Shqipërisë me korridoret Paneuropiane të transportit.
- Zhvillimi i Shqipërisë si qendër infrastrukturash dhe energjie për të gjithë rajonin e Ballkanit.
- Promovimi i zhvillimit nëpërmjet një sistemi të zhvillimit urban policentrik dhe të decentralizuar.
- Promovimi dhe aksesueshmëria e zonave me mjedis të shquar natyror dhe peizazh, e kombinuar me menaxhimin inteligjent të burimeve natyrore dhe kulturore me qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre në kuadër të zhvillimit dhe globalizimit. Shfrytëzimi i njëkohshëm i tyre nëpërmjet përmirësimit të aksesueshmërisë të tyre me qëllim zhvillimin ekonomik.
- Zhvillimi i sistemeve të transportit multimodal, miqësor ndaj mjedisit për të mbështetur zhvillimin rural policentrik, së bashku me përmirësimin e infrastrukturës dhe zhvillimin ekonomik.
- Nxitja e përdorimit të burimeve të energjisë të rinovueshme në sektorin e energjisë.
- Dizajni dhe zhvillimi i shërbimeve të integruara në fushën e komunikimit, transportit, bujqësisë dhe energjisë.
- Organizimi hierarkik, specializimi dhe grupimi funksional i qyteteve shqiptare.
- Urbanizimi dhe formalizimi i zonave informale të ndërtimit.

Këto objektiva kombëtare i shërbejnë vizionit të vendit për krijimin e një demokracie vibruese në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, me një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese, e cila garanton lirinë dhe të drejtat e njeriut. Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, favorizon pjesëmarrjen e vendit në një rrjet ndërkombëtar të transportit rrugor, detar, dhe intermodal. Dhjetë korridore të transportit multimodal të interesit Evropian, krijojnë një bazë për zhvillim në degen e transportit për në Evropën Lindore, me portet e Shqipërisë në Adriatik dhe detin Jon të jenë një parametër i rëndësishëm. Për këto arsye, është veçanërisht e rëndësishme për vendin perfundimi i rrugëve / korridoreve kombëtare, perfundimi i korridorit hekurudhor, zgjerimi dhe fuqizimi i aeroportit të Tiranës dhe aeroporteve rajonale, ndërtimi i terminaleve në porte dhe qytete, që do të inkurajojnë transportin multimodal dhe forcimin e shërbimeve në portet e vendit.

Në të njëjtën kohë, kërkohet një përpjekje për të transformuar shoqërinë në shoqëri të të mësuarit dhe informacionit, përmes integritetit të infrastrukturës dixhitale në të gjithë vendin, përmirësimin e shërbimeve elektronike publike dhe krijimin e transparencës në qeverisjen e vendit. Për më tepër, nga pikpamja administrative, Shqipëria synon të forcojë qeverisjen lokale dhe decentralizimin, të përmirësojë efikasitetin e qeverisjes në përputhje me parimet evropiane të vetëqeverisjes vendore dhe vlerat e modelit të Menaxhimit të Decentralizuar Evropian.

Në sektorin e mjedisit, qëllimi është zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik me mbrojtjen e burimeve natyrore nga ndotja dhe degradimi përmes menaxhimit të integruar dhe përmirësimin e vlerave mjedisore që kontribuojnë për prosperitetin ekonomik. Qëllimi është i bazuar në parimin e zhvillimit të integruar, mbrojtjen dhe rritjen e burimeve mjedisore, si dhe sigurimin e rritjes ekonomike dhe prosperitet social dhe kohezionit. Sot, zonat e mbrojtura në Shqipëri përbëjnë 15%





të sipërfaqes së vendit dhe janë pjesë e Brezit të Gjelbër Evropian, por gjithsesi shumë zona të mbrojtura nuk janë të vizituara dhe nuk kontribuojnë financiarisht në vend. Gjithashtu, është e njohur që mjedisi është pjesë e pasurisë kombëtare dhe ndikohet si nga proceset natyrore edhe nga ndërhyrja e njeriut. Kështu, objektivat kryesore për menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit janë:

- Mbrojtja e zonave ekologjike të ndjeshme dhe sigurimi i një funksionimi të vazhdueshëm të mirë në të ardhmen.
- Krijimi i një sistemi informacioni për mbrojtjen e burimeve natyrore.
- Zhvillimi i rolit të burimeve mjedisore dhe natyrës në zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve të qendrave urbane, duke lidhur qytetet me zonat natyrore.
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për të mbështetur zhvillimin ekonomik në të gjitha fushat, p.sh. bujqësi, pylltari, peshkim, gurore, energji, industri, shërbime, turizëm etj
- Krijimi i rrjetit evropian Natura 2000 për mbrojtjen e zonave ekologjike të ndjeshme dhe ruajtjen e peizazheve të vlefshme natyrore.
- Rritja e pjesëmarrjes së publikut në proceset e vendimmarrjes dhe integrimi i planifikimit hapësinor në vend.

Zhvillimi rural ka nevojë për të promovuar zhvillimin e sektorit të bujqësisë, me ndihmën e një kornize për të siguruar sektorin agro-ushqimor, inovativ dhe të qëndrueshëm, të aftë për të përballuar presionet e tregut dhe kriteret e cilësisë të Bashkimit Evropian. Rezultati do të jetë vende të reja pune, rritje ekonomike, kohezion social dhe mbrojtje e cilësisë së jetës për banorët e zonave rurale. 40% e sipërfaqes së vendit përbëhet nga tokë bujqësore dhe gjysma e saj është e vendosur në pjesën perëndimore të vendit dhe në zonën bregdetare të saj. Pjesëmarrja e bujqësisë në Produktin Kombëtar Bruto është 20%, me 50% të punësuarve i perkasin veprimtaritë primare. Objektivi kryesor është përmirësimi i bilancit ushqimor të importeve - eksporteve, pasi eksportet janë rritur ndjeshëm në dekadën e fundit, por balanca mbetet negative. Gjithashtu thelbësore është ripyllëzimi i zonave të degraduara dhe testimi i kulturave të reja fitimprurëse në zonat rurale, paralelisht me krijimin e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit rural- ekonomik. Reduktimi i kostove të prodhimit, investimeve në teknologji për zonat rurale, menaxhimi i ujit për ujitje dhe ndërtimi i infrastrukturës përkatëse, bashkëpunimi në sektorin e bujqësisë me sektorët e tjerë si p.sh. agroturizmi cilësor, futja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në aktivitetet rurale dhe krijimi i qendrave dhe poleve të prodhimit bujqësor, në varësi të karakteristikave të produkteve, janë faktorët kryesor për zhvillimin rural.

Qëllimi për turizmin parashikon njohjen e Shqipërisë si një destinacion tërheqës turistik në Evropë, autentik dhe mikpritës, bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe burimeve kulturore, të cilat do të jenë të qasshme në tregjet ndërkombëtare.

Për sektorin e energjisë, objektivi kryesor është pavarësia energjetike e Shqipërisë dhe zhvillimi i një ekonomie me karbon të ulët, me përdorimin e burimeve të energjisë të rinovueshme, futjen e teknologjive të reja në energjetikë dhe zhvillimi i kërkimeve përkatëse për këtë qëllim. Objektivat e politikës energjetike janë përdorimi i energjisë me 20% nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë, përmirësimi i efikasitetit të energjisë në masën 20% dhe duke reduktuar emetimet e CO₂ me 20%.



Në të njëjtën kohë, është i domosdoshëm zhvillimi i mëtejshëm të hidrocentraleve, pasi Shqipëria ka burime të mjaftueshme ujore, forcimi i rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe integrimi i tyre në planifikimin hapësinor, përdorimi i energjisë diellore dhe zhvillimi i fushave ekzistuese gjeotermale. Me rëndësi strategjike është edhe gazsjellesi TAP (Tran Adriatic Pipeline) që do të kalojë përmes Shqipërisë.

3.4. STRATEGJI/ PLANE KOMBËTARE TË LIDHURA ME VSM-në PËR PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR

Bazuar edhe në legjislacionin përkatës, të gjithë dokumentet e planifikimit të territorit duhet të zhvillohen në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar mbi bazën e parimit të hierarkisë së dokumenteve të planifikimit dhe, sipas rastit, në përputhje me planet sektoriale dhe planet e detajuara për zonat me rëndësi kombëtare, si dhe duke ju përmbajtur normave teknike të planifikimit të territorit. Gjatë përgatitjes së kësaj VSM-je janë marrë në konsideratë të gjithë planet apo strategjitë kombëtare të cilët ndikojnë në një mënyrë apo tjetër në zhvillimin e PPV-së për Bashkinë Këlcyrë.

Tabela 2. Dokumentat Strategjike të Zhvillimit të Vendit që lidhen me PPV-në të shqyrtuara gjatë VSM

Nr.	Dokumenti
1.	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
2.	Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit
3.	Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit
4.	Strategjia e Pyjeve dhe Kullotave
5.	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020
6.	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve
7.	Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit në Shqipëri

Shqyrtimi i këtyre dokumentave synoi gjithashtu identifikimin e çështjeve apo objektivave egzistuese të qëndrueshmërisë të cilat duhet të merren parasysh gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe gjatë Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Theksojmë se Dokumentat Strategjike Kombëtare të marra në shqyrtim reflektojnë edhe angazhimet e Shqipërisë në Marrëveshjet Ndërkombëtare përkatëse dhe janë të orientuara drejt procesit integruar në Bashkimin Europian të vendit. Në tabelën e mësipërme paraqitet lista e Dokumentave Zhvillimore të shqyrtuara dhe marra në konsideratë nga Grupi i Punës gjatë hartimit të VSM-së ndërsa në vijim paraqitet një përmbledhje e shkurtër e secilit prej tyre si dhe pikëprerjet më kryesore me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Këlcyrë dhe VSM-në respektive.

3.4.1. Plani i Përgjithshëm Kombëtar

Vizioni i Planit të Përgjithshëm Kombëtar e sheh Shqipërinë si një qendër të integruar në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Evropian, me ekonomi të shumëllojshme dhe konkurese në hapësirën ballkanike, si një shtet që synon barazinë në aksesin në infrastrukturë, ekonomi dhe dije. Siguron mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore me synimin për t'u shndërruar në një destinacion autentik.



Në objektivat strategjik të planit parashtrohet si fillim, sigurimi i integritetit fizik dhe territorial të peizazhit historik, kulturor, natyror dhe urban në të gjithë territorin shqiptar. PPK-ja synon një riorganizim të territorit shqiptar, duke strukturuar vendbanimet në qendra urbane: primare, sekondare dhe terciare, strukton lidhjet dhe aksesin si pjesë e korridoreve evropiane dhe ballkanike, duke krijuar rajone të forta ekonomike që kanë marrëdhënie plotësuese me njëri-tjetrin.

Në lidhje me Bashkinë Këlcyrë, PPK-ja jep disa orientime bazë në nivelin rajonal. Bashkia e Këlcyrës është pjesë e zonës me specifikë zhvillimi Skrapar-Përmet-Këlcyrë (Figura 5).




Figura 5. Harta e Rekomandimeve nga Plan i Përgjithshëm Kombëtar, Shqipëria 2030.



Orientimet e zhvillimit fokusohen në:

Planifikim të politikave dhe skemave mbështetëse të zhvillimit rural, duke siguruar një mbështetje të zonës për një "zinxhir të plotë të vlerës" të bimëve mjekësore, si edhe të drurëve frutorë.

Krijimi i tregut rajonal bujqësor dhe blegtoral, në mbështetje të ekonomisë që në këtë zonë ka shumë potencial. Ky treg do plotësojë zinxhirin e agro-përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Industria agro-përpunuese është parë me prioritet në këtë zonë, duke përfshirë dhe lidhjet me polin e zhvillimit rajonal të Korçës dhe atij të Gjirokastrë-Sarandës.

Orientimi i tretë i zones është drejt sektorit të turizmit dhe më specifikisht nënprodukteve të tij: kulturor, balnear, malor, natyror, fetar.



3.4.2. Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit


Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (SNM), e propozuar nga Ministria e Mjedisit për periudhën 2015-2020 është vazhdim i objektivave të Strategjisë së miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 847, datë 29.11.2007 dhe është dokumenti bazë që parashtron politikën shtetërore në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Qëllimi përfundimtar i hartimit, miratimit dhe zbatimit të tij është plotësimi i detyrimit kushtetues ndaj shtetasve që gëzojnë të drejtën e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjik, zhvillimit të Shqipërisë në mënyrë të qëndrueshme nëpërmjet përdorimit racional të pasurive natyrore, ruajtjes së tyre nga ndotja dhe degradimi, si dhe promovimit të vlerave mjedisore për t'i kthyer ato në asete të rëndësishme të rritjes së mëtejshme ekonomike të vendit.

Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit (SNM) është pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ajo duhet parë në kontekstin e politikës kombëtare. Shumë nga politikat dhe masat e kësaj strategjie, mbështeten nga programet dhe veprimet të përcaktuara në strategjitë ndërsektoriale, siç janë turizmi, energjia dhe bujqësia etj.

Strategjia zbërthen realizimin e objektivave të saj në një program masash konkrete të shoqëruar me afatet kohore, institucionet përkatëse dhe parashikimet financiare. Këto masa ndiqen nga insitucionet politike-bërëse dhe ato zbatuese. Kuadri ndërsektorial afron një trajtim modern dhe të integruar të sektorit mjedisor dhe sektorëve të tjerë me ndikim të fortë në cilësinë e mjedisit si transporti, bujqësia, rregullimi i territorit etj. Ky konceptim pranon përgjegjësinë e ndarë midis shumë institucioneve qeverisëse, të nivelit qëndror apo vëndor, për mbrojtjen e mjedisit dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm të vëndit. SNM-ja mbështetet nga programe veprimi më të hollësishme që trajtojnë çështje specifike siç janë Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin, Strategjia për Zhvillimin e Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, Strategjia e Peshkimit dhe Plani Kombëtar i Administrimit të Mbetjeve. Kjo Strategji Ndërsektoriale për Mjedisin bashkon elementët më të rëndësishëm të këtyre veprimeve në një tërësi të vetme dhe bashkëkohore.

3.4.3. Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit

Shqipëria ka qenë dhe mbetet pjesëmarrëse e iniciativave europiane dhe rajonale në përgjigje të Konventës së Diversitetit Biologjik (CBD), në mënyrë të veçantë të Strategjisë Pan-Europiane të Diversitetit Biologjik dhe Pejsazhor (SPEDBP). Edhe pse një vend i vogël, Shqipëria shquhet për një diversitet biologjik e pejsazhor të pasur. Në origjinë të këtij diversiteti qëndrojnë pozicioni gjeografik, faktorë gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima. Relievi i thyer dhe vertikalliteti i theksuar kanë krijuar kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri llojesh relikte, endemikë e subendemikë; 27 llojet endemike dhe 160 subendemike të bimëve të larta që rriten në vendin tonë paraqesin një rëndësi të veçantë ruajtjeje. Diversiteti i lartë i ekosistemeve dhe habitateve (ekosisteme detare, bregdetare, laguna e vende të lagëta, delta lumenjsh, duna ranore, liqene, lumenj, shkurreta mesdhetare, pyje gjethëgjere, halorë dhe të përzierë, livadhe e kullota subalpine dhe alpine, ekosisteme të maleve të lartë), ofron një larmi të pasur llojesh bimore e shtazore; rreth





3,200 lloje bimësh të larta dhe 756 lloje rrutorësh raportohen deri më sot në Shqipëri. Flora e Shqipërisë përfaqësohet me afro 30% të florës Europiane. Pyjet e lartë të Shqipërisë mbajnë komunitete gjitarësh të mëdhenj si ujku, ariu, rrëqebulli, dhia e egër etj, si dhe komunitete karakteritike shpendësh të lidhur me pyjet e virgjër. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brëndësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratorë; mesatarisht rreth 70 lloje shpendësh uji me një numër prej 180,000 individë kalojnë dimrin në to. Shqipëri, është një pikë e rëndësishme e kryqëzimit të rrugëve migratore të shpendëve, lakuriqëve të natës dhe insekteve.

Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 31, datë 20.01.2016 është një hap i rëndësishëm në mbrojtjen dhe vlerësimin e diversitetit biologjik në vendin tonë.

3.4.4. Strategjia e Pyjeve dhe Kullotave

Pyjet dhe kullotat përbëjnë një trashëgimi me vlera jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin e me gjerë. Ato duhet të mbrohen dhe qeverisen në mënyrë të tillë që të mundësojë një zhvillim më të madh ekonomik në të ardhmen, duke kontribuar në uljen e nivelit të varfërisë, pa prishur ekuilibret biologjike natyrore.

Strategjia për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave ka si qëllim sigurimin e menaxhimit dhe zhvillimit të qëndrueshem e shumëfunksional të burimeve pyjore dhe kullosore në përputhje me politikat qeveritare të synuara në këtë sektor. Konservim i vazhdueshem, përdorimi racional dhe vlerësimi i drejt i të mirave publike të eko - sistemeve pyjore dhe kullosore, në përputhje me interesat e shtresave të ndryshme të popullsisë realizohet nëpërmjet një qeverisje të qëndrueshme e shumëfunksionale.

Strategjia e Zhvillimit të Sektorit të Pyjeve e Kullotave synon një vlerësim shumëfunksional të burimeve pyjore e kullosore ku do të veçonim: pyjet si burim energjie, si burim i produkteve dytësore jo-drusore dhe biomasës, si burim i diversitetit biologjik dhe i sekuestrimit të karbonit, etj.

3.4.5. Strategjia Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020

Strategjia Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020 e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 709, datë 29.10.2014 thekson si synim të saj rritjen e prodhimit bujqësor nëpërmjet përmirësimit të kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm të garantuar nga institucione efikente. Zbatimi i politikave të sektorit do të përcaktohet nga përmbushja e një sërë kriteresh ndër të cilat dhe ulja e ndikimit të saj mbi mjedisin. Strategjia Ndërsektorale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor me perspektivën e anëtarësimit në BE përcakton ndërhyrjet strategjike për zhvillimin e bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri që të jenë të afta të përballen me sfidat e kërkesave të tregut të vetëm evropian dhe për përshtatjen e politikave shqiptare për zhvillimin rural dhe bujqësor sipas PPB-së.



Për këtë arsye, SNZHRB-j, është hartuar në harmoni me parimet kryesore të politikave të ardhshme të BE-së, PPB-në dhe politikat e para-aderimit (IPARD), duke zgjedhur ndërkohë masa politikash që kanë në fokus të tyre trajtimin e problemeve specifike të bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri.

Vizioni për zhvillimin e bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri do të mbështesë dhe zhvillojë kushtet e kuadrit të duhur për një sektor agrorushqimor efikas, novator dhe të qëndrueshëm, të aftë për të përballuar presionin e konkurrencës dhe për të përmbushur kërkesat e tregut të BE-së përmes një shfrytëzimi të qëndrueshëm të burimeve dhe zonave rurale produktive, duke ofruar aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi jetese për banorët në zonat rurale.

3.4.6. Strategjia Kombëtare dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve

Mbetjet dhe trajtimi i tyre në territorin e Shqipërisë janë një nga problemet e mëdha mjedisore ndonëse ndikimi i tyre në shëndetin e njeriut është më i madh se ndotës të tjerë. Sidoqoftë, mbetjet (solide ose ujore/ujërat e zeza) ndikojnë në komponentë të tjerë mjedisorë si uji, ajri, toka dhe nëpërmes zinxhirit ushqimor dhe/ose kontaktit direkt me këto është mjaft i madh. Mbetjet ndodhen ngado dhe kultura së bashku me mungesën e financimeve dhe sidomos ndërgjegjësimi i popullsisë dhe rritja e përgjegjësisë së autoriteteve lokale mbeten sfida për të ardhmen. Nuk mund të ketë cilësi jete të lartë nëse nuk manaxhohen mbetjet e ngurta dhe ujërat e zeza.

Planet e Përgjithshme Vendore lidhen ngushtësisht me problemet e menaxhimit të mbetjeve dhe do të jenë një pengesë e madhe për zhvillimin nëse nuk projektohen, implementohen dhe mirëmbahen struktura dhe infrastrukturat e përshtatshme. Ky studim do të konsiderojë ato në detajte më të mundshme.

Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 175, datë 19.01.2011 synon në: parandalimin/minimizimin e mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve si dhe përmirësimi i eficiencës së përdorimit të tyre.

Sfidat në fushën e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve janë: (i) ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Integruar të menaxhimit të mbetjeve; (ii) ndërgjegjësimi i komunitetit për trajtimin e mbetjeve; si dhe (iii) bashkërendimi administrativ ndërmjet strukturave qendrore dhe vendore për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe qartësimin funksional të tyre.

Përcaktimi i përparësive në ligje, strategji, plane dhe programe të menaxhimit të integruar të mbetjeve të trashëguara apo të atyre që krijohen bëhet duke pasur parasysh hierarkinë e mëposhtme: (a) parandalimin e mbetjeve; (b) përgatitjen për ripërdorim; (c) riciklimin; (d) rikuperime të tjera dhe (e) asgjësimin.

3.4.7. Plani Kombëtar i Veprimit për Zbatimin e Konventës së Aarhus-it

Ndër Konventat mjedisore, me të drejtë, Konventa e Aarhusit është vlerësuar më e rëndësishmja, si Konventa e demokracisë në fushën e mjedisit. Konventa e nënshkruar nga Shqipëria që në vitin 1998, përfaqëson një dokument madhor ndërkombëtar me karakter të theksuar politik, sepse kërkon të realizohen në praktikë liri dhe të drejta bazë të njeriut në fushën e mjedisit.





Si dokument juridik ndërkombëtar, Konventa përfaqëson një tërësi të drejtash, detyrimesh, rregullash e procedurash të detyrueshme për zbatim për shtetet që e nënshkruajnë dhe e ratifikojnë. Kërkesat e Konventës, të drejtat dhe detyrimet që ajo përmban, janë orientuar në momente kyç të marrëdhënieve mjedisore dhe grupohen në tri drejtime themelore të tyre që jo pa qëllim janë quajtur edhe tri shtyllat e Konventës:

- ✦ E drejta e publikut për të patur e për të kërkuar informacion mjedisor;
- ✦ E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit;
- ✦ E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit.

Eshtë dokumenti bazë që parashtron politikën shtetërore për rritjen e rolit aktiv të shoqërisë civile, të publikut, të OJF-ve, të organizatave të biznesit e të individit në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Qëllimi themelor i hartimit, i miratimit dhe i zbatimit të tij është plotësimi i detyrimeve kushtetuese ndaj shtetasve që ata të jenë të informuar për gjendjen e mjedisit që mjedisi të mbrohet e të administrohet sipas kërkesave të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe që ata të jetojnë në një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për vete dhe për brezat e ardhshëm. Në këtë mënyrë, ai nxit përafrime të dukshme me legjislacionin komunitar për çështjet e mjedisit, i cili, gjithashtu, synon të kontribuojë për ruajtjen, mbrojtjen dhe për përmirësimin e cilësisë së mjedisit, si dhe për mbrojtjen e shëndetit njerëzor.

Synimet e Konventës janë të gjera dhe shumëplanëshe prandaj duke ruajtur këtë tipar të saj, Strategjia dhe plani i veprimit, me konstatimet e analizat që bën, si dhe me kërkesat që parashtron, synon t'u hapë rrugë të gjera zbatimi, me qëllim që të konsolidohen edhe në Shqipëri mendësi, psikologji, metoda pune e veprimtari praktike bashkëkohore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit, të cilat duhet të zbatohen, më së pari, në zbatimin e kërkesave që shtrun Konventa dhe konkretisht:

- ✦ Në përcaktimin e rregullave, procedurave e afateve të sigurimit, përpunimit dhe publikimit të vazhdueshëm të informacionit mjedisor, si dhe të plotësimit të kërkesave të publikut për të (aktiv dhe pasiv);
- ✦ Në tërheqjen në rritje të publikut dhe të pjesëmarrjes së tij në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit;
- ✦ Në konsolidimin e rregullave dhe të praktikave të thjeshta e operative që publiku të ushtrojë natyrshëm të drejtën ankimore në rrugë administrative dhe gjyqësore për çështje të mjedisit.

Strategjia dhe Plani Kombëtar i veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit përbën një dokument të rëndësishëm shtetëror në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Tashmë, për të gjithë është mëse e qartë se mbrojtja e mjedisit përbën një nevojë të domosdoshme për të arritur zhvillim ekonomik shoqëror të shëndetshëm e afatgjatë dhe cilësi të lartë jetese për sot dhe për të ardhmen e qytetareve. Për përbushjen e detyrimeve të Konventës dhe në zbatim të kësaj Strategjie kuadri ligjor për mjedisin ka adaptuar dhe normuar juridikisht e praktikisht realizimin e informimit të publikut për mjedisin, marrjen e mendimit të tij në vendimmarrjen mjedisore dhe aksesin për t'ju drejtuar organeve ankimese për çështje që lidhen me mjedisin.



IV. PËRSHKRIMI I KUSHTEVE BAZË TË MJEDISIT


Vlerësimi i saktë i ndikimeve në mjedis që rrjedhin nga zbatimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Këlcyrë kërkon pikësëpari që të njihet gjendja eksistuese e mjedisit të zonës ku do shtrihet kjo PPV. Seksioni në vijim ofron një përshkrim të detajuar të kushteve bazë mjedisore në zonë duke u ndalur në mjedisin fizik (klima, gjeologjia dhe gjeomorfologjia, ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, sizmiciteti), biologjik (sipërfaqet pyjore, biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura), problemet mjedisore në nivelin aktual të menaxhimit të mbetjeve dhe ujerave të ndotura, si edhe problemet mjedisore nga rreziqet natyrore (zjarret, përmytjet).

4.1. MJEDISI FIZIK

4.1.1. Klima

Klima përbën një element shumë të rëndësishëm si në formimin e zhvillimin e bimësisë, ashtu edhe për fenomenin e erozionit. Shqipëria shquhet për larmi të kushteve klimaterike dhe kjo pasqyrohet edhe në hartën klimatike të vendit. Sipas këtij rajonizimi, Shqipëria ndahet në katër zona: mesdhetare fushore, mesdhetare kodrinore, mesdhetare paramalore, dhe mesdhetare malore; secila prej tyre e ndarë në disa nënzona. Bashkia e Këlcyrës shtrihet në zonën klimatike mesdhetare paramalore, nënzona jugore dhe zonën klimatike mesdhetare malore, nënzona juglindore (Figura 6).

Në vijim jepen disa tregues të klimes: diellëzimi, temperatura, rreshjet dhe erërat në qytetin e Këlcyrës.





4

ATLASHI I BUDHETI ANTIKORUPSIONAL

SHKURTYMJE
SHKURTYMJE
SHKURTYMJE
SHKURTYMJE
SHKURTYMJE



Ministria e Mbrojtjes
e Mjedisit dhe Energjitikës

Shënim: Ky plan është miratuar nga Këshilli Bashkiq për Planifikim Urban dhe Zhvillim Urban në datën 15.05.2019.

Shënim: Ky plan është miratuar nga Këshilli Bashkiq për Planifikim Urban dhe Zhvillim Urban në datën 15.05.2019.



Titulli	Adresa	Telefoni	E-mail	Web	Facebook	Twitter	Instagram	LinkedIn	YouTube	Google Plus	Other
Ministria e Mbrojtjes e Mjedisit dhe Energjitikës	Rr. E Kosovës, Nr. 35, T. 6, Ap. 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 10110, Tirane, Shqiperi	+3554 2222804	2430195	e-mail							

PLANI I PËRGJITHSHËM I VËNDOSJES DHE SHKËMBIMIT TË ZONAVE KLIMATIKE
NË BASHKIËN E KËLCYRËS




Figura 6. Harta e zonave klimatike. Bashkia Këlcyre



42

Rr. E Kosovës, Nr. 35, T. 6, Ap. 4/1, Njësia Administrative Nr. 5, 10110, Tirane, Shqiperi - Tel +3554 2222804 / 2430195, e-mail




Temperatura

Këlcyra ka një klimë të ngrohtë dhe të temperuar (Csa në klasifikimin e klimës sipas Köppen and Geiger). Vera, është e shkurtër, e ngrohtë dhe e thatë dhe kryesisht me qiell të hapur kurse dimri është i gjatë, i ftohtë dhe i lagësht. Gjatë rrjedhës së një viti, temperatura zakonisht varion nga 0 ° C deri 32 ° C dhe rrallë është më poshtë se -5 ° C ose më lart se 36 ° C (Grafiku 1).

Sezoni i ngrohtë zgjat 2.9 muaj nga 12 Qershori deri me 9 Shtator me një temperaturë mesatare ditore mbi 27 ° C. Dita më e ngrohtë e vitit është 30 Korriku me një temperaturë mesatare ditore të lartë mbi 32 ° C dhe të ulët prej 17 ° C.

Sezoni i ftohtë zgjat 4 muaj nga 20 Nëntori deri me 20 Mars ku mesatarja e temperatures më të lartë ditore është nën 14 ° C. Dita më e ftohtë e vitit është 4 Janari ku temperatura mesatare ditore është më e ulët 0 ° C dhe më e lartë 9 ° C.



Grafiku 1. Temperaturat më të larta dhe më të ulëta ditore (Burimi: Weatherspark.com)

Në grafikun e mësipërm janë paraqitur temperaturat mesatare ditore të ulëta (ngjyre blu) dhe të larta (ngjyre të kuqe), me bandat e përqindjeve (banda e brendshme nga 25 deri përqindëshen e 75 dhe bandat e jashtme nga 10 deri në përqindëshin e 90-të).

Reshjet


Në diagramat e mëposhtme (Grafiku 2 dhe 3) janë dhënë treguesit e reshjeve dhe karakteristikat e tyre. Si vecori e përgjithshme e reshjeve është se ato janë me tepër në shpatet perendimore e juperendimore të maleve dhe me pak në shpatet lindore. Një shpërndarje e tillë është e lidhur me vendosjen e relievit. Probabiliteti i rënies së reshjeve në Këlcyrë ndryshon gjatë gjithë vitit. Reshjet



është më e mundshme të ndodhin në 50% të ditëve rreth datës 7 dhjetor. Reshjet kane më pak të ngjarë të bien rreth datës 3 gusht, vetëm në 18% të ditëve.


Sezoni i lagësht zgjat 6.9 muaj, nga 25 Shtatori deri 23 Prill, me probabilitet më të madh se 22% që një ditë e caktuar të jetë e lagësht. Probabiliteti i rënies së shiut arrin maksimumin me 39% në 21 Nëntor. Sezoni i thatë zgjat 5.1 muaj, nga 24 Prill deri 27 Shtator. Probabiliteti i më i ulët i të qenurit ditë e lagësht është 6% në 7 Korrik.

Grafiku me poshtë tregon për çdo muaj numrin e ditëve me diell, pjesërisht me re, të mbuluar me re dhe me reshje. Ditë me mbulesë me re më pak se 20% konsiderohen si dite me diell, 20-80% mbuluar pjesërisht me re dhe me më shumë se 80%, si të mbuluara me re.




Grafiku 2. Numri i diteve me diell, vranesi dhe me reshje

Këlcyra përjeton variacione ekstreme sezonale përsa i përket sasisë mujore të reshjeve. Periudha e shirave gjate nje viti zgjat pothuajse 10.9 muaj. Shumica e sasisë së reshjeve bien gjate fundit të Nëntorit ku arrihet dhe sasia mesatare maksimale prej 119 milimetra. Periudha e thatësisë zgjat pothuajse 4.1 javë. Sasia minimale e reshjeve regjistrohet rreth 15 Korrikut me vetëm 10 milimetra.




Grafiku 3. Sasi të mesatare mujore të reshjeve për Bashkinë Këlcyrë



Erërat

Ky seksion diskuton mesataret e vektorit të erërave (shpejtësinë dhe drejtimin) në lartësinë 10m mbi tokë për Këlcyrën. Thëksojmë që erërat në çdo vëndndodhje të dhënë varen shumë nga topografia lokale dhe faktorë të tjerë, dhe shpejtësia dhe drejtimi i erërave të rastësishme mund të variojnë shumë më tepër sesa mesataret e tyre orare.

Shpejtësia mesatare orare e erës në Këlcyrë nuk ndryshon shumë përgjatë vitit duke qenë në kufijtë 0.2 metër për sekond deri në 1.4 metër për sekond.




Grafiku 4. Shpejtësia mesatare e erës për Bashkinë Këlcyrë

Në grafikun e mësipërm mesataret e shpejtësisë së erës (pjesët brenda vijës gri të errët janë brenda bandave nga 10 deri në përqindëshin e 90-të).

Mesatarja e drejtimin të erës në Këlcyrë varion shumë gjatë vitit. Era, është kryesisht nga lindja për 2.7 javët nga 28 Prilli deri në 17 Maj, dhe për 6.4 muaj nga 12 Shtatori deri më 25 Mars, me pikun e saj prej 28% në 6 Maj.

Era fryn kryesisht nga perëndimi për 3.7 javët, nga 17 Maji deri më 12 Qershor dhe për 3.4 javët, nga 19 Gushti deri më 12 Shtator, me pikun e saj prej 32% më 22 Gusht.

Era fryn kryesisht nga veriu për 2.2 javët, nga 12 Qershori deri më 19 Gusht me pikun e saj prej 39% më 15 Korrik.



Grafiku 5. Drejtimi i erës për Këlcyrën

Përqindja e orëve në të cilën drejtimi mesatar i erës është nga një prej katër drejtimeve kryesore. Pjesëzat me ngjyra më të hapura në kufijtë e tyre janë përqindja e orëve kur era fryn nga drejtimet e ndërmjetme (verilindje, juglindje, jugperëndim, dhe veriperëndim).





Tabela 3. Të dhënat klimaterike për Këlcyrën dhe Ballabanin (1961–1990, ekstremet 1940– deri 2015)

Muaji	Jan	Shkurt	Mar	Pril	Maj	Qer	Kor	Gus	Shta	Tet	Nen	Dhje	Vjetore
Temperatura mesatare mujore °C	Këlcyra 5.9	7.2	9.7	13.1	17.4	21.4	23.7	23.7	20.3	15.6	11	7.3	14.7
	Ballabani 5.4	6.7	9.1	12.4	16.8	20.6	22.9	23.1	19.7	15	10.5	6.8	14.1
Temperatura minimale °C	Këlcyra 2.1	3.3	5.3	8.3	12.1	15.6	17.4	17.4	14.6	10.8	7	3.6	9.8
	Ballabani 1.7	2.9	4.8	7.7	11.6	14.9	16.8	16.9	14.1	10.3	6.6	3.2	8.8
Temperatura maksimale °C	Këlcyra 9.7	11.2	14.1	17.9	22.7	27.2	30	30	26	20.4	15	11	19.6
	Ballabani 9.2	10.6	13.4	17.1	22	26.4	29.1	29.3	25.3	19.7	14.4	10.5	18.9
Mesatarja e reshjeve (mm)	Këlcyra 179	166	118	92	70	36	23	31	70	133	207	218	1388
	Ballabani 161	146	108	89	74	39	27	33	69	125	186	187	1244
Burimi: https://en.climate-data.org/location/470887/ dhe https://en.climate-data.org/location/469703/													



4.1.2. Topografia

Bashkia e Këlcyrës ndodhet në juglindje të Shqipërisë, me qendër qytetin e Këlcyrës. Ajo shtrihet në koordinatat gjeografike $40^{\circ} 18''$ gjatësi gjeografike veriore dhe $20^{\circ} 11''$ gjerësi gjeografike lindore. Bashkia ka një sipërfaqe totale prej rreth 304.6 km².

Zona e bashkisë Këlcyrë është një territor me karakter kodrinoro-malor e cila shtrihet në lartësinë 230m deri në 1100m mbi nivelin e detit. Bashkia Këlcyrë shtrihet midis vargmaleve Trebeshinë-Dhëmbel dhe malit të Qarrihtës dhe përshkohet nga dy lumenj ai i Vjosës dhe i Dëshnicës duke krijuar dy lugina të ngushta në të cilat shtrihen rreth 500 ha toke bujqesore e cila ka mundësi të futet e gjitha nën ujë.

Lugina dhe lumi i Vjosës


Lugina e Vjosës shtrihet nga Mesareja (vendi ku Vjosa hyn në territorin tonë) deri në Poçëm, ku ajo del përfundimisht në Ulëtisrën Bregdetare. Brenda Krahinës Malore Jugore përfshihet tërë rrjedhja e mesme e Vjosës me gjatësi 166 km dhe gjerësi nga 600-800 m deri në 1000-1500 m. Ajo është një nga luginat më të mëdha e më të rëndësishme të vendit tonë dhe njëkohësisht lugina kryesore e Krahinës Malore Jugore (Figura 7).



Figura 7. Baseni ujëmbledhës i Vjosës (Burimi: Sala & Qiriazi, 2016)

Larmia litologjike, evolucioni morfologjik dhe morfogjenetik, levizjet neotektonike etj, kanë shkaktuar kontraste të mëdha midis sektorëve të kësaj lugine. Ajo është e gjerë pasi hyn në territorin tonë, ndonëse shtrati i saj ngushtohet përsëri derisa del nga gryka e Këlcyrës në Dragot. Prej këtej e në vazhdim lugina zgjerohet mjaft, me përjashtime të vogla në sektorët e grykës së Dorzës e të Pocemit.

Formimi i luginës së Vjosës duhet të lidhet me pliocenin, kur pjesa më e madhe e strukturave që ndërpret Vjosa kishin dalë përfundimisht mbi ujë. Por duke pasur parasysh ndërtimin strukturor dhe evolucionin paleogeografik të zonës, ka mundësi që zanafillën e rrjetit hidrografik të jetë më e





nerishme (gjatë miocenit). Fillimisht ajo "zgjodhi" rrugën më të lehtë nga JL në VP, në përputhje me boshtin e strukturës rrugë që lehtësohej nga sinklinali I Përmetit (Figura 8).






Figura 8. Harta Litologjike dhe Gjeologjike e Basenit të Vjosës (Burimi: Sala & Qiriazi, 2016)

Lugina e Vjosës shtrihet nga lartësia 120-150 m (Poçëm) dhe 150-170 m (Dragot) deri në 600-800 m (Mesare). Por pjesa më e madhe e saj shtrihet në lartësitë 400-600 m. Relievi i luginës është tepër i copëtuar (nga 1 km/km² në mbi 5 km/km²). Vlerat më të vogla takohen në territoret me ndërtim karbonatik, kurse më të lartat në depozitimet flishore. Energjia e relievit merr vlerat nga 300 m/km² deri në mbi 500 m/km². Vlerat e larta deri në 300-500 m/km² kanë përhapje më të vogël, kurse vlerat shumë të larta mbi 500 m/km² i gjejmë në shpatin e majtë të luginës (Dhëmbel- Nemërçkë) dhe grykën e Këlcyrës, Dorzës e Poçemit, që lidhen në përgjithësi me shkëputjet tektonike dhe përbërjen litologjike (gëlqerore) (Figura 8).

Vlerat e larta të copëtimit horizontal, energjia e lartë e relievit dhe pjerrësia e konsiderueshme e shpatëve janë rezultat i evolucionit të shpejtë të relievit të luginës dhe në të njëjtën kohë trgojnë për intensitetin e madh të proceseve aktuale të relievformuese. Prandaj studimi i veçorive morfologjike dhe i historisë së shumë çështjeve të lidhura me originën dhe evolucionin e luginave për mbarë vendin tonë.

Veçoritë morfologjike të luginës së Vjosës ndryshojnë shumë gjatë shtrirjes, në varësi të ndërtimit litologjik dhe strukturave që ajo ndërpret. Lugina pëson zgjerime në sektorët ku lumi ndërpret ose përshkon strukturat sinklinale që ndërtohen nga shkëmbinj terrigjenë (flishe e molasa). Këto zgjerime janë më të theksuara sidomos në sektorin nga Dragoti e më poshtë. Ngushtimet janë në sektorët ku lumi çan strukturat antiklinale, të ndërtuara kryesisht nga shkëmbinj të fortë (gëlqerorë), si në Grykën e Këlcyrës, të Dorzës e të Poçemit.

Mendohet se lumi Vjosa në grykën e Këlcyrës ka pasur gjithmonë drejtimin që ka sot. Ajo është shmangur në mënyrë graduale nga e majta e bushtit të strukturës sinklinale të Përmetit. Ka shumë mundësi që gryka e Këlcyrës të jetë me originë antecedente. Në rast se formimi i luginës do të



përputhej me strukturën dhe litologjinë, lumi I Vjosës do të derdhej në Osum duke ndjekur vazhdimësinë e sinklinalit të Përmetit në veriperëndim. Por studimet e kryera si në luginën e Dëshnicës ashtu dhe në atë të Vokopolës nuk e vërtetojnë një mendim të tillë. Nuk janë konstatuar në asnjë rast depozitime të vjetra lumore ose tarraca të Vjosës në luginën e Dëshnicës dhe as në atë të Vokopolës.

Si përfundim del se gryka e Këlcyrës është formuar me antecedencë, ashtu si dhe mjaft gryka të tjera në luginat e vendit tonë.

Kthesa nga perëndimi që merr Vjosa në grykën e Këlcyrës nuk është një dukuri e rastit ose një veçori locale e këtij lumi, por një dukuri thuajse e përgjithshme që vërehet edhe në lumenj të tjerë të vendit tonë (Shkumbin, Mat, Drin etj.). Ajo duhet të lidhet me shkaqe më të përgjithshme siç është migrimi i orogjenezës nga lindja në perëndim etj. Karakteri dhe veçoritë morfologjike të luginës së Vjosës, ndryshojnë nga njëri sektor në tjetrin. Secili prej tyre ka tiparet e veta origjinale, që lidhen me veçoritë e ndërtimit litologjik, karakterin e shpateve, praninë ose mungesën e tarracave mbi shtratin aktual të lumit etj.

Sipas veçorive morfologjike e morfogjenetike lugina e Vjosës mund të ndahet në tre sektorë kryesorë. Nga Mesareja në Këlcyrë, prej kësaj deri në Dragot (Tepelenë), dhe nga Dragoti në Poçëm, ku ajo e humbet karakterin e saj si luginë meqenëse njësohet me fushën e Myzeqesë. Në sektorin e parë Mesare-Këlcyrë lugin, është e zhvilluar në strukturën sinklinalë të Përmetit me drejtim JL-VP, në përputhje me drejtimin e strukturave kryesore dhe është e tipit sinklinal. Lumi ka formuar dhe përpunuar luginën në shkëmbinjtë flishorë të oligocenit të poshtëm, të cilët ndërtojnë sinklinalin e Përmetit. Në këtë sektor lugin, është relativisht e gjerë dhe ka formën e një govate. Vende-vende në nivelin e tarracës së parë ajo zgjerohet deri në 800-1500 m, sinë Këlcyrë, Kosinë, Qilarisht, Përmet etj.

Elementi më i rëndësishëm morfologjik në këtë sektor të luginës së Vjosës janë tarracat lumore që ruhen mirë. Ato takohen në të dy anët e luginës në pozicione të ndryshme hipsometrike, por zhvillim shumë të madh kanë në shpatin e djathtë të luginës. Dallohen pesë nivele tarracash erozivo-akumuluese, por mund të takohen edhe tarraca të tjera në nivele më të larta, të paktën tarraca erosive (Figura 9).




Figura 9. Tarraca të Vjosës në rrjedhen e mesme Carçovë - Këlcyrë



Ruhen mirë tarracat më të reja dhe pikërisht tre nivelet e para. Niveli I parë shtrihet pothuajse pandërprerje, gjatë gjithë gjatësisë së luginës dhe në të dy shpatet e saj. Zhvillimin më të madh kjo tarracë akumulative e ka në shpatin e djathtë të luginës, në lartësinë 10-15 m mbi shtratin e lumit. Në sipërfaqen e kësaj tarrace janë zbuluar tuma ilire, siç është ajo e Piskovës, ku është gjetur një material i pasur arkeologjik.

Tarraca e dytë ka zhvillim fragmentar ose në trajtën e një brezi në të dy anët e lumit si në Kutali, Piskovë, Kuqar. Mbi to vendosen proluvione dhe kjo është tarracë e tipit erozivo-depozitues. Lartësia e saj nga shtrati i lumit është nga 25 deri në 45 m.

Tarraca e tretë, ashtu si dhe e dyta, ka zhvillim fragmentar. Lartësia nga shtrati i sotëm i lumit është 80-100 m. Dallohet mirë në Kuqar, në Badëlonjë, në Kaludh, në Iljar (në shpatin e djathtë të luginës) dhe në Përmet (Balëngë) në shpatin e majtë.

Tarracë e katërt erozivo-akumuluese ruhet mirë në Iljar, Kaludh, Qilarisht, Kutali, Kosinë. Ndodhet mbi nivelin e lumit në lartësi rreth 125-130 m.



Edhe tarraca e pestë, gjithashtu erozivo-akumuluese ruhet mirë dhe ndodhet në lartësinë 165 m mbi nivelin e sotëm të lumit.

Shpatet e luginës së Vjosës në këtë sektor janë asimetrike. Shpati I djathtë bie më butë dhe është I ndërprerë nga një rrjet I dendur lumenjsh e përrenjsh mjaft të zhvilluar. Disa nga degët kryesore si lumi i Dëshnicës etj, në pjesët e poshtme të tyre formojnë lugina të gjera, me shtrate të mbushura me aluvione në grykëderdhjet e tyre në trajtë të koneve të depozitimit. Pjerrësi, është shumë më e madhe. Shpati I majtë I luginës në sektorin e sipërm është më I pjerrët, më I pyllëzuar dhe shumë I copëtuar nga përrenj, disa prej të cilëve (ata që zbresin nga Nemërçka) kanë depozituar deri në bregun e Vjosës sasi të mëdha materiale shpesh copëzore me origjinë akullnajore dhe lumakullnajore (psh. Përballë fshtarave Pëllumbas e Stërmbec). Këto material kanë ngushtuar së tepërmi shtratin e Vjosës, madje edhe duhet ta kenë bllokuar atë derisa mbetjet e tyre gjenden në të dy anët e luginës. Formimi I këtyre materialeve që u mbivendosën tarracave të Vjosës në disa sektorë, duhet të ketë ndodhur nga fundi I periudhës së vrmit, pra në fazën e shkrirjes së shpejtë të akujve. Materiale të tilla takohen dhe në Badëlonjë, Dëshnicë, (Sukë), Vasjar etj.

Në sektorin e dytë të luginës (Këlcyre-Dragot), lumi I Vjosës e ndryshon drejtimin, duke kaluar nga lindja në perëndim.

Në këtë pjesë ajo ka formuar grykën e madhe të Këlcyrës, të gjatë rreth 13 km, të thellë mbi 1000 m dhe tepër të ngushtë. Këtu Vjosa e ka përpunuar luginën e vet nëpërmjet erozionit thellësinor duke çarë tërthor strukturat, dhe duke ndarë malin e Trebeshinës nga Dhëmbeli dhe Shëndëllinë nga Lunxheria.

Gryka e Këlcyrës, siç u tha, është me origjinë antecedente, në përgjithësi simetrike dhe në prerjen tërthore ka formën e germës "V" me shpate që bien thikë mbi Vjosë. Gjerësia e shtratit shkon nga 13-20 m në 50-60 m. Më rrallë, në sektorin ku lumi I Vjosës kalon nëpër sinklinalin e vogël të Zagorisë dhe në të dalë të grykës së Këlcyrës (Dragot), shtrati zgjerohet deri në 120-200 m. Në nivelin e tarracës së parë lugin, është e gjerë deri në 250-350 m.



Në grykën e Këlcyrës ruhet mirë tarraca e parë (akumulative) që vazhdon pothuajse gjatë gjithë shtrirjes së saj, por zhvillimin më të madh e ka në shpatin e djathtë. Vetëm në Mëzhgoran tarraca zhvillohet më tepër në shpatin e majtë. Ajo gjendet në lartësinë 5-10 m.

Karakteristikë për këtë sektor të luginës së Vjosës janë edhe dukuritë karstike, që përfaqësohen nga zgavra e shpella (Mezhgoran, Dragot). Në pjesën e poshtme të luginës dalin burime të shumta karstike, midis të cilave dallohet "Ujëti e Zi" në afërsi të Këlcyrës, në Mezhgoran etj. Burime të tjera dalin edhe nga të çarat e shkëmbinjve ose drejtpërdrejt nga deluvionet sidomos tek pika turistike e Këlcyrës.

Nga Dragoti deri në Poçëm shtrihet sektori I tretë i luginës së Vjosës. Në këtë sektor lugina zgjerohet shumë duke arritur vende-vende deri në 1-2 km (Qesarat, Kutë, Poçëm, etj.). Vetëm në sektorë të kufizuar, veçanërisht në Dorëz e Poçëm, ajo ngushtohet mjaft duke marrë formën e grykës.

Lugina e Vjosës dallohet për klimën e saj shumë të butë, gjë që lidhet me faktin se përmes saj deri në skajin më lindor, depërtojnë erërat e ngrohta detare që vijnë nga veriperëndimi.

Rrjeti hidrografik i luginës së Vjosës përfaqësohet në radhë të parë nga rrjedhja e sipërme dhe e mesme e lumit Vjosa. Në këtë pjesë formohen përfundimisht tiparet themelore hidrologjike të Vjosës si një lumë ujëshumë. Në formimin e regjimit të Vjosës në këta sektorë të rrjedhjes rol të madh luajnë burimet e shumta nëntokësore, sidomos ato që merr në grykën e Këlcyrës (Uji i Zi etj) si dhe një radhë degësh të rëndësishme e me prurje të konsiderueshme siç është Dëshnica.

Tipat kryesore të tokave janë ato të hirta kafe dhe aluvionale. Mbulesa bimore në luginën e Vjosës përfaqësohet kryesisht nga shkurret mesdhetare të tipit të makjeve, por më të zhvilluara janë në shpatin e djathtë të Vjosës, të ekspozuar diellit. Ato shtrihen deri në lartësinë 700-800 m mbi nivelin e detit. Në shpatin e djathtë, po në këtë lartësi, takohet dhe bredhi i Maqedonisë (midis Kaludhit dhe Petranit), një relik bimore mesdhetare. Gjatë shtratit të Vjosës rritet rripi dhe shelgu. Shpesh me makjet takohen edhe bungëbuta, panja, bliri, krekëza, shkoza, mëllëza etj.

Lugina dhe lumi i Dëshnicës

Lugina e Dëshnicës, degë e djathtë e Vjosës, përbëhet nga dy degë kryesore që bashkohen në afërsi të fshatit Ballaban shtrihet në pjesën perëndimore të nënzonës së Dëshnicë-Vokopelë. Gjatësia e përgjithshme e luginës është rreth 23 km. Ajo kalon pothuajse në zonën e kontaktit të sinklinalit të Zhepovës dhe antiklinalit të Trebeshinës. Shmangia e luginës është rreth 23 km. Ajo kalon pothuajse në zonën e kontaktit të sinklinalit të Zhepovës dhe antiklinalit të Trebeshinës. Shmangia e luginës nga boshti i sinklinalit ka ndodhur për shkak të ngritjes më të madhe të Trebeshinës. Shpatet e luginës dallohen për asimetri të theksuar për shkaqe strukturore dhe litologjike. Shpati i majtë është tepër i gjerë dhe i butë, kurse i djathti është më i ngushtë dhe më i pjerrët. Në shpatin e majtë kemi tipin e relievit erozivo-denudues, që është tepër i përçarë nga një numër i madh rrëkesh e përroshkash për shkak të burimeve që dalin nga kjo anë dhe përbërjes flishore. Ko ka çuar në krijimin e vatrave erozive mjaft aktive dhe sot, të cilat rrezikojnë tokat bujqësore. Kurrizet ujëndarëse midis përrenjve ngushtohen gjithnjë e më shumë duke çuar në zvogëlimin e sipërfaqes së tokës bujqësore.





Lugina e Dëshnicës ka profil tërthor në formën e govatës, me fund të gjerë e të sheshtë dhe me shpate që ngrihen gradualisht. Duke filluar nga fshati Ballaban e deri në afërsi të qytetit të Këlcyrës është formuar një fushë e gjerë aluvionale. Gjerësia më e madhe arrin në fshatin Ballaban e Sukë 500-600 m dhe gjatësi rreth 6 km.

Duke filluar nga grykëderdhja e përroit të Leskovecit deri në Këlcyrë, lugina e Dëshnicës fillon të ngushtohet mbasi çan përmes materialeve të shumta copëzore të ardhura nga shpati i trebeshinës. Këto material ka mundësi të kenë origjinë akullnajore.

Mbulesa bimore përfaqësohet nga kati I shkurreve mesdhetare të tipit të makjes në luginat e përrenjve dhe nga dushku në shpatet dhe kurrizet e kodrave. Tipat kryesorë të tokave janë tokat e hinjta kafe dhe të kafejta.



Vargu Trebeshinë-Dhëmbel. Ky vargmal fillon me malin e Trebeshinës në Veri perëndim (tek Qafa e Kiçokut).

Trebeshina shtrihet ndërmjet Qafës së Kiçokut dhe Grykës së Këlcyrës në një gjatësi prej rreth 18 km dhe lartësi maksimale 1922 m. Ndërtohet tërësisht nga gëlqerorë të paleogjenit dhe pjesërisht nga flishe (në këmbët e malit). Trebeshina formon një strukturë antiklinale, asimetrike të tipit sëndukor. Amplituda hipsometrike luhet nga 1000 m në shpatin perëndimor, në 1500 m në atë lindor. Parametrat e copëtimit horizontal lëvizin nga 1-5 km/km², ndërsa energjia e relievit, në sektorë të veçantë arrin 500-700 m/km² (në shpatin lindor dhe juglindor). Kushtet morfometrike nxitin proceset e shpatit si rrëzimet, shkarjet dhe përrenjtë gurorë. Kurrizi i malit, për shkak të strukturës, është i shtruar, me rënie graduale në drejtim të veri-perëndimit dhe i modeluar fuqimisht nga bora dhe karsti. Lidhur me karstin, mbizoteron një peizazh me githfarë formash nga hinkat deri tek lugjet e proskat karstike.

Shpati lindor i Trebeshinës që bie në luginën e Dëshnicës është i rregullt dhe ka natyrë karstike. Gjatë tij zbresin disa përroska të thata e të cekëta. Profili tërthor në pjesën e sipërme është i lugët dhe herë-herë i mystë. Në rrëzën e këtij shpati, në afërsi të Katundishtës, vërehen koluvione, të cilat aktualisht janë të stabilizuara. Në të njëjtin drejtim me to, në luginën e Dëshnicës, matanë shtratit të lumit ndërmjet Sukës dhe Këlcyrës, ruhen të njëjtat depozitime në formë proluvionesh, të vendosura mbi flishe në një sipërfaqe prej 4 km². Këto depozitime mund të jenë me origjinë lum-akullnajore të cilat janë transporuar gjatë periudhës së shkrirjes së akujve. Shpati perëndimor i Trebeshinës është shumë i pjerrët dhe thuajse tërësisht i zhveshur.

Dhëmbeli, që përbën halkën e mesme të këtij vargu, shtrihet nga Gryka e Këlcyrës deri tek Qafa e Dhëmbelit, në një gjatësi rreth 16 km dhe gjerësi 3-5 km. Ndërtohet tërësisht nga gëlqerorë të paleogjenit, më pak nga ata të kretakut dhe flishe.

Kuota më e lartë është 2050 m dhe gjendet në pjesën jugore të tij. Dendësia e copëtimit të relievit lëviz nga 1-5 km/km², ndërsa energjia e tij është më e lartë në shpatin perëndimor (deri në 700 m/km²). Kurrizi i malit është i rregullt me valëzime të lehta dhe rënie graduale në drejtim të Grykës së Këlcyrës. Dukuritë karstike janë mjaft të përhapura, sidomos ato sipërfaqësore si shkrepja, hinka, vrima e forma më të mëdha. Shpati lindor i Dhëmbelit është jo fort i pjerrët dhe pak i përçarë nga rrjeti hidrografik, i cili ka karakter të theksuar karstik.



Shpati perëndimor është më i pjerrët dhe në të mbizotëron tipi i relievit stukturoro-denudues. Në rrëzën e shpatit vërehen deluvione të ardhura nga pjesët e sipërme të tij. Dhëmbeli ndahet nga Nemërçka me anë të Qafës së Dhëmbelit, 1400 m mbi det, e cil, është me origjinë tektonike. Ajo ka pamjen e një grope karstike të përzgjatuar në drejtim lindje-perëndim, me fund të lugët e relativisht të gjerë, me mure rrethuese të larta e të pjerrëta.

Mbulesa bimore e vargut Trebeshinë-Dhëmbel-Nëmërçkë është e varfër. Sigurisht kushtet për rritjen e pyjeve, sidomos në terrenet e thepisura gëlqerore, nuk janë të volitshme, por këtu ka ndikuar shumë edhe prerja sistematike e pyjeve, zjarret etj. Pyjet formojnë korije të vogla të shpërndara aty-këtu, sidomos në luginat e viset e mbrojtura, me toka me lagështirë më të madhe. Përhapjen më të mëdha e kanë dushqet, lathitë e më rrallë halorët e ahu (kryesisht në Nemërçkë).

Vargu përmendet për kullotat e pasura verore sidomos në Trebeshinë e Dhëmbel.

Malësia e Dangëllisë dhe e Leskovikut shtrihet midis luginës së Lemnicës dhe asaj të Kreshovës në veri e veriperëndim, luginës së Vjosës në jug e juglindje dhe pellgut të Kolonjës në lindje.

Ndërtohet kryesisht nga flishe dhe gëlqerorë. Këta të fundit dalin në formën e pullave të vecanta në qendër të malësisë (Kokojkë, Lemnicë, Borockë, Lengaricë, Postenan dhe Melesin). Kjo bërthamë karbonike është vazhdim i strukturës antiklinale të Tomorit.

Malësia e Dangëllisë shtrihet në juglindje të Dëshnicës, prej së cilës ndahet nga lugina e Lemnicës dhe ajo e Kreshovës. Në ndërtimin strukturor të saj marrin pjesë antiklinali i Lemnicës (në JL ai vazhdon me atë të Postenan -Melesini), që është vazhdim i antiklinalit të Tomorit dhe sinklinali i Frashërit.

Në Dangëlli dallohet vetëm një varg malor që ndahet në tre degë. Shpatet e këtij vargu janë asimetrike për shkak të mbihijes së strukturave nga lindja në perëndim dhe të litologjisë. Shpesh ai është prerë tërthor nga luginat e lumenjve, të cilat në sektorë të vecantë kanë krijuar gryka të ngushta e të thella me shpate shumë të rrëpirëta, si ajo e Lemnicës dhe e Lengaricës. Kjo dëshmon për ngritjen e shpejtë të saj. Atje ku territoret flishore janë zhveshur nga mbulesa bimore kemi një copëtim të madh horizontal me vlera mbi 5 km/km² (Frashër, Ogren, Gostivisht etj). Këto sipërfaqe janë të erodura fuqishëm dhe në to janë krijuar vatra të shumta erosive.

Dega e parë e këtij vargu malor fillon në qafën e Micanit (1146 m) dhe vazhdon me malin e Qelzës (1662 m), Qafën e Dëllënjës (1356 m), dhe mali Piskalit (1437 m) që ulet gradualisht në rrjedhën e sipërme të Lengaricës. Ai formon një reliev me pamje të valëzuar dhe shpate asimetrike. Pika më e lartë arrin në malin e Qelzës dhe dallohet qartë në mjedisin rrethues.

Në perëndim të saj, rreth 1000 m mbi nivelin e detit, ndodhet një nga gropat më interesante për morfologjinë e saj, gropa e Frashërit. Ajo ka formën e një elipsoidi, rrethuar nga mallet e Qelzës dhe Zavalanit nga lindja dhe Kreshovës e Kokojkës nga perëndimi. Fundi shumë i copëtuar i saj, përbën shtratin e përroit të Frashërit dhe Selenicës. Përroskat që zbresin nga mallet përreth kanë sjellë materiale të shumta copëzore.





Gropa e Frashërit është formuar thujtse në boshtin e sinklinalit të Frashërit, kurse modelimi i saj i detyrohet veprimtarisë së fuqishme erozivo-denuduese dhe ngricave, të cilat këtu janë mjaft të theksuara.

Në pjesën lindore të saj vërehet një reliev kuestor, i formuar nga alternimi i gëlqerorëve me flishin. Kuesti me gjatësi rreth 3-4 km, fillon prej Qafës së Lekës në VP deri në afërsi të fshatit Zavalan në JL në lartësinë rreth 1300 m. Balli i kuesti është ndrejtim të kundërt të rënies së shtresave. Poshtë tij gjenden edhe dy kueste të tjera. Përmes tyre kalon Qafa e Shkëmbit (1100 m); që lidh gropën e Frashërit me Qafën e Dëllënjës, prej së cilës kalohet në gropën e Kolonjës. Në perëndim të gropës së Frashërit lartësohet dega e dytë e vargut malor, ku dallohen një sërë majash me forma të rrumbullakosura, të ndara midis tyre prej qafash jo të larta dhe luginave të përrenjve. Drejtimi i përgjithshëm është VP-JL, në përputhje me shtrirjen e strukturës. Kjo degë fillon me malin e Lajthisë (1040m) dhe të Kreshovës (1246 m) në VP, duke vazhduar me Kokojkën e Frashërit (1549 m) dhe Taborin (1572 m) më në jug të tij. Në drejtim të JL lartësohet Çuka e Luarit (1021 m) që ulet gradualisht në drejtim të luginës së Lengaricës, pas së cilës ngrihet përsëri me malin e Teperit (1041 m) dhe atë të Vinjakut (819m).

Shpatet jugore dhe jugperëndimore të tyre janë thujtse të zhveshura nga mbulesa bimore dhe tepër të gërryera nga një numër i madh përroskash që shënojnë fillimin e luginës së Lemnicës. Majat e tyre gëlqerore janë në kontrast me shpatin perëndimor dhe VP të Kokojkës së Frashërit dhe Taborin mbuluar me një bimësi të dendur, vecanërisht me dushk dhe bredh të Maqedonisë (bredhi i Hotovës). Lugina e Lemnicës kalon tërthor strukturës me të njëjtin emër. Në këtë mënyrë si pasojë e lëvizjeve ngritëse, lumi ka çarë thellë gëlqerorët duke formuar prerje erosive në formë kanioni si ato në Borockë, Kamenicë e gjetkë. Këto kanione janë disa metra të thella, nga 5-10 m të gjera dhe 500-600 m të gjata.

Në muret vertikale të tyre janë krijuar guva dhe shpella karstike, ndërsa në hapësirën e kanionit të krijuar si rezultat i erozionit diferencial Lugina e Lemnicës fillon nga mali i Kokojkës dhe përfundon në Vjosë në afërsi të fshatit Piskovë. Në fillim ajo është e ngushtë në formën e germës "V", por vjen duke u zgjeruar nga Pagria në grykëderdhje. Aty vërehet qartë niveli i zallishtes si dhe tarraca e parë erozivo-akumuluese me lartësi 10-15 m mbi shtratin aktual të lumit.

Në JP të Dangëllisë shtrihet dega e tretë e vargut malor, e cila fillon nga Hotova e Mokrica në VP deri tek Mali i Bardhë (451 m) në JL. Ai ndërpritet nga luginat e përrenjve të Hotovës dhe Bodarit. Pika më e lartë është mali i Mokricës (803 m), i cili drejt jugut ulet gradualisht të Mali i Bardhë, ku përfundon në luginën e Lengaricës dhe të Vjosës. Në figurën 10 është paraqitur harta topografike e Bashkisë Këlcyrë.







Figura 10. Harta topografike, Bashkia Këlcyrë








4.1.3. Hidrologjia

Pellgu hidrologjik i Bashkisë Këlcyrë përbëhet nga lumi Vjosa dhe nga lumi i Dëshnica. Lumi Vjosa rrjedh gjithsej rreth 12 km brënda territorit të Bashkisë së Këlcyrës. Për nga prurja, lumi Vjosa, është lumi i dytë më i madh i Shqipërisë mbas lumit Drin. Ai buron në Greqi, dhe mbas hyn në Shqipëri në sektorin e Tre Urrave, rrjedh gjatë gjithë territorit të Bashkisë Përmet dhe rreth 5.5 km në jug të qytetit të Këlcyrës hyn në territorin e kësaj bashkie. Prurja e lumit është mjaft e ndryshme; sipas të dhënave të "Hidrologjia e Shqipërisë" – 1984, rrjedhja mesatare vjetore në Këlcyrë është 80.8 m³/s (pellgu ujqor 3060 km²), kurse rrjedhja vjetore me siguri 90% është 54.9 m³/s. Prurjet më të mëdha të lumit në Këlcyrë luhaten rreth 700-750 m³/s. Lumi Dëshnica ka një pellg ujqor prej 173 km² i cili i gjithi ndodhet brënda territorit të Bashkisë Këlcyrë. Prurja mesatare vjetore e lumit Dëshnica në derdhje (në lumin Vjosa-Këlcyrë) është 3.33 m³/s, kurse prurja me siguri 90 është 2.10 m³/s. Ky lumë i cili ka më shumë karakterin e një përroi malor i cili karakterizohet nga prurje shumë të mëdha në perjudhë rreshjeh torencale, prurja mesatare maksimale është 123 m³/s, kurse prurjet maksimale absolute i kalojnë 200 m³/s.

Përshkrimi gjeologjik është bazuar në Hartën Gjeologjike të Shqipërisë në shkallë 1:200.000, botimi vitit 2004, në tekstin sqarues të saj si dhe Hartat gjeologjike Shkallë 1: 100.000 të qarqeve të botuara nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar.

Në pikëpamje gjeologjike në territorin e Bashkisë Këlcyrë dallohen dy sektorë me ndërtim gjeologjik të ndryshëm, sektori perendimor dhe sektori lindor. Sektori perendimor përfshin gjithë pjesën e lartë malore ku hyjnë mali i Trebeshinës dhe ai i Dhëmbelit. Të dy malet ndërtohen nga shkëmbinj karbonatikë që në pikëpamje moshore fillojnë nga Jurasiku i poshtëm deri në Eocen (Figura 11). Formacionet karbonatike janë të ndryshme; ato më të vjetrat Jurasiket, karakterizohen nga gëlqerorë, gëlqerorë mergelore dhe argjilore shtresë hollë dhe pllakorë me stralle. Gëlqerorë e kretakut zakonisht janë shtresë hollë deri në shtresë trashë, shpesh janë argjilore dhe porcelanikë. Gëlqerorët e paleocenit dhe të eocenit janë kryesisht turbididikë, shtresorë.

Sektori lindor i Bashkisë Këlcyrë, fillon që nga mezi i lartësisë së shpatit lindor të sektorit malor, dhe mbulon krejt territorin e bashkisë deri në ujëndarësin me Qarkun e Beratit (Harta 8). Flishet janë të moshës së eocenit (Pg2) dhe të oligocenit (Pg3) dhe përfaqësohen kryesisht nga ndërthurje ritmike shtresash argjilore, alevrolitor dhe ranore. Depozitimet më të reja, ato të holocenit, përbëjnë një mbulesë dherash aluviale të shkrufta kokërndryshme nga zhavorre deri në argjila si dhe shtresa konglomeratike. Ato përhapen vetëm në luginën e lumit Vjosa ku ndërtojnë terracën e parë mbizallishore dhe kanë trashësi maksimale rreth 15 m. Në luginën e lumit Dëshnica depozitime e reja të holocenit kanë përhapje të kufizuar, ato mbushin kryesisht shtratin e rrjedhjes së lumit, kanë përbërje zhavorrore dhe trashësi deri rreth 3 m.






Figura 11. Harta gjeologjike, Bashkia Këlcyrë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)



4.1.4. Pasuritë minerale

Territori i bashkisë së Këlcyrës ka depozitime metalesh jo metalore dhe mungojnë pothuaj plotësisht mineralet metalore. Ndër mineralet jo metalore mund të përmendim gëlqerorët, gurë dekorativë dhe argjila (Figura 12). Vendburimet kryesore janë përshkruar shkurtimisht më poshtë:

- ✦ *Vendburimi i gëlqerorëve i Këlcyrës.* Vb vendoset në formacionet karbonatike të eocenit të përfaqësuar nga gëlqerorë kristalin shtresëtrashë të pjesës së sipërme të prerjes. Shtresat gëlqerore paraqiten të trasha deri masive, janë shumë kristalinë më ngjyrë të bardhë qumështi. Poshtë këtyre shtrihen gëlqerorë shtresorë pelitomorf me ngjyrë hiri në të bardhë. Tipi i mineralizimi është sedimentar. Pakot produktive përfaqësohen nga gëlqerorë pelitomorfë mikrokristalinë me ngjyrë hiri të bardhë deri gri të kaltër me nuancë në bezhë. Kryesisht janë me shtresëzim të hollë 0.03 – 0.20m. Elementët e rënies së shtresave 50-600 / 20-250. Përbërja mesatare kimike e pakos së gëlqerorëve që shfrytëzohen është: CaO = 48.5 – 54% mesatarisht është 51.2%; MgO = 0.7 – 1.8% mesatarisht është 1.25%; SiO₂ = 0.6 – 0.8% dhe mesatarisht është 0.70%, Al₂O₃ = 0.8 – 0.92 është mesatarisht 0.85%, Fe₂O₃ = 1.4 – 1.8% është mesatarisht 1.6%. Sasia e rezervave: Janë llogaritur C1= 400 000 m³.
- ✦ *Vendburimi i gurëve dekorativë i Ballabanit.* Mineralizimi ka dalje në sipërfaqe dhe përfaqësohet nga një pako me ndërthurje ranorësh mikro kokrrizorë dhe alevrolitikë dhe argjilitë me trashësi të përgjithshme 8-10 m. Vendosen brenda depozitimeve të Pg₃¹ dhe vërehet shtresëzim 0,15-0.30 m. Pakot produktive kanë trashësi 0,20 – 0,50 m me ngjyrë gri me nuance jeshile në thellësi, ndërsa në sipërfaqe marrin ngjyrë gri në bezhë nga oksidimi i mineraleve hekurorë. Shtresat janë me çimentim silicor-karbonatik. Tipi i mineralizimit është sedimentar dhe sasia e rezervave është: C1 = 55 500 m³, C2 = 72 150 m³ dhe C1 + C2 = 127 650 m³. (Burimi: Nora & Joka, 2006).
- ✦ *Shfaqja e gurëve dekorativë e Këlcyrës.* Formacionet gjeologjike ku vendoset shfaqja e ranorëve janë depozitimet argjilo – alevrolitike të Pg₃¹. Ranorët kanë trashësi 1 – 1,2 m, ka elementë të shtrishmërisë 50 – 60 0 / 30 – 350. Ranorët paraqiten mikrokokrrizor me strukturë massive brenda. Përbërjen kryesore të tij e formojnë kokrrizat deri 1 – 1,15 mm të shkëmbinjve magmatike. Tipi i mineralizimit është sedimentare. Sasia e rezervave të llogaritura rreth 575 000 m³.



Figura 12. Harta e pasurive minerale, Bashkia Kelcyre (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

4.1.5. Hidrogeologjia

Kushtet hidrogeologjike të territorit të Bashkisë Këlcyrë paraqiten në hartat hidrogeologjike të Shqipërisë në shkallë 1:200.000 dhe në atë me shkallë 1:100.000. Zona e Këlcyrës karakterizohet nga prania e tre tipeve shkëmbinjsh me karakteristika hidrogeologjike krejt të ndryshme: shkëmbinj gëlqerorë, shkëmbinj flishorë dhe dhera zhavorrore-argjilore (Figura 13).

Shkëmbinjtë gëlqerorë kanë rezerva të mëdha ujërash nëntokësore. Ata ndërtojnë pjesën perendimore të territorit dhe lidhen me varg-malin Trebeshinë-Dhëmbel. Gëlqerorët kanë çarshmëri të lartë si dhe janë të karstëzuar gjë që manifestohet me hapësirat e mëdha karstike që ato përmbajnë si karie, hinka dhe shpella karstike. Si rezultat infiltrimi i rreshjeve atmosferike në to është i lartë, zakonisht mbi 50% e rreshjeve shkon për ushqimin e ujërave nëntokësore karstike.

Po te kemi parsysh sipërfaqen e madhe që zënë gëlqerorët (rreth 60-65 km²), si dhe sasinë e madhe të rreshjeve vjetore në këtë zonë (rreth 1300 mm) kuptojmë se rezervat e përgjithëshme të ujërave karstike mbriknë mesatarisht disa m³/s, ose rreth 40.000.000 m³/vit. Rezervat e mëdha të ujërave karstike lëvizin drejt Grykës së Këlcyrës ku edhe drenohen në formë burimesh të mëdhenj prurja e të cilëve është shumë e ndryshueshme gjatë vitit. Në Grykën e Këlcyrës, brënda territorit të Bashkisë së Këlcyrës drenohen dhe ujërat e asaj pjese të Malit të Dhëmbelit që nuk përfshihet në këtë Bashki. Si rrjedhim rezervat e ujërave karstike që shkarkohen (drenohen) në Grykën e Këlcyrës janë disa herë më të mëdha se ato që ushqehen nga infiltrimi i rreshjeve brënda territorit të Bashkisë.

Burimi më i madh është Syri i Zi i cili buron rreth 1.2 km në perëndim të Këlcyrës. Dalja e burimit është në nivelin e lumit Vjosa por prurja e madhe e burimit nuk lejon të përmytet nga lumi edhe në kohën e plotave. Prurja e burimit luhetet nga rreth 1-1.5 m³/s deri në mbi 7-8 m³/s.

Po kështu në largësi rreth 2 deri 5 km në perëndim të Këlcyrës dalin burime të tjerë karstikë, njëri prej të cilëve formon një ujëvarë të vogël por shumë të bukur që është fshehur në mënyrë të pa justifikuar nga klube dhe restorant të vendosura në vendin e gabuar; ata e maskojnë rrjedhjen e bukur të ujërave karstike e cila më parë përbënte një atraksjon të vërtetë turistik. Tashti duhet të shikojmë ujin karstik nëpërmjet dyshemesë me xham transparent të restoranteve dhe klubeve.

Shkëmbinjtë flishorë, të treguar në Hartë me ngjyrrë bezhë (Harta 10) zënë pothuaj dy të tretat e territorit të Bashkisë. Këta shkëmbinj të cilët përfaqësohen nga ndërthurje ritmike shtresash alevrolitësh, argjilash dhe ranorësh dallohen për porozitet aktiv shumë të ulët. Si rrjedhim flishet paraqiten si shtresa ujëizoluese dhe praktikisht nuk përmbajnë ujëra nëntokësore të rëndësishme.

Vetëm në rastet kur shtresat ranore paraqiten më të trasha ato përmbajnë rezerva ujore të vogla dhe formojnë burime zakonisht me prurje më të vogël se 0.1 l/s. Pjesa më e madhe e fshatrave të Bashkisë së Këlcyrës vendosen në formacione flishore dhe rrjedhimisht ndjejnë së tepërmi mungesën e ujit si për nevoja komunale ashtu edhe për ujitje.

Dherat zhavorrore-argjilore mbushin pjesën e sipërme të luginës së lumenjve Vjosa dhe Dëshnica. Në luginën e lumit Vjosa ato përfaqësohen nga zhavorre dhe shtresa të trasha konglomeratike të cilat në sipërfaqe kanë një mbulesë suargjillore. Këto depozitime përmbajnë ujëra nëntokësore të cilat mund të shfrytëzohen me anë pusesh me thellësi maksimale rreth 30 m, megjithatë duhet nënvizuar se ato nuk janë studiuar mjaftueshëm në pikëpamje hidrogeologjike.




Figura 13. Harta hidrogeologjike, Bashkia Këlcyrë (Burimi. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)



4.1.6. Gjeologjia inxhinierike

Kushtet e përgjithëshme gjeologo-inxhinierike tregohen në figuren 14. Llojet shkëmbore që gjenden në territorin e Bashkisë këlcyrë ndahen në dy grupe:

- ☐ Shkëmbinj të fortë
- ☐ Shkëmbinj mesatarë

Shkëmbinjtë e forte, Rsh > 500 bar. Në harte ngjyrosen më ngjyre të kuqe. Në këtë grup janë klasifikuar shkëmbinjtë karbonatike që përfaqësohen nga gëlqeroret jurasikë, kretak dhe eocenikë të cilët ndërtojnë strukturat karbonatike të strukture së Trebeshinë Dhëmbelit. Parametrat gjeoteknike mesatarë të tyre janë dhënë në Tabelën 4.

Shkëmbinjtë mesatare, Rsh 50 – 500 kg/cm². Në hartë ngjyrosen me ngjyre manushaqe dhe përfaqësohen nga depozitimet flishore e flishoidale që ndërtojnë zonën kodrinore. Parametrat gjeoteknike mesatarë të tyre janë dhënë në Tabelën 5.


Klasifikimet gjeoteknike të dherave marrin parasysh vetitë ndërtuese ose tregues që ndikojnë në projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin normal të veprave gjeologo-inxhinierike. Dherat simbas kohezionit janë klasifikuar në dy grupe:

Dhera me kohezion

Dhera pa kohezion

Tabela 4. Parametrat gjeoteknike mesatarë të shkëmbinjve

Parametri	Shkëmbinj të fortë	Shkëmbinj mesatarë
Pesha volumore (Δ) (gr/cm ³)	2,5 – 2,8	2,1 – 2,5
Poroziteti (n) (%)	1,0 – 5,0	5,0 – 15,0
Rezistenca në shtypje njëboshtore (Rsh) (kg/cm ²)	500 – 2000	200 – 400
Moduli i elasticitetit (E) (kg/cm ²)	104 – 106	103 – 3x104
Koeficienti i Puasonit (μ)	0,15 – 0,35	
Ngarkesa e lejuar (σ) (kg/cm ²)	> 20	10 – 15






Figura 14. Harta gjeologjiko-inxhinierike, Bashkia Këlcyrë (Burimi: Shërbimit Gjeologjik Shqiptar)

Dhera me kohezion në harte ngjyrosen më ngjyre të verdhe dhe përfaqësohen nga surëra deri në suargjila të vendosura mbi zhavorre (Szh): Suargjila vendosen kryesisht mbi zhavorret aluviale të tarracave të lumenjve dhe përmbajnë të material argjilore dhe alevrolitore; ato kanë trashësi nga 1 – 2 m derinë 10 – 15 m. Vetitë e tyre ndikohen negativisht nga prezenca e ujërave rrjedhës sipërfaqësore. Parametrat gjeoteknike të tyre janë dhënë në Tabelën 5.



Tabela 5. Parametrat gjeoteknike mesatarë të shkëmbinjve

Parametri	Dhera me kohezion	Dhera pa kohezion	
		Zhavorre e popla aluviale	Rërat
Kufiri i sipërm i plasticitetit (Wr) (%)	25 - 33		
Kufiri i poshtëm i plasticitetit (Wp) (%)	18 - 21		
Pesha volumore në gjendje natyrale (Δ) (gr/cm ³)	1,75 - 1,95	1,6 - 2,1	1,75 - 1,95
Kendi i fërkimit të brendshëm (φ)(°)	14 - 22	38 - 42	20 - 28
Kohezioni (c) (kg/cm ²)	0.15 - 0,25	0	0
Moduli i deformacionit (E) (kg/cm ²)	40 - 100	500- 800	80 - 150
Ngarkesa e lejuar (σ) (kg/cm ²)	1,6 - 2,5	2,8 - 4,0	2.2 - 3,0
Poroziteti (n) (%)		30 - 85	38 - 50
Koeficienti i filtrimit (Kf) (cm/s)		5x10 ⁻² - 5x 10 ⁻¹	10 ⁻⁴ -10 ⁻³


Dhera pa kohezion (c=0), në harte ngjyrosen më ngjyre portokalli. Ato janë zhavorre e popla dhe rana më origjinë aluviale dhe proluviale që mbushin kryesisht luginën e Vjosës, Lemnicës dhe Lëngaricës e fushave aluviale e të tarracave lumore. Trashësia e tyre maksimale në luginën e Vjosës ndryshon nga një sektor në tjetrin nga disa metra deri në 30-40m. Poshtë tyre shtrihen konglomeratet. Përbërja e zhavorreve është: gëlqerore (rreth 50-60%) ranore (30-40%) dhe magmatike (5-15%).

Zhavorre e popla aluviale dhe proluviale me madhësia të copave të tepër heterogjene. Parametrat gjeoteknike të tyre janë Parametrat gjeoteknike të tyre janë dhënë në Tabelën 5.

Rërat (R): Mund të jenë rëra nga kokrizë-madhe deri kokrizë-imët deri në surëra, me trashësi nga 2 deri në 20 m. Parametrat gjeoteknike të tyre janë dhënë në Tabelën 5.

Fenomenet e rrezikut gjeologjik, përhapja dhe përshkrimi i tyre

Në territorin e Bashkisë Këlcyrë gjejnë përhapje elemente të rrezikut gjeologjik, të cilat dëmtojnë objektet inxhinierike që ndërtohen në këtë territor. Si rezultat i proceseve të vazhdueshme tektonike në përgjithësi dhe atyre të denudimit në veçanti, prishet gjendja e masiveve shkëmbore në shpate, për rrjedhojë shkëputen masa shkëmbi të përmasave të ndryshme në formën e rrëzimeve, shembjeve, rrëshqitjeve etj, vëllimi i të cilave arrin nga disa deri dhjetra milion m³. Sikurse duket në figuren 15, dukuritë kryesore të rrezikut gjeologjik që takohen në bashkinë e Këlcyrës janë: erozioni, rrëzimet e gurëve dhe fenomenet karstike.






Figura 15. Harta e rezikut gjeologjik, Bashkia Këlcyre. (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Erozioni është fenomeni më i përhapur, ku zona të tëra, ku përhapen formacionet argjilore e flishore (Figura 16), si në zonën kodrinore të Bashkisë Këlcyre janë të prekura nga ky fenomen, i cili nga ana e tij është ndihmuar në një masë shumë të madhe nga shpyllëzimet e shumta që u bënë gjate viteve '80 – '90 të shekullit të kaluar. Erozioni sipërfaqësor është karakteristik për lartësitë deri 800-1000 m.

Më pak të gërryeshëm janë shkëmbinjtë gëlqerorë. Erozioni sipërfaqësor fillon me rrekëzat e rrëketë, përroskat deri në përrenjtë me thellësi dhe gjerësi disa dhjetëra metra. Këtu mund të



përmenden sektorët ku zhvillohen më shumë depozitimet argjilore, flishore si në rrjedhjen e lumenjve Vjosa dhe, Lermnica e Lëngarica.

Mbulesa vegjetale, sidomos ajo më lartësi të vogël, luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e qëndrueshmërisë së shpatit. Ajo, nga njëra anë, ruan shpatin nga depërtimi i lagështisë, nga ana tjetër, konsumon një vëllim të madh uji gjatë transpiracionit duke e mbajtur shpatin të thatë. Shpyllëzimet e kryera në vendin tone gjatë viteve 1968-1990 në zonat kodrinore, të përbëra kryesisht nga depozitimet flishore dhe mollasike aktivizuan në shpate shkëputjen e masave shkëmbore të tjetërsuara.

Rrëzimet e copave ose të blloqeve më rrokullisje, përmbysje ose shembje të menjëhershme janë karakteristike për shkëmbinjtë e forte ose mesatarisht të fortë. Ato lindin në shpate me pjerrësi të madhe nën ndikimin e proceseve të tjetërsimit, sidomos ndryshimit të temperaturës, ngrirjes dhe shkrirjes së ujit në çarje, veprimtarisë së rrënjëve të bimëve etj. Madhësia e copave që shkëputen është në varësi të vetive fizike të shkëmbinjve. Rreze shpateve të shkëmbinjve të forte grumbullohen copa me përmasa të vogla që shpesh formojnë pjerrësi shpati 36-370. Ato takohen në shpatet gëlqerore të Grykës së Këlcyrës dhe për rritjen e qëndrueshmërisë së shpateve në fjalë janë mbjellë pisha.

Dukuritë karstike janë të zhvilluara në vargmalin Trebeshinë-Dhembel. Në zonën tone të studimit dukuritë ka karstike sipërfaqësore ashtu edhe nëntokësore. Dukuritë sipërfaqësore këtu nuk kanë ndonjë zhvillim shumë intensive sikurse ka në disa zona të tjera karstike të vendit tone. Ato janë kryesisht forma të korozionit karstike si karie të cialt zhvillohen në krejt sipërfaqen karstike dhe hinka karstike të madhësive të ndryshme që zhvillohen kryesisht në pjesët më të larta afër kreshtës malore.




Figura 16. Formacion flishore në sektorin Vinokash-Ballaban



Ndër format nëntokësore mund të përmendim shpellat të cilat gjithashtu janë të rralla; shpella më e madhe e njohur është ajo e Petranit e cila ndodhet në shpatin e majtë të lumit Vjosa rreth 600 m në perëndim të qendrës së Këlcyrës. Kjo shpellë ka gjatësi rreth 30 m dhe pastaj vazhdon me një sifon dhe mesa duket vazhdon dhe përtej saj. Në dukuritë karstike duhen përfshirë dhe burimet karstikë të cilat I kemi përshkruar në paragrafin e hidrogeologjisë. Dukuritë karstike në Bashkinë e Këlcyrës nuk përbëjnë ndonjë problem negativ që vështirëson ndërtimet këtu ose organizimin e përditëshëm jetësor. Ato zhvillohen kryesisht në lartësi të mëdha ku nuk ka veprimtari jetësore intensive, dhe kur ato zhvillohen në lartësi të vogëla, si në grykën e Këlcyrës, ato kanë qëndrueshmëri dhe nuk krijojnë pasoja negative.

Tabela 6. Parametrat gjeoteknike të dherave


Parametri	Dhera me kohezion	Dhera pa kohezion	
		Zhavorre e popla aluviale	Rërat
Kufiri i sipërm i plasticitetit (Wr) (%)	25 - 33		
Kufiri i poshtëm i plasticitetit (Wp) (%)	18 - 21		
Pesha volumore në gjendje natyrale (Δ) (gr/cm ³)	1,75 - 1,95	1,6 - 2,1	1,75 - 1,95
Këndi i fërkimit të brendshëm (ϕ) (°)	14 - 22	38 - 42	20 - 28
Kohezioni (c) (kg/cm ²)	0.15 - 0.25	0	0
Moduli i deformacionit (E) (kg/cm ²)	40 - 100	500 - 800	80 - 150
Ngarkesa e lejuar (σ) (kg/cm ²)	1,6 - 2,5	2,8 - 4,0	2,2 - 3,0
Poroziteti (n) (%)		30 - 85	38 - 50
Koeficienti i filtrimit (Kf) (cm/s)		$5 \times 10^{-2} - 5 \times 10^{-1}$	$10^{-4} - 10^{-3}$

Dhera pa kohezion ($c=0$), në harte ngjyrosen më ngjyre portokalli. Ato janë zhavorre e popla dhe rana më origjinë aluviale dhe proluviale që mbushin kryesisht luginën e Vjosës, Lemnicës dhe Lëngaricës e fushave aluviale e të tarracave lumore. Trashësia e tyre maksimale në luginën e Vjosës ndryshon nga një sektor në tjetrin nga disa metra deri në 30-40m. Poshtë tyre shtrihen konglomeratet. Përbërja e zhavorreve është: gëlqerore (rreth 50-60%) ranore (30-40%) dhe magmatike (5-15%).

4.1.7. Tokat

Bashkia Këlcyrë është e vendosur një territor me karakter kodrinoro-malor nga lartësia 230m deri në 1100m mbi nivelin e detit. Bashkia Këlcyrë shtrihet midis vargmaleve Trebeshinë -Dhëmbel dhe malit të Qarrishtës dhe përshkohet nga dy lumenj ai i Vjosës dhe i Dëshnicës duke krijuar dy lugina të ngushta në të cilat shtrihen rreth 500 ha tokë bujqësore e cila ka mundësi të futet e gjitha në ujë. Mikroklima e zones është mesdhetare dhe paramalore me vere të nxehte e të thate dhe dimër të ashpër e me lageshti.

Tokat në territorin e Këlcyrës kanë cilësi të ulët. Përsa i përket bonitetit, në Bashkitë e Përmetit, Këlcyrës dhe Skraparit boniteti i tyre nuk është përcaktuar. Struktura e tokës bujqësore dominohet nga toka arë (5.664 ha). Ndërsa pemishtet dhe vreshtat zënë një sipërfaqe të vogël, respektivisht 52





dhe 82 ha. Sipërfaqe më e madhe e tokës arë dhe e pemishteve shtrihet në Sukë, ndërsa sipërfaqja më e madhe e vreshtave shtrihet në Ballaban dhe Sukë. Tokat e dedikuara për bujqësi gjenden kryesisht në zonat fushore të territorit të Bashkisë, kryesisht përgjatë luginës së Vjosës (Figura 17).

Në Bashkinë e Këlcyrës shtrihen më të madhe e kanë tokat kafe. Ky tip toke është shumë i përhapur, pothuajse në 40 % të sipërfaqes totale. Këto toka janë mesatarisht të thella. Ky tip toke është i vendosur mbi formacionin gjeologjik sedimentar, duke bërë që të jenë të rrezikuara nga erozioni sipërfaqësor.

Në përgjithësi janë toka me strukturë kokrëzore jo vetëm në sipërfaqe por edhe në thellësi, me përqindje mbi mesatare të argjilës fizike duke i vlerësuar këto toka si SAR. Gjenden në fshatrat Vinokash, Vinokash Fushë, Mazhar, Kondas, Psar, etj.

Tokat aluvionale shtrihen në trajtë fragmentare nëpër zallishtoret e luginës së Vjosës dhe përbëhen prej depozitimesh të trasha zhavorri [rrallë prej rëre të trashë], të përziera me gurë të mëdhenj. Në Bashkinë e Këlcyrës hasen kryesisht në Ballaban, Sukë, Katundishte.

Tokat e kafenjta malore janë të mbuluar me pyjet e lisit, të cilat janë një pasuri e madhe për Bashkinë. Ky tip toke është mesatarisht i thelle, me përqindje të lartë të elementeve ushqyes, me tregues mesatare të përberjes fizike dhe shumë të favorshme për zhvillim normal të pyjeve që janë instaluar. Tokat e kafenjta malore shtrihen në pjesët më të ulëta të zonës dhe shkojnë deri në 900-1200 m mbi nivelin e detit. Ato gjenden sidomos në pjesët e mesme të luginave lumore si në luginën e Dëshnicës, etj.

Tokat e murrme pyjore vendosen kryesisht midis 800-1600 m lartësi, pra në katin bimor të ahut. Formimi i këtyre tokave është bërë në kushtet e një lagështie mjaft të madhe, periudhe të vogël thatësire, temperaturave të ulëta, mbulesës së pasur bimore [thuajse tërësisht pyje ahu] dhe pjerrësisë së madhe të shpatëve [30-45°]. Sasia e madhe e reshjeve dhe pjerrësitë e theksuara të relievit kanë kushtëzuar proceset e fuqishme të gërryerjes së këtyre tokave. Në këtë tip bëjnë pjesë edhe tokat ndërzonale, siç janë tokat karbonato-humusore, të cilat kanë përmbajtje më të lartë të humusit.

Tokat livadhore malore shtrihen në lartësitë më të mëdha midis 1,700-1950 m, pra në brezin e kullotave alpine. Tipari dallues i këtyre tokave është përqindja e lartë e humusit [25-30%]. Përhapjen më të gjerë e kanë në Malet e Trebeshinë-Dhëmbel, etj. Në këto territore ato gjejnë kushte natyrore mjaft të përshtatshme, të tilla si lagështia e madhe, temperaturat e ulëta [deri 8 muaj me ngrica] dhe mbulesa relativisht e pasur bimore [kullota alpine]. Në to rritet një bimësi barishtore shumë e pasur me cikël të shkurtër vegjetativ, e cila bëhet shkak për formimin e një shtrese të trashë humusi [60-70 cm], që ka prirje të zhvillohet drejt torfës, veçanërisht në sektorët me lagështi të madhe dhe pjerrësi shumë të vogël.

Bazuar në të dhënat e QTTB në Fushë-Krujë, tokat në Bashkinë e Këlcyrës janë të tipeve të ndryshme, konkretisht:

1. Grupimi i tokave Kambisole (Cambisol Cm).

Kambisolet janë toka me moshë të kufizuar dhe konsiderohen si toka me strukturë tranzicioni të zhvillimit. Këto toka kanë në përbërje të profilit të tyre një horizont Bkambik (si cilësi diagnostikuese),



një horizont sipërfaqësor A-ochrich, një A-molik ose një A-umbrik. Ato janë toka me kapacitete të ndryshme absorbuese (16-32 mek/ 100 gr), me reaksion acid lehtë. (PH 5,5-6,5), neutrale dhe të lehta bazike (pH 6.5 -8.0) me nivele të larta të karbonit organik, që shkon nga 0.3 - 1.7

Formacioni tokëformues përfaqësohet nga materiale në shkallë të ndryshme teksturimi që rrjedhin nga alternimi i llojeve të ndryshme të shkëmbinjëve të tillë si: ranorë, konglomeratë, gëlqerorë të cilat gjenden në depozitime proluviale, kolviale, aluviale të periudhës së neogjenit, kuaternarit etj. Këto toka zhvillohen në kushte mjaft të ndryshme klimatike, të relievit, si dhe nga një vegjetacion (nga bimësia e makies të kullotat subalpine), gjithashtu i ndryshueshëm.

Në bashkinë e Këlcyrës janë kryesisht të nën-kategorisë Calcaric Cambisols ose Eutric Cambisols dhe gjenden kryesisht në Lamar, Rodenjt, pjesërisht në Sukë, etj.




Figura 17. Harta Pedologjike për Bashkinë e Këlcyrës

2. Grupimi i tokave Luvisole (Luvisols/lv)

Termi Luvisol ka rrënjë latine (Luere-me shpla), pra janë toka me horizont B-argjilik të formuara kryesisht nga shplarja e argjilës nga horizonti sipërfaqësor.

Formacioni tokëformues përfaqësohet kryesisht nga depozitetet kolviale, aluviale, të përbërë nga materiale të pakonsoliduara me natyrë të ndryshme. Këto toka takohen kryesisht në reliev të rrafshët.

Profili i tokave Luvisole paraqitet si A- Bt- C, ndonëse kushtet e mjedisit dhe variacionet në formacionet tokëformues u japin këtyre tokave një diversitet të lartë përsa i përket zhvillimit të



profil. Në sipërfaqe kanë një horizont me ngjyra që ndryshon nga kafe në kafe të errët, nën horizont, mund të jetë një horizont argjilik në ngjyre kafe të theksuar ose të kuqërremtë.

Tokat Luvisole janë të përhapura në zonën e studiuar. Karakteristike e gjenezës së tokave Luvisole është formimi i horizontit argjilik (B) si rezultat i migrimit nga uji të argjilës, nga horizonti sipërfaqësor dhe i akumulimit, në pjesën e mesme të profilit.

Kapaciteti për shkëmbim kationic është e barabartë ose më e madhe se 24, EK / 100g baltë, ngopja në bazë është 50% ose më e lartë, në të gjitha shtresat B. Këto toka formojnë një shtresë kulluejse në sipërfaqe; prandaj, përmbajtja e humusit, azotit dhe karbonateve është relativisht e ulët. Ato janë pak acide dhe pak bazike në reagim (pH 6.0 -7.5). Shtresa B, ka një natyrë neutrale dhe me akumulimin e karbonateve. Përmbajtja e elementeve ushqyese N, P, K, është nga të mesëm në të lartë

Kjo është kategoria dominuese e tokave në Bashkinë e Këlcyrës ku nën-kategoria Calcic Luvisols takohet nga Malas, Vinokash, Ballaban ne veri të bashkisë deri në qytetin e Këlcyrës dhe Mbrezhdan në jug. Vertic Luvisols takohen kryesisht në Kondas dhe Komarak.

3. Grupimi i tokave Regosol.

Regosol karakterizohen nga materiale bazë të cekët, të mesëm të pa konsoliduara, të cilat mund të jenë me origjinë aluviale dhe nga mungesa e formimit të një horizonti të konsiderueshëm të tokës (shtresës) për shkak të kushteve klimatike të thata ose të ftohta. Regosols kanë përhapje të gjerë në sipërfaqet e eroduara dhe në shpatet e maleve në zonat e thata ose gjysëm të thata. Në bashkinë e Këlcyrës kjo kategori tokash është tejet e përhapur në pjesën lindore të Bashkisë, në shpatet e malit Qarrishtë që nga Toshkëzi në veri, në Zhepovë e Topojan në qendër deri në Fratan në Jug të territorit të Bashkisë.


4. Grupimi i tokave Phaeozems.

Phaeozems karakterizohen nga një shtresë sipërfaqësore me humus të mbuluar në gjendjen natyrore me bar të bollshëm ose vegjetacion bimor gjethesh. Ato janë toka shumë të lërueshme. Gjenden në pothuajse rreth 15% të sipërfaqes në zonën e Malëshovës, Leskaj, Katundisht e Fushëgoricë.

4.1.8. *Cilësia e Ajrit*


Shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit

Ndotësit kryesorë të cilët ndikojnë në cilësinë e ajrit janë: dioksidi i azotit (NO₂), dioksidi i squfurit (SO₂), monoksidi i karbonit (CO) Ozoni (O₃), grimcat e pluhurit me madhësi deri 10 micrometer (PM₁₀), grimcat e pluhurit me madhësi deri 2.5 micrometer (PM_{2.5}) dhe benzeni të cilët emetohen nga djegia e lëndës fosile për energji dhe transport. Ozoni (O₃) është një ndotës sekondar i cili formohet nga oksidimi i ndotësve primarë në prani të rrezatimit diellor, i cili ndikon në ndryshimin e klimës globale. Oksidet e Squfurit dhe Azotit në bashkëveprim me lagështirën e ajrit kthehen në acide dhe depozitohen në tokë në formën e shiut acid i cili është i dëmshëm për bujqësinë dhe për mjedisin në përgjithësi. Ndotja e ajrit nga kimikatet, grimcat e pluhurit ose materialet biologjike shkaktojnë shqetësime ose dëmtime tek njerëzit dhe organizmat e tjera duke ndikuar negativisht në mjedisin natyror.



Burimet e ndotjes së ajrit mund të kenë origjinë natyrore ose antropogjenike. Efektet shëndetësore shkaktuar nga ndotësit e ajrit klasifikohen si ndryshime fiziologjike dhe biokimike të lehta deri në vështirësi në frymëmarrje, nuhatje, kollitje dhe probleme kardiake e respiratore.

Në zonën e bashkisë së Këlcyrës nuk vërehet ndotje e ajrit edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare të cilat të bazohen në kërkime dhe informacione zyrtare. Mungesa e ndotjes lidhet ngushtë, së pari me karakteristikat e Bashkisë dhe në mënyrë të veçantë me praninë e madhe të zonave malore, pyjore dhe bujqësore pa burime kryesore të ndotjes atmosferike, dhe së dyti me mungesën e qendrave të mëdha urbane dhe zonave industriale.



Grafiku 6. Tendanca e emetimeve të dioksidit të karbonit për banor në Shqipëri (Burimi: Banka Botërore)

Banka Botërore ka bërë përlogaritjen e emetimeve të dioksidit të karbonit (CO_2) për banor në Shqipëri në tone metrik (<https://data.worldbank.org/indicator/EN.ATM.CO2E.PC>). Sikurse shikohet në Grafikon 6 mesatarisht në Shqipëri emetohen 2 tonë metrik për banor.

Nga grafiku shihet qartë se nga viti 1998 ka një rritje të vazhdueshme të sasisë së emetuar të dioksidit të karbonit. Disa nga arsyet që lidhen me ritmin e rritjes së emetimeve të dioksidit të karbonit të cilat ndikojnë edhe në cilësinë e ajrit në Bashkinë e Këlcyrës.

- ↓ Rritja e numrit të makinave dhe përdorimi i çdokohshëm i makinave private;
- ↓ Shumica e këtyre automjeteve janë më shumë se 15 vjeçare dhe nuk janë në përputhje me Euro I apo II;
- ↓ Rreth 70% e tyre punojnë me naftë;
- ↓ Cilesia e karburanteve që përdorin automjetet le shumë për të deshiruar.

Një çështje tjetër madhore e cilësisë së ajrit ka lidhje me veprimtaritë ndërtuese. Ndërtimi kontribuon në një masë të madhe në përqendrimin e cilësisë së ajrit. Ndërtimi rrit gjithashtu dhe ndotjen nga automjetet, si rezultat i qarkullimit të shumë automjeteve të renda.

Ndotësit e ajrit

Emetimet e gazrave (për të cilat nuk ka të dhëna analitike, duke qenë se stacionet e regjistrimit përqendrohen në qendra të mëdha urbane) vlerësohet se janë mjaft të kufizuara për shkak të numrit të ulët popullsisë, konsumit të ulët të energjisë shtëpiake dhe të ngarkesës së qarkullimit, por edhe dhe aktiviteteve profesionale të kufizuara. Djegia e drurit për ngrohje përbën një faktor tjetër të ndotjes nëpërmjet emetimit të mikrogrimeve, por përsëri, për shkak të shkallës së vendbanimeve, ky fenomen është relativisht i kufizuar, siç janë gjithashtu edhe pasojat e tij.

Sipas Bankës Botërore, emetimet në CO₂ për banor për vitin 2014, luhaten rreth vlerës 2.0 tonë metrikë. Nga të dhënat e popullsisë së Bashkisë për vitin 2016 në kombinim me të dhënat e Bankës Botërore për emetimet e dioksidit të karbonit për vitin 2014, u përlogarit emetimi i CO₂ për çdo njësi administrative në Bashkinë Këlcyrë (Tabela 6).

Tabela 7. Sasia e CO₂ të emetuar për çdo njësi administrative në Bashkinë Këlcyrë

Njësitë Administrative	Sipërfaqe (km ²)	Popullsia 2016	Emetimet e CO ₂ (ton metrik)
BALLABAN	155.4	884	1768
KËLCYRË	131.2	353	706
PËRMET	1.9	5,496	10902
SUKË	152.0	1,521	3042
BASHKIA KËLCYRË	601.65	9,868	19736

Indikatorët më kryesorë të cilësisë së ajrit, LNP, PM₁₀, NO₂, SO₂, Pb, O₃, CO dhe BTEX në stacione të përzgjedhura qëllimisht në zonat urbane më të rënduara, përfaqësojnë treguesit më të rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së tij, mbështetur në udhëzimet e BE-së dhe të reflektuara edhe në VKM nr 803, date 04.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit".

Monitorimi i ajrit është realizuar me pajisje automatike, për indikatorët e gaztë NO₂, O₃ të dhënat regjistrohen çdo 30 minuta kurse të dhënat e SO₂ regjistrohen çdo 5 minuta, d.m.th matjet realizohen 100% të kohës vjetore. Të dhënat e monitorimit për pluhurat (PM₁₀ dhe PM_{2.5}) realizohet në baze orare. Në grafikët e mëposhtëm paraqiten të dhënat mesatare për treguesit e monitoruar.

Pluhurat janë një nga ndotësit e ajrit që realisht shkaktojnë probleme serioze në shëndetin e njeriut.

Ndodja nga PM₁₀ dhe PM_{2.5} sipas rekomandimeve të OBSH është rreziku më i madh shëndetësor sot për ajrin urban në shkallë botërore, pasi grimcat me përmasa nën 10 mikron dhe 2.5 mikron mund të depërtojnë në pjesën e poshtme të mushkerive.

Kjo ndotje vjen kryesisht nga shkarkimet e automjeteve dhe është karakteristike për makinat e vjetra me motor dizel. Gjithashtu ndërtimi dhe infrastruktura në ndërtim janë kontribues në rritjen e PM₁₀. Nga rezultatet e monitorimit të PM₁₀ dhe PM_{2.5}, përmbajtja mesatare vjetore e PM₁₀ nuk e tejkalon normën Shqiptare dhe standartin e BE në asnjë nga stacionet e monitoruara. Në vlerësimin

e cilësise së ajrit urban, rëndësi të veçantë ka përmbajtja e gazeve, nivelet e larta të të cilave janë me pasoja të rëndësishme për shëndetin dhe për mjedisin.

Në bazë të të dhënave të monitorimit urban në përgjithësi rezultojnë i pastër nga ndotësit e gaztë (SO_2 dhe NO_2), pasi në të gjithë stacionet e monitoruara vlerat mesatare vjetore janë brenda normave të lejuara të standartit shqiptar dhe standartit të BE.

4.1.9. Ndotja akustike

Ndotja akustike i detyrohet kryesisht trafikut rrugor, ku nivelet e presionit akustik gjatë 24 orëve mund të arrijnë 75-80 dBA (në zonat të dendura të trafikut rrugor). Gjithnjë e më shumë ndotja akustike është duke u rritur dhe duke u shfaqur si një rrezik mjedisor "i dukshëm". Efektet e zhurmave grumbullohen tek individit si ngjarje zhurmë, me efekte negative në dëgjim, psikike dhe mënyrën e jetesës.

Presioni akustik është një matje bazë e vibracioneve të ajrit që përbëjnë zhurmën. Meqënëse intervali i presionit akustik, që auditori human mund të zbulojë (dallojë), është shumë i gjerë këto nivele i matim me një shkallë logaritmike me njësi decibel (dB).

Niveli i zhurmave urbane (LAeq) është niveli i vazhduar ekuivalent i presionit akustik të ponderuar (A0), të prodhuar nga të gjithë burimet e zhurmave që ekzistojnë në një vend të caktuar dhe gjatë një kohe të caktuar.

Monitorimi i zhurmave urbane i kryer nga Instituti i Shëndetit Publik ka për qëllim matjen e nivelit të ndotjes akustike, në pikat e monitorimit të 8 qyteteve kryesore të vendit tonë, për të dhënë mundësinë që të gjykohej mbi masën e ekspozimit të popullatës ndaj zhurmave. Kur niveli i zhurmave është rreth 65 dBA, gjumi bëhet shqetësim serioz dhe shumica e popullatës bezdisen.


Edhe pse matjet nga Instituti i Shëndetit Publik mungojnë, vlerësohet se vlerat mesatare për periudhën e ditës janë nën lerën standarte për ditën 55 dBA.

4.1.10. Rreziku sizmik në Bashkinë e Këlcyrës

Vlerësimi i rrezikut sizmik të rajoneve të ndryshme të prekur nga tërmetet, është bërë një drejtim i preferuar i sizmologjisë kryesisht gjatë dekadave të fundit. Në vitin 1979, u realizua studimi "Rajonizimi Sizmik i Republikës së Shqipërisë" së bashku me hartën përkatëse në shkallën 1:500.000 (Sulstarova et al, 1980). Që nga ajo kohë e në vazhdim Harta e Rajonizimit Sizmik e Shqipërisë në shkallën 1:500.000 është pjesë integrale e Kushteve Teknike të Projektmeve e Ndërtimeve Antisizmike – KTP N2-1989.

Harta e Rajonizimit Sizmik e Shqipërisë paraqet efektin maksimal sipëfaqësor të pritshëm për kushte mesatare trualli, të shprehur në intensitetin bazë të përcaktuar sipas shkallës MSK-1964. Intensiteti bazë është konsideruar si intensiteti maksimal i vërtetueshëm në një pikë të dhënë për një periudhë kohore të caktuar në të ardhmen.

Në Hartën e Rajonizimit Sizmik të Shqipërisë janë identifikuar tre kategori zonash: zonat me intensitet bazë të lëkundjeve VIII, VII e VI ballë; brënda zonave VIII ballëshe për kushte të këqija trualli, të përmendura më lart, janë dalluar zona me intensitet të pritshëm IX ballë.



Në botimin e fundit "Sizmiciteti, sizmotekonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri", në të cilin përfshihet përvoja mbi 40 vjeçare e studimeve në fushën e sizmologjisë, jepen përfundime të arritura nëpërmjet debatit shkencor e hulumtimit të thellë dhe kulmohet me formën më të plotë të rrezikut sizmik të vendit, një dokumentacion me rëndësi praktike për ndërtimet në Shqipëri.

Për të plotësuar dy kërkesat baze të Eurokodit 8, llogaritjet e rrezikut sizmik të Shqipërisë janë kryer për dy nivele probabiliteti:

- ✓ 10% probabilitet tejkalimi në 50 vjet (10%/50), ose 0,0021 në vit, që i korespondon një tërmeti me periudë përsëritje 475 vjet, dhe
- ✓ 10% probabilitet tejkalimi në 10 vjet (10%/10), ose 0,0105 në vit, që i korespondon një tërmeti me periudë përsëritje 95 vjet.

Në zonimin sizmik mbarëbotëror, Shqipëria zë vend në brezin sizmik Alpin-Mesdhetar, i cili është ndër me aktivet në botë. Në këtë brez, pjesa më aktive nga pikpamja sizmike është Egjeu dhe zona rrethuese e tij, ku bëjnë pjesë Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Bullgaria Jugore dhe Turqia Perëndimore. Çdo vit në këtë rajon (34-43° N dhe 18-30° E), ndodh të paktën një tërmet me $M > 6.5$ (Papazachos, 1990).

Shqipëria është një ndër vendet më sizmoaktive në Evropë. Epiqëndrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive. Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M \leq 3.0$), nga shumë tërmete të vegjël ($3.0 < M \leq 5.0$), nga tërmete të rrallë me madhësi mesatare ($5.0 < M \leq 7.0$) dhe shumë rrallë nga tërmete të fortë ($M > 7.0$). Përgjithësisht tërmetet e Shqipërisë dhe rajoneve përreth kanë vatra të cekta, thellësia e të cilave shkon nga 10-25 km.

Në llogaritjet e rrezikut sizmik për truall shkëmbor, shpejtimi (akseleracioni) maksimal i truallit - PGA si dhe shpejtimet spektrale - SA për shuarje 5 % përcaktohen për dy perioda të përsëritjes të tërmeteve: 475 e 95 vjet, për të cilat ndërtohen edhe hartat përkatëse të rrezikut sizmik. Bazuar në këtë metodikë është bërë edhe vlerësimi i rrezikut sizmik të territorit të Bashkisë të Këlcyrës që paraqitet në vijim (Tabela 8).

Tabela 8. Vlerat e rrezikut sizmik (PGA dhe SA (g)) për Bashkinë Këlcyrë me probabilitet 10% /10 vjet (me periudë përsëritje 95 vjet) dhe probabilitet 10%/50 vjet (me periudë përsëritje 475 vjet), në truall shkëmbor.

Vendi	Koordinatat		Probabiliteti	PGA 0.01 s	SA			
	N	E			0.2 s	0.5 s	1.0 s	2.0 s
Ballaban	40.42	20.12	10%/10 10%/50	0.104 0.225	0.246 0.523	0.129 0.29	0.066 0.145	0.028 0.064
Dëshnicë	40.34	20.21	10%/10 10%/50	0.099 0.216	0.236 0.505	0.124 0.276	0.063 0.139	0.027 0.061
Këlcyrë	40.31	20.16	10%/10 10%/50	0.108 0.234	0.210 0.459	0.088 0.202	0.066 0.149	0.028 0.065
Sukë	40.38	20.15	10%/10 10%/50	0.104 0.225	0.246 0.523	0.129 0.290	0.066 0.145	0.028 0.064

Këto vlera të parametrave të rrezikut sizmik kanë rëndësi praktike për ndërtimet në secilën Njësi Administrative të Bashkisë Këlcyrë, sepse:

- Vlerat e shpejtit maksimal të truallit - PGA dhe të shpejtit spektral - SA për perioda 0.2-0.5 sekonda u korespondojnë energjisë periudhë-shkurtër, e cila do të ketë efektin më të madh mbi strukturat periudhë-shkurtër, në ndërtimet deri afër 7 kate të lartë, ndërtimet më të zakonshme sot.
- Hartat e shpejtit spektral periudhë-gjatë: 1.0 sek., 2.0 sek. etj. paraqesin nivelin e lëkundjes të truallit që do të ketë efektin më të madh në strukturat më periudhë-gjata, në ndërtimet 10 kate të lartë e me tepër, në urat etj.
- Duke qenë se rreziku sizmik është llogaritur për truall shkëmbor, për ndërtimet në truall shkëmbor duhet eliminuar pjesa e sipërme reth 5-6 m e depozitimeve të shkrifta deluvialoeluviale që mbulojnë shkëmbijtë rrënjësorë. Ndërsa për ndërtimet në troje të butë, mbi depozitimet Kuaternare (Holocene), kërkohet kryerja më parë e studimeve gjeologjiko-inxhinierike për saktësimin e modelit gjeoteknik dhe mandej vlerësimi i rrezikut sizmik për çdo zonë që do t'i nënshtrohet zhvillimit të ri perspektiv.




Figura 18. Harta e shpejtit spektral SA (0.2) me shuarje 5% në truall shkëmbor dhe probabilitet 10%/50 vjet ose 475 vjet periudhë përsëritje 475 (Majtas) dhe Harta e Rrezikut Sizmik në Shqipëri (Djathtas) (Burimi: Aliaj et al. 2010))

Mbështetur në hartën e rajonizimit sizmik të Shqipërisë, intensiteti i pritshëm sizmik për kushte mesatare truall për Bashkinë e Këlcyrës është $IO = 6$ ballë MSK-64. (Figura 18).



4.2. MJEDISI BIOLOGJIK

Biodiversiteti përbën një komponent shumë të rëndësishëm të pasurive natyrore të një vendi, hapësirë apo rajoni. Me biodiversitetin nënkuptohet shumëllojshmëria e organizmave të gjalla në të gjitha nivelet, duke përfshirë ato tokësore, detare, ujërave të ëmbla, si dhe komplekse ekologjike, pjesë e të cilëve ato janë. Në origjinë të këtij diversiteti qëndrojnë pozicioni gjeografik, faktorë gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë

Konventa e Rio de Janerios e vitit 1992, mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (Samiti i Tokës) e përkufizoi diversitetin biologjik si "ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë nga të gjitha burimet, duke përfshirë, ndër të tjera, tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore, dhe komplekset ekologjike të të cilave ato janë pjesë: kjo përfshin diversitetin brenda llojeve, mes llojeve dhe të ekosistemeve". Biodiversiteti përbën një komponent shumë të rëndësishëm të pasurive natyrore të një vendi, hapësirë apo rajoni. Në origjinë të këtij diversiteti qëndrojnë pozicioni gjeografik, faktorë gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima. Zonat e mbrojtura në një mënyrë ofrojnë mundësinë që të ndalohet apo kufizohet humbja e biodiversitetit në vend.

4.2.1. Vegjetacioni dhe flora

Duke u shtrirë vertikalisht nga lugina e Vjosës (ca. 250 m) deri në malin e Trebeshinës (ca. 1950 m), në Bashkinë e Këlcyrës takohen të katër brezat / zonat fitoklimatike që hasen në vendin tonë 1) Brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare 2) Brezi i dushkajave 3) Brezi i ahishteve dhe 4) Brezi i kullotave alpine. Prania e këtyre brezave është një pasqyrim i madh i vlerave të florës, birmësisë dhe habitateve në këtë zonë. Gjithësesi, dominues mbeten Brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare dhe Brezi i dushkajave


1. Brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare

Në vendin tonë, ky brez haset mbi terrene, pjerrësi dhe kundrejtime të ndryshme, dhe në habitate që karakterizohen nga një periudhë e gjatë vegjetacioni. Ky i fundit paraqitet në trajtën e dy tipeve 1) Pyje mesdhetare (halorë dhe gjethegjerë) dhe 2) Shkurreve mesdhetare.

Në zonën e studimit ky brez dominohet kryesisht nga shkurret mesdhetare sklerofile, fizionomikisht të tipit të makies, të cilat fillojnë në lartësitë mesatare 230 m deri në 700 m (lugina e Vjosës, të vendosura në shkemb amnor flysh (makie tipike) dhe gëlqeror (formacionet me *Phillyrea latifolia* L. dhe *Pistacia lentiscus* L.). Mungojnë pyjet halorë mesdhetarë, si dhe pyjet gjethegjera kryesisht me *Quercus ilex*.

2. Brezi i dushkajave

Ky brez shtrihet në lartësitë që fillojnë nga niveli i sipërm i brezit të parë (i ndryshëm për zona të ndryshme) deri në 1200 m në Shqipërinë jugore dhe ka përhapje të gjerë. Pyjet e dushkut përfshihen në dy breza të ndryshëm vegjetacioni: 1) pyjet e shkurretat sklerofile mesdhetare (dushqe



Në zonën e Këlcyrës ai përfaqësohet nga pyjet mezofile të dushqeve gjetherënës (*Quercus cerris*, *Q. frainetto*, *Q. pubescens* dhe *Q. trojana*). Ndërkohë, i përhapur në këtë brez është vegetacioni me shkozë (*Carpinus orientalis*) dhe me dëllinjë (*Juniperus oxycedrus*) në zona flyshore, argjilore dhe pak shkëmbore.

Duhet theksuar se formacionet bimore ndryshojnë në varësi të kundrejtimt të shpatit. Nëse, për shembull, në shpatet perëndimore e jugore, që janë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të klimës mesdhetare, brezi i makies është i dukshëm dhe dominon deri në lartësinë 700 m, në shpatet lindore e verjore, ku klimë është më e freskët, makia është e pranishme shumë pak.

Sipas V.K.M. Nr. 433 datë 08.06.2016 "Transferimi në pronësi të bashkisë Këlcyrë të pyjeve dhe kullotave sipas listave të inventarit" Bashkia Këlcyrë zotëron një fond pyjor prej 8.200 ha dhe një fond kulloror prej më shumë se 9.200 ha. Së bashku fondi pyjor dhe ai kulloror përbëjnë mbi 17.400 ha ose rreth 57.2% të sipërfaqes totale (30.465 ha) të territorit të Bashkisë. Pjesa më e madhe e tyre gjendet në Njësinë Administrative Dëshnicë pyjet e së cilës zënë një sipërfaqe prej mbi 3240 ha. Përsa i përket volumit të materialit drusor, pyjet e Bashkisë së Këlcyrës kanë një volum drusor në këmbë prej afërsisht 490.000 m³. Në Figurën 19 është paraqitur gjendja e pyjeve në njësinë administrative të Dëshnicës.




Figura 19. Gjendja eksistuese e pyjeve në Njësinë Administrative Dëshnicë

4.2.2. Habitatet Natyror me Interes Komunitar, sipas Klasifikimit Natura 2000

Sipas hierarkisë së klasifikimit të habitateve natyrore në territorin Evropian, të listuara në manualin e interpretimit të habitateve (EC, 2007), janë 9 kategori të mëdha hierarkike klasifikimi që përfaqësojnë 233 tipe të ndryshëm habitatesh të listuara në këto kategori klasifikimi; disa prej të cilave hasen në Bashkinë e Këlcyrës. Një pjesë e habitateve të zonës në studim përfaqësojnë habitate të degraduara, dhe si rrjedhim jo në Natura 2000. Përshkrimi i të gjithë habitateve është pasuruar me informacion të grumbulluar nga literatura si dhe nga vëzhgimet në terren.

H- 9180 *Pyje të aleancës Tilio-Acerion të shpateve shkëmbore, çakëllishteve luginave të thata

Ky tip habitati prioritar është i përhapur në formë copëzash në ultësirat e territorit, dhe kryesisht midis habitatit të Pyjeve gjetherënës Ballkano-Panoniqë me dushqe, kështu që ky habitat nuk formon pyje të pastra dhe reale. Mund të gjendet në lartësitë 300-1000m mbi nivelin e detit. Speciet identifikuese të këtij habitati janë bliri gjethegjërë [*Tilia platyphyllos*], Panja gjethe rrap [*Acer pseudoplatanus*], Frashëri i zi [*Fraxinus excelsior*], Vidhi [*Ulmus glabra*], dhe bliri gjethekordë [*Tilia cordata*], të cilët rriten midis specieve të tjera të pyllit të këtij habitati, dhe veçanërisht në faqet e pjerrëta ose përgjatë shtrateve aluvionale të luginave, të mjediseve shkëmbore gëlqerore [NATURA 2000, 2013].

Habitati preferon mjediset e ftohta dhe me lagështi, është gjithashtu tolerant ndaj hijezimit. Bimësia dominohet nga specia Panja gjethe rrap [*Acer pseudoplatanus*] e nën-aliancës Lunario-Acerenion, dhe speciet tipike tolerante ndaj thatësisë [*Tilia cordata*, *T. platyphyllos*] të nën-aliancës Tilio-Acerenion. Speciet treguese të tij janë: *Actaea spicata*, *Acer campestre*, *Anemone nemorosa*, *Fraxinus excelsior*, *Sorbus aucuparia*, *Ulmus glabra* ose *Carpinus betulus*, *Corylus avellana*, *Rosa canina*, *Tilia cordata*, *T. platyphyllos* etj.

H- 92C0 *Habitatet e Lumit dhe Përroit [*Platanus orientalis* dhe *Liquidambar orientalis* (Plantanion orientalis)]

Ato janë të shpërndara në të gjithë territorin duke kolonizuar depozita aluviale të pasura të lumenjve të mëdhenj, depozita zhavorrash ose gurësh të rrymave të përherëshme ose të përkohshme, pellgje pranverore, dhe në veçanti, fundin e grykave të pjerrëta dhe të hijezuara, ku ato përbëjnë komunitete të pasura me lloje. Flora shoqëruese mund të përfshijë: *Salix alba*, *S. elaeagnos*, *S. purpurea*, *Alnus glutinosa*, *Cercis siliquastrum*, *Celtis australis*, *Populus alba*, *P. nigra*, *Juglans regia*, *Fraxinus ornus*, *Alnus glutinosa*, *Crataegus monogyna*, *Cornus sanguinea*, *Ruscus aculeatus*, *Vitex agnus-castus*, *Nerium oleander*, *Rubus spp.*, *Rosa sempervirens*, *Hedera helix*, *Clematis vitalba*, *Vitis vinifera ssp. sylvestris*, *Ranunculus ficaria*, *Anemone blanda*, *Aristolochia rotunda*, *Saponaria officinalis*, *Symphytum bulbosum*, *Hypericum hircinum*, *Calamintha grandiflora*, *Melissa officinalis*, *Helleborus cyclophyllus*, *Cyclamen hederifolium*, *C. repandum*, *C. creticum*, *Galanthus nivalis ssp. reginae-olgae*, *Dracunculus vulgaris*, *Arum italicum*, *Biarum tenuifolium*, *Brachypodium sylvaticum*, *Dactylis glomerata*. Këto habitate gjithashtu mbështesin një sërë myshqesh, likenesh dhe fierësh, shpesh të dominuara nga *Pteridium aquilinum*.

H- 9340 *Shkurre/Pyje Sklerofile Gjithmonë të Gjelbra – Macchia

Habitatet Evropiane përfshijnë H 5210 pyje Arborescent matorral me Dëllinjë (*Juniperus* spp.) dhe H 9340 me Ilqe (*Quercus ilex*). Pyjet e vërteta Sklerofile Gjithmonë të Gjelbra janë shumë të rralla tani dhe përfaqësohen vetëm nga fragmente të vogla. Zona e variantit të lagësht të klimës Mesdhetare në vendndodhjet e pyjeve të mëparshme është tashmë e zënë nga Macchia-t e mirë zhvilluara, gjithashtu të dominuara nga bimë gjithmonë të gjelbra. Macchia-t janë përfaqësuese të një shkalle degradimit të pyjeve mesdhetare gjithmonë të gjelbra ose pyjeve të vjetra me Ilqe (*Quercus ilex*). Speciet më të rëndësishme që i japin këtij formacioni fizionominë e tij janë shkurret gjithmonë të gjelbra si Mare (*Arbutus unedo*), Mretë gjethengushtë (*Phillyrea angustifolia*), Shqopë (*Erica arborea*), Dëllinjë e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Xanë (*Spartium junceum*), Lofatë (*Cercis siliquastrum*), Drizë (*Palurus spina-christi*), Goricë (*Pyrus amygdaliformis*), Frashër i Zi (*Fraxinus ornus*), Cërmëdell (*Cotinus coggygria*). Xinë (*Pistacia lentiscus*), Mërsinë (*Myrtus communis*), Ilqe (*Quercus ilex*) të përshtatura të rriten për një periudhë të gjatë në mot të nxehtë dhe me mangësi reshjesh. Struktura e dendur e Macchie-ve nuk lejon rritjen e florës së pasur barishtore. Pjesa më e madhe e bimëve barishtore thahen gjatë periudhës së verës. Ndër bimët barishtore gjenden: Rriell moçalesh (*Euphorbia characias*), Rrushkull gjembor (*Ruscus aculeatus*), Shpargull (*Asparagus acutifolius*), Bar majasëlli (*Teucrium polium*), Mënishtë (*Cistus incanus*), Rrëshajë (*Cistus salviafolius*), Luledelë (*Bellis perennis*), Morenxë e ashpër (*Smilax aspera*), Telish (*Dactylis glomerata*), Kelkazë (*Arum italicum*), Anemone apenine (*Anemone hortensis*), Gram (*Cynodon dactylon*), Pesta erëmirzë (*Anthoxanthum odoratum*), Brizë e madhe (*Briza maxima*), Belismë e zezë (*Chrysopogon gryllus*), Flokëz qepore (*Poa bulbosa*), Bishtmi i Alpeve (*Micromeria juliana*), Cinozur gjembak (*Cynosurus echinatus*), Arrs dushk i vogël (*Teucrium chamaedrys*), Sarushë mjeksore (*Stachys officinalis*), Rrëzë shtegtare (*Rubia peregrina*), Fier i zi (*Asplenium adianthum-nigrum*), Kufilmë zhardhokore (*Symphytum tuberosum*), Doriknë pesëgjethesh (*Dorycnium hirsutum*), Qirinthë e madhe (*Cerithe major*) etj.

H- 9530 *Pyll Halor – Dominuar nga *Pinus nigra* (Pisha e zezë)

Ky lloj habitati përfaqëson një habitat natyral me përparësi në Evropë (lloje habitatesh në rrezik zhdukje dhe hapësira natyrale e të cilave kryesisht ndodhet brenda territorit të Bashkimit Evropian; Shtojca 1, Direktivë e Këshillit 92/43/EEC datë 21 maj 1992 mbi ruajtjen e habitateve natyrale dhe faunës dhe florës së egër, O.J. L206, 22.07.92).

Në një lartësi prej rreth 1.000-1.500 metra mbi nivelin e detit në formacione kalciumi dhe ultra bazike, pyjet halore (në disa raste të mbjellë), dominuar nga pisha e zezë (*Pinus nigra*) kanë shtrirje të gjerë dhe gjithashtu janë një komunitet me gjendje të stabilizuar natyrale. Fasha komplet me vetëm pishë të zezë (*Pinus nigra*) shihen në vend megjithëse një sërë drurësh dhe shkurresh gjetherënëse shpesh shoqërohen me këto halorë duke përfshirë: shparth (*Quercus frainetto*), Mjedhër (*Rubus idaeus*), fier (*Pteridium aquilinum*), dëllinjë e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), qarr (*Quercus cerris*), panjë (*Acer obtusatum*), Fshikëkarthë (*Colutea arborescens*), thanë (*Cornus mass*), Cërmëdell (*Cotinus coggygria*), frashër i zi (*Fraxinus ornus*) dhe mëllezë (*Ostrya carpinifolia*). Në disa raste bimë shkurre si bush (*Buxus sempervirens*), dafinë (*Daphne laureola*), etj. gjenden në këtë lloj pylli. Flora e barnave është relativisht e pasur, p.sh. Rriell si bajame (*Euphorbia amygdaloides*),





luledele (*Bellis perennis*), *Agrimonia agrimonoides*, *mercurialis* shumëvjeçar (*Mercurialis perennis*), etj. Gjysmë parazitimi gjithmonë i gjelbër (*Viscum album*) është i zakonshëm tek pisha e zezë (*Pinus nigra*). Shpesh këto pyje janë dëmtuar dhe janë në gjendje shumë të keqe si rezultat i prerjes për dru, çka rezultojnë në zona të dominuara nga lajthia (*Coryllus avellana*) dhe bimë të tjera oportuniste si: shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*), *Stachelina uniflosculosa*, *Rrielli* me gjemba (*Euphorbia spinosa*), etj. në shumë raste këto formacione, veçanërisht në shkëmbinj ultra-bazikë, janë shumë të hapur.


H- 8210 *Gurë të Zhveshur me Bimësi të Rrallë.

Habitatet Evropiane 8210 përfshijnë shpate shkëmbore gëlqerore me bimësi që rritet në të çarat e gurit. Brenda zonës së studimit ky habitat është i përfaqësuar nga një habitat shumë i fragmentuar dhe i varfër në specie. Parcela të vogla me mbulim me bimë të rralla mbi shpate me erozion, pjesë të dala shkëmbore dhe gurë me një florë të specializuar është mbulesa kryesuese e tokës për këtë habitat. Shumica e parcelave me gurë të zhveshur brenda zonës së studimit janë rezultat i humbjes së mbulesës së bimësisë origjinale dhe tregojnë degradim dhe erozion të avancuar. Pjesë të mëdha të këtij lloji habitatit janë në një fazë aktive erozioni dhe mbështesin një mbulim shumë të kufizuar me bimësi.

Megjithatë zona të mëdha me erozion jashtë këtyre zonave janë shkaktuar gjithashtu nga humbja e mbulimit me bimësi si rezultat i degradimit të pyllit, prerjes së shumtë, kullotjes së tepërt dhe djegies. Gurë më së shumti gëlqeror, të zhveshur, pa ujë, nën ekspozimin e diellit dhe erës me bimësi të shpateve shkëmbore dhe të cacrave në gur, nuk duken si një habitat i favorshëm për rritjen e suksesshme të specieve të bimëve. Megjithatë kjo është shtëpia e një numri të madh bimësh të quajtura bimë që rriten në të çarat e gurëve, të cilat i janë përshtatur këtyre kushteve jo mikpritëse dhe tërësisht jo të favorshme. Megjithëse habitatet janë në pjesën më të madhe uniforme, flora e kësaj zone është me goxha diversitet. Arsyeja për këtë paradox është izolimi lokal i habitateve si dhe nga ndryshimet klimatike në nivel rajonal dhe vendor. Bimë karakteristike enëzore të të carave përfshijnë Dëllinjën e kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Trumzën e maleve (*Satureja montana*), Kokoçel i Greqisë (*Micromeria graeca*), Fierin me qime (*Asplenium trichomanes*), Fieri i gjelbër (*Asplenium viride*), Barin e gjarprit (*Ceterach officinarum*), Fieri shkëmbor (*Asplenium ruta-muraria*), *Putoria calabrica*, etj.

Ky habitat është përgjithësisht i varfër në specie me mbulim të ulët me bimësi për shkak të arsyeve ekologjike të veçanta. Si rrjedhojë, vlera botanike e bimësisë dhe habitateve të hasura brenda zonës së studimit është e ulët.

Disa nga llojet e rrezikuara të florës janë: Kokoçeli (*Centaurea epirota*), solenanti shqiptar (*Solenanthus albanicus*), gështenja e kalit (*Aesculus hippocastanum*), rigoni (*Origanum vulgare*), *Asperug* (*Asperula clorantha*), nepeta (*Nepeta parnasica*), bliri (*Tilia platyphyllos*). Për më tepër ka edhe mbi 120 lloje bimësh mjekësore ku mund të përmendim: sherebelën (*Salvia officinalis*), shqemja (*Rhus coriaria*), marreja (*Arbutus unedo* L), trëndafilin e egër (*Rosa canina* L), borzilokun (*Ocimum basilicum*), rigonin, shporri shumë e shkurtër si trastë - salep - (*Orchis morio* L), çajin e malit (*Sideritis raeseri*) etj.



2.3. FAUNA TOKËSORE DHE UJORE

E gjendur midis dy vargmaleve, atij Trebeshinë-Dhembel dhe malit të Qarrishtës (Malësia e Dangëllisë) dhe e përshkruar nga dy lumenj, ai i Vjosës dhe i Deshnicës, Bashkia e Këlcyrës është e njohur gjithashtu dhe për pasuritë e saj faunistike. Me larmishmërinë e saj dhe format e terrenit, ndryshimet e mëdha në altitude (nga shtrati i lumit Vjosa në lartësi 230m deri në 1922 m në malin e Trebeshinës), ajo ofron mundësi të shumta ushqimi dhe strehimi për shumë specie. Këtu gjenden nga specie të rralla të habitateve ujore deri te gjitarë të mëdhenj. Zona shquhet për praninë e shumë taksonëve të kafshëve dhe disa nga llojet invertebrore dhe vertebrore janë, gjithashtu të shumtë në numer.

Vertebroret janë përfaqësuar nga të gjitha grupet, si amfibet, zvarraniket, zogjtë dhe gjitarët.

Pyjet gjethegjërë janë një habitat i përshtatshëm për gjitarët e mëdhenj si: ariu i murrmë (*Ursus arctos*) dhe ujku (*Canis lupus*) të cilët kane përhapje të gjerë brenda zonës në varësi të habitatit të gjahut.

Ndër gjitarët e tjerë të mëdhenj në zonë gjenden edhe derri i egër (*Sus scrofa*), kunadhja gushebardhe (*Martes foina*), Baldosa (*Meles Meles*), dhelpra (*Vulpes Vulpes*) dhe macja e egër (*Felis sylvestris*). Për më tepër gjitarët përfaqësohen edhe nga ketri (*Sciurus vulgaris*), gjumashi i majme i pyllit (*Glis Glis*), gjumashi i lajthive (*Muscardinus avellanarius*).

Grumbujt e vjetër pyjorë të dushkajave ofrojnë nishe ekologjike të rëndësishëm për insektet (flatrafortët dhe fluturat), disa prej të cilëve kanë interes të veçantë ndërkombëtar dhe kombëtar për ruajtje, si *Cerambyx cerdo*, *Lucanus cervus*, *Carabus coriaceus*, *Osmoderma eremita*, *Papilio alexanor* etj.

Me shumëllojshmërinë e habitateve që ajo përmban, territori i bashkisë së Këlcyrës ofron mundësi për praninë e shumë llojeve të shpendëve të lidhur me ekosisteme dhe habitate të ndryshme. Lloje si Bui - *Bubo bubo*, Huta bishtbardhë - *Buteo rufinus*, Gjeraqina këmbëshkurtër - *Accipiter brevipes*, Skifteri i Mesdheut - *Falco biarmicus*, Gjeraqina e shkurtës - *Accipiter nisus*, Shqiponja e maleve - *Aquila chrysaetos*, Pernis apivorus, Gjeraqina - *Accipiter gentilis*, Shqiponja gjarpërngrenëse - *Circetus gallicus*, Kali i qyqes - *Neophron percnopterus*, Qukapiku i përhimë - *Picus canus*, Kukuvaika mjekëroshe - *Tyto alba* janë të pranishëm dhe indikatorë të gjëndjes së ekosistemeve të zonës.

Reptilet përfaqësohen nga gjarprinjtë, shigjeta e gjate të Ballkanit (*Coluber gemonensis*), Bolla laramane (*Elaphe situla*), bolla me kater vija (*Elaphe quatuorlineata*), breshka e zakonshme (*Testudo hermanni*), breshkujca Evropiane (*Emys orbicularis*) dhe zhapi i gjelbër Evropian (*Lacerta viridis*).

Lumenjtë dhe përrenjtë malorë, përbëjnë një habitat të rëndësishëm për llojet shtazore të lidhur me ujërat e freskët, si pilivesat, peshqit (troftat), amfibët dhe disa reptile. Amfibët janë një grup taksonomik zakonisht të lidhur me habitatet e ndryshme gjatë ciklit jetësor të tyre, me ujin dhe tokën. Amfibët më të njohura që hasen janë bretkosa barkverdhe (*Bombina variegata*) dhe thithlopa (*Bufo bufo*). Lloje amfibësh tipik të lidhura kryesisht me habitatet ujore janë bretkosa e përrenjve - *Rana graeca*, bretkosa e zakonshme - *Rana balcanica*, Triton i madh - *Triturus cristatus*, etj.





Sipas Shumka (2016) në ujërat e lumit Vjosa gjenden 9-10 lloje peshqish, si: (1) *Ochinemachileus*, (2) *Anguilla Anguilla*, (3) *Alburnoides bipunctatus*, (4) *Alburnus spp.*, (5) *Barbus spp.*, (6) *Gobio spp.*, (7) *Leuciscus cephalus* (8) *Pachychilon pictum* (9) *Pelagius sp.*, dhe (10) *Pseudorasbora parva*.

Shpellat dhe çarjet shkëmbore janë një habitat shumë i rëndësishëm për lakuriqët e natës banorë të shpellave kryesisht për *Rhinolophus ferrumequinum*, *R. blasii*, *R. euryale*, *R. hipposideros*, *Eptesicus serotinus*, *Myotis myotis*, *Myotis blythi*, *Myotis capaccinii*, *Tadarida teniotis*, *Miniopterus schreibersii*, *Vesperugo murinus*, *Plecotus spp.* etj.

4.2.3. Fauna tokësore dhe e trupave ujorë

E gjendur midis dy vargmaleve, atij Trebeshine-Dhembel dhe malit të Qarrishtës (Malësia e Dangëllisë) dhe e përshkruar nga dy lumenj, ai i Vjosës dhe i Deshnicës, Bashkia e Këlcyrës është e njohur gjithashtu dhe për pasuritë e saj faunistike. Me larmishmërinë e saj dhe format e terrenit, ndryshimet e mëdha në altitudë (nga shtrati i lumit Vjosa në lartësi 230m deri në 1922 m në malin e Trebeshinës), ajo ofron mundësi të shumta ushqimi dhe strehimi për shumë specie. Këtu gjenden nga specie të rralla të habitateve ujore deri te gjitarë të mëdhenj. Zona shquhet për praninë e shumë taksonëve të kafshëve dhe disa nga llojet invertebrore dhe vertebrore janë, gjithashtu të shumtë në numer.


Vertebroret janë përfaqësuar nga të gjitha grupet, si amfibet, zvarraniket, zogjtë dhe gjitarët.

Pyjet gjethegjere janë një habitat i përshtatshëm për gjitarët e mëdhenj si: ariu i murrme (*Ursus arctos*) dhe ujku (*Canis lupus*) të cilët kane përhapje të gjerë brenda zonës në varësi të habitatit të gjahut.

Ndër gjitarët e tjerë të mëdhenj në zonë gjenden edhe derri i egër (*Sus scrofa*), kunadhja gushebardhe (*Martes foina*), Baldosa (*Meles Meles*), dhepra (*Vulpes Vulpes*) dhe macja e egër (*Felis sylvestris*). Për më tepër gjitarët përfaqësohen edhe nga ketri (*Sciurus vulgaris*), gjumashi i majme i pyllit (*Glis Glis*), gjumashi i lajthive (*Muscardinus avellanarius*),

Grumbujt e vjetër pyjorë të dushkajave ofrojnë nishe ekologjike të rëndësishëm për insektet [flatrafortët dhe fluturat], disa prej të cilëve kanë interes të veçantë ndërkombëtar dhe kombëtar për ruajtje, si *Cerambyx cerdo*, *Lucanus cervus*, *Carabus coriaceus*, *Osmoderma eremita*, *Papilio alexanor* etj.

Me shumëllojshmërinë e habitateve që ajo përmban, territori i bashkisë së Këlcyrës ofron mundësi për praninë e shumë llojeve të shpendëve të lidhur me ekosisteme dhe habitate të ndryshme. Lloje si Bui - *Bubo bubo*, Huta bishtbardhë - *Buteo rufinus*, Gjeraqina këmbëshkurtër - *Accipiter brevipes*, Skifteri i Mesdheut - *Falco biarmicus*, Gjeraqina e shkurtës - *Accipiter nisus*, Shqiponja e maleve - *Aquila chrysaetos*, *Pernis apivorus*, Gjeraqina - *Accipiter gentilis*, Shqiponja gjarpërngrënëse - *Circaetus gallicus*, Kali i qyqes - *Neophron percnopterus*, Qukapiku i përhimë - *Picus canus*, Kukuvaika mjekëroshe - *Tyto alba* janë të pranishëm dhe indikatorë të gjëndjes së ekosistemeve të zonës.



Reptilet përfaqësohen nga gjarprinjtë, shigjeta e gjate të Ballkanit (*Coluber gemonensis*), Bolla laramane (*Elaphe situla*), bolla me kater vija (*Elaphe quatuorlineata*), breshka e zakonshme (*Testudo hermanni*), breshkujca Evropiane (*Emys orbicularis*) dhe zhapiku i gjelbër Evropian (*Lacerta viridis*).

Lumenjtë dhe përrenjtë malorë, përbëjnë një habitat të rëndësishëm për llojet shtazore të lidhur me ujërat e freskët, si pilivesat, peshqit (troftat), amfibët dhe disa reptile. Amfibët janë një grup taksonomik zakonisht të lidhur me habitatet e ndryshme gjatë ciklit jetësor të tyre, me ujin dhe tokën. Amfibët më të njohura që hasen janë bretkosa barkverdhe (*Bombina variegata*) dhe thithlopa (*Bufo bufo*). Lloje amfibësh tipik të lidhura kryesisht me habitatet ujore janë bretkosa e perrenjve - *Rana graeca*, bretkosa e zakonshme - *Rana balcanica*, Triton i madh - *Triturus cristatus*, etj.

Sipas Shumka (2016) në ujërat e lumit Vjosa gjenden 9-10 lloje peshqish, si: (1) *Ochinemachileus*, (2) *Anguilla Anguilla*, (3) *Alburnoides bipunctatus*, (4) *Alburnus spp.*, (5) *Barbus spp.*, (6) *Gobio spp.*, (7) *Leuciscus cephalus* (8) *Pachychilon pictum* (9) *Pelagus sp.*, dhe (10) *Pseudorasbora parva*.

Shpellat dhe çarjet shkëmbore janë një habitat shumë i rëndësishëm për lakuriqët e natës banorë të shpellave kryesisht për *Rhinolophus ferrumequinum*, *R. blasii*, *R. euryale*, *R. hipposideros*, *Eptesicus serotinus*, *Myotis myotis*, *Myotis blythi*, *Myotis capaccinii*, *Tadarida teniotis*, *Miniopterus schreibersii*, *Vesperugo murinus*, *Plectotus spp.* etj.

4.2.4. Zonat e Mbrojtura

Në kategorizimin e zonave të mbrojtura mjedisore dhe në përcaktimin e statusit për secilën prej tyre, institucionet përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë mbështeten në kriteret e Unionit Ndërkombëtar të Ruajtjes së Natyrës (IUCN). Sipas Ligjit Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", zonë e mbrojtur është një hapësirë tokësore, ujore, detare e bregdetare, e përcaktuar qartë gjeografikisht, e njohur, me kufij të qartë fizikë dhe e menaxhuar përmes mjeteve ligjore apo mjeteve të tjera të efektshme, për të arritur ruajtjen/mbrojtjen afatgjatë të natyrës, e lidhur me shërbimet e ekosistemit dhe të vlerave kulturore.

Sipas këtij ligji, kategoritë e zonave të mbrojtura mjedisore janë:

- "Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor (kategoria I)
- "Park kombëtar (kategoria II)"
- "Monument natyror (kategoria III)"
- "Rezervat natyror i menaxhuar/park natyror (kategoria IV)"
- "Peizazh i mbrojtur (kategoria V)"
- "Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara (kategoria VI)"
- "Park natyror bashkiak (kategoria IV)", dhe
- "Kurorë e gjelbër (kategoria V)".

Në juridiksionin e Bashkisë Këlcyrë, përfshihet një sipërfaqe prej 304.65 km² duke patur statutin e një qendre terciare urbane në hierarkinë e qendrave urbane sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar për planifikimin e territorit.

Pavarësisht vlerave të larta të biodiversitetit që zona mbart, për shkak edhe të sipërfaqes së kufizuar (vetëm 304.6 km² apo 30 460 ha) në Bashkinë e Këlcyrës, numri i zonave të mbrojtur, është i kufizuar vetëm në kategorinë III- "Monument natyror".





Figura 20. Uji i Zi në Grykën e Këlcyrës

4.2.5. Monumentet e Natyrës (Biomonumentet)

Monumentet e natyrës janë një tjetër aset i rëndësishëm natyror në zonën e Bashkisë së Këlcyrës. Monumentet e natyrës, bazuar në ligjin Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", përfaqësojnë kategorinë e tretë të zonave të mbrojtura në Shqipëri. Ato janë shpallur me VKM. Nr. 676, datë 20.12.2002 "Për Shpalljen Zonë e Mbrojtur të monumenteve të natyrës Shqiptare".

Në Bashkinë Këlcyrë, sipas VKM 676, gjenden këto monumete natyre:

Pylli i Sukës: Ndodhet në qendër të fshatit me të njëjtin emër, 680 m mbi nivelin e detit. Përbën një pyll me trung dhe kurorë të veçantë (ombrelle) me lartësi 25 m dhe diametër të trungut rreth 0.8 m dhe moshë mbi 120 vjeçare. Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike. Vlerat e tij janë të karakterit vendor.

Rrepet e Grykës së Këlcyrës: Ndodhen në shtratin e lumit të Vjosës në sektorin e grykës së Këlcyrës, pranë qytetit homonim. Përbëjnë një grup druresh dhe shkurresh prej rrapi të ruajtura mire. Lartësia e druveve shkon nga 2-3 m në rreth 15 m, ndërsa diametri i trungjeve nga 10 – 15 cm në rreth 80 cm. Krijojnë një mjedis shumë terheqës. Kanë vlera shkencore (biologjike), didaktike e turistike. Vizitohet me shumë lehtësi sipas rrugës automobilistike Tepelenë –apo Gjirokastër – Këlcyrë.

Rrepet e Kuqarit: Ndodhen në afërsi të fshatit me të njëjtin emër, rreth 400 m mbi nivelin e detit. Përbëhet nga disa drurë rrapi, me lartësi mesatare rreth 20- 25 m, dimatër të trungut 60 - 80 cm, perimetër të tij rreth 1.5 – 2 m dhe moshe rreth 150 - 200 vjeçare. Kanë vlera biologjike, estetike, e turistike. Mund të vizitohen sipas rrugës automobilistike Përmet – Kuqar.

Uji i Zi Këlcyrë: Ndodhet në afërsi të qytetit të Këlcyrës, në krahun e majtë të shtratin të lumit të Vjosës, në rrëzën veriore të malit Dhëmbelit, në lartësinë 160 m mbi nivelin e detit. Përbëjnë 8-10 burime karstike me prurje 400-500l/sek., që dalin në kontaktin litologjik midis gëlqerorëve të kretës së sipërme dhe flishit (Figura 20). Kanë ujë të pastër dhe të ftohtë. Krijojnë një mjedis shumë tërheqës. Kanë vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), kulturore, didaktike dhe turistike.

4.3. EFEKTET E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

4.3.1. Ndryshimet klimatike në Shqipëri

Shqipëria, si pjesë e rajonit të Europës Juglindore, pritet të ketë pasoja të ndjeshme nga ndryshimet e pritshme klimatike. Sipas raportit të Ministrisë së Mjedisit (2016), ndryshimet kryesore që parashikohen janë:

- rritja e temperaturave
- ulja e sasisë së reshjeve,
- shtimi i fenomeneve ekstreme të motit
- rritja e nivelit të detit.

Sipas skenarëve të ndryshëm, sikurse në pothuajse gjithë territorin e vendit, sektorët që do të ndikohen më shumë nga ndryshimet klimatike, edhe për Bashkinë Këlcyrë janë bujqësia, energjia, biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore. Për këtë arsye duhen marrë masa për fortifikimin e barrierave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekura edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu, duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës.

4.3.2. Rritja e temperaturave

Bazuar në të dhënat e paraqitura në komunikimin e tretë që Shqipëria ka bërë për ndryshimet klimatike në tre skenare të përgatitur, tregohet një rritje e mundshme e temperaturës mesatare vjetore përgjatë viteve 2030, 2050, 2080 dhe 2100. Si temperaturë reference është marrë temperatura mesatare e vitit 1990 (Tabela 8).

Tabela 9. Skenaret e parashikimit të rritjes së temperaturës

Stinët	Vitet			
	2030	2050	2080	2100
Vjetor	1.0 (0.7 to 1.2)	1.7 (1.3 to 2.2)	2.8 (2.0 to 3.5)	3.2 (2.4 to 4.1)
Dimër	0.8 (0.7 to 0.9)	1.2 (1.1 to 1.4)	2.0 (1.7 to 2.3)	2.4 (1.9 to 2.7)
Pranverë	1.0 (0.8 to 1.12)	1.5 (1.3 to 1.8)	2.6 (2.2 to 3.0)	3.1 (2.6 to 3.6)
Verë	1.6 (0.5 to 1.8)	2.5 (2.1 to 2.8)	4.3 (3.8 to 4.9)	5.3 (4.6 to 6.0)
Vjeshtë	1.0 (1.0 to 1.1)	1.6 (1.5 to 1.8)	2.8 (2.7 to 3.0)	3.5 (3.2 to 3.7)

Burimi: Ministria e Mjedisit, 2016

Në skenaret e rritjes së temperaturës, në vitin 2050 parashikohet një rritje mesatare e temperaturës me 1.7°C dhe skenari maksimal 2.2°C. Ndërsa në vitin 2080 temperatura mund të rritet me 2.8°C, ndërsa vlera maksimale e vlerësuar mendohet të arrijë shifrën 3.5°C. Në vitin 2100, temperatura mesatare vjetore parashikohet të rritet me 2.4- 4.1°C.





Duke vëzhguar vlerën e rritjes së temperaturës sipas stinëve të vitit, shqetësues është fakti që rritja më e madhe e temperaturës parashikohet të ndodhë në stinën e verës, duke e kthyer atë në një stinë akoma më të nxehtë e të thatë. Temperaturat mesatare vjetore për skenaret e përgatitur mund të rriten me 2.1-2.8°C në vitin 2050 dhe një rritje me 4.6-6.0°C në vitin 2100, referuar me temperaturat e vitit 1990. Temperaturat mesatare vjetore, sipas skenareve të hartuara, pritet të arrijnë në 25°C në vitet 2050 dhe në 30°C në vitin 2100.

Përveç rritjes së temperaturave në përgjithësi, parashikohet edhe shtimi i fenomeneve ekstreme të motit siç janë numri i ditëve me temperaturë >35°C pa ndërprerje, numri i ditëve me valë të nxehta, dhe numri i ditëve me temperaturë të ftohtë pa ndërprerje Burimi:


Duke iu referuar të dhënave nga Ministria e Mjedisit (2016) përgjatë gjithë viteve të ardhshme, deri në vitin 2100, do të kemi një rritje të ditëve me temperatura maksimale mbi 35°C ku nga 1.7-5.8 në periudhën 1961-1990, në vitin 2100 do të arrijnë 10-24 ditë me temperatura mbi 35°C në veri, ndërsa në pjesën qendrore dhe jugore kjo vlerë është më e ulët. Gjithashtu, numri i ditëve me valë të nxehta do të rritet përgjatë viteve të ardhshme, nga 19-27 ditë në periudhën 1961-1990 në 115-120 në vitin 2100 në pjesën veriore, ndërsa në atë qendrore dhe jugore vlerat paraqiten më të ulëta. Përsa i përket ditëve me temperaturë me të ulët se 0°C të paraqitura në tabelën e mësipërme, parashikohet një rënie drastike deri në vitin 2100, krahasuar me vitin 1990, nga 10-27 ditë në periudhën 1961-1990, në vitin 2100 këto ditë nuk do të jenë të pranishme fare në të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, edhe ditët me valët e të ftohtit nuk do të jenë të pranishme në vitet 2100.

Si pasojë e rritjes së temperaturës dhe rritjes së numrit të ditëve me valë të nxehta, vendi do të përballlet me thatësira të konsiderueshme dhe të nxehta. Ndikim i menjëhershëm do të shihet në rritjen e mesatares vjetore të vdekshmërisë, kryesisht për moshat e treta; në kërkesën në rritje për ujë të pastër; dhe në probleme me përshtatjen e kulturave bujqësore me klimën.

Ulja e sasisë së reshjeve: Një problem i rëndësishëm që pritet të vijë bashkë me ndryshimet klimatike, tashmë të vërtetuara shkencërisht, është ulja e sasisë së reshjeve vjetore dhe shpërndarja e tyre përgjatë vitit.

Në vitet e ardhshme pritet që sasia e reshjeve të ulët rreth 14.37% në vitin 2080 dhe deri në mbi 18% në vitin 2100. Në vitet e ardhshme parashikohet që periudhat e thatësirës të shtohen së tepërmi, si pasojë e uljes së sasisë mesatare të reshjeve vjetore dhe shpërndarjes së tyre përgjatë vitit. Nga të dhënat e skenareve të parashikuara të shpërndarjes së reshjeve vjetore (Tabela 9), vihet re që stina e verës do të jetë mbi 50% më e thatë. Mungesa e reshjeve do të çojë në një verë shumë më të nxehtë dhe të thatë, duke u kthyer në problem serioz për zhvillimin e bujqësisë, dhe do të nxjerrë në pah shumë probleme të tjera në sektorë të ndryshëm ekonomik.

Rritja e temperaturave në territorin e Bashkisë Këlcyrë do të ketë një sërë problemesh kryesisht në zhvillimin e bujqësisë dhe në biodiversitet. Zhvillimi bujqësor në territorin e bashkisë do të përballlet me kushte klimatike më të thata, e si pasojë do të ketë një rritje të kërkesës për ujë për vaditje dhe nga ana tjetër një ulje në sasinë e reshjeve dhe rezervave ujore të përdorshme për bujqësinë. Shtimi i dëmtuesve (parazitë, mikroba, insekte) do të jetë një problem ekzistent në rritjen e



temperaturës mesatare vjetore. Biodiversiteti do të preket ndjeshëm nga kohëzgjatja e periudhave të nxehta gjatë vitit dhe mungesës së reshjeve, si pasojë dhe intensifikimi i zjarreve të cilët dëmtojnë specie dhe habitate në tërësi. Për zhvillimin sa më të qëndrueshëm të biodiversitetit duhen marrë masa në kohë sa më të hershme, për adoptimin e bujqësisë dhe gjetjen e mënyrave për plotësimin e nevojës me ujë për vaditje.

Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit: Përgjatë viteve, fenomenet ekstreme të motit si përmbytjet, valët e të nxehtit etj. kanë qënë të pranishme në vendin tonë. Përmbytjet kanë një ndikim të madh në aspektin e jetës së njerëzve, ekonomisë, bujqësisë dhe mjedisit. Pika kulminante e përmbytjes në vitin e fundit është regjistruar në vitin 2015, në të cilën humbjet arritën në rreth 0.18% të PBB-së së vendit. Në vitet që vijnë, fenomeni i përmbytjeve i ndihmuar nga shirat intensive që pritet të shtohen, parashikohet të shpeshtohet. Stina e verës do të pësojë ndryshime të theksuara duke krijuar kushte ekstreme si temperatura të larta dhe periudha të zgjatura të thata. Ndërsa në zonat bregdetare, me rritjen e temperaturave dhe intensifikimin e reshjeve, parashikohet të formohen stuhitë, të cilat do të kenë një ndikim jo të vogël në ato zona.

Në skenarët e parashikimit të ndryshimit të klimës, theksohet shtimi i fenomeneve ekstreme të motit, kryesisht shtimi i shirave intensivë, të cilët janë tepër problematikë në fryrjen e menjëhershme të lumenjve dhe si pasojë përmbytjet do të jenë më të mëdha. Zonat breglumore, apo dhe zona përreth, do të jenë tepër të prekura nga përmbytjet që parashikohen në të ardhmen, ndaj duhen marrë masa të menjëhershme për përbalimin e këtij fenomeni, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe të zonave urbane.

Përfundime dhe rekomandime

Ndryshimet klimatike tashmë janë një realitet. Ky ndryshim i klimës ka ndikim të madh në shumë fusha të zhvillimit të vendit, sidomos në atë bujqësor dhe energjitik. Vetëm sektori i bujqësisë ka rreth 50% të punësuarve në Shqipëri. Gjithashtu, kontributi i këtij sektori në PPB arrin në 24%. Në këtë kontekst shihet më se e rëndësishme të merren masa të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë duke patur parasysh ndryshimet klimatike. Disa nga këto masa në bujqësi përfshijnë përshtatjen kulturave bujqësore me ndryshimet e klimës, manaxhimin e duhur të burimeve ujore, rritjen e kapaciteteve kulluese dhe ato ujitëse, masa për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve, mbrojtjen e tokës nga erozionit etj.

Popullsia në territorin e Bashkisë Këlcyrë do të përballet me jo pak probleme në të ardhmen për shkak të ndryshimeve klimatike. Ndër problemet kryesore që do të hasen në territorin e Bashkisë janë: shtimi i rasteve të zjarrit, thatësira të zgjatura, përmbytjet nga fryrja e rrjedhave të lumenjve dhe kërkesa në rritje për ujë në bujqësi dhe në uljen e sasisë së ujit të përdorshëm nga ky sektor. Popullsia në territorin e Bashkisë, në zonat të cilat janë në kuota të ulëta mbi nivelin e detit, do të pësojnë kripëzimin e ujit të pijshëm dhe kripëzimin e tokave bujqësore. Ndërsa zonat e banuara në afërsi të brigjeve të lumenjve do të preken së tepërmi nga përmbytjet, të cilat priten të shtohen si pasojë e shirave intensiv. Zhvillimi bujqësor do të sigurojë të ardhura më të pakta për banorët, pasi rritja e periudhës së thatësirave çon në rritjen e kërkesës për ujë dhe aktualisht kanalet ujitës nuk janë totalisht në funksion.





4.4. POPULLSIA DHE ASETET MATERIALE

4.4.1. Popullsia dhe tendencat demografike

Në këtë seksion është bërë analiza dhe vlerësimi i karakteristikave demografike të Bashkisë Këlcyrë dhe zhvillimi përgjatë kohës. Ky vlerësim i gjendjes ekzistuese ashtu edhe të tendencave të tij, jep mundësinë të përcaktohet pozicioni përkatës i Bashkisë dhe rezultatet e analizës mund të shërbejnë si një bazë për formulimin e politikave të nevojshme për nxitjen e perspektivave të zhvillimit të Bashkisë në nivel organizimi dhe menaxhimi të territorit, por edhe në aspektin ekonomik dhe social. Burimi kryesor i Informacionit të përdorur ka qenë baza e të dhënave demografike të Institutit të Statistikave (INSTAT).

Shpërndarja dhe përqëndrimi i popullsisë në territor

Të dhënat e Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë (Census 2011), paraqesin Bashkinë Këlcyrë me një popullsi rezidente prej 6 113 banorë. Popullsia rezidente e aktualizuar vlerësohet të jetë 5 625 banorë, për një territor me një sipërfaqe prej 304.6 km² (Tabela 10).

Njësia Administrative Këlcyrë regjistron numrin më të lartë të banorëve, më shumë se 43% të popullsisë së bashkisë, kurse ndër Njësitë e tjera Administrative Ballabani, paraqet numrin më të ulët të banorëve, duke mos kaluar vlerën e 1,200 banorëve për njësi administrative. Në këtë kontekst, ku numri i banorëve është i ulët, vërehet një densitet mesatar tepër i ulët, me rreth 18 banorë/km², duke shënuar një vlerë pesë herë më të ulët se densiteti mesatar kombëtar prej 97 banorë/km².


Tabela 10. Shpërndarja e Popullsisë. Bashkia Këlcyrë

Njësitë Administrative	Popullsia (në 2016)	Sipërfaqe (km ²)	Densiteti (Banorë/km ²)
Ballaban	959	89.1	10.76
Këlcyrë	2437	57.7	42.23
Sukë	1160	75.7	15.33
Dëshnicë	1070	82.1	13.03
Bashkia Këlcyrë	5625	304.6	18.48

Siç vërehet dhe nga tabela, qyteti i Këlcyrës ka densitetin më të lartë me rreth 42.23 banorë/km², ndërsa njësitë e tjera administrative paraqesin një densitet 10 -15 banorë/km². Densiteti ulët i popullsisë, është një tregues i karakterit rural të bashkisë Këlcyrë.

Ndryshe nga popullsia rezidente e vlerësuar nga Census 2011, e cila tregon një imazh statik të numrit të banorëve në një zonë të caktuar, në një moment të caktuar, Gjendja Civile tregon popullsinë e regjistruar nga pikëpamja administrative në një territor. Popullsia e Regjistruar në Gjendje Civile, lejon një vlerësim të popullsisë ekzistuese dhe potenciale të Bashkisë Këlcyrë (Figura 21).

Nëse krahasojmë popullsinë rezidente me popullsinë e regjistruar në Gjendjen Civile, vërehet një diferencë tepër e lartë, për shkak të disa faktorëve si p.sh.: migrimi i popullsisë jashtë vendit dhe migrimi i brendshëm. Siç vërehet në hulumtimet e kryera në territor dhe konstatimet e Raportit Instat 2014, për "Projeksionet e Popullsisë së Shqipëri 2011-2031", kriza ekonomike botërore e viteve të fundit (2009-2012), ka patur një efekt pozitiv në rikthimin e popullsisë së migruar. Në këtë



kontekst, studim më i detajuar mbi tendencat e popullsisë së regjistruar në gjendje civile, bëhet i domosdoshëm.




Figura 21.. Densiteti i banorëve në njësitë administrative të Bashkisë Këlcyrë

Rezultatet e Census 2011 regjistrojnë 6,113 banorë në bashkinë Këlcyrë, kurse për të njëjtin vit në Gjendje Civile regjistrohen 12,909 banorë. Kjo diferencë e lartë është e qëndrueshme dhe për vitin 2015 ku popullsia rezidente vlerësohet të jetë 5,625 banorë, kurse popullsia në Gjendje Civile regjistrohen 12,537 banorë.


Rënia e popullsisë së regjistruar në Gjendje Civile gjatë 15 viteve të fundit, lidhet ngushtë me migrimin e brendshëm. Kjo rënie e popullsisë tregon qartë atraktivitetin e qendrave urbane kombëtare dhe dinamikat migratore brenda territorit të republikës së Shqipërisë. Diferenca e lartë ndërmjet popullsisë rezidente dhe popullsisë të regjistruar në Gjendje Civile dhe tendenca në rënie të popullsisë, shfaqin qartë një nivel të lartë migrimi jashtë vendit dhe një migrim të brendshëm të konsiderueshëm. Frenimi i tendencave migratore është një nga problematikat kryesore të Bashkisë Këlcyrë, për këtë arsye ndërmarrja e politikave lokale në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe ekonomisë rajonale, janë të domosdoshme për qëndrueshmërinë demografike të bashkisë.

Fenomeni i migrimit dhe eksodi rural të 25 viteve të fundit, mund të perceptohen dhe më qarta falë diferencave të ndryshimit të popullsisë ndërmjet Censusit 1989, 2001 dhe 2011.

Ndryshimi i popullsisë dhe tendencat demografike

Ndryshimi i popullsisë rezidente ndërmjet 2001 dhe 2011, tregon se rreth 30.8% e ekuivalentit të popullsisë është larguar nga territori për një periudhë kohore 10 vjeçare. Njësitë administrative më të prekur nga fenomeni i migrimit janë Njësitë Administrative: Sukë, Ballaban dhe Dëshnicë. Megjithatë, njësia Këlcyrë shënon një nivel migrimi më të ulët se mesatarja e bashkisë, migrimi i popullsisë të secilës njësi administrative të Bashkisë Këlcyrë tejkalon ndjeshëm mesataren kombëtare prej 8.7%.


Ndryshimi i popullsisë rezidente ndërmjet 1989 dhe 2011, tregon se rreth 61% e ekuivalentit të popullsisë 2011 është larguar nga territori për një periudhë kohore 20 vjeçare. Të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Këlcyrë, shfaqin një nivel të lartë ndryshimi popullsie, që tejkalon mesataren kombëtare prej 12% (Grafiku 7). Janë Njësinë Administrative Ballaban, Sukë dhe Dishnicë, që regjistrojnë vlerat më të larta të ndryshimit të popullsisë, me përkatësisht 81%, 77% dhe 75%.



Census 2011, Instal. përpunat Atelier 4

Grafiku 7. Ndryshimi i popullsisë rezidente ndërmjet CENSUS 1989-2011

Qyteti i Këlcyrës shënon ndryshimin më të ulët të popullsisë, më vetëm 40%. Pra në një këndvështrim të përgjithshëm, vërehet se njësitë më karakter rural shfaqin një tendencë migratore më të lartë, duke regjistruar një ndryshim të popullsisë që tejkalon 75% e ekuivalentit të popullsisë rezidente 2011 (Grafiku 8). Për të vlerësuar ritmin e migrimit që prek njësitë e ndryshme administrative, është e nevojshme të krahasojmë dhe rezultatet e ndryshimit të popullsisë ndërmjet regjistrimeve të ndryshme të popullsisë.




Census 2011, Instal, përpunoi Atelier 4

Grafiku 8. Ndryshimet e popullsisë ndërmjet regjistrimeve të ndryshme të popullsisë, (1989-2001-2011)

Nëse krahasojmë diferencat e ndryshimit të popullsisë rezidente ndërmjet Census 1989-2001- 2011, vërehet se gjatë Census 2001-2011, ka një qëndrueshmëri të rritimit të migrimit, krahasuar me 1989-2001. Rreth 61% e ekuivalenti të popullsisë rezidente 2011, është larguar nga bashkia Këlcyrë gjatë viteve 1989-2011, kur 30.8% prej tyre janë larguar gjatë 2001-2011 dhe rreth 30% janë larguar gjatë 1989-2001. Niveli i lartë dhe qëndrueshmëria e i ritmeve të migrimit të popullsisë, shfaq problematika të rënda ekonomike dhe sociale. Në përfundim mund të themi se Bashkia Këlcyrë përballlet me një nivel të lartë të migrimit të popullsisë.

4.4.1.1. Piramida e moshës dhe tendencat demografike

Piramida e moshës së Bashkisë Këlcyrë për vitin 2016 shfaq karakteristika të përbashkëta me piramidën e moshës së Qarkut Gjirokastrë (Census 2011), ku vërehet një rënie e grup moshave të reja, një rritje e grup moshave 10-30 vjeç dhe grup moshave 45-60 vjeç. Nga piramida e moshës, vërehet se ka një rënie të lindshmërisë dhe një vjetërsim të popullsisë, por megjithatë popullsi, është relativisht e re. Fakti se popullsi, është kryesisht e re, dhe grup-mosha 15-30 vjeç, përfaqësojnë një pjesë të madhe të popullsisë, tregon qartë potencialin demografik të Bashkisë Këlcyrë, në rinovimin e popullsisë në moshë pune (Grafiku 9).



Grafiku 9. Piramida e moshës. Bashkia Këlcyrë 2016.

Elementët kryesor demografik të Bashkisë Këlcyrë

- ✦ Bashkia Këlcyrë ka një popullsi rezidente prej 5,625 banorë dhe një sipërfaqe prej 304.6 km², ku shfaqet një densitet mesatar tepër të ulët, rreth 18 banorësh/km²
- ✦ Shpërndarja gjeografike e popullsisë thekson karakterin rural të zonës, dhe ndikon negativisht në ofrimin dhe implementimin e shërbimeve publike cilësore.
- ✦ Qyteti i Këlcyrës evidentohet si pol demografik i rëndësishëm në Bashkinë Këlcyrë
- ✦ Tendencat demografike shfaqin një nivel të lartë migrimi i cili prek kryesisht zonat rurale, duke rrezikuar braktisjen e territorit nga popullsia lokale.
- ✦ Ndryshimi i popullsisë ndërmjet viteve 1989-2011 regjistron vlerat më të larta se mesatarja kombëtare (ekuivalenti i 61% të popullsisë rezidente aktuale është larguar gjatë viteve 1989-2011).
- ✦ Njësitë Administrative të cilat hasin një mungesë të theksuar infrastrukture rrugore dhe ndërlidhje me tregjet kryesore rajonale, regjistrojnë nivelin më të lartë të migrimit.
- ✦ Bashkia Këlcyrë gëzon një popullsi relativisht të re, megjithëse vërehet një rënie lindshmërisë dhe një vjetërsim i popullsisë.

Për të frenuar braktisjen e territorit nga popullsia rezidente, përmirësimi i cilësisë së jetës, aktivitetit ekonomik, tregut të punës, aksesit dhe shërbimet publike, shfaqen si ndërhyrje me prioritet të lartë.

4.4.2. Strehimi


Aksesi në strehim të sigurt është një e drejtë që duhet ta gëzojë çdo qytetar. Kushtet e strehimit dhe të jetesës kane një ndikim të drejtpërdrejtë si në shëndetësi ashtu dhe në nivelin arsimor të popullsisë dhe kështu e shtrirë në gjendjen sociale dhe ekonomike të popullsisë.

Në seksionin e mëposhtëm jepet një pasqyrë e kushteve të jetesës për Bashkinë Këlcyrë siç rezultojnë nga të dhënat e Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) për regjistrimin e popullsisë të vitit 2011.

Gjendja e Njësive Ekonomike Familjare (NjEF),


Nevojat për banim në përgjithësi dhe për banesa sociale për grupet në nevojë, rrjedhin kryesisht nga një kërkesë lokale. Vlerësimi i strukturave familjare dhe i situatës socio-ekonomike të zonës, lehtëson identifikimin e kërkesës së ardhshme për banim. Gjendja e Njësive Ekonomike Familjare (NjEF), përbën një indikator të rëndësishëm mbi strukturën familjare dhe sociale të Bashkisë Këlcyrë.

Bashkia Këlcyre shfaq një mesatare prej 3.5 anëtarëve për NjEF, duke shënuar një vlerë nën mesataren kombëtare që është 3.9 anëtarë për NjEF. Pra Struktura familjare të Bashkisë Këlcyrë, përbehet mesatarisht, nga një numër modest anëtarësh (Grafiku 10).



Grafiku 10. Përbërja e njësive familjare, Bashkia Këlcyrë

Numri i ulët i anëtarëve për NjEF, mbështetet dhe në faktin se vetëm 9.5% e NjEF të Bashkisë Këlcyrë kanë një përbërje familjare që tejkalon 6 anëtarë (Graiku 11).




Grafiku 11. Njësitë ekonomike familjare me më shumë se 6 anëtarë, Bashkia Këlcyrë

Gjendja e Banesave

Densiteti i banesave është një tregues i rëndësishëm territorial, i cili tregon përdorimin dhe organizimin e sistemit të banimit. Këlcyrë shfaq një densitet të ulët të banesave duke mos tejkaluar 16 banesa/km². Densiteti i ulët i banesave në zonat rurale shpjegohet për faktin se 95% e ndërtesave për qëllim banimi, janë ndërtesa të ulëta një katëshe, dhe vetëm 1% e ndërtesave për banim janë mbi 3 katëshe.


Ndërtesat e ulëta, shpjegohen për faktin e tipologjisë së ndërtesave, ku 98% e ndërtesave të Bashkisë Këlcyrë janë të llojit shtëpi. Megjithatë njësia Këlcyrë evidentohet si qendra kryesore e urbanizuar, vërehet se ka një nivel të lartë ndërtesash të tipit shtëpi.

Për një përjasje më të saktë, përpos sistemit të banimit është e nevojshme të vlerësohen dhe strukturat e banesave. Mesatarja e dhomave për njësi ekonomike familjare në Bashkinë Këlcyrë është 2.8 dhoma /NjEF, vlerë kjo e përafërt me mesataren kombëtare prej 2.9 dhoma /NjEF (Grafiku 12).




Grafiku 12. Dhomat për njësi familjare, Bashkia Këlcyrë

Vlerësimi i numrit të dhomave për banor ose sipërfaqja e banueshme përbëjnë treguesit kryesorë të situatës të banimit në zonë. Vlerësohet se Bashkia Këlcyrë ka një mesatare prej 0.8 dhoma/banorë, duke qenë e njëjtë me mesataren kombëtare prej 0.8 dhoma/banorë. Po ashtu edhe sipërfaqja e banueshme regjistron vlera të ngjashme me mesataren kombëtare 14.5 m² për banor (Grafiku 13).



Grafiku 13. Sipërfaqe e banueshme për banorë, Bashkia Këlcyrë

Megjithëse kërkesa e ardhshme për banim konsiderohet modeste, për shkak të përbërjes së njësive familjare, numri i ulët i dhomave dhe sipërfaqja e vogël e banesës për NjEF, janë indikatorë të një kërkesë potenciale për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe për pasojë rritjen e kërkesës lokale për diversifikim dhe cilësi në strukturat e banimit. Në mbështetje të këtij trendi mund të shtojmë dhe faktin që 94% e banesave të bashkisë Këlcyrë janë në pronësi të një nga anëtarëve të familjes (Grafiku 14).



Grafiku 14. Njësitë ekonomike familjare që kanë banesën në pronësi. Bashkia Këlcyrë
Elementët kryesorë të situatës të Banesave

- ✦ Përqendrimi i banesave në Bashkinë Këlcyrë ka një shpërndarje të theksuar në zonat rurale, duke regjistruar një densitet nën 16 banesa për km².
- ✦ Ndërtesat për arsye banimi janë kryesisht shtëpi të ulëta një katëshe (98% e banesave të tipit shtëpi dhe 95% e banesave janë 1 katëshe). Shpërndarja gjeografike e banesave në zonat rurale, thekson vështirësinë e Bashkisë Këlcyrës në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike.
- ✦ Vërehet se ka një shfrytëzim të dobët të banesave ekzistuese, ku 37% e tyre regjistrohen si të pabanuara dhe 11% si banesave dytësore. Janë pikërisht njësitë administrative të cilat kanë njohur dhe lëvizjet më të lartë të popullsisë që shënojnë dhe vlerat më të lartë të banesave të pabanuara (ku vlen të përmenden Njësitë Ballaban, Sukë dhe Dëshnicë, me respektivisht 38%, 48% dhe 49% të banesave janë të pabanuara).

Përmirësimi i standardeve dhe shfrytëzimi optimal i sistemit imobiliar, përbëjnë faktorët kryesorë në zhvillimin e ardhshëm të sistemit të banimit në Bashkinë Këlcyrë.

4.4.3. Trashëgimia Arkeologjike dhe Kulturore

Materiale arkeologjike të nxjerra nga gërmime të ndryshme në krahinën e Këlcyrës dëshmojnë për prezencën e jetës njerëzore që në prehistori, e më pas vijimësi të saj deri në mesjetë. Në vitin 1988, në luginën e sipërme të Vjosës, në të dalë të Këlcyrës, gjatë punimeve për ndërtimin e një ngrehine, rastësisht u zbulua një varr cist. Në këtë varr u gjetën dy armë bronxi, një shpatë dhe një majë heshte. Nga studime të kryera më pas, u vërtetua që varri i gjetur ishte pjesë e mbetur e një varreze tumulare të shkatërruar kohë më parë. Shpata dhe maja e heshtës të zbuluara në këtë varr u studiuan me shumë kujdes dhe u arrit në përfundimin se ishin armë të modeleve hibride por të




4

ATLICH - ETUDES ARCHITECTURALES

prodhuara në zonë e jo armë të sjella nga vendet përreth. Këto përbëjnë dëshminë e parë të jetës së zhvilluar në krahinën e Këlcyrës, që në epokën e bronzit. Më pas, në hartën e rrugëve dhe të urave të ndërtuara dhe përdorura në antikitet, Këlcyra shfaqet në pike-takimin e rrugëve antike që lidhnin Tepelenën me Përmetin dhe krahinën e Zagorisë me krahinën e Skraparit të sotëm. Gjithashtu në hartën e vendbanimeve antike Këlcyra shfaqet si një qendër e banuar e nivelit të dytë, dëshmuar kjo edhe me ndërtimet e kalave të Këlcyrës dhe Limarit.

Emri i qytetit mendohet të ketë origjinën nga Klisura (njësi administrative-ushtarake në periudhën bizantine) e cila si funksion parësor kishte kontrollin e kalimit në pikat me rëndësi strategjike. Gjurmët e Këlcyrës humbasin në tymtajën e shekujve dhe qyteti del përsëri në dritë si prone e Muzakajve, Andrea Muzakës – zot i Beratit dhe Marshall i Arbërisë (1280-1319). Në një kronikë mesjetare të vitit 1272 Këlcyra përmendet me emrin latin Clausura, fjalë që i ka rrenjet në greqishten e lashtë, me të njëjtën prejardhje etimologjike me fjalën e anglishtes së sotme "closed", përkthehet në shqip "vend i mbyllur", pra Grykë. Në shek XIV, qyteti thirret Chisania ose me emrin greko-romak, Clazura, Clisania, Klisura.

Ndërtimet tradicionale janë të ngjashme me ndërtimet e banesave në krahinat përreth; ndërtuar me mur guri gëlqeror, lidhur me llaç gëlqere. Megjithëse e thjeshtëzuar krejt shkallë përpunimi plastik të fasadës, në banesën e Këlcyrës nuk mungojnë edhe elementët dekorativë prej guri në dyer e dritare, apo dhe në qoshet e mureve.



4.5. VLERËSIMI I KËRCËNIMEVE PËR BURIMET NATYRORE DHE PROBLEMATIKA MJEDISORE

Bashkia e Këlcyrës, edhe pse me një territor relativisht të kufizuar, shquhet për pasurinë në burime natyrore, gjendja e të cilave paraqitet përgjithësisht e kënaqshme. Kjo e ndikuar nga traditat e kësaj zone, vecoritë gjeografike dhe klimatike, numrit të vogël të banorëve, shkallës së ulët të mekanizimit të bujqësisë, etj. Pavarësisht kësaj, kërcënimet për burimet natyrore janë të pranishme.

4.5.1. Rreziku i përmytjeve

Vendi ynë është kërcënuar nga përmytjet e lumenjve ndër vite. Sipas studimeve të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP, 2013), informacionet e para rreth përmytjeve në vend janë regjistruar në vitet 1854-1871, periudhë gjatë së cilës kanë ndodhur 11 përmytje. Përmytjet kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në vend. Megjithatë, përmytja e viteve 1962-1963 konsiderohet përmytja me ndikim më të madh. Lumenjtë e Drinit dhe të Bunës përmytën fushat e Shkodrës dhe Zadrimës, lumenjtë Mat dhe Drin përmytën fushën e Lezhës, lumi Ishëm përmyti fushën e Thumanës, ndërsa lumenjtë Shkumbin dhe Seman kanë përmytur fushat përreth tyre. Sipas llogaritjeve të asaj kohe, janë përmytur gjithsej 70,000 ha tokë bujqësore duke shkaktuar dëme të mëdha në ekonominë e banorëve vendas.

Përmytje të tjera të një shkalle të gjerë janë regjistruar në vitet 1970-71 dhe në vitin 2002. Në vitin 1970-71 ndikimet më të mëdha janë ndjerë në luginën e Vjosës, ashtu sikurse edhe në janar të vitit 2015 dhe në dhjetor 2017. Në shtator të vitit 2002, përmytjet janë përsëritur duke mbuluar me ujë rreth 30,000 ha tokë bujqësore. Lumenjtë që dolën nga shtrati ishin lumi Erzen dhe, mbi të gjitha, degët kryesore të lumenjve Vjosë (Drinosi), Seman (Gjanica) si dhe përrenj të tjerë të vegjël (Gjadri, Përroi i Manatinës në Lezhë dhe Përroi i Zezës). Përmytjet kanë vazhduar sërish duke shkaktuar dëme të mëdha në vendet ku ato ndodhin.

Lumi i Vjosës llogaritet të ketë përmytur 14,000 ha në vitin 2002 dhe shkaktuar dëmtime dhe shkatërrime të argjinaturave, kanaleve ujitëse, urave, stacioneve të pompimit etj.

Në janar të vitit 2015 lumi i Vjosës llogaritet të ketë përmytur rreth 9,275 ha kurse si rezultat i prurjeve tejet të mëdha në ditët e para të dhjetorit 2017, lumi i Vjosës llogaritet të ketë përmytur rreth 10,700 ha.

Rekordet e niveleve maksimale për Vjosën, përpara këtyre dy ngjarjeve, i përkisnin vitit 1970, ndërsa për degën më të madhe të saj, lumin Drino, ky rekord i takon 16 nëntorit të vitit 1962. Nga të dhënat e mediave, që i referoheshin burimeve të ndryshme zyrtare, disa ditë pas ngjarjes së 1 shkurtit 2015, rezultoi se ky rekord për pjesën e Vjosës është thyer (Grafiku 15). Si pikë referimi është marrë vendmatja hidrometrike e Përmetit. Në vendmatjen e Çarshovës, që është stacioni i pare hidrometrik i Vjosës, në territorin e Shqipërisë, prurja maksimale e datës 1.02.2015 shkatërroi bazamentin e betonit që ishte ndërtuar para 30 vjetësh.







Line graph showing the average monthly precipitation (mm) in Viot from 1960 to 2020. The Y-axis represents precipitation in mm, ranging from 220 to 228. The X-axis represents the year. The graph shows a highly variable trend with significant peaks and troughs. A linear trend line is also shown, indicating a slight overall increase in precipitation over the period.

Year	Precipitation (mm)
1969	222.95
1970	223.48
1971	226.76
1972	226.14
1973	222.37
1974	223.95
1975	223.20
1976	225.48
1977	223.77
1978	224.18
1979	223.78
1980	223.53
1981	222.58
1982	221.1
1983	224.63
1984	223.98
1985	222.58
1986	221.41
1987	222.06
1988	221.68
1989	222.78
1990	221.88
1991	222.38
1992	221.86
1993	221.88
1994	220.78
2005	225.18
2015	227.18

Përmbijtjet zakonisht janë të lidhura ngushtë me periudhën kur sasia e reshjeve është më e lartë në vend, e cila përkon me muajt nëntor-mars. Këto janë edhe muajt kur bien rreth 80-85% të reshjeve në vend. Në përgjithësi, dhe sidomos në kohët e fundit, reshjet intensive janë të befasishme dhe dallohen për një kohëzgjatje për rreth 8-10 orë (Figura 22). Si rrjedhojë, lumenjtë kryesorë të vendit arrijnë kapacitetin e tyre maksimal deri në dalje nga shtrati duke përmbytur tokat përreth. Gjatë përmbytjeve, prurja specifike e lumenjve në vendin tonë luhetet nga 0.5-2.5 m³/s/km².



98



Vjosa dallon nga të gjithë lumenjtë e tjerë në Ballkan për shkallën e lartë të ujeshmërisë, ndërtimin gjeologjik të formacioneve që përshkon dhe larminë e peizazheve përgjatë luginës.

Nga të dhënat e tabelës në vijim (Tabela 11), rezultojnë se niveli maksimal i vitit 1970 i përket një periudhe përsëritjeje 1 herë në 50 vjet (861 cm sipas llogaritjeve dhe 858 cm niveli i vrojtuar). Ngjarja e vitit 2015, që ishte 900 cm, e tejkalon këtë rekord dhe mund të thuhet se niveli i datës shkurt 2015 i takon një periudhe përsëritjeje prej rreth 75 vjetësh.

Tabela 11. Nivelet e Vjosës me periudhë përsëritjeje të ndryshme, Përmët (Burimi: Kolaneci & Mato, 2015)

Përsëritja (në vjet)	10	20	50	100
Niveli (në cm)	676	757	861	939
Lartësia mbi nivelin e detit (në m)	224.94	225.75	226.79	227.57

4.5.2. Ndërtimi i Hidrocentraleve mbi lumin Vjosa dhe tributarët e tij

Lugina Vjosës përbën një habitat për shumë lloje kafshësh dhe bimësh që janë shumë të rralla ose janë zhdukur fare nga lumenjtë e tjerë të Evropës. Megjithatë, shumë prej këtyre gjallesave tashmë kërcënohen të zhduken nga ndërtimi i planifikuar i hidrocentraleve mbi të apo tributarët e tij.

Ndërtimi i hidrocentraleve me diga mund të ngrejë nivelin e ujit. Kjo krijon një përmbajtje të krejt zonës së rezervuarit dhe sjell ndryshime të thella të kushteve të habitatit. Si rrjedhojë ka filluar të shfaqet një ekuilibër i ri i ekosistemit, krejt ndryshe nga i mëparshmi. Ky ndryshim i dinamikës ndikon tek speciet tradicionale që kanë patur foletë, janë rritur e ushqyer tradicionalisht në këto zona dhe mund të sjellë dhe specie invazive që dëmtojnë habitatin dhe speciet vendase.

Problem tjetër është edhe sedimentimi. Sedimentet janë materiale organike dhe inorganike që mbledhen në ujë për shkak se diga nuk i lejon të vazhdojnë me rrjedhën. Këto sedimente brenda digës sjellin një efekt të quajtur "mbingarkimin me lëndë ushqyese", shtimin e gjallesave dhe shkakton varfërimin me oksigjen të ujit.

4.5.3. Erozioni i tokës, shembjet dhe rrëshqitjet

Dukuria e erozionit lidhet me modifikimin apo shkatërrimin e habitateve, veçanërisht në pjesën më malore të bashkisë. Prerja e drurëve, zjarret dhe degradimi i pyjeve në zonat me shpate të larta, shoqërohen me rritje të mëtejshme të erozionit që së bashku me erozionin që ndodh natyrshëm, ndikon ndjeshëm tek habitatet. Erozioni çon në shkatërrimin dhe fragmentimin e habitateve, zhdukjen e specieve, modifikimin e bimëve dhe komuniteteve të kafshëve vendase, dhe së fundi, në ndryshimin e përhershëm të ekosistemit dhe peizazhit. Rrëshqitjet e tokës në territorin e bashkisë janë prezente dhe mund të shtohen nëse dëmtohet mbulesa pyjore apo nuk mirëmbahet ajo ekzistuese.

Sipas një studimi të ndërmarrë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe të realizuar nga specialistët e Universitetit Bujqësor të Tiranës, (AKM, 2017), nga analiza e elementeve kimike të tokave ka



rezultuar se ndryshimet ndermjet tokave përsa i përket nivelit të erozionit lidhen jo vetëm me kushtet natyrore të formimit dhe evolucionit, por edhe me nderhyrjet humane në ekosistemet natyrore në zonën e studimit.

Sasia e erozionit potencial të tokës e llogaritur nga ekuacioni USLE tregoi se në rastin e pyjeve fletore me kurorë-dendesi të lartë, sasia e tokës së eroduar (ton/ha/vit) është shumë herë më e ulët sesa në rastin e pyjeve halore ($0.32 < 1.77$; $0.32 < 1.32$)

Po kështu sasia e erozionit në pyje halore me pjerrësi të ndryshme rezultoi më e madhe në shpatet me pjerrësi më të madhe (pyll halor me pjerrësi 39% < pyll halor me pjerrësi 58%).

Në kullotat e degraduara sasia e erozionit potencial të tokës rezultoi më e madhe se në kullotat e padegraduara ($1.32 > 0.47$ ton/ha/vit). Për tipet e studiuara të mbulesës u konstatua se rrjedha siperfaqësore kishte këtë trend:

kullotë < pyll dushku

pyll dushku < pyll pishe artificial (39% pjerrësi)

pyll pishe artificial (39% pjerrësi) < pyll shkurresh i mbikullotur

pyll shkurresh i mbikullotur < pyll pishe artificial (58% pjerrësi)

pyll pishe artificial (58% pjerrësi) < pyll pishe i djegur.


Rezultatet e monitorimit vjetor të prodhimit të sedimenteve në pikën e monitorimit në Trebeshinë (pranë implantit të Ujit Trebeshina) sygjerojnë se mbulesa bimore ka efekt proporcional direkt mbi rrjedhën sipërfaqësore dhe sasinë e sedimenteve të prodhuara në kushtet biogeoklimatike të eksperimentit.

Pvltaria dhe Kullotja

Ligji Nr. 5/2016, datë 04/02/2016 "Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë" ndalon ushtrimin e të veprimtarisë së shfrytëzimit të lëndës drusore në fondin pyjor publik/privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, tregtimin e produkteve të tij, ndalon eksportin e lëndës së drurit të papërpunuar, lëndës së ndërtimit, drurëve të zjarrit, si dhe qymyrit të drurit. Por ligji lejon shfrytëzimin e lëndës drusore për plotësimin e nevojave të banorëve të bashkive për dru zjarri dhe kjo rregullohet me VKM 438, datë 8.6.2016 "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore" (Ndryshuar me VKM Nr. 438, datë 17.5.2017).

Pavarësisht kësaj, prerja e pakontrolluar e drurëve e cila vjen edhe për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit publik, zbatimit të rregullave, si dhe burimeve njerëzore të kufizuara në dispozicion për inspektimin dhe menaxhimin e tyre, mbetet rrezik evident.

Planet e menaxhimit të pyjeve komunalë, treguan se më së shumti në afërsi të fshatrave ka një ndikim të madh njerëzor: prerje, kullotje intensive dhe shpyllëzime në disa vende me qëllimin e përfitimit të tokave bujqësore për kultivimin e bimëve bujqësore.



Përpos kësaj, këto plane menaxhimi të pyjeve komunalë, (tashmë pjesë përbërëse e Bashkisë) tregojnë për nevoja shumë më të larta për dru zjarri sesa oferta. Kjo domosdoshmërisht ka rritur dhe do të rritë presionin mbi pyjet.

4.5.4. Dëmtimi i faunës

Edhe pse sipas ligjit Nr. 61/2016, date 02/06/2016 "Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë" është bërë pezullimi i përdorimit të zonave të gjuetisë dhe pezullimi i gjuetisë në zonat e mbarështimit të faunës së egër, problem mbetet gjuetia e paligjshme, e cila kryesisht synon llojet të cilat janë me statuse të veçanta mbrojtje. Evidentimi dhe ndëshkimi i gjuetisë së paligjshme duhet të vazhdojë të jetë prioritet për stafin lokal të bashkisë.

4.5.5. Turizmi

Turizmi krijon presion në mjedisin natyror dhe kulturor duke kërcënuar kështu burimet, strukturat, modelet kulturore, aktivitetet ekonomike dhe përdorimin e tokës në komunitetin lokal. Në mënyrë që presionet të tilla të mos krijojnë probleme, duhet të merren masa të veçanta për të zbutur ndikimet e tyre në mjedis. Zhvillimi me ritme të shpejta i turizmit ndikon me zhvillimin e infrastrukturës në zonë, si për shembull nevoja për ndërtimin e restoranteve, hoteleve, shërbimeve të tjera shtesë të cilat ndikojnë direkt në prishjen e peizazhit kulturor të parqeve. Në mënyrë që komuniteti dhe bizneset turistike në zonë të përgjigjeshin kërkesës së turistëve, janë bërë shumë investime në mënyrë të paplanifikuar si dhe shpeshherë jo në harmoni me peizazhin.

Hapja e rrugëve të reja, krijimi i shtigjeve, ndërtimet, mbetjet, deformimi kulturor, ndotja e ujërave, prishja e habitateve, rritja e rreziqeve nga zjarret, ndikimi në vegjetacion, zhurmat, dëmtimi i zonave historike, etj, janë kërcënime që duhet të merren në konsideratë në menaxhimin e burimeve natyrore të zonës.

4.5.6. Karierat e gurit

Në territorin e Bashkisë së Këlcyrës janë të licensuara tre kariera guri. Karierat e gurit kanë ndikim negativ së pari në peizazh pasi hapja e tyre dhe nxjerrja e gurëve/ rrasave nga thellësia nënkupton së pari shpyllëzim apo zhveshjen e terrenit (Figura 23). Ky shpyllëzim shpie në rritjen e mundësisë dhe shkallës së erozionit. Aktiviteti i shfrytëzimit në guror mund të çojë në ndryshimin e cilësisë së ujit të pijshëm për shkak të penetrimit në thellësi të ujërave të shplarjes që përdoren në guror, si dhe ndotësve të tjerë. Jo më pak i rëndësishëm është ndikimi negativ i këtij aktiviteti në cilësinë e ajrit.



Figura 23. Karierë guri pranë rrugës Këlcyrë –Përmet



Figura 24. Gurë masivë të depozituar në pikën e grumbullimit

4.6. ANALIZA E PROBLEMATIKËS MJEDISORE

Bashkia e Këlcyrës nuk përfshihet në listën e bashkive me problematika të theksuara mjedisore dhe vendi që ajo zë në raportet vjetore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është pothuajse I papërfillshëm. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që problematika mjedisore nuk ekziston në zonë. Problemet kryesore mjedisore në zonë, të detajuara në vijim janë:

1. Ndërtimi i HEC-ve të Vegjël
2. Menaxhimi i mbetjeve;
3. Ndotja e ujërave;
4. Degradimi i tokës
5. Cilësia e ajrit;

4.6.1. Ndërtimi i Hidrocentraleve të vegjël mbi lumin Vjosa dhe tributaret e tij

Në Vjosë janë regjistruar 300 lloje gjallesash të ndryshme, përfshirë 41 lloje specimesh që janë gjetur për herë të parë në Shqipëri, duke e renditur lumin që buron në malet e Pindit në Greqi dhe derdhet në detin Adriatik, si një prej lumenjve me rëndësi Europiane për sa i përket biodiversitetit. Megjithatë, shumë prej këtyre gjallesave tashmë kërcënohen të zhduken nga ndërtimi i hidrocentraleve të planifikuara për tu ndërtuar mbi të apo tributaret e tij.

Në territorin e Bashkisë së Këlcyrës janë dhënë tashmë leje për ndërtimin e katër HEC-ve në tributarin e Shtikës. Në vitin 2016 HEC Shtika 1 me fuqi të instaluar prej 1.3 MW ka filluar prodhimin e energjisë, ndërsa të tjerët janë në ndërtim. Edhe pse për dy nga HEC e planifikuara të ndërtohen në Bashkinë e Këlcyrës, nuk janë dhënë akoma lejet, (Tabela 11) habitatet tokësore dhe ujore të bashkisë janë ndikuar dhe mund të ndikohen nga ndërtimi dhe funksionimi i HEC-ve të ndërtuara tashmë apo atyre në ndërtim.

Tabela 12. HEC-e të planifikuara për tu ndërtuar në lumin Vjosa dhe Tributaret e tij (Burimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit)

No.	Emri i Kompanisë	Baseni	Emri i HEC	Kordinatat	Tributari
1	"Qeramika e Jugut"	Vjosë	Shtika 1	40°21'55.99"N 20°14'8.78"E	Shtika
2	"Qeramika e Jugut"	Vjosë	Shtika 2	40°21'4.27"N 20°13'41.70"E	Shtika
3	"Qeramika e Jugut"	Vjosë	Shtika 3	40°20'30.70"N 20°13'42.93"E	Shtika
4	"Qeramika e Jugut"	Vjosë	Shtika 4	40°18'44.15"N 20°12'56.90"E	Shtika
5	Leja nuk është dhënë akoma	Vjosë	Këlcyra	40°18'25.88"N 20°11'8.07"E	Vjosë
6	Leja nuk është dhënë akoma	Vjosë	Dragoti	40°17'33.50"N 20° 04'49.10"E	Vjosë

Ndërtimi i një hidrocentrale mund të ngrejë nivelin e ujit me diga nga pak deri në qindra metra. Kjo krijon një përmytje të krejt zonës së rezervuarit dhe sjell ndryshime të thella të kushteve të habitatit. Si rrjedhojë shfaqet një ekuilibër i ri i ekosistemit, krejt ndryshe nga i mëparshmi. Ky ndryshim i

dinamikës ndikon tek speciet tradicionale që kanë patur foletë, janë rritur e ushqyer tradicionalisht në këto zona dhe mund të sjellë dhe specie invazive që dëmtojnë habitatin dhe speciet vendase.

Problem tjetër është edhe sedimentimi. Sedimentet janë materiale organike dhe inorganike që mbledhen në ujë për shkak se diga nuk i lejon të vazhdojnë me rrjedhën. Ky fenomen mund të prekë ekosistemin në dy mënyra. Së pari, kushtet jetësore të habitatit ndryshojnë duke ulur sasinë e ushqyesve të rëndësishëm organikë për speciet që jetojnë atje, gjë që sjell largimin e tyre ose deri në ngordhjen e tyre. Së dyti, këto sedimente brenda digës sjellin një efekt të quajtur "mbingarkimin me lëndë ushqyese", shtimin e gjallesave dhe shkakton varfërimin me oksigjen të ujit.

4.6.2. Menaxhimi i mbetjeve

Në Bashkinë e Këlcyrës gjenerohen çdo vit 3.300 ton mbetje. Nga këto, rreth 2.560 janë mbetje të ngurta shtëpiake kurse 730 ton janë mbetje inerte. Ashtu, si në çdo pjesë tjetër të territorit të vendit, edhe në Bashkinë e Këlcyrës mbetjet përfaqësojnë një ndër problemet më kryesore mjedisore.

Arsyet e kësaj problematike janë:

- ✦ Grumbullimi i padiferencuar mbetjeve – që nënkupton të gjitha mbetjet grumbullohen, hidhen, transportohen dhe depozitohen në të njëjtin vend pa u trajtuar e seleksionuar paraprakisht;
- ✦ Mungesa e një landfill-i të posaçëm për mbetjet e bashkisë;
- ✦ Mungesa e trajtimit apo ndarjes së mbetjeve organike (kompostimi dhe ri-përdorimi i tyre);
- ✦ Mungesa e një landfill-i për mbetjet e rrezikshme (bateri, vajra, mbetje spitalore e industriale etj);
- ✦ Numri i pamjaftueshëm i kontenierëve, duke bërë që mbetjet të hidhen në tokë apo të bëhen burim sëmundjesh dhe ndotje të ajrit të zonës;
- ✦ Mungesë e automjeteve të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve;
- ✦ Mungesa e industrisë ricikluese në zonë;
- ✦ Mungesa e ndërgjegjësimit të komunitetit të zonës lidhur me problematikën e mbetjeve dhe rreziqet që ato shkaktojnë në mjedis dhe shëndetin e banorëve.
- ✦ Vend-depozitime ilegale mbetjesh, për shkak të mungesës së kontenierëve, largësisë së kontenierëve nga familjet/bizneset apo dhe nivelit të ulët të ndërgjegjësimit publik.

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbetjeve konsiston në mbledhjen e mbetjeve të depozituara nga qytetarët, bizneset brenda kontenierëve si dhe rreth tyre, dezinfektimi i kontenierëve dhe vendit përreth me gëlqere dhe klor, transportimi i mbetjeve urbane me makinën teknologjike deri në pikën përfundimtare të depozitimit. Ky shërbim që ofrohet gjatë gjithë vitit përfshin pjesën më të madhe të zonës urbane, kryesisht në akset kryesore të rrugëve ku janë të pozicionuar pjesa më e madhe e kontenierëve.

Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve realizohet përmes kontenierëve të vendosur në territorin e qytetit si dhe të mjetit përkatës që bën shkarkimin e kontenierëve dhe transportin e mbetjeve në venddepozitimin e tyre. Sasia ditore e mbetjeve për banorë në Bashkinë Këlcyrë si pjesë e qarkut të Gjirokastrës vlerësohet të jetë 0.7 kg për njësinë administrative Këlcyrë dhe 0.4 kg për njësitë e tjera

administrative. Përbërja e mbetjeve vlerësohet në rreth 45% organike, ndërsa pjesa tjetër janë mbetje të rrymave të ndryshme (letër, plastikë, qelqurina, metale, tekstile etj).

Përsa i përket mbetjeve spitalore të gjeneruara nga farmacitë, klinikat mjekësore, klinikat dentare (subjekte private), nuk ka të nënshkruar asnjë kontratë shërbimi midis tyre dhe Bashkisë. Pjesa më e madhe e qendrave shëndetësore të rrethit Këlcyrës, deklarojnë se mbetjet e gjeneruara i groposin, ndërkohë, subjektet e tjera i hedhin ato në koshat publik.

Vend-depozitimi aktual i mbetjeve ("Arat e lira" në lindje të qytetit) është i vogël dhe jashtë standarteve dhe përbën një burim kryesor ndotje dhe përhapje sëmundjesh në zonë. Problematika e mbetjeve përveçse në qytetin e Këlcyrës është prezente në të gjitha njësitë administrative të bashkisë.

Venddepozitimi i mbetjeve është i parrethuar dhe nuk ka porta hyrëse/dalëse dhe ka vetëm një mjet shtypës.

4.6.3. Ndotja e ujërave

Për shkak të kushteve të veçanta gjeologjike ku shtrihet bashkia Këlcyrë, ndotja e ujërave është gjithashtu një problem në zonë. Për shkak të shkallës së lartë të infiltrimit të ujërave, ndodh që bashkë me to të infiltrohen edhe burimet ndotëse të tyre, si për shembull;

- ✦ Infiltrimi i ujërave të zeza nga banesat dhe bizneset; Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza është tejet i amortizuar dhe ka mbi 30 vjet që nuk është nderhyrë në të. Pjesa më e madhe e pusetave është e bllokuar për shkak të nderhyrjeve nga ndertimet e reja dhe sjellin shpeshherë shqetësime për banorët nga ndotja që shkaktohet. Derdha e tyre bëhet në lumenjtë Dëshnice e Vjosë jashtë çdo parametri të kerkuar sipas legjislacionit në fuqi.
- ✦ Përdorimi i kimikateve në bujqësi (ushqyesit, herbicidet dhe pesticidet);
- ✦ Infiltrimi i ndotjeve nga shërbimet dhe veçanërisht nga serviset e mjeteve;
- ✦ Përdorimi i ndotësve të tjerë [solucioneve] në aktivitetet tregtare, industriale dhe familjare.

Problematika më e madhe e ndotjes së ujërave zhvendoset në Lumin e Vjosës dhe Dëshnicës, ku të gjithë këta ndotës depozitohen bashkë me ujërat që derdhen në të.

Sipas Raportit të Gjendjes në Mjedis 2017 [AKM], Baseni i Vjosës referuar vlerave mesatare të monitorimit klasifikohet si në gjendje të mirë – Klasa II. Pavarësisht kësaj, nga monitorimi i: temperaturës, pH, alkalinitet, përcjellshmëria elektrike, oksigjeni i tretur, nevoja kimike për oksigjen NKO, nitritet, nitratet, amoniaku, ortofosfatet, fosfori total, lënda pezull dhe saliniteti, shikohet që ka probleme

Ujërat e lumit Vjosa janë relativisht të ngopura me oksigjen, vlerat e përmbajtjes së fosforit rezultojnë në nivele të larta, me transparencë të ulët dhe përmbajtje të NKO me tendencë rritje, si pasojë e shkarkimeve të ndryshme në lumin e Vjosës.

Pesticidet e organoklorinuar (OCPs) dhe pesticidet e poliklorinuar (PCB) janë një grup përbërësish me stabilitet të madh kimik dhe prania e vazhdueshme e tyre në mjedis është një tregues i qartë i ndotjes antropogjene. Përdorimi masiv i pesticideve për qëllime bujqësore ka shpënë në përhapjen e tyre në të gjitha mjediset duke përfshirë një gamë të gjerë të organizmave deri tek njerëzit.

106

HCH-të u gjetën në nivel të ulët pothuajse për të gjitha mostrat. Përjashtim bënte vetëm mostra V12 me përqendrim maksimal (45.4 ng / L). Kjo mund të jetë për shkak të një burimi të pikësor në këtë pjesë të lumit. Lindani u gjet në nivelin më të ulët në 25% të mostrave të ujit. Profilet e HCHs ishin: Alfa-HCH > deltaHCH > Lindane > epsilon-HCH > beta-HCH. Totali i HCHs ishin më të ulëta se niveli i lejuar (20 ng / L) për ujërat sipërfaqësore në përputhje me Direktivën 2008/105 / EC.

Niveli i PCBs në ujërat e lumit Vjosa është më i ulët sesa nivelet e raportuara për ekosisteme të tjera ujore në Shqipëri (Como et al, 2010, Neziri et al, 2013) por profili i PCB-ve ishte i ndryshëm. Në studime të tjera nivelet më të larta ishin për PCB e paqëndrueshëm. Ky profil mund të jetë për shkak të burimeve të pikësore në rrjedhat e ujit. Shkarkimi i mbeturinave nga industritë dhe bizneset mund të ndikojë në nivelet e tyre

Përqendrimet individuale të ndotësve të studiuar ishin më të ulëta se nivelet e lejuara për ujërat sipërfaqësore në bazë të Direktivës 2008/105 /EC.

4.6.4. Degradimi i tokës

Degradimi i tokës është gjithashtu një problem i rëndësishëm mjedisor në Bashkinë e Këlcyrës. Aspektet e degradimit të tokës janë,

- Erozioni;
- Ulja e cilësisë së tokave;
- Ndotja e tokave;

Nga këto elemente, erozioni i tokës vlerësohet si mjaft problematik në luginën e Vjosës por edhe të lumenjëve/përrenjëve që e ushqejnë atë.

Humbja e tokës e matur në terren rezulton që për kullotat të jetë 0.37 ton/ha/vit. Kjo lidhet me efektin pozitiv të barerave të kullotës mbi infiltrimin e ujit në tokë, duke reduktuar rrjedhën sipërfaqësore dhe prodhimin e sedimenteve.

Nga përlllogaritjet rezulton se humbja ekonomike nga erozioni i tokës në basenin e Vjosës për afro 60% të sipërfaqes rezulton në 1.29 mln US\$ në vit.

Në faktorët natyrorë që ndikojnë në sasinë e erozionit, rëndësi parësore kanë faktorët hidrometeorologjikë (rreshjet dhe intensiteti i tyre), ndërtimi gjeologjik i rajonit (shkalla e përshkueshmërisë së formacioneve), pjerrësitë e relievit në brigjet e shtrretërve (koeficienti i rrjedhës), pjerrësitë e vetë shtratit (gradienti i shtratit dhe i rrjedhës), shkalla e zhveshmërisë së pellgut ujëmbledhës (mbulesa bimore), etj.

4.6.5. Cilësia e ajrit

Ndotja e ajrit vjen nga; grimca pluhuri, kimikate apo materiale biologjike, të cilat kanë efekte mbi organizmin e njeriut, mjedisin apo atmosferën. Treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit janë të një niveli dhe përqëndrimi i gazeve të tillë si;

- ✦ SO₂, NO_x dhe NH₃ (amonjaku), të cilët shkaktojnë ndër të tjera edhe shirat acide;
- ✦ CO₂, CH₄ [metani], NO₂, lidhen me emetimin e gazeve në atmosferë të shkaktojnë nga aktivitetet njerëzore (djegia e biomasës, dekompozimi i bimësisë në liqen apo mbarështimi i blegtorisë);
- ✦ PM₁₀, tregon përqëndrimin e grimcave të ngurta në ajër.

Në të gjitha raportet e Gjendjes në Mjedis, Bashkia Këlcyrë nuk vlerësohet për ndotje të ajrit mbi normat e lejuara.

Harta më poshtë (Figura 25) paraqet problematikën mjedisore në Bashkinë e Këlcyrës.

4.7. METABOLIZMI I TERRITORIT NË BASHKINË E KËLCYRËS

"Metabolizmi i territorit" është model që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe të energjisë brenda territoreve të caktuara. Ky model ofron një kuadër, nëpërmjet të cilit mund të studiohen ndërveprimet e sistemeve natyrore dhe njerëzore në rajone të caktuara. Metabolizmi urban është një vatrë hulumtimi shumëdisiplinare, e prirur për të ofruar njohuri të rëndësishme rreth sjelljes së territorit me qëllim përfitim të propozimeve për një të ardhme më njerëzore dhe ekologjikisht të përgjegjshme.

Përfaqja e metabolizmit rikoncepton mënyrën se si përballemi me sfidat hapësinore në epokën tonë urbane duke analizuar marrëdhëniet midis shoqërisë dhe natyrës dhe midis qytetit dhe peizazhit. Sot jetohet në peizazhe të mëdha urbane, në sisteme komplekse dhe aktive që janë bërë mjedisi ynë natyror. Këto sisteme punojnë në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar nevojat e përdoruesve të tyre, të cilat mund t'i përshkruajmë në aspektet organike. Ashtu si trupi i njeriut merr frymë, pi, ha, përdor shqisat e tij dhe sekretion mbetjet, po të njëjtat flukse materiale jetike mund të identifikohen në peizazhin urban; flukse të tilla si: energjia, uji, ushqimi, mbetjet, biomasa, mallrat, paratë, informacioni, sedimentet dhe njerëzit. Nëse analizohen këto flukse dhe studiohen me koherencë, ka mundësi të zhvillohen ndërhyrje hapësinore që në mënyrë proaktive dhe produktive shfrytëzojnë metabolizmin, duke krijuar kështu modele më të qëndrueshme të zhvillimit hapësinor që krijojnë një territor.

Përfaqja e metabolizmit ofron një kuadër që lejon të bëhet kalimi i nevojshëm nga planifikimi linear dhe shkak-pasojë (analiza që çon në strategji, pastaj në planifikim dhe më pas në veprim) në një përfaqje më të pastër planifikimi, një punë në vazhdimësi që lejon shumë më tepër kompleksitet. Kjo metodë ndihmon të zbulohen mbivendosjet që krijojnë pika strategjike ndërhyrjeje dhe të ndërliken sfidat me mundësitë e zhvillimit. Si kuadër për zhvillimin, kjo metodë gjeneron lindjen e një marrëdhënieje shumë- planëshe dhe shumë të nevojshme ndërmjet përjetimit, rikuadrimin dhe vizionimit

Hartat në vijim janë një përmbledhje e analizës të detajuar të territorit të Bashkisë Këlcyrë, si dhe reflektim i gjetjeve të analizës metabolike të territorit të Shqipërisë.

Duke qenë se territori i bashkisë ka një dendësi shumë të ulët banimi rreth 18 banorë/km² dhe një territor mbi 66% natyror, edhe lëvizjet metabolike janë të kufizuara.

Territori i Këlcyrës mban potenciale të shumta natyrore ashtu dhe në prodhimtari e në vlera njerëzore, kulturore dhe tradita, por shfrytëzimi i këtyre potencialeve dhe flukset janë të "cunguara" nga mungesat e infrastrukturës dhe investimeve.

Janë analizuar flukset e Ujit, Ushqimit, Energjisë dhe Turizmit (lëvizshmëri dhe ekonomi).

4.7.1. Flukset e Ujit

Në territorin e Bashkisë Këlcyrë shtrihen vijat ujore të lumit të Vjosës, Dishnicës dhe të Zagorisë, duke bërë që zona të ketë potencial ujqor mesatar për furnizimin me ujë. Përgjatë Grykës së Këlcyrës gjenden 4 burime ujore. Problematikë për territorin e bashkisë është venddepozitimi ekzistues në afërsi të fshatit Mbrezhdan. Në të njëjtën mënyrë ndojta e lumit Vjosa, përgjatë Grykës së Këlcyrës dhe përgjatë shtrirjes së tij në territorin e bashkisë, shkaktohet nga mbetjet urbane, si dhe nga mungesa e kanalizimeve apo përdorimi i pa kontrolluar i kimikateve në bujqësi.

Duhet të përmendet që vetëm qyteti i Këlcyrës mbulohet me sistemin e kanalizimeve.

4.7.2. Flukset e Ushqimit

Në Bashkinë Këlcyrë blegtoria dhe bujqësia janë sektorët kryesorë për lëvizjet e ushqimit në territorin e bashkisë. Blegtori, është aktiviteti kryesor në Bashkinë Këlcyrë, ku në pjesën perëndimore ndodhet mali i Trebeshinës i cili ka edhe kullotat më të mira për prodhimin e bulmetit Zhvillimi i blegtorisë dhe përpunimi i saj shihet i shtrirë pothuajse në të gjithë territorin e njësive administrative Sukë, Dishnicë dhe Ballaban (Figura 26). Në territorin e bashkisë gjenden 3 baxho, 1 në dalje të qytetit të Këlcyrës rrugës drejt Kanionit të Këlcyrës, 1 në Podgoran është një baxho në shpellë, 1 në njësine administrative Dishnicë pranë fshatit Kuqali.

Aktiviteti bujqësor është i përqëndruar kryesisht përgjatë rrjedhës së lumit Vjosë dhe degës së tij Dishnicës, ku gjenden toka me kultivim kompleks (Ballaban, Kajca, Pavari, Psar, Corrogunji, Zhepova, Katudishta dhe Mbrezhdan). Në sipërfaqe jo shumë të mëdha gjenden edhe pemtore, siç shihen në zonën e Zhepovës dhe në pjesën jug-lindore të qytetit të Këlcyrës. Ndërkaq tokat arë janë të shpërndara dhe në sipërfaqe të vogla, kryesisht në pjesën qendrore të territorit të bashkisë dhe në zonën e fshatit Shalës.

4.7.3. Flukset e Energjisë

Baseni i Vjosës, një nga lumejtë e fundit të virgjër Evropianë ka filluar të përdoret si burim energjie të rinovueshme me anë të HEC-eve. Energjia në territorin e Bashkisë Këlcyrë favorizohet nga rrjeti i pasur hidrografik, edhe pse numri i HEC-eve është 3. Janë HEC-e privatë dhe ndodhen në afërsi të fshatit Panarit (Figura 27). Pjesa jug-lindore e bashkisë është një zonë me potencial energjitik, pasi bën pjesë në zonën më rrezatim mesatar diellor.

Në të ardhmen duhet të konsideron të gjitha mundësitë së të mos cënohen më shumë potencialet natyrore të ekosistemit hidrologjik të Vjosës.

Në lidhje me energjinë duhet të përmendim dhe linjat e tensionit të lartë që kalojnë në territor pjesë e rrjetit kombëtar 110-220 kv, si dhe në afërsi të fshatit Mbrezhdani gjendet 1 nënstation elektrik.

4.7.4. Flukset e Turizmit


Ekonomia e turizmit është potenciali më i madh i zhvillimit, pas ekonomisë së blegtorisë dhe bujqësisë, prandaj janë analizuar flukset jo vetëm të lëvizjes, por edhe të vendndodhjes së lokaliteteve me potenciale turistike dhe zonat që duhen ruajtur si potencial i lartë natyror (Figura 28).

Zona përbehet nga një territor tepër i larmishëm, i cili zbërthehet në elemente të ndryshme natyrore, shumë prej të cilave janë monumente natyre. Aksi automobilistik nga Çarçova deri në Këlcyrë shoqërohet nga peizazhi që të ofron vargmali Nemërçkë-Dhembel-Trebeshinë si dhe nga lugina e Vjosës. Po ashtu drejt luginës nga Podgorani, ofrohen pamje peizazhistike të bashkimit të lumit të Dishnicës me atë të Vjosës nga rruga pranë fshatit Mbrezhdan. Akse peizazhistike, shtrihen edhe përgjatë fshatrave Mërtinj – Bënjë – Fratar, Grykës së Këlcyrës, lugina e Zagorisë, lumit Vjosë dhe Grykës së Këlcyrës ku gjendet edhe ujëvara. Një pikë tjetër me mundësi zhvillimi turistike është edhe



ujëvarë pranë fshatit Tolar. Po ashtu në afërsi të saj gjenden edhe disa fshatra të tjerë, për karakteristikat e tyre dhe peizazhet unike që ofrojnë ku përmenden fshatrat Leskovec, Bënjë, Fratar, Maleshovë, etj. Zhvillimi i fshatrave, tashmë ka nisur, duke patur parasysh, fermat (guesthouse), të ndërtuara në afërsi të fshatit Komarak. Rruga lidhëse e Bashkisë Këlcyrë me Bashkinë Berat kalon nga fshati Komarak, Beqaraj, Bubës, por është në gjëndje shumë të keqe. Një rrugë e tillë lidhëse do të shfaqte një mundësi shumë të lartë për zhvillimin e turizmit nëpërmjet dhe përgjatë këtij aksi. Monumentet e natyrës dhe kulturës, ndër vite kanë shërbyer si ftues për turistët. Në territorin e Bashkisë Këlcyrë prania e kalasë apo e Sarajeve, ura e kalasë në luginën e Zagorisë pranë fshatit Limar, kisha e vjetër në fshatin Mbrezhdan, Teqe e vjetër në fshatin Xhanaj, Teqe në fshatin Mazhar (mekami i "Dervish Aliut"), teqe në fshatin Bubës (mekami i "Memajdinit") teqe në fshatin Sukë, shërbejnë për promovimin e zonës dhe shtimin e numrit të vizitorëve, të cilat shërbejnë për mirëqenien e banorëve të bashkisë.








Figura 28. Flukset e Ushqimit, Bashkia Këlcyrë



Figura 29. Flukset e Energjisë, Bashkia Këlcyrë




Figura 30. Flukset e Turizmit, Bashkia Këlcyrë

4.8. NDARJA E TERRITORIT NË SISTEME

Njësitë e qeverisjes vendore, për qëllime planifikimi, ndahen në sisteme territoriale të cilat listohen si më poshtë:

- ☐ Sistemi Urban
- ☐ Sistemi Natyror
- ☐ Sistemi Bujqësor
- ☐ Sistemi Urban
- ☐ Sistemi Infrastrukturor

Sistemi natyror: është sistemi mbizotërues në të gjithë territorin e bashkisë, duke qenë i pranishëm në të gjithë territorin, kryesisht në zonat malore, duke zënë një sipërfaqe totale prej 22103.69 Ha, përbën rreth 2/3 të territorit të Bashkisë Këlcyrë. Në këtë sistem përfshihen peizazhe, fushat, pyjet me drurë gjethegjerrë, halorë, etj. (Tabela 12).

Sistemi bujqësor: gjendet i shpërndarë në territor, por kryesisht në zonën fushore të njësive administrative përgjatë luginës së lumit Dishnicë. Duke qenë se bujqësi, është ndër sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik në bashki, zë rreth 8740.91 Ha.

Sistemi urban: Zë një sipërfaqe totale prej 432.39 Ha. Ndryshimet më të mëdha të këtij sistemi kanë ndodhur në qytetin e Këlcyrës dhe në afërsi të fshatrave të tij. Gjithashtu, ndërtime të reja kanë ndodhur në edhe në qendrat e fshatrave të njësive administrative Sukë, Ballaban e Katundishtë.

Sistemi ujqor: në përbërjen e territorit të bashkisë përfshihen, lumenj, përrrenj dhe rezervuarë. Prania e lumit të Vjosës, lumit të Dishnicës, si dhe përrrenjve të ndryshëm janë disa nga elementët e sistemit ujqor që formojnë 178.1 ha sipërfaqe ujore në territor.

Sistemi infrastrukturor: Ndër elementët kryesor të sistemit infrastrukturor renditet transporti rrugor, rrjeti i furnizimit me ujë dhe kanalizime, rrjetin e kanaleve të kullimit dhe vaditjes, rrjetin elektrik, atë të telekomunikacionit, sikurse dhe strukturat ndihmëse dhe të shërbimit në funksion të këtyre sistemeve, duke zënë rreth 116.1 ha në territor. Pjesë e infrastrukturës rrugore është aksi më i rëndësishëm që kalon në territorin e Bashkisë Këlcyrë për ta lidhur me Përmetin. Furnizimi me ujë funksionon në disa mënyra në zona të ndryshme, me rrjet furnizimi, me puse shpimi ose me depo uji, kjo ndodh në varësi të pozicionimit në territor. Rrjeti i kanaleve të kullimit dhe vaditjes është i pranishëm në të gjithë territorin e bashkisë, në shumicën e rasteve është në funksionim, por ka nevojë për punime mirëmbajtje, pastrime e thellime sikurse gjenden edhe raste të bllokimit apo prishjes së këtij rrjeti.

Figura 31. Sistemet teritoriale, Bashkia Këlcyrë



Tabela 13. Sipërfaqet e sistemeve dhe përdorimit të tokës

	TË DHËNAT EKZISTUESE TË SISTEMEVE TERRITORIALE	TË DHËNAT E PROPOZUARA TË SISTEMEVE TERRITORIALE	%
SISTEMI URBAN (UB)	432.39 ha	328.65 ha	- 0.33 %
BANIM	323.63	216.46	
SHËRBIME	2.25	8.48	
INDUSTRI EKONOMI	90.75	81.13	
INSTITUCIONE	2.28	2.73	
ARSIM	2.85	2.53	
SHËNDËTËSI	0.24	0.18	
AKTIVITETË SHOQËRORE & ARGËTIMI	1.54	8.29	
MONUMENTE	2.17	2.17	
VARREZË	6.68	6.68	+0.28%
SISTEMI INFRASTRUKTUROR (IN)	116.1 ha	204.22 ha	
INFRASTRUKTURË TRANSPORTI	115.66	191.3	
INFRASTRUKTURË ENERGIJTIKE	0.34	0.44	
INFRASTRUKTURË TELEKOMUNIKACIONI	0.1	0.1	
INFRASTRUKTURË UJËSJELLËS KANALIZIME	-	0.61	
INFRASTRUKTURË MENAXHIMI MBETJESH	-	11.77	3.03 %
SISTEMI BUJQËSOR (B)	8740.91 ha	7787.44 ha	
TOKË BUJQËSORE	8151.82	7278.9	
INFRASTRUKTURË BUJQËSORE	16.62	75.84	
EKONOMI BUJQËSORE	2.43	176.96	
BUJQËSI-BANIM	570.04	255.74	+3.1%
SISTEMI NATYROR (N)	22103.69 ha	23088.9 ha	
TOKË NATYRORE	22067.36	23008.73	
NATYRË DHE ARGËTIM	36.33	80.17	-
SISTEMI UJOR (U)	178.1 ha	178.1 ha	
UJËRA	178.1	178.1	

4.9. ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është një mjet i planifikimit strategjik që përdoret për të analizuar faktorët e brendshëm dhe jashtëm që ndikojnë në një projekt.

Analiza SWOT është një analizë cilësore dhe përbëhet nga katër koncepte: pikat e forta (përparësitë), dobësitë, mundësitë dhe rreziqet. Përparësitë dhe dobësitë kanë të bëjnë me mjedisin apo faktorët e brendshëm ndërsa mundësitë dhe rreziqet kanë të bëjnë me mjedisin apo faktorët e jashtëm që mund të ndikojnë në projekt. Përparësitë dhe dobësitë paraqesin situatën e aktuale duke u bazuar në të kaluarën, ndërsa mundësitë dhe rreziqet paraqesin situatën e ardhshme duke u bazuar në të kaluarën dhe të tashmen.

Në hartimin e Planeve të Pergjithshme Vendore, analiza SWOT është një mënyrë për vlerësimin e aftësive konkurruese të bashkisë, si dhe një instrument që ndihmon autoritetet lokale të përqendrojnë kapacitetet e tyre në përfitim të maksimal nga pikat e forta territoriale si dhe në zgjidhjet më efektive të problematikave për të synuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe për të siguruar një territor fleksibël në kohë.

"Pikat e forta" janë asete dhe potenciale të trashëguara të territorit bashkiak si peizazhet, lidhjet rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, kushtet e mira klimaterike, potencialet turistike, sisteme të mira bankare, potenciale investimi, menaxhim i mirë bashkiak dhe shërbime sociale e infrastrukturore.

"Dobësitë" janë faktorët që pengojnë zhvillimin e qytetit, siç janë infrastruktura e pamjaftueshme, menaxhimi i dobët bashkiak, procedura administrative të komplikuar, dhe menaxhimi i keq i trafikut.

"Mundësitë" mund të jenë ato projekte kombëtare ose ndërkombëtare që krijojnë vende pune dhe mundësi biznesi.

"Rreziqet" mund të eiejdhin nga problematika mjedisore ose e kapaciteteve njerëzore.

Qëllimet e kësaj analize janë:

- ☐ Të nxjerrë në pah dhe të vlerësojë avantazhet konkurruese dhe potencialet e Bashkisë Këlcyrë;
- ☐ Të analizojë perspektivën e zhvillimit të ardhshëm në lidhje me kërkesën dhe ofertën;
- ☐ Të identifikojnë masat e nevojshme për të minimizuar efektet e kërcënimeve.

SWOT është i artikuluar në katër shtylla kryesore për zhvillimin e vizionit. Këto shtylla janë bazuar në sistemet urbane dhe në dinamikën njerëzore dhe ekonomike të bashkisë. Shtyllat janë: Sistemi Natyror dhe Ujor, Sistemi Bujqësor, Sistemi Urban, Sistemi Infrastrukturor.

Sistemet urbane janë detajuar në disa aktivitete ekonomike dhe nevoja të administratës publike, që janë kyçe në planifikimin e ardhshëm. Kjo ndarje është bërë sepse koncepti i planifikimit, nuk duhet të kufizohet vetëm me përcaktimin e hapësirës fizike, por bazohet më shumë në vlerësime ekonomike që trajtojnë çështje që lidhen me cilësinë e jetesës, ambientin dhe klimën për investime, menaxhimin e zonës urbane dhe rurale të bashkisë, sfidat e reja me të cilat përballlet qeverisja vendore, si dhe kontekstin socio-ekonomik (Tabela 14).

Tabela 14. Analiza SWOT për Bashkinë Këlcyrë

BASHKIA KËLCYRË				
SISTEMI BUIQËSOR				
TOKA DHE PRODHIMET BUIQËSORE DHE BLEGTORALE				
PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBETA	MUNDESITE	KERCENIMET	
Prodhimet e bimëve bujqësore dhe blegtorale kanë rendimente dhe cilësi të kënaqshme, si imitave dhe nën produktet e tij, tregtimi i tyre për vetëkonsum, ashtu edhe treg të mirë shiteje dhe me përfitim optimal.	Mungesa e një bujqësie intensive në pjesën më të madhe të territorit	Avantazhet klimatike dhe gjeologjike ofrojnë mundësinë e specializimit në produkte me prodhueshmëri më të lartë dhe diversifikim të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.	Amortizimi i plotë dhe mostfunksionimi i rrjetit të kanaleve ujëtare.	
Tradita në prodhimin e rrushit, frutave dhe nënproduktet e tyre, si dhe qumështit të imitave dhe nën produktet e tij, tregtimi i tyre dhe kërkesa e lartë në nivel kombëtar.	Mungesa e një sistemi të nevojshëm ujëtar dhe kullimit, i tokave bujqësore në të gjithë territorin e bashkisë.	Kërkesa e lartë në rritje e tregut të brendshëm dhe të huaj për prodhimet specifike të Rajonit të Këlcyrës, si rrush, fruta, verë, fruta të përpunuara, nënprodukte të qumështit.	Dështimi apo ulja e cilësive se produkteve të freskëta, si rezultat i mungesës së pikave të grumbullimit, ruajtjes dhe vonësës së tregimit, jashtë territorit të Bashkisë.	
Një numër i konsiderueshëm i bagëtive të imta që e bën bashkinë një prodhues konkurrues të nën produkteve të qumështit dhe mishit.	Mungesa e mekanizimit dhe e teknologjive të përpunuara të kullimit të kulturave bujqësore.	Kapacitetet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme e me dije optimale.	Mungesa e përmirësimeve të rrjetit të kanaleve ujëtare rrezikon cilësinë e produktit bujqësor.	
Kushtet e përshatshme klimatiko tokësore për zhvillimin e sektorit të vreshtarisë, pemëve frutore, blegtorisë së imët, bimëve mjekësore, duke kombinuar traditën, krijonë kushte optimale prodhimi e tregtimi.	Mungesë e njohurive për marketimin, seleksionimin, paketimin dhe ruajtjen e produkteve të freskëta, të përpunuara, të prodhimit bujqësor dhe të prodhimeve blegtorale.	Tradite dhe specializim i prodhimit të produkteve bujqësore e blegtorale dhe përpunimit të nënprodukteve të tyre.	Mungesa e mirëmbajtjes së sistemit të kullimit ulin cilësinë e tokave dhe prodhimin.	
Brëndi i produkteve cilësore nga treva e Këlcyrës si vera, djathi i bardhë, djathi kaçkavall aromatik nga kullotat e malit të Trebeshinës.	Mungesë e pajisjeve dhe pikave të grumbullimit, ruajtjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale.	Prodhueshmëria e lartë, krijon një ekosistem të favorshëm për zhvillimin e industrisë së lehtë të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale që ofron dhe një stabilitet ekonomik afatgjatë për prodhuesit.	Mungesa e arsimit të mesëm profesional në fominin bujqësor dhe blegtoral të popullsisë aktive, ul nivelin e dijes, kufizon shpërndarjen e teknologjive dhe teknikave të reja dhe nuk garanton ruajtjen e traditës së zonës.	



ATKINDER STUDIO ARHITEKTURË



Zonë e favorshme për mbarështimin e bletëve dhe kullota malore të populluara me bimë mjekësore e etero-vajore cilësore.	Organizimi akoma i dobët i komunitetit të prodhuesve e grumbulluesve të prodhimeve bujqësore e blegtorale.	Specializimi në fusha të caktuara të prodhimit, integrimi teknologjik bashkëkohor, aplikimi i normave të cilësise, ofrojnë një mundësi zhvillimi ekonomik më të qëndrueshëm.	Agrobiznesi është një sektor jo vetëm me ndjeshmëri të lartë përballë rreziqeve klimatike dhe natyrore, por dhe konkurrencës rajonale dhe ndërkombëtare
Prodhimet dhe nënproduktet e bimëve perimore kanë një treg të mirë shitje dhe me përfitim optimal, krahasuar me kulturat e tjera bujqësore.	Largësia nga tregjet rajonale dhe kombëtare, si rezultat i vendndodhjes së territorit të Bashkisë Këlcyrë.	Organizimi i strukturuar i prodhimit dhe bashkëpunimi ndërmjet prodhuesve, ofron një mundësi për financim dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.	Integrimi i agroteknikave moderne dhe i teknologjisë bashkëkohore, ka për efekt të rritë rendimentin dhe të reduktojë kërkesën për forcë punëtore, që duhet të orientohet në sektorë të tjerë të ekonomisë.
Popullsia e zonës: fermerët e organizuar dhe individë; ka njohuri dhe eksperiencë në prodhimin e kulturave bujqësore dhe kyesisht perimore.	Mbështetja e ulët dhe përfutimi i pakët nga strukturat shtetërore dhe projektet e bashkëpunimit me donatorët e huaj.	Zhvillimi i agro-turizmit është një mundësi e re për promovimin e produkteve vendase, diversifikimit të aktivitetit ekonomik, monitorimin e kërkesave të tregut dhe zhvillimit ekonomik.	
Tradita e fermerëve dhe struktura e prodhimit të fermave bujqësore të rajonit, është rentabel dhe me përparësi për kultivimin e bimëve intensive dhe mbarështimin e gjedhëve.	Në sektorin e blegtorisë ndihet mungesa e bashkëve moderne dhe thertoreve me standarte.		
Organizimi i grupeve të interesit të prodhuesve dhe tregtuesve brenda territorit të Bashkisë Këlcyrë.	Mungesa e trajtimit dhe përpunimit të mbejeve organike për t'u kthyer në kompost.		
	Mungon një ndërlidhje e pershtatshme ndërmjet prodhuesve		
	Mungesa e një zinxhiri të plotë prodhim, magazinim, përpunim tregim rezikon prodhimin.		





SISTEMI URBAN			
ZHVILLIMI URBAN, DEMOGRAFIJA ÇESHTJES SOCIALE DHE KULTURA			
PIKAT E DOBETA		MUNDËSITË	KËRCËNIMET
Pozicionimi i bashkisë në një territor me larmi relievësh e me vlera peizazhiste.	Ndërtime të pa bazuara në plane, që krahas informalitetit ligjor kanë prodhuar një estetikë të diskutueshme të zonave urbane.	Zhvillimi i turizmit natyror, ekologjik, rural dhe agro-turizmit redukton efektin ekonomik negativ të sezonalitetit, rrit qendrueshmërinë e turistëve.	Mungesa e investimeve në përmirësimin e infrastrukturës inxhinierike dhe sociale do të rrisë shkallën e migrimit të banorëve.
Aksesibiliteti me pikat kulturore dhe polet ekonomike të vendit.	Ndërtime të përqëndruara pranë aksëve kryesore duke vështirësuar ofrimin e shërbimeve.	Zhvillimi i Sektorit turistik ofron një punësim të lartë për popullsinë aktive me arsim të ulët dhe të mesëm.	Mungesa e studimeve të tregut dhe cilësisë së godinave do të sjellë një keq administrim të stokut të banesave.
Zona urbane kryesisht të përqëndruara, me intensitet të ulët ndërtimi, të përshtatura me relievin ekzistues.	Ndërtimi i rrjeteve inxhinierike nuk ka ecur me të njëjtin ritëm si zhvillimet private të banesave duke krijuar zona të tëra pa infrastrukturë dhe/ose infrastrukturë të amortizuara.	Zhvillimi i itinerareve kulturore, natyrore, sportive, që ndërthrin vlerat unike të zonave rrit ofertën turistike.	Mungesa e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të konsoliduara, rrezikon shfrytëzimin optimal të burimeve njerëzore, natyrore dhe vlerave unike të zonës.
Investime në infrastrukturën e zonave urbane dhe në trajtimin e hapësirave publike.	Lidhjet e fshatrave të amonizuara që pengojnë zhvillimin dhe sjellin izolimin e tyre, mungesë e lidhjeve mes prodhimit dhe tregut.	Fshatra me një unitet arkitektonik, të cilat mbartin një traditë dhe kulturë interesante, mundësojnë agro-turizmin, i cili promovon produktet vendase, kulturën dhe punësimin rural.	Mungesa e bashkërendimit të investimeve dhe strategjive ndërmjet bashkive fqinje rrezikon zhvillimin optimal të territorit.
Vendbanime që përfshijnë zona urbane e rurale.	Problematika të pazgjidhura në regjistrimin e pronave që janë frenues të zhvillimit.	Krijimi i qendrave komunitare në mbështetje të edukimit kulturës, zhvillimit social dhe mirëqenies.	Problematikat e pronësishë rrezikojnë implementimin e projekteve zhvilluese.



4 STUDIO ARKITEKTURAL

ARHITEKTURA
URBANE
PËR PLANIMET
DHE DOKUMENTET
E NEVOJSHME

Rruajtje e tokave bujqësore.	Niveli i ulët i arsimimit pengesë për zhvillim ekonomik.	Specializimi i zonave, që përfaqësojnë vlera unike të trashëgimisë kulturore, traditës si dhe vlera mjedisore, drejt turizmit	Mungesa e shpërndarjes së njëtrajtshme të institucioneve arsimore, shëndetësore dhe sociale, kontribuojnë në lëvizjen e e popullsisë.
Territori i pasur me gjurmë të vendbanimeve të lashta dhe me objekte monument	Mungesë e aktivitetëve social-kulturore, veçanërisht në zonën rurale.	Strukturat të braktisura (psh. ish magazina) të vendosura në kryesore janë mundësi për zona multifunkionale në funksion të profilizimit të ri të vendbanimeve.	Ekonomia e orientuar vetëm në sektorin e bujqësisë dhe cilat janë sektorë të ndjeshëm ndaj klimës dhe rrezikut natyror.
Ekzistenca e qendrave kulturore në Këlcyre	Mungon promovimi i pasurive natyrore dhe kulturore.	Zhvillimi i transportit publik do të sjellë një stabilitet në migrimin nga zonat rurale.	Qëndrueshmëria e imazhit të turizmit ende të pa maturuar, rrezikon sektorin e turizmit në një vizion afatgjatë.
Shyalla kryesore e zhvillimit ekonomik të zonës bazohet te bujqësia dhe blegtoaria, të favorizuara nga kushtet e përshatshme klimatike dhe terreni, ende të pa shfrytëzuara totalisht.	Lëvizje e konsiderueshme e popullsisë residente që reflektohet nga Censusi 2001-2011.	Zhvillimi teknologjik dhe teknik bashkëkohor i bujqësisë rrit efikasitetin prodhues.	Mos koordinimi i operatorëve të ndryshëm turistikë rrezikon vizibilitetin e sektorit turistik.
Industri e orientuar drejt Agro-biznesit dhe artizanatit.	Niveli i lartë i njësive ekonomike familjare me më shumë se 6 antarë tregon nevojat për politika sociale mbështetëse dhe nevojat për ndërtim.	Zhvillimi i prodhimeve të reja dhe të traditës vëndase me përfitim të lartë. (elickulturës, hidroponisë, kultivimin e fazanit, ngjallës, karkalecit etj).	Integrimi i aktivitetëve të ndryshme ekonomike me impakt mjedisor të lartë.
Studime në nivel kombëtar kanë dhënë orientime për zhvillimin e zonës (PPK-së).	90% e subjekteve ekonomike janë biznese të vogla, të cilat hasin vështirësi në financim.	Struktura grumbullimi dhe prodhimi të ndërdhura me tregun vendas e të huaj.	Rreziku i emigrimit të forcës punëtore në moshë pune drejt baseneve me të favorshëm, rrezikon efektin terheqës të zonës.
Shërbimet përbëjnë burimin e dytë të rëndësishëm të të ardhurave lokale, ku rol ijaft premtues luan turizmi (parqë kombëtare, monumente historike) vendas dhe i huaj, edhe pse në hapat fillestare.	Kapaciteti i ulët jo cilësor i një gamë të kufizuar akomodimi dhe shërbimesh turistike dhe mungesa e një vlerësimi zyrtar të cilësë. Turizëm sezonal dhe afatshkurtër.	Zhvillimi i industrisë së lehtë të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale rrit punësimin dhe redukon lëvizjet e popullsisë.	Rreziku i eksodit rural drejt zonave të urbanizuara, për shkak të diferencës ekonomike sociale ndërmjet zonave rurale urbane.

Përmirësimi të vazhdueshme në sistemin arsimor dhe shëndetësor (qendra e re shëndetësore).

Mungesa e promovimit të vlerave unike të territorit ndërmjet marketingu tradicional dhe kanaleve të TIK.	Zhvillimi i arsimit profesional orientuar drejt bujqësisë dhe blegtorisë, industrisë së lehtë përpunuese sektorit të shërbimeve do të mundësojë kualifikimin e forcës punëtore, do të risë aktivitetin ekonomik ndërmjet modernizimit dhe cilësisë duke ndikuar pozitivisht në mirëqënien dhe tregun e punës.	Rritja e ardhshme e koeficientit të varësisë të të moshuarve, rrezikon zgjerimin e shërbimeve ndaj brezit të tretë.
Fragmentim i tokës, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet subjekteve bujqësore, nuk mundëson mrigë të shpejtë të prodhimitarise dhe rendimentit, si dhe parandalon ekonominë e shkallës.	Orientimi i ekonomisë drejt disa profileve (bujqësi, do të shërbejë si iniciator i krijimit të organizatave dhe klusterave.	Shkalla e lartë e informalitetit pengon konkurrencën e lirë dhe të ndershme, duke rrezikuar zhvillimin e subjekteve efikente.
Mungesa e strukturave të: furnizimit, grumbullimit, ruajtjes, përpunimit, kontrollit të cilësisë, të certifikimit të cilësisë dhe të tregjeve të specializuara.	Krijimi dhe promovimi i markës së produkteve lokale.	Qëndrueshmëria e diferencës të nivelit të papunësisë midis njësive administrative të bashkisë thellon pabarazhinë sociale në territor.
Largimi i individëve të mirëarsimuar drejt rajonit Tiranë-Durrës, apo jashtë Shqipërisë, ndikon në zhvillimin e ngadalë të bashkisë.	Vetë proçesi i hartimit të kësaj plani do të risë kapacitetet administruese dhe profesionale të shtatit të bashkisë, si dhe do të ndërgjegjësojë komunitetin për prioritetet zhvillimore në vitet e ardhshme.	Modernizimi teknik dhe teknologjik rrezikon të risi ndjeshëm papunësinë e popullsisë të punësuar në sektorin bujqësor.
	Diaspora, si burim remitancash dhe investimesh private.	Mosshfrytëzimi apo keqpërdorimi i burimeve natyrore, në veçanti i ujërave dhe pyjeve, do të pengonte seriozisht potencialin e zhvillimit ekonomik të zonës.



STUDIO ARHITEKTURALE

ADRESA
KOD POSTAL
TEL. 06 421 11 11
FAX 06 421 11 12
WWW.STUDIO.AK

SISTEMI NATYROR DHE UJOR			
BURIMET UJORE, SISTEMET E FURNIZIMIT ME UJE DHE KANALIZIMEVE			
PIKAT E FORTA		MUNDËSITË	
PIKAT E DOBËTA		KERCËNIMET	
MUNDËSITË			
Prania e ekosistemit të lumit Vjosa, me vlera të ralla, i konsideruar edhe si "lumi i vetëm i egër" në Europë.	Degradim progresiv i cilësive mjedisore të përgjithshme, për shkak të mungesës së sistemeve të trajtimit të mbetjeve urbane dhe impiantit të trajtimit të ujërave të zeza.	Mundësia e zhvillimit të turizmit natyror, kulturor dhe agroturizmit	Përfaqësues apo humbje e resurseve ujore prej ndojes së akuiferëve sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.
Larmishmëria dhe prezenca e habitateve të rëndësishme dhe atyre prioritare.	Mungesë e sistemeve të përshtatshme të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane.	Përmirësimi i përgjithshëm i ekuilibrit ekologjik dhe përmirësim të gjendjes së pyjeve dhe biodiversitetit si rezultat i politikave të përshtatshme mjedisore	Rrezik i lartë zjarresh për shkak të mungesës së kontrollit, menaxhimit të aktivitetëve pyjorë dhe blegtorale.
Prania e specieve të rralla dhe endemike (specie që gjenden vetëm në një territor të caktuar) në ekosistemin lumor të Vjosës dhe në Trebeshinë.	Përdorimi dhe mbishfrytëzimi i burimeve natyrore (fauna) me impakt afat-gjatë në mjedis.	Përmirësimi i përgjithshëm i cilësive së jetesës në qendrat urbane me realizimin e ndërrimeve për zbutjen e ndikimeve të prodhuara nga aktivitetet që ndodhin ujërat, tokës dhe ajrin.	Humbje progresive e biodiversitetit të kafshëve, zvogëlimi i numrit të specieve të mbrojtura, për shkak të mos zbatimit të rregullave apo kontrolleve të aktivitetit të gjuetisë
Ajri në përgjithësi është i pastër dhe ndotja, është poshtë limitit të lejuar nga normat Europiane.	Mungesa e mjeteve të kontrollit të mjedisit natyror dhe resurseve ekologjike nga ana e administratës së Bashkisë.	Lamia e resurseve natyrore, shumëllojshmëria e florës dhe faunës janë premisa për të orientuar drejt një turizmi ekologjik duke rritur shtrirjen kohore të sezonit turistik.	Ujia e cilësive së ajrit dhe mjedisit për shkak të shpëllimit progresiv të zonave malore, rritjes së fenomenit të erozionit dhe mbathjes së shtratit të lumit Vjosa dhe të lumenjve ushqyes të tij.





	Shfrytëzim pa kriter dhe i fragmentuar i pasurive natyrore.		Zhvillimet urbane nëse nuk kontrollohen: zgjerimi i zonave urbane, mungesa e trajtimit të mbetjeve urbane dhe ujërave të zeza që shpesh jo vetëm tokat bujqësore, por dhe pasuritë natyrore të rajonit.
	Përqendrim i rreshjeve në sezonin e dimrit krijon probleme në ujëgjatë e zonave kodinore gjatë sezonit të thatë.		Mos marrja në konsideratë e pasurive natyrore mund të sjellë degradim dhe shkatërrim gradual të tyre.
	Mungesë e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza.		Ndryshimet klimatike mund të jenë të ndryshme në veçanti në zonën bregdetare ku në afat shekullor kërcënohen me përmbytje dhe thatësira të gjata si dhe me dëmtime të ekosistemeve. Duhet të adaptohen masa për të reduktuar ndryshimet e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike.
Burime ujore të mjaftueshme në dispozicion për furnizimin me ujë dhe kanalizimet.	Rrjeti i shpërndarjes nuk mbulon të gjithë territorin duke marrë në konsideratë zonat rurale;	SISTEMET E FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE	
Rrjeti i shpërndarjes në qytetin e Këlcyrës i rikonstruktuar;	Niveli relativisht të lartë të humbjeve;	Rikonstruksioni i plotë i rrjetit të furnizimit me ujë, shirëza e tij në zona sot të pa shërbyera dhe automatizimi i procesit të prodhimit dhe monitorimit do të ulin koston e prodhimit, humbjet në rrjet dhe do të rrisin kohezionin e furnizimit me ujë 24/7 dhe cilësinë e shërbimit.	Mungesa e investimeve në infrastrukturimin, dixhitalizimin e NUK do të sjellë vonesa në ofrimin e shërbimeve cilësore.
			Mungesa e një monitorimi periodik si dhe gjetja e burimeve alternative mund të rrezikojë një shfrytëzim tejet normave të lejuara të burimeve aktuale.



ATLIES STUDIO ARCHITECTURE

Komunitete me popullësi të vogël, e të përqendruar janë premisë për realizim të shpejtë të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime.	Sisteme miks të KUZ-se dhe KUB-se;	Ndërtimi i një skeme të largimit të ujrave të zeza duke synuar grupimin e rrjeteve sipas fshatrave, ndërtimi i impianteve dhe gropave septeke me standarte do të përmirësojnë ndjeshëm ndikimin në mjedis.	Mungesa e një monitorimi periodik mund të rezultojë në ndoje të pushtpimeve dhe të vend-grumbullimeve të ujit të pijshëm.
Prania e infrastrukturës mbështetëse në reduktimin e impaktit të shkakësit të nënprodukteve të impianteve të Trajtimin të Ujrave të Zeza (kolektorët e kullimit.	Situata e rrjetit është gjërësisht e amortizuar (pus shpime, pompa, stacione pompimi, rrjet dërgimi dhe shpërndarje).	Vendosja e impianteve të Trajtimin të Ujrave të Zeza sa më pranë infrastrukturës apo konfigurimit të përshatshëm topografik, që mundëson evakuimin e shpejtë dhe të padëmshëm të nën produkteve, në shtretër natyrorë.	Vonesat në investime në Impiantin e Trajtimin të Ujrave të Zeza do të rëndojë situatën e ndojes mjedisore
Prania e një strategjie kombëtare të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.	Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve ka nivel shumë të ulët të dixhitalizimit të të dhënave dhe të administrimit të prodhimit.	Dixhitalizimi i informacionit, trajnimi i personelit të NUK do të lehtësojë proceset e monitorimit, operimit dhe mirëmbajtjes së rrjeteve dhe strukturave	
SISTEMI INFRASTRUKTUROR			
RRJETI RRUGOR DHE HEKURUDHOR			
PIKAT E DOBËTA		MUNDËSITË	KERCËNIMET
PIKAT E FORTA	PIKAT E DOBËTA		
Afërsia e zonës në studim me Korridorin Veri-Jug, i cili do të përfundohet në të ardhmen dhe akteve kombëtare Tepelenë-Përmet dhe Berat-Këlcyre.	Mungesa e infrastrukturës rrugore, si dhe gjendja e saj në shumë fshatra, vështirëson transportin e produkteve lokale, si dhe kërkon kosto të larta në investime gjë që kërkon kohën e duhur në planifikimin e burimeve financiare.	Përmirësimi i gjendjes ekzistuese të rrugëve nëpërmjet investimeve dhe mirëmbajtjes do të sjellë uljen e problematikave dhe njollave të zeza.	Mos kategorizimi i rrjetit rrugor do të ndikojë negativisht në rrirjen e trafikut dhe njollave të zeza
Ekziston një vullnet i Bashkisë për ngritjen e sistemit të transportit publik – projekti pilot në proces.	Mungesa e një skeme të plotë rrugore që do mundësojë një qarkullimin sa më efikas të mjeteve.	Klasifikimi i rrugëve sipas kodit rrugor të Shqipërisë si dhe profilizimi i tyre sipas përdorimit do të ulë ndoijen dhe strukturën e mirë lëvizshmërinë	Pengesat në aplikimin e një transporti urban eficient të integruar me sistemin e parkimeve do të rrisin flukset e mjeteve private duke ndikuar negativisht në ekonominë e turizmit



Elizojnë projekte dhe investime si në plotësimin e infrastrukturës rrugore të vendbanimeve ashtu dhe në plotësimin e infrastrukturës në shërbim të bujqësisë.	Prania e zonave - njollave të zeza në asin kryesor.	Ndërtimi i rrugëve të reja sipas specifikimeve të kodit rrugor dhe ndërtimi i tyre me akset kryesore kombëtare dhe urbane	Mos krijimi i akteve të dedikuara për bujqësinë do të rrisë përdorimin e akteve urbane nga mjetet bujqësore duke sjellë një amortizim më të shpejtë të tyre.
Afërsia me koridoret kryesore rrugore do mundësojë shërbime të pranueshme të transportit në brendësi dhe në koridoret kryesore të njerëzve dhe mallrave.	Mungesa e një terminali Multimodal dhe e parkimeve publike, në qytet, njësitë administrative dhe zonat turistike.	Ngritja e sistemit të transportit urban – qëndër kontrolli, sinjalistikë, njësitë multimodale dhe sistemi i transportit publik ndërtim me rrethet e parkimeve do të ulë ndjeshëm impaktin e mjeteve motorike në mjedis	
	Mungesa e një qendër të kontrollit dhe menaxhimit të trafikut	Instalimi i një sistemi urban dedikuar nxënësve të shkollës.	
	Mungesa e shërbimeve të monitorimit CCTV dhe e semaforëve në kryqëzime për sistemin e trafikut.	Mbështetja e turizmit me akse të dedikuara për këmbësorë dhe biçikleta, shtimi i linjave	
	Ndërtimet e reja të lokalizuara pranë rrugëve ndikojnë negativisht në funksionimin normal të tyre.		
	Mungesa e klasifikimit të rrugëve sipas Kodit Rrugor të Shqipërisë.		
	Mungesa e kalimeve të dedikuara për këmbësorë dhe biçikleta. Përdorimi i të njëjtës hapësirë nga shumë përdorues (këmbësorë, biçikleta, autovetura mjete të përdorimit bujqësor).		





4 STUDIO ARHITEKTURALE

ARTUR
1970
1975
1980
1985
1990
1995
2000
2005
2010
2015
2020
2025



RRJETI ELEKTRIK DHE TELEKOMUNIKACIONI			
Prezenca e nënstacionit elektrik 110/10KV e cila gjithashtu ndikon në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes në tension të mesëm 10KV e cila duhet vlerësuar si një mundësi për të kaluar në rrjetin 110/20 KV	Rrjeti elektrik nuk mund të përballojë kërkesën në rrjet të konsumatorëve dhe nuk siguron cilësinë e duhur për zhvillimin e bizneseve me kërkesa specifike për furnizimin me energji elektrike.	Mundësi për t'u integruar në rrjetin e tensionit të lartë për shkak të pozicionit gjeografik të Këlcyrës dhe kalimit të linjave në territor.	Mungesa e investimeve dhe rikonstruksioneve në të gjitha elementët e rrjeteve elektrike 10kv/20 kv do të rrisë koston e shërbimit dhe do të largojë investime të rëndësishme turistike dhe ekonomike.
Për konsumatorë të rëndësishëm ekziston mundësia e furnizimit nga nënstacioni i cili me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit energjistik të zonës.	Mungesa e burimeve të energjisë elektrike të rinovueshme të cilat do të ndihmonin shumë në rrjetin e eficientës së energjisë.	Linja e shpërndarjes të tensionit të mesëm është e mundur të kalojë nga 10 kv në rrjetin 20 KV duke përmirësuar ofrimin e shërbimit si në zonat urbane ashtu dhe në zonat me potenciale turistike.	Mungesa e ndriçimit publik, veçanërisht në zonat urbane dhe turistike është premisë për rritjen e kriminalitetin dhe evitimin e këtyre zonave.
Këlcyra qytet ka zhvilluar disa projekte në kuadrin e rivitalizimit të qendrës apo zona të caktuara duke mbuluar kështu akset kryesore si dhe sheshet qëndrore me ndriçim publik.	Mungesa e ndriçimit rrugor në pjesën më të madhe të territorit	Ndricimi ekzistues mund të përmirësohet duke rritur eficientën me një kosto të ulët, pa ndërhyrje në infrastrukturë	Mos respektimi i normave dhe standarteve me rrezikun e jetës për banorët e zonave pranë strukturave dhe linjave të rrjetit elektrik
Investitorë privatë të lokalizuar pranë akseve të rëndësishme rrugore me investimet në hapësirat e tyre të biznesit kanë ndihmuar dhe ndriçimin e hapësirave publike	Përdorimi i ndriçuesve me konsum të lartë të energjisë elektrike, dhe jetëgjatësi të shkurtër duke shtuar nevojën për shërbime mirëmbajtje.	Ka mundësi për zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik dhe rrugor në përputhje me zhvillimin urban dhe industrial të saj	Rrjetet e telekomunikacionit shtrirje e fibrave optike, rrjetit i telefonisë fikse dhe i antenave të telefonisë mobile do të kthehet në pengesë në zhvillimin ekonomik, industrializimin dhe turizmin.
Këlcyra është lidhur me rrjetin e komunikimit të të dhënave me fibër optike nëpërmjet operatorëve privatë të këtyre shërbimeve.	Rrjeti elektrik i ndriçimit ekzistues është i amortizuar dhe jashtë kushteve teknike.	Ndricimi publik mund të realizohet me ndriçues me eficientë të lartë dhe konsum të vogël energjie.	Mungesa e investimeve në rrjetet e telekomunikacionit shtrirje e fibrave optike, rrjetit i telefonisë fikse dhe i antenave të telefonisë mobile do të kthehet në pengesë në zhvillimin ekonomik, industrializimin dhe turizmin.



STUDIO ARKITEKTURA

- Projekti i Planit Strategjik të Sektorit të Energjitikës dhe Energjisë Elektrike
- Projekti i Planit Strategjik të Sektorit të Energjitikës dhe Energjisë Elektrike
- Projekti i Planit Strategjik të Sektorit të Energjitikës dhe Energjisë Elektrike
- Projekti i Planit Strategjik të Sektorit të Energjitikës dhe Energjisë Elektrike

Ekziston rrjeti telefonik i cili mbulon të gjithë qytetin si dhe në disa fshatra, kryesisht qendrat e njësive administrative.	Rrjeti i transmetimit të të dhënave me fibra optike si dhe rrjeti telefonik mbulon më cilësi të mirë kryesisht qytetin e Këlcyres, duke mos siguruar të njëjtën shpejtësi dhe cilësi për zonat e tjera.	Potenciali e zhvillimit të ekonomisë dhe të turizmit do të bëjë më tërheqës investimet në fushën e telekomunikacionit	
Shërbimi telefonik mobile ofrohet nëpërmjet operatorëve telefonikë privatë.	Rrjeti telefonik mobile nuk mbulon me të njëjtën cilësi të gjithë hapësirën e Bashkisë Këlcyre duke krijuar vështirësi për zonat të veçanta.	Përdorimi i energjive alternative do të ulë ndjeshëm kostot e mirëmbajtjes të të gjitha infrastrukturave publike dhe do të krijojë një pavarësi nga tregu i hidrokarbureve	
Gadishmëri e donacioneve për financimin e projekteve ndërkulturore të infrastrukturës në mbështetje të zhvillimit të turizmit.			





4.9.1. *Përmbledhja e aspekteve pozitive*

Nga analiza e gjithë elementëve të listuar në pikat e forta dhe mundësitë, mund të bëhet një përmbledhje më unifikuese e tyre, në referencë të sistemeve që ato përfaqësojnë. Në lidhje me sistemin natyror mund të përmenden elementët që përbëjnë relievin gjeografik të bashkisë si: elementët e fortë natyrorë, pyjet, pasuritë e nëntokës, rezervat ujore, cilësia e ajrit, etj. Në lidhje me sistemin bujqësor ajo që spikat më shumë janë potencialet, që derivojnë prej kushteve të përshtatshme klimatiko-tokësore për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë dhe më pas sigurimit të tregut, si rrjedhojë e pozicionimit gjeografik ndërmjet tregjeve rajonale, kombëtare dhe më gjerë. Në lidhje me sistemin infrastrukturor spikasin pozicionimi dhe lidhja me Përmetin dhe me tej me Gjirokastrën apo Tepelenën, burimet nëntokësore, etj.

4.9.2. *Problematikat e evidentuara dhe rekomandimet për zbutjen e impaktit*

Në linja të përgjithshme problematikat që hasen menjëherë nga vizita në terren janë mungesa e infrastrukturës rrugore ose cilësia e ulët e saj dhe ndërtimi pa kriter në mënyrë të përhapur. Analiza më e thelluar ka evidentuar probleme të infrastrukturës inxhinierike, të përmytjes nga liqeni, të shpyllëzimit dhe problematikave të tjera mjedisore, ndotje urbane për shkak të mungesës së vendgrumbillimit të plehrave dhe keqfunksionimit të sistemit të kanalizimeve.

Zhvillimi i bujqësisë has vështirësi për shkak të mungesës së strukturave mbështetëse, si për shembull mungesa e mirëmbajtjes së rrjetit të kanaleve dhe argjaturave, rezervat e vogla ujore, erozioni, copëtimi i tokave bujqësore, si dhe mungesës së hallkave të ndërmjetme të zinxhirit ekonomik prodhim-shitje.

Problematika të tjera kryesore që hasen në fushën e shërbimeve, ekonomisë dhe turizmit janë mungesa e vendeve të caktuara të parkimit, si dhe e një terminali multimodal, transporti urban i pastrukturuar, sinjalistika rrugore, korsitë e dedikuara, si dhe mungesa e modernizimit dhe standartizimit në rang kombëtar. Ka probleme dhe në rrjetin elektrik dhe të telekomunikacionit, si për shembull mungesa e rrjetit 20kv, ndriçimi rrugor, amortizimi i rrjetit ekzistues dhe humbjet e konsiderueshme në të, kontakti i njerëzve me linjat dhe kabinat, rreziku nga tensioni i lëkundur për pajisjet elektroshtëpiake, mungesa e internetit në zona apo objekte të rëndësishme.

4.9.3. *Rekomandime për zbutjen e impaktit të këtyre problematikave:*


Investime për mbulimin me infrastrukturën bazë të të gjithë qendrave të banuara, për të bërë të mundur arritshmërinë e tyre, gjë e cila mungon sot në pjesën më të madhe të zonave malore. Furnizimi me infrastrukturë inxhinierike që do siguronte kushtet normale të jetesës dhe në të njëjtën kohë të rivlerësonte pronat, si truall ashtu dhe godina të këtyre zonave;

Qendërimi i zonave të banuara me qëllim efektshmërinë e investimeve publike dhe ruajtjen e tokës bujqësore;

Nxitja e zhvillimit të një kulture agrare për t'i dhënë identitet zonës dhe konkurrencë ekonomike në rajon.

Sugjerimet e planit për zbutjen e impaktit bazohen në legjislacionin në fuqi, ku parashikohen brezat mbrojtës dhe distancat e sigurisë. Shumë probleme të derivuara deri sot janë pasojë e shkeljes së zonave bufferike. Rreziqe që vijnë nga afërsia me rrugët urbane dhe ndërrbane, kabllot e tensionit të lartë, etj. është me rëndësi respektimi i kufizimeve për ruajtjen e mjedisit natyror, i cili shfaq kërcënime për zhvillimin afër tij ose të mjedisëve me vlera të veçanta.

Në aspektin social, nevojitet hartimi i programeve dhe projekteve social-kulturore për të përmirësuar jetën shoqërore, kryesisht në zonat rurale.



V. TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN (ALTERNATIVA ZERO)

5.1. HYRJE

Alternativa zero – ("no action alternative") shpeshherë barazohet me ruajtjen e situatës ekzistuese ose baseline, Në fakt, alternativa zero ose mos-ndërhyrja është situata e ardhshme pa zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, por që merr parasysh evoluimin e kushteve bazë, përfshirë projektet e tjera, të miratuara ose të parashikuara në mënyrë të arsyeshme në të ardhmen. Shpeshherë kjo alternativë përmendet, ndoshta edhe pa të drejtë, sidomos në rastet kur ajo nuk është një alternativë realiste.

Por duke patur parasysh gjendjen aktuale finaciare dhe mundësitë e kufizuara të Bashkisë Këlcyrë, alternativa zero është një alternativë realiste dhe si e tillë duhet marrë në konsideratë.

Në paragrafët e mëposhtëm përshkruhet zhvillimi i mundshëm i treguesve mjedisorë në të ardhmen, në kushtet e mungesës së zbatimit të PPV-së (alternativa zero) për Bashkinë Këlcyrë.

5.2. ZONIMI, PËRDORIMI I TOKËS DHE POLITIKAT PUBLIKE

Bashkia Këlcyrë nuk ka zona të ligjëruara të përdorimit të tokës, kështu që investitorët dhe banorët e zonës mund të ndërtojnë dhe të zhvillojnë çdo aktivitet ekonomik, pa pasur kufizime, me përjashtim të disa kufizime që ekzistojnë në legjislacionin aktual. Skenari I mos-ndërhyrjes (alternativa zero), i cili në thelb përfshin mungesën e vazhdueshme të zonave të përdorimit të tokës në Bashkinë e Këlcyrës, mund të shkaktojë probleme në të ardhmen. Ka shumë të ngjarë të ketë papajtueshmëri midis përdorimeve të tokës dhe aktiviteteve në Bashkitë fqinje, papajtueshmëri të cilat do të krijojnë "konflikte të përdorimit të tokës". Pavarësisht nga "konfliktet e përdorimit të tokës," nuk përballohen ndotje nga aktivitete shqetësuese.

Skenari I mos-ndërhyrjes (alternativa zero), do të përputhej shumë pak me qëllimet dhe objektivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar në atë që nuk do të mbështesë qëllimet e PPK për të rritur qëndrueshmërinë dhe elasticitetin e resurseve natyrore në territorin e Bashkisë dhe do të siguronte qasje më të vogël në resurset unike të hapësirës së kësaj Bashkie. Kështu, alternativa zero, do të kishte si rezultat degradimin e mundshëm (të mëtejshëm) të zones.

5.3. TOKA

Në mungesë të ndërhyrjes (alternative zero) ekziston rreziku i degradimit të mëtejshëm të tokës, kryesisht përgjatë pjesës së sheshtë të luginës së lumit Vjosa. Kjo së pari lidhet me intensifikimin e kulturave dhe përdorimin në sasi të tepërt të plehrave dhe pesticideve për të maksimizuar rritjen e prodhimit. Së dyti, në mungesë të veprimeve të parashikuara në PPV e Bashkisë Këlcyrë, kryesisht ndërhyrjeve në argjinaturën e lumit Vjosa, permbytjet në sipërfaqet e kultivuara mund të jenë më të shpeshta dhe me dëme shumë më të mëdha. Kjo do të sjellë edhe reduktim të cilësisë së ketyre tokave si rezultat i shpëlarjes së shtesës më prodhuese të tokës dhe t'i mbulojë ato me materiale të sjella nga përrenjtë që mund të përbëhen nga dhera dhe gurë të madhësive të ndryshme, trungje pemësh, mbetje, etj. Probleme të ngjashme të degradimit të tokës mund të lindin për shkak të erozionit të zonave malore që nuk janë të mbuluara me bimësi, nga rrëshqitjet e tokës apo ndotjet.



4

ATELIER STUDIO ARCHITECTURE

Rrezik potencial paraqet edhe vendosja apo ndërtimi i pakontrolluar i veprave të infrastrukturës apo aktiviteteve të tjera të zhvillimit.

Gjithashtu, rreziku i degradimit të tokës do të vijë edhe nga hedhja e pakontrolluar e mbeturinave, të shpërndara në fusha, shpatet e përrënjeve dhe në gryka. Në përfundim, me alternativën zero, toka dhe pjelloria e saj si një ndër treguesit më të rëndësishëm mjedisor, ka shumë gjasa të përkeqësohet edhe më tej në të ardhmen.

5.4. AJRI

Mungesa e industrisë së metaleve apo industrisë së prodhimit të çimentos që janë zakonisht përgjegjësit kryesorë për emetime në sasi të konsiderueshme të ndotësve të ajrit në atmosferë, i kufizon burimet e ndotjes në Bashkinë e Këlcyrës. Faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e ajrit janë lëvizja e automjeteve, kryesisht në qytetin e Këlcyrës dhe djegia jo e plotë e materialeve të ndryshme në soba për ngrohje në dimër. Duke pasur parasysh se shumica e automjeteve që qarkullojnë në Bashkinë e Këlcyrës kanë motorë me naftë që shpesh i kalojnë të 20 vjetët në përdorim, shumë rrugë janë të ngushta dhe të vështira, konsumi i naftës dhe ndotja e ajrit maksimalizohet. Në alternativën zero, të gjitha sa përmenden më lart ekzistojnë ende, dmth rreziqet e degradimit të mjedisit atmosferik do të mbeten të dukshme dhe mund të intensifikohen, sepse me intensifikimin e mëtejshëm të prodhimit primar dhe përpunimit të produkteve bujqësore, ruajtjen dhe rritjen e popullsisë së bashkisë do të rritet lëvizja e automjeteve brenda dhe jashtë qytetit, do të rritet trafiku i automjeteve të rënda dhe si pasojë problemet e ndotjes së ajrit do të intensifikohen. Rrjeti rrugor problematik nuk do të jetë në gjendje të mbështesë rritjen ekonomike dhe gjendja e dobët e rrugëve do të ndikojë në uljen e nivelit të shërbimit të automjeteve, me pasoja negative për mjedisin dhe sidomos ndotjen e ajrit.

5.5. FAKTORET KLIMATIKE

Skenari i mos-veprimit nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në faktorët klimatikë. Temperatura, era, reshjet, etj. nuk pritet të ndryshojnë mënyrë specifike në të ardhmen për shkak të alternativës zero. Faktorët klimatikë mund të ndryshojnë në rast ndryshimesh të klimës globale për shkak të emisioneve dhe përqendrimit të ndotësve në atmosferë p.sh. CO₂, CH₄, etj. Megjithatë, kontributi i Bashkisë për këtë fenomen është i papërfillshëm, për këtë arsye nuk ka asnjë arsye për analiza të mëtejshme.

5.6. UJI

Bashkia e Këlcyrës është e pasur në burime ujore ku dominojnë lumenjtë Vjosa dhe Deshница bashkë me përrënjet dhe rrjedhat e tjera që i furnizojnë dhe që derdhen në atë. Është i njohur presioni mbi ujërat nëntokësore nga numri i puseve private, ndërsa në akuiferet nëntokësore përfundon ndotja nga pesticidet dhe plehrat kimike, duke i degraduar ato. Këto rrjedha ujore janë gjithashtu të rrezikuara nga hedhja e pakontrolluar e mbeturinave dhe hedhja e mbetjeve të ndërtimit. Në alternativën zero, presioni që do të ushtrohet në ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore do të rritet, ndërsa cilësia e tyre ka të ngjarë të përkeqësohet nëse do të rritet më tej ndotja e tyre nga të gjithë faktorët e mësipërm. Rritja ekonomike në të ardhmen, që do të bazohet kryesisht në sektorin

134

Rr. "E Skopjes", Nd.35, H. 6 Ap.4/1, Njësia Administrative H. 5, 1019, Tirane, Shqipëri - Tel. +3554 2222804 / 2430195 - e-mail: [illegible]



primar dhe sekondar, me shërbime trampolinë do të jetë një faktor i rëndësishëm që do të shtonte tryshninë mbi ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

5.7. BIODIVERSITETI DHE ZONAT E MBROJTURA

Biodiversiteti përbën një komponent shumë të rëndësishëm të pasurive natyrore të një vendi, hapësirë apo rajoni. Në origjinë të këtij diversiteti qëndrojnë pozicioni gjeografik, faktorë gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima. Zonat e mbrojtura përbëjnë një rezervë të rëndësishme të kapitalit natyror, kulturor dhe social, dhe në një mënyrë ofrojnë mundësinë që të ndalohet apo kufizohet humbja e biodiversitetit në vend.

Në mungesë të ndërhyrjes (alternativa zero) rreziku i dëmtimit dhe humbjes së një pjese të pasurisë floristike dhe faunistike është më i lartë si pasojë e presioneve antropogjene. Në rast të mungesës së PPV problematikat e shfaqura me lumin Vjosa, i konsideruar si "lumi i egër i fundit i Euroës" do të vazhdojnë duke vënë në rrezik ekzistencën e shumë llojeve të rëndësishme të botës ujore.

Prerja e pakontrolluar e pyjeve do të shkaktojë dëmtime të habitateve të rëndësishme për specie me vlerë të faunës, por njëkohësisht edhe do të rriste rrezikun e ndryshimit të statutit të llojeve të kërcënuara apo të rrezikuara të florës barishtore të pyjeve.

Gjuetia e paligjshme do të ndikonte negativisht në reduktimin e popullatave të gjitarëve të mëdhenj dhe në rritjen e rrezikut të zhdukjes së llojeve të rrezikuara. Kështu, nëse zbatohet alternativa zero, ekziston rreziku që brenda një periudhe afat-mesme të ketë humbje të vlerave të biodiversitetit dhe degradim të disa habitateve kyçe.

5.8. MBETJET

Aktualisht çështja e depozitimit apo trajtimit të mbetjeve përbën një nga problemet më të mëdha në të gjithë vendin. Në Bashkinë e Këlcyrës venddepozitimi aktual nuk është në përputhje me standardet europiane dhe kontribuon në masë të madhe në ndotjen e mjedisit, matricës së ajrit, ujit dhe tokës. Rrjeti i grumbullimit të mbetjeve është tërësisht i pamjaftueshëm, aq sa mbetjet braktisen ose hidhen në rrjedhat ujore, dhe ende nuk ka filluar përhapja e grumbullimit të diferencuar. Rritja e popullsisë do të sjellë rritjen e prodhimit të mbetjeve urbane, dhe në mungesë të masave për të përmirësuar menaxhimin e tyre, ndotja e mjedisit do të rritet në mënyrë të konsiderueshme: venddepozitime të reja abuzive do të krijohen në zonat rurale në afërsi të qendrave të banuara dhe ato ekzistuese do të zgjerohen.

Sipas skenarit të mos-veprimit (alternativa zero) dhe pa ndonjë program për zhvillimin e rrjetit të menaxhimit të mbetjeve dhe minimizimin e emetimeve të lëndëve të dëmshme, shëndeti i njeriut është në rrezik konstant.

Një problem të madh sanitar do të përbëjë rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza, që do të jetë rezultat i pamjaftueshëm siç është ende sot. Nëse nuk do të kushtohet vëmendje mirëmbajtjes në kohë, nuk do të zëvendësohen pjesët e rrjetit të vjetëruara dhe nuk do të implementohen masat e nevojshme për të menaxhuar rritjen e fluksit të ujërave të zeza komunale, do të shohin një përkeqësim të mëtejshëm të cilësisë së ujit dhe tokës.

5.9. NDOTJA AKUSTIKE DHE NIVELI I ZHURMAVE





Në territorin e Bashkisë Këlcyrë aktualisht burimet kryesore të ndotjes akustike (zhurmave) janë përdorimi i automjeteve dhe aktivitetet që lidhen me sektorin sekondar, dmth prodhimin, artizanatin, punëtoritë profesionale, etj. Burimet e zhurmës nuk janë veçanërisht shqetësuese dhe në të ardhmen kjo situatë nuk ka gjasa të ndryshojë negativisht në skenarin e alternativës zero.

5.10. POPULLSIA, KUSHTET SOCIO-EKONOMIKE DHE ASETET MATERIALE

Skenari i mos- ndërhyrjes (alternativa zero) nuk do të kërkonte zhvendosje apo lëvizje të drejtpërdrejtë të banorëve ose bizneseve. Megjithatë, alternativa e mos-veprimit nuk do të ofronte të njëjtat mundësi për banorët dhe bizneset lokale që mund të preken nga akses i kufizuar në aktivitetin ekonomik të gjeneruar nga zhvillimi i turizmit apo sektorit të agro-industrisë. Në këto kushte, do të vazhdonte migrimi i brendshëm nga fshatrat drejt qytetit të Këlcyrës si edhe drejt qendrave të mëdha të banuara në Shqipërinë Qëndrore. Kjo do të sillte një boshatisje totale të fshatrave të zonës dhe zhvlerësim të skajshëm të asetet materiale të qytetareve si; shtëpitë, dyqanet, repartet e artizanëve dhe punëtoritë profesionale.

Fenomenet e erozionit dhe rrëshqitjet e tokës në zonat malore si dhe përmbytjet e mundshme në luginën e lumit Vjosa dhe Deshnica të cilat mund të ndodhin në rastin e skenarit të mos-ndërhyrjes (alternativa zero) mund të rrisin mundësinë e dëmeve në asetet materiale.



5.11. TRASHËGIMIA KULTURORE

Trashëgimia Kulturore në Bashkinë Këlcyrë identifikohet kryesisht me objekte të tilla si: kalaja apo Sarajet, ura e kalasë në luginën e Zagorisë pranë fshatit Limar, kisha e vjeter në fshatin Mbretzhdan, Teqe e vjeter në fshatin Xhanaj, Teqe në fshatin Mazhar (mekami i "Dervish Aliut"), teqe në fshatin Bubës (mekami i "Memajdinit") teqe në fshatin Sukë, Vendet arkeologjike dhe monumentet, të cilat janë përcaktuar si të tillë nga legjislacioni shqiptar, kërkojnë mirëmbajtje. Për të shpëtuar ato, nevojiten fonde, ndërsa korniza e mbrojtjes institucionale është mjaft e ngurtë që disa herë ka çuar në braktisjen e tyre. Për këtë arsye, alternativa zero në afat të mesëm ka të ngjarë të çojë në një përkeqësim të qendrave të trashëgimisë kulturore.

5.12. PEIZAZHI

Kuadri legjislativ i Shqipërisë ka mungesë për sa i takon konceptit të peizazhit dhe vendi ynë nuk është në listën e vendeve (palë) nënshkruese të Konventës Evropiane të Peizazhit (Firence, 2000). Konventa Evropiane e Peizazhit, e njohur edhe si Konventa e Firences, është traktati i parë ndërkombëtar që i kushtohet ekskluzivisht të gjitha aspekteve të peizazhit evropian. Ajo zbatohet për të gjithë territorin e Palëve dhe mbulon zonat natyrore, rurale, urbane dhe peri-urbane. Ajo ka të bëjë si me peizazhet që mund të konsiderohen si të jashtëzakonshme, ashtu edhe me peizazhe të përditshme ose të degraduara. Konventa synon: mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e të gjitha peizazheve dhe ngritjen e vetëdijes për vlerën e një peizazhi jetësor.

Në identifikimin e veprimeve në kuadër të kësaj VNM, koncepti i peizazhit i shprehur në këtë dokument, i referohet përkufizimit sipas Nenit nr. 1 të konventës: "Për qëllimet e konventës, peizazhi



është një sipërfaqe (zonë), karakteri i të cilës është rezultat i veprimit dhe bashkëveprimit të faktorëve natyrorë dhe/ose të njeriut". "Mbrotja e peizazhit" nënkupton veprimet për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e veçorive të rëndësishme ose karakteristike të peizazhit, të justifikuara nga vlera e trashëgimisë së tij që rrjedh nga konfigurimi i tij natyror dhe/ose nga aktiviteti njerëzor.

"Menaxhimi i peizazhit" nënkupton veprimet, nga perspektiva e zhvillimit të qëndrueshëm, për të siguruar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e një peizazhi, në mënyrë të tillë që tu paraprijë dhe të harmonizojë ndryshimet që rrjedhin nga proceset sociale, ekonomike dhe mjedisore.

Bashkia Këlcyrë shquhet për larmishmërinë e peizazheve; nga lumore, bujqësore, kodrinore e deri në ato malore. Por ato që përcaktojnë fizionominë e Bashkisë Këlcyrë janë peizazhi lumor (luginë e Vjosës dhe Dëshnicës) dhe ai malor (në dy anët e luginës së Vjosës. Vjosa përgjatë luginës së saj ofron peizazhe mahnitëse si ajo e grykës së Këlcyrës. Taracat e luginës së Vjosës e bëjnë akoma më tërheqës këtë peizazh. Zona të vogla janë nën kërcënim të vazhdueshëm nga përmytjet. Me rritjen e lartësisë, shpatet bëhen më intensive dhe ndryshon mbulesa e tokës. Në krahun perëndimor të luginës së Vjosës shtrihet mali I Trebeshinës. Trebeshina shtrihet ndërmjet Qafës së Këlcyrës dhe Grykës së Këlcyrës në një gjatësi prej rreth 18 km dhe lartësi maksimale 1922 m. Trebeshina formon një strukturë antiklinale, asimetrike të tipit sëndukor. Kurri i malit, për shkak të strukturës, është i shtruar, me rënie graduale në drejtim të veri-perëndimit dhe i modeluar fuqimisht nga bora dhe karsti. Lidhur me karstin, mbizoteron një peizazh me githfarë formash nga hinkat deri tek lugjet e proskat karstike.

Shpati lindor i Trebeshinës që bie në luginën e Dëshnicës është i rregullt dhe ka natyrë karstike. Gjatë tij zbresin disa përroska të thata e të cekëta. Profili tërthor në pjesën e sipërme është i lugët dhe herë-herë i mystë. Në rrëzën e këtij shpati, në afërsi të Katundishtës, vërehen koluvione, të cilat aktualisht janë të stabilizuara. Në të njëjtin drejtim me to, në luginën e Dëshnicës, matanë shtratit të lumit ndërmjet Sukës dhe Këlcyrës, ruhen të njëjtat depozitime në formë proluvionale.

Skenari I mos-veprimit (alternativa zero) mbart rreziqe për peizazhin. Së pari, duke pasur parasysh se nuk do të ketë asnjë kufizim për zonimin lidhur me përdorimin e tokës, ekziston mundësia e zhvillimit të aktiviteteve (si psh ato të infrastrukturës) që ndikojnë negativisht në peizazh. Së dyti, vazhdimi i karierave të gurorëve apo shtimi i numrit të tyre, do të ndikojë negativisht në peizazh.

5.13. PËRFUNDIME

Sikurse u theksua më lart, skenari i mos-veprimit (alternativa zero), i cili konsiston në mungesën e zbatimit të PPV të Bashkisë Këlcyrë, në të ardhmen do të sillte ndikime negative në mjedis për shumicën e treguesve të shqyrtuar. Këto ndikime mund të jenë direkte ose indirekte. Sipas këtij skenari, zhvillimi i Bashkisë Këlcyrë, do të jetë i fragmentuar dhe "anarkik", me shumë gjasa mbështetur vetëm në interesa dhe iniciativa private të rastit që nuk mbështeten në një planifikim strategjik të unifikuar. Për këtë arsye, përgatitja e PPV në ndihmë të zhvillimit të Bashkisë Këlcyrë, merr një rëndësi të vecantë.

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Këlcyrë është një instrument efikas për zhvillimin e territorit, pasi: (1) merr në konsideratë synimet ekonomiko-sociale të komunitetit në nivel strategjik; (2) evidenton veprimet strategjike që mund të realizohen në një kohë të shkurtër me anë të resurseve të disponueshme dhe/të përdorshme; dhe (3) përcakton objektiva konkrete dhe afatet kohore të tyre.





VI. BAZA PËR PËRGATITJEN E VLERËSIMIT MJEDISOR

6.1. PËRCAKTIMI I OBJEKTIVAVE MJEDISORE

Ligjin Nr. 91/2013, datë 28.02. 2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" dhe aktet e tjera nënligjore përcakton një sërë faktorësh që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit. Bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese të mjedisit, në ndikimet potenciale që mund të shkaktohen në mjedis nga aktivitetet e parashikuara në PPV dhe detyrimeve të specifikuara në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, raporti i VSM-së përcakton sektorët më të rëndësishëm mjedisorë dhe objektivat mjedisorë si më poshtë:

Toka	Biodiversiteti	Uji
Ajri	Peizashi	Faktorët klimatikë
Popullsia dhe Asetet materiale	Shëndeti i Njeriut	Mbetjet
Trashëgimia Kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkitektonike dhe arkeologjike)		

Objektivat për mbrojtjen e mjedisit,

☐ Toka

Objektivi Mjedisor 1: Mbrojtja e formave të relievit, proceseve dhe sistemeve natyrore.

Objektivi Mjedisor 2: Mbrojtja, menaxhimi dhe përdorimi i qëndrueshëm të tokës

☐ Ajri

Objektivi Mjedisor 3: Ulja e nivelit të konsumit të energjisë dhe arritja e objektivave afatgjata për sasisë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, në përputhje me vlerat e lejuara nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

☐ Faktorët klimatikë

Objektivi Mjedisor 4: Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasisë vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

☐ Uji

Objektivi Mjedisor 5: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit ujor, duke përfshirë sistemet e lumenjve

☐ Mjedisi natyror- Biodiversiteti dhe hapësirat e gjelbra

Objektivi Mjedisor 6: Mbrojtja e specieve (specifike), popullatave dhe habitateve dhe krijimi dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbëra të rëndësishme për rekreacion dhe biodiversitet


Objektivi Mjedisor 7: Mbrojtja nga veprimtaritë me ndikime të konsiderueshme e zonave që gëzojnë status të veçantë.

☐ Mbetjet

Objektivi Mjedisor 8: Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe reduktimi i sasisë së mbetjeve të gjeneruara duke rritur riciklimin dhe ripërdorimin e tyre

☐ Ndotja akustike

Objektivi Mjedisor 9: Reduktimi i ndotjes akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH



☐ Popullata dhe asetet materiale

Objekti Mjedisor 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

☐ Trashëgimia kulturore

Objekti Mjedisor 11: Mbrojtja e veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore, përmirësimi dhe, sipas rastit, rivendosja dhe ristrukturimi i mjedisit historik.

☐ Peizashi

Objekti Mjedisor 12: Mbrojtja e veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore, përmirësimi dhe, sipas rastit, rivendosja dhe ristrukturimi i mjedisit historik.

6.2. DETYRIMET SIPAS KONVENTAVE NDËRKOMBËTARE DHE DOKUMENTAVE STRATEGJIKE TË SHQIPËRISË



Për të përcaktuar objektivat e rëndësishme specifike, janë përdorur detyrimet e specifikuar në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, si dhe në dokumentet strategjike të Shqipërisë. Lidhja mes sektorëve të mjedisit dhe objektivave mjedisore si dhe dokumentet përkatës të planeve, programeve apo politikave mjedisore janë paraqitur në tabelën 15, më poshtë:

Tabela 15. Lidhja mes sektorëve të mjedisit dhe objektivave mjedisore si dhe dokumentet përkatës të planeve, programeve apo politikave mjedisore

Dokumenti	Qëllimi dhe objektiva	Lidhja me Sektorin e Mjedisit	Lidhja me Objektivin Mjedisor
Strategjia tematike për Mbrojtjen e Tokës – COM (2006). Referenca në Shqipëri gjendet në Ligjin nr. 10431 datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" (neni 18)	Strategjia merr në konsideratë një sërë funksionesh, diversitetin dhe kompleksitetin e tokës si dhe një sërë procesesh degradimi të cilave ajo (toka) u nënshtrohet. Objekti strategjik është mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës, bazuar në parimet e mëposhtme udhëzuese: - parandalimi i degradimit të mëtejshëm dhe ruajtja e funksioneve të tokës, kur toka përdoret dhe kur funksionet e tokës shfrytëzohen, si dhe kur toka shërben si mjedis pritës për efektet e aktivitetit të njeriut apo fenomeneve mjedisore; - Rikthimi i tokës së degraduar në një nivel funksionaliteti konsistent të paktën me përdorimin aktual apo të synuar, duke pasur parasysh kostot e restaurimit të tokës.	Toka	OM 1 OM2
Direktiva 2008/98/EC dhe Direktiva 2006/12/EC për mbetjet transpozuar në legjislacionin shqiptar si VKM nr. 175, datë 19.1.2011 "Për Miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve 2010-2025 dhe të planit kombëtar	Qëllimi thelbësor i të gjitha rregulloreve mbi mbetjet është mbrojtja e shëndetit të njerëzve dhe e mjedisit nga efektet e dëmshme që shkaktohen nga grumbullimi, transportimi, përpunimi, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve Direktiva 2008/98/KE (Direktiva Kuadër mbi Mbetjet) parashikon një qasje të re mbi administrimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe duke synuar kufizimin e prodhimit të mbetjeve, si dhe nxitjen e përdorimit si burim nga riciklimi dhe rikuperimi. Mbetja është një burim i	Toka Mbetjet	OM 1 OM8


të menaxhimit të mbetjeve 2010 - 2025"	lëndës së parë (dhe jo diçka që duhet shpërbërë sa më lire që të jetë e mundur), kështu që duhet të merren masa për të ripërdorur mbetjet sa më shumë të jetë e mundur. Përsa i përket riciklimit, paraqet një objektiv mjedisor që është 55% e masës totale të mbetjeve të ripërdoret apo riciklohet, deri në 2020		
Direktiva 2008/50/EC mbi cilësinë e ajrit dhe për ajër më të pastër për Evropën. Direktiva 2004/107/CE lidhur me arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e mjedisit. Shqipëria i ka përfruar plotësisht keto direktiva përmes: - Ligjit nr. 162/2014, datë 12.04.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit" dhe -VKM nr. 594, datë 10.09.2014 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit"	Direktiva 2008/50/EC përcakton masat që synojnë si vijon: 1. Përkufizimin dhe përcaktimin e objektivave për cilësi të ajrit të ambientit hartuar në mënyrë të tillë që shmangin, parandalojnë apo reduktojnë efektet e dëmshme në shëndetin e njerëzve dhe në mjedisin në tërësi, 2. Përllogaritjen e cilësisë së ajrit të ambientit në Vendet Anëtare me bazë metoda dhe kritere të përbashkëta; 3. Sigurimin e informacionit mbi cilësinë e ajrit të ambientit në mënyrë që të ndihmojë luftën kundër ndotjes dhe shqetësimit të ajrit dhe të monitorojë prirjet dhe përmirësimet që vijnë si rezultat i masave kombëtare dhe të Komunitetit; 4. Garantimin se informacioni i tillë mbi cilësinë e ajrit të ambientit do t'i bëhet i disponueshëm publikut; 5. Mirëmbajtjen e cilësisë së ajrit atje ku është e mirë dhe përmirësimin e saj në raste të tjera; 6. Nxjten e rritjes së bashkëpunimit midis vendeve Anëtare për reduktimin e ndotjes së ajrit. Objektivat e Direktives 2004/107/CE janë të: a. të përcaktojnë një vlerë të synuar për përqendrimin e arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe benzo (a) pirenit në ajrin e ambientit me qëllim shmangien, parandalimin ose reduktimin e efekteve të dëmshme të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në shëndetin e njeriut dhe në mjedis si një l tërë; b. të sigurojnë, në lidhje me arsenikun, kadmiumin, nikelin dhe hidrokarburet policiklike aromatike, që cilësia e ajrit të ambientit është ruajtur atje ku ajo është e mirë dhe është përmirësuar në raste të tjera; c. të përcaktojnë metodat e përbashkëta dhe kriteret për vlerësimin e përqendrimeve të arsenikut, kadmiumit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në ajrin e ambientit si dhe për depozitimin e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike; d. të sigurojnë që informacioni i duhur mbi përqendrime të arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike në ajrin e ambientit si dhe mbi depozitimet e arsenikut, kadmiumit, merkurit, nikelit dhe hidrokarbureve policiklike aromatike është marrë dhe të sigurojë se ajo është vënë në dispozicion të publikut.	Ajri	OM 3

Strategjia e BE për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike (COM (2013) -VKM 949, datë 30.03.2016 Lligji nr. 75/2016, datë 14.07.2016 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara, për ndryshimet klimatike".	Objektiva e përgjithshme e Strategjisë së BE për adaptimin është të kontribuojë në një Evropë më elastike ndaj klimës. Kjo do të thotë rritjen e punës përgatitore dhe të kapacitetit për t'ju përgjigjur ndikimeve nga ndryshimet klimatike në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, duke zhvilluar një përafrim logjik dhe duke përmirësuar koordinimin. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit, në Tetor 1999, si dhe është anëtare e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), që nga Janari 1995. Shqipëria ka përgatitur tre Komunikime Kombëtare në 2002, 2009 dhe në 2016. Brenda vitit 2018 priten të miratohen: • Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike me kohështrirje 2018-2030, bazuar në tre përbërës: pakësim, përshtatje, zhvillim i qëndrueshëm; • Plani Kombëtar i Veprimit për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë, i cili ka në qendër të tij zbatimin e Kontributit Kombëtar të Synuar, dhe. • Liqi për Ndryshimet Klimatike	Faktoret klimatike	OM 4
Vendimi 406/2009/EC për përpjekjet e Shteteve Anëtare të zvogëlojnë emetimet e gazeve serë që t'i plotësojnë detyrimet e Komunitetit për zvogëlimin e gazeve serë deri më 2020	Vendimi 406/2009/EC përcakton kontributin minimal të vendeve anëtare për të arritur detyrimin për zvogëlimin e emetimit të gazeve "serë" për periudhën nga 2013 deri në 2020 për emetimet e gazeve "serë" që mbulohen nga ky vendim si dhe rregullat për arritjen e këtyre kontributeve dhe vlerësimin e tyre. Angazhimi për reduktimin e emetimeve të gazeve "serë" i referohet: • emetimeve nga përdorimi i lëndëve djegëse në shtëpi dhe në sektorin e shërbimeve; • emetimeve nga përdorimi i lëndëve djegëse në sektorin e transportit; • emetimeve nga përdorimi i lëndëve djegëse në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe në sektorin e energjisë; • emetimet që çlirohen nga sektori i energjisë; • emetimet nga proceset industriale; • përdorimi i tretësve dhe produkteve të tjerë; • emetimet nga bujqësia; • emetimet nga administrimi i mbetjeve. Shqipëria akoma nuk e ka transpozuar këtë vendim; është parashikuar të bëhet në vitin 2018.	Faktoret klimatike	OM 4
Direktiva 2000/60/EC (Direktiva Kuadër e Ujit) (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore")	Direktiva përcakton masat për arritjen e objektivit strategjik të statusit të mirë ekologjik për ujërat në vitin 2015.	Uji	OM 5
Direktiva 2008/56/EC që vendos kuadrin për	Direktiva përcakton kuadrin brenda së cilit vendet anëtare duhet të marrin masat e nevojshme « për të		






veprimin e komunitetit në fushën e politikës mjedisore të detit (Direktiva Kuadër e Strategjisë Detare). Shqipëria planifikon ta adoptojë plotësisht këtë strategji gjatë tremujorit të fundit të vitit 2018 përmes një VKM-je specifike "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Mjedisore Detare".	arritur apo mbajtur një gjendje të mirë mjedisore në mjedisin detar » deri në vitin 2020. Në përputhje me këtë Direktivë janë hartuar dhe zbatuar strategjitë detare, me qëllim që të: • mbrojnë mjedisin detar, parandalojnë degradimin e tij, apo, nëse është e mundur, rivendosin ekosistemet detare në zonat e prekuara nga efektet e dëmshme; • parandalojnë dhe pakësojnë ndërhyrjet në mjedisin detar me qëllim eliminimin gradual të ndotjes dhe kështu garantojnë se nuk ka pasoja të mëdha për biodiversitetin detar, ekosistemet detare dhe shëndetin e njeriut dhe se këto nuk janë të kërcenuara.	Uji	OM 5
Direktiva 2008/105/EC për standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikave ujore (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore")	Kjo Direktivë përcakton standardet e cilësisë mjedisore për substancat prioritare dhe ndotësit e tjerë, siç përcaktohet në Direktivën 2000/60/EC me objektiv arrijen e një gjendjeje të mirë kimike të ujërave sipërfaqësore dhe në përputhje me parashikimet dhe objektivat e Direktivës 2000/60/EC mbi parandalimin e emetimit të substancave në ujë, duke ndarë ujërat e zeza. VKM-ja që transpozon Direktivën 2008/105/EC në legjislacionin shqiptar përcakton normativa të detajuara dhe gjithëpërfshirëse për vlerësimin e gjendjes kimike të ujërave sipërfaqësore	Uji	OM 5
Direktiva 2006/7/EC për Menaxhimin e Cilësisë së Ujit për Larje (transpozuar ne legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore")	Direktiva përcakton masat për të: • monitoruar dhe klasifikuar sipas cilësisë ujin për larje; • menaxhuar cilësinë e ujit për larje; • informuar publikun mbi cilësinë e ujit për larje. Qëllimi (objektiva) i kësaj Direktive është 'të ruajë, mbrojtë dhe përmirësojë cilësinë e mjedisit dhe të mbrojtë shëndetin e njerëzve, duke plotësuar Direktivën 2000/60/EC'.	Uji	OM 5
Direktiva 98/83/EC në lidhje me cilësinë e ujit të caktuar për konsumim njerëzor (transpozuar në legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore")	Direktiva e Keshillit 98/83/EC rregullon cilësinë e ujit që përdoret për konsum nga njerëzit. Uji është i shëndetshëm dhe i pastër nëse ai nuk përmban mikroorganizma, parazitë dhe çdo substancë tjetër, të cilat në sasi apo përqendrime të caktuara përbejnë një rrezik potencial për shëndetin e njerëzve. Objekti kryesor i kësaj direktive është të mbrojtë shëndetin e njerëzve prej çdo efekti negativ apo ndotjeje të ujit që përdoret për konsum nga njerëzit, duke garantuar që uji të jetë i pastër dhe i shëndetshëm.	Uji	OM 5
Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi (transpozuar ne legjislacionin shqiptar përmes VKM nr. 246, datë 30.04.2014 "Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore")	Direktiva 2006/118/EC për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkeqësimi përcakton masa specifike për të parandaluar dhe kontrolluar ndotjen e ujërave nëntokësore në përputhje me Direktivën 2000/60/EC. Këto masa kryesisht përfshijnë: • kritere për vlerësimin e statusit kimik të ujit nëntokësor, dhe • kritere për identifikimin dhe kthimin mbrapsht të tendencave të konsiderueshme dhe te	Uji	OM 5



të cilësish të mjedisit për ujërat sipërfaqësore")	qendrueshme të rritjes, dhe për përcaktimin e pikënisjeve për tendencat e kundërta.		
Direktiva 2007/60/EC për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmblytjet (Direktiva e Përmblytjeve). Shqipëria e ka përfshirë pjesërisht këtë direktivë përmes: - Ligji nr. 9860, datë 21.01.2008 që amendon Ligjin nr. 8518, datë 30.7.1999 "Për Ujtin dhe Kullimin" - VKM nr. 835, datë 3.12.2004 "Për Planin Kombëtar të Emergjencave Civile" - VKM nr. 267 datë 07.05.2014 "Për miratimin e listës së substancave prioritare në mjediset ujore"	Direktiva ka përcaktuar negociatat ndërkufitare lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga përmblytjet, dhe përfshin angazhime të rëndësishme për të rritur transparencën dhe integrimin e qytetareve. Objektiva e direktivës së menaxhimit të rreziqeve nga përmblytjet është të reduktojë rreziqet dhe pasojat negative të përmblytjeve në BE. Direktiva ka përcaktuar negociatat ndërkufitare lidhur me menaxhimin e rreziqeve nga përmblytjet, dhe përfshin angazhime të rëndësishme për të rritur transparencën dhe integrimin e qytetareve.	Uji	OM 5
Direktiva 2009/147/EC për mbrojtjen e zogjve të eger. Shqipëria e ka përfshirë pjesërisht këtë direktivë, përmes ligjeve: - Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e Biodiversitetit" i ndryshuar me ligjin nr. 68/2014 datë 3.7.2014 - Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008, "Për mbrojtjen e faunës së eger" - Ligji nr. 10253, datë 11.3.2010 "Për Gjuetinë"	Direktiva ofron një komizë të plotë për mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e të gjithë zogjve të eger që ndodhen në BE. Direktiva udhëzon shtetet anëtare të marrin masa për të mbajtur popullacionin e të gjitha llojeve të zogjve të eger që ndodhen në shtetin e BE -së. Masa të tilla mund të përfshijnë mirëmbajtjen dhe/ose rikrijimin e vendbanimeve në mënyrë që të mbajnë këto popullata të zogjve. Për të gjitha speciet e zogjve që referohen në Shtojcën I të Direktivës si dhe për të gjitha speciet e rregullta migratore, që kanë nevojë për mbrojtje, vendet anëtare duhet të krijojnë Zonat e Veçanta të Mbrojtjes (ZVM), apo të quajtura zonat Natura 2000. Në këto ZVM duhet garantuar që popullatat e specieve gjenden në një situatë të favorshme. SKZHI II përcakton si objekte strategjike "Ngritjen e rjetit ekologjik "Natura 2000". Gjatë vitit 2018 është parashikuar amendimi i ligjit "Për gjuetinë", gjë që do të sigurojë përfshirjen e plotë të kësaj Direktive në legjislacionin shqiptar.	Mjedisi natyror-biodivers.	OM 6
Direktiva e Keshillit 92/43/EEC për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së eger. Shqipëria e ka përfshirë pjesërisht këtë direktivë përmes ligjeve: - Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"	Direktiva e habitateve kërkon që shtetet anëtare duhet të marrin masa të duhura për të mënjanuar në zonat e veçanta të ruajtjes shkatërrimin e habitateve natyrore dhe të habitateve të specieve si dhe shqetësimin e specieve për të cilat janë përcaktuar zonat e Natura 2000, në rastet kur ky shqetësim është dukshëm i lidhur me objektivat e kësaj Direktive. Kjo dispozitë aplikohet për ZVM-te e propozuara, sic përcaktohet në përputhje me procedurat dhe kriteret e direktivës së habitateve.	Mjedisi natyror-biodivers.	OM 6



Ligji nr. 81/2017, "Për Zonat e Mbrojtura", Datë 4.5.2017 Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", dhe - VKM nr. 866, datë 10.12.2014 "Për miratimin e listës së habitateve natyrore, florës, faunës dhe zogjve me interes për KE"	SKZHI II përcakton si objektiva strategjike: - Një rritje e synuar me 17% e sipërfaqes së Zonave të Mbrojtura në gjithë territorin, përmes zgjerimit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura, - Garantimi i statusit të mbrojtur për 5% të specieve dhe habitateve të kërcënuara.		
Konventa e Bernës (Bern, 1979) me Ligjin nr. 8294, datë 2.3.1998)	Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror evropian.	Mjedisi natyror-biodivers.	OM 6
Konventa Ramsar (Ramsar, 1971) (ratifikuar në 29.3.1996)	Shtetet palë kanë rënë dakort që të: - përcaktojnë ligatinat e territorit të tyre të përshatshme për t'u përfshirë në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare; - formulojnë dhe zbatojnë plane për promovimin dhe mbrojtjen e ligatinave të përfshira në listë, si dhe për përdorimin sa më racional të ligatinave në territorin e tyre. - promovojnë ruajtjen e ligatinave dhe shpendve ujore duke krijuar rezervate natyrore në ligatina, të përfshira ose jo në listë, dhe siguron ruajtjen e tyre në mënyrën më të përshatshme; - marrin në konsideratë përgjegjësinë e tij ndërkombëtare për ruajtjen, menaxhimin dhe përdorimin racional të grupeve shtegtare të shpendve ujore, si kur përcakton një hyrje në listë ashtu dhe kur ushtron të drejtat e tij për ndryshim në këtë listë në lidhje me ligatinat në territorin e tij; - konsultojnë njëra-tjetrën rreth zbatimit të detyrimeve të dala nga kjo Konventë veçanërisht në rastet kur një ligatinë shtrihet në territorin e më shumë se të një shteti palë ose kur një sistem ujor ndahet mes disa shteteve palë.	Mjedisi natyror-biodivers.	OM 6
Direktiva 2002/49/EC për vlerësimin & administrimin e zhurmës në mjedis. Shqipëria e ka përafëruar pjesërisht këtë Direktivë përmes Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis"	Objekti kryesor është menaxhimi i qëndrueshëm i zhurmës me qëllim respektimin e niveleve të lejuara dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve përcaktojnë kërkesa specifike për zhurmat e gjeneruara nga sektorë të tjerë, siç është transporti rrugor, ajror, hekurudhor, zhurmat e gjeneruara nga pajisjet dhe makineritë.	Zhurmat	OM 9
Direktiva 2008/96/EC mbi sigurinë e infrastrukturës rrugore (e përafëruar plotësisht nëpërmjet Udhëzimit Nr. 9, datë 3.07.2012 "Mbi auditimin dhe	Objektiva e kësaj Direktive është "garantimi i infrastrukturës së sigurtë rrugore për të gjithë përdoruesit e rrugës".	Popullsia & asetet Materiale	OM 10



Inspektimin e sigurisë rugore*			
Konventa Europiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike-Konventa e Maltës (MEKVAD) (Shqipëria ka aderuar përmes miratimit të Ligjit nr. 9806 datë 17.9.2007)	Konventa i referohet konceptit gjithëpërfshirës të ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike. Ajo përcakton lidhjen mes ruajtjes së trashëgimisë arkeologjike dhe planifikimit hapësinor. Konventa kërkon që çdo palë firmosëse të: - kërkojë të pajtojë dhe ndërthurë kërkesat përkatëse të arkeologjisë me planet hapësinore duke siguruar që arkeologët marrin pjesë në hartimin e politikave të planifikimit hapësinor dhe në faza të ndryshme të zbatimit të këtyre politikave; -sigurojë që arkeologët, planifikuesit urbanë dhe ata hapësinorë konsultohen sistematikisht me njëri-tjetrin me qëllim lehtësimin e modifikimit të atyre planeve hapësinore që kanë të ngjarë të dëmtojnë trashëgiminë arkeologjike - sigurojë kohë dhe burime të mjaftueshme për një studim të duhur shkencor që duhet të bëhet në zonën përkatëse dhe që të publikohen rezultatet e atij studimi - sigurojë që vlerësimi për ndikimin në mjedis dhe vendimet rezultuese përfshijnë konsideratën e plotë mbi zonat arkeologjike dhe shtrirjet e tyre - garantojë konservimin <i>in situ</i>, kur është e mundur, të elementëve të trashëgimisë arkeologjike që janë gjetur gjatë kryerjes së aktiviteteve hapësinore; - sigurojë që zonat arkeologjike janë të arritshme nga publiku, dhe se rrugët hyrëse për pranimin e një numri të madh vizitorësh, nuk dëmtojnë veçoritë arkeologjike dhe shkencore të këtyre zonave dhe mjedisit përreth	Trashëgi mia kulturore	OM 11
Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitektonike të Europës - Konventa e Granadës (Shqipëria ka aderuar përmes miratimit të Ligjit nr. 9806 datë 17.9.2007)	Konventa përforcon konceptin gjithë-përfshirës në ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike (monumente, njësi arkitektonike, zona apo struktura memoriale). Konventa kërkon që çdo palë pjesëmarrëse të: - zbatojë mbikëqyrje dhe procedurat e autorizimeve të duhura në përputhje me kërkesat e paracaktuara për mbrojtje ligjore të strukturave në fjalë; - parandalojë dëmtimin, rrënimin ose shkatërrimin e strukturave të mbrojtura. Politika e ruajtjes gjithëpërfshirëse të trashëgimisë arkitektonike i detyron të gjitha palët firmosëse që të: - përfshijnë mbrojtjen e trashëgimisë arkitektonike si objektiv të rëndësishëm në planifikimin hapësinor dhe atë urban; - nxitin programet për restaurimin dhe mirëmbajtjen e trashëgimisë arkitektonike;	Trashëgi mia kulturore	OM 11
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, draftri 2-të, 2015 - 2020	Strategjia e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II) paraqet vizionin e Shqipërisë për zhvillimin e saj social, demokratik dhe ekonomik për periudhën 2015-2020, si dhe aspiratën për integrimin evroplan. SKZHI-II shpjegon se si do të arrihet ky vizion përmes politikave dhe strategjive të qeverisë, duke synuar në:	Toka Ajri	OM 1 OM 2 OM 3 OM 4



	- Shëndërimin e Shqipërisë në një vend të denjë për t'u anetësuar në Bashkimin Evropian, - Aritjen e standardeve që i shërbejnë qytetarëve, nritjes së mirëqenies së tyre dhe garantimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre, dhe - Hartimit të politikave që nxitin konkurrueshmërinë dhe prosperitetin ekonomik në Shqipëri si dhe krahasuar me vendet e rajonit dhe më gjerë. Kuadri kohor 2015-2020 i SKZHI-II është harmonizuar me periudhën vijuese 2014-2020 të planifikimit financiar të BE-së, me Strategjinë e Lisbonës deri në 2020, dhe me tre ciklet vijuese kuadrit afatmesëm buxhetor. Përveç këtyre proceseve, SKZHI-II është harmonizuar edhe me procese dhe dokumente të tjera kyç të zhvillimit dhe reformimit strategjik, si me poshtë: - Dokumenti Tregues Strategjik për Shqipërinë (2014-2020), referuar gjithashtu edhe si: Dokumenti Strategjik i Komisionit Evropian për Vendlin; - Programi Kombëtar i Reformave Ekonomike (PKRE) 2015-2017, përfshirë Strategjinë e zhvillimit të Bizneseve dhe Investimeve 2014- 2020; - Strategjia e Administrimit të Financave Publike 2014-2020; - Strategjia e Evropës juglindore 2020 (SEE2020): Punësimi dhe Prosperiteti në Perspektivën Evropiane; - Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2014-2020; Integrimi në BE është qëllimi madhor. Mirëqeverisja, demokracia dhe sundimi i ligjit përbëjnë themelet mbi të cilat do të arrihet vizioni i SKZHI-II.	Faktoret klimatike	OM 5
			OM 6
		Uji	OM 7
			OM 8
		Mjedisi natyror	OM 9
			OM 10
			OM 11

6.3. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE

Ndikimet mjedisore që mund të shkaktohen nga veprimtaritë e parashikuara në Plan janë përvijuar në Tabelën 16, më poshtë:

Tabela 16. Ndikimet mjedisore të mundshme nga zbatimi i Planit

Treguesi i mjedisit	Përcaktimi i ndikimeve që mund të vlerësohen në raportin e VSM-së	Vlerësimi PO/JO
Toka	- Rrëshqitje të mëdha të tokës - ndryshim i rrjedhjes së lumenjve apo rrjedhave të tjera - shpërhapja urbane, - fragmentimi i zonave me aktivitet të dendur bujqësor /zona pyjore - administrimi i mbetjeve të gjeneruara nga ndërhyrjet në infrastrukturë - humbja e tokës nga erozioni dhe rrëshqitjet - ndryshimi i mundshëm i kategorisë së përdorimit të tokës nga aktivitetet prodhuese dhe infrastruktura - rreziqe të degradimit të tokës bujqësore, pyjore	PO

	- erozioni lumor - zonat e ndotura industriale dhe burime të tjera të ndotjes	
Ajri	- Emetimi i ndotësve në ajër, me ndikime të dëmshme - emetimi i ndotësve për të cilët janë përcaktuar kufijtë e sipërm në nivel kombëtar - ndikimi në shëndet në praninë e lartë të ndotësve në ajër	PO
Faktorët klimatike	- Ndeshmëria e rrjeteve dhe strukturave ndaj situatave ekstreme të motit (infrastrukturës dhe strukturave mbrojtëse) - emetimet e gazrave "serë" që shkaktohen nga djegia e karburanteve - përshatja ndaj ndryshimeve të klimës - përshatja e infrastrukturës	PO
Uji	- Ndikimet e substancave ndotëse e të rrezikshme në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, - ndikimet tek cilësia e ujit të pijshëm - ndikimet mbi ujërat e plazheve - burimet e ndotjes së ujit	PO
Mjedisi natyror (biodiversiteti, habitatet, zonat e mbrojtura)	- Fragmentimi i habitateve, speciet e rrezikuara - ndikim në migrimin e kafshëve - ndikim në integritetin dhe funksionalitetin e zonave të mbrojtura dhe të zonave të Natura 2000 - ndikim mbi tipologjinë dhe cilësitë e vecorive natyrore, - Administrimi dhe mbrojtja e pyjeve dhe kullotave	PO
Mbetjet	- Ndikimet nga zona të ndotura të njohura si Hot-Spote, - ndikimet nga vend depozitime të hapura të mbetjeve, - kapaciteti i pamjaftueshëm i landfilleve ekzistues / mungesa e tyre, - mbetjet inerte të rrezikshme, spitalore dhe të kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore, - ndarja në burim e mbetjeve / riciklimi, - Grumbullimi/ripërdorimi/riciklimi	PO
Zhurma	- Ndotja akustike si rezultat i ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës perkatese dhe ndikimi tek shëndeti i njerëzve, - Monitorimi i zhurmës	PO
Popullsia dhe asetet materiale	- Ndikime mbi asetet materiale për shkak të nevojës për hapësirë, - aksesibiliteti dhe lidhjet mes zonave/rajoneve të ndryshme, - ndikimet që lidhen me sigurinë rrugore,	PO
Trashëgimia Kulturore	- Ndikime në elementet e trashëgimisë kulturore - ruajtja në procesin e planifikimit,	PO
Rreziqet: Përmbytjet	- Përmbytje nga lumenjtë Vjosa dhe Dëshnica - përmbytje nga mungesa e pastrimit të sistemit kullues, - përmbytje nga dëmtimi argjinaturave, - pasojat e përmbytjeve	PO
Peizashi	- Ndryshimi i peizazhit dhe i vecorive pamore të hapësirës, - mbrojtja e peizazhit	PO

6.4. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NDIKIMEVE TË PLANIT DHE PROJEKTEVE

Ndikimet mjedisore që mund të shkaktohen nga veprimtaritë e parashikuara në Planin e Përgjithshëm Vendor janë të natyrave të ndryshme dhe peshë apo rëndësia e tyre është e ndryshme. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kalon nëpër dy faza të cilat janë përshkruar në seksionet e mëposhtme:

6.4.1. Vlerësimi i ndikimit

Kjo është faza kur vlerësohet ndikimi që çdo projekt i Planit ka në mjedis. Me synim vlerësimin e ndikimeve mjedisore të planit të propozuar, ndiqet metodologjia që është propozuar nga Jahn et al, (2012) e cila bazohet Direktivën 42/2001/CE, Annex II, e përshtatur për nevojat dhe karakteristikat specifike të PPV të Bashkisë dhe të propozimeve të tij. Për këtë qëllim, fillimisht, vendosen 6 *elementë* (kriterë, përbërës) që kanë lidhje me ndikimin e mundshëm të propozimeve të PPV të Bashkisë në mjedis. Këto 6 elementë janë (Tabela 17):

1. Probabiliteti i shfaqjes (së ndikimit): element i cili shqyrton mundësinë e shfaqjes së ndikimit mjedisor të një projekti specifik në një objektiv mjedisor,
2. Kohëzgjatja (e ndikimit): vlerëson shtrirjen kohore të ndërhyrjes në mjedis që është parashikuar për një projekt,
3. Ndikimi (i projektit): shpreh me vlerë numerike shkallën e ndikimit të një projekti të Planit për çdo objektiv mjedisor (ujë, ajër, tokë, etj.),
4. Rikthimi (i ndikimit): ky tregues shpreh mundësinë e rikthimit të ndikimit në mjedis të një projekti mbas zbatimit të tij,
5. Ndërveprimi (aspekti kumulativ): potenciali që bart ndërhyrja në mjedis gjatë realizimit të projektit për të shtuar dhe prodhuar efekt të akumuluar në fazën e operimit dhe shfrytëzimit,
6. Shtrirja (e ndikimit): tregon hapësirën fizike (sipërfaqen) në të cilën shtrihet ndikimi në mjedis i një projekti.

Tabela 17. Treguesit/Elementët e Vlerësimit të Ndikimit

SHTRIRJA	NA (Nuk Aplikohet)
	E Ulët, e kufizuar vetëm tek veprimi
	Mesatare, në nivelin e zonave të ngjashme
	E Lartë, mbi nivelin e Bashkisë
	Shumë e Lartë, në nivel ndërkultar
INTENSITETI	NA (Nuk Aplikohet)
	I Ulët
	Mesatar
	I Lartë
	Shumë i Lartë
	NA (Nuk Aplikohet)
	E Ulët: kostot e kthyeshmërisë < përfitimet nga veprimi

KTHYESHMËRIA	Mesatare: kostot e kthyeshmërisë = përfitimet nga veprimi
	E Lartë: kostot e kthyeshmërisë > përfitimet nga veprimi
	Shumë e Lartë: efekt negativ dhe të pashmangshëm
NDËRVEPRIMI	NA (Nuk Aplikohet) - asnjë ndikim me parametra të tjerë
	Kumulativ
	Sinerqjizm
PROBABILITETI	NA (Nuk Aplikohet)
	E Ulët
	Mesatar
	E Lartë
FREKUENCA	NA (Nuk Aplikohet)
	E Ulët: Përkohësisht
	Mesatare: periodike gjatë një viti
	E Lartë: periodike gjatë një dite
	Shumë e Lartë: në vazhdimësi

Përsa i përket mjedisit, në kontekstin e vlerësimit mjedisor të PPV-së, mjedisi është zbërthyer në 10 sektorë (elementë) që supozohet se janë pësuesit e pasojave që vijnë nga ndërhyrjet në mjedis gjatë zbatimit të projekteve. Këto 10 sektorë janë toka, ajri, klima, uji, biodiversiteti, mbetjet, ndotja akustike, popullsia dhe asset materiale, trashëgimia kulturore dhe peizazhi të cilët gjatë gjithë procesit të vlerësimit në mjedis janë quajtur objektiva mjedisorë ose OM. Pra, çdo element i mjedisit që është marrë për bazë për vlerësimin e ndikimit të projekteve në mjedis, përbën një objektiv mjedisor më vete. Për shembull, toka, është objektivi mjedisor numër 1, ajri është objektivi mjedisor numër 2 e kështu me radhë (Tabela 18).

Numri i objektivit mjedisor ka thjesht funksion renditës dhe nuk ndikon në vlerësimin e projektit.

Tabela 18. Objektivat mjedisorë dhe kodifikimi

Objektivat Mjedisorë	Kodifikimi i tyre
Toka	OM 1
Ajri	OM 2
Faktoret klimatike	OM 3
Uji	OM 4
Biodiversiteti	OM 5
Mbetjet	OM 6
Zhurma	OM 7
Popullsia	OM 8
Trashëgimia kulturore	OM 9
Peizazhi	OM10

Objektivat mjedisorë të marrë si bazë për vlerësimin mjedisor të projekteve të PPV-së janë përcaktuar në Ligjin 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", objektivat e përcaktuara në SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar politikat dhe

projektet që parashikon Plani i Përgjithshëm Vendor për të arritur objektivat e tij. Për vlerësimin e ndikimit të çdo elementi (kriteri) të ndikimit në një OM janë përdorur vlerat numerike ndërmjet [0-10] ku është ndjekur logjika e mëposhtme:

- Vlera numerike 0: është përdorur për të shënuar projekte dhe objektiva ndikimi i të cilëve në mjedis nuk është i matshëm dhe i vlerësueshëm,

- Vlerat numerike 0.1-10: janë vlerat numerike që i jepen projekteve në varësi të ndikimit të tyre specifik në objektivat e mjedisit. Në parim, madhësia e ndikimit të një projekti në mjedis dhe vlerësimi numerik lidhen ndërmjet tyre në përpjestim të zhdrejtë. Sa më i lartë që të jetë numri i pikëve që merren në vlerësim, aq më i ulët është ndikimi i një projekti në mjedis dhe anasjelltas. Për shembull, vlera "1" tregon ndikim të lartë të projektit në mjedis ndërsa vlera numerike "10" tregon mungesë ndikimi ose ndikim të papërfillshëm. *Kjo vlen si në nivel elementit të ndikimit (kriteri), ashtu edhe në nivel projekti.* Për vlerësimin e ndikimit ndiqet procesi i mëposhtëm:

- ☐ Vlerësimi me vlera numerike i ndikimit në një OM: Fillimisht kryhet vlerësimi në pikë i ndikimit të çdo elementi/kriteri të ndikimit në një OM.
- ☐ Llogaritja e peshës specifike të një kriteri të vlerësimit në raport me totalin: Si hap i dytë llogaritet pesha specifike e elementeve/kritereve të ndikimit në raport me totalin. Për çdo element (kriter) të vlerësimit, është përcaktuar pesha specifike (e shprehur me %) që ky element ka në raport me ndikimin total të projektit në mjedis. Për shembull, pesha e kriterit "Natyra e ndikimit" është 20% në raport me shumën totale të ndikimit që është 100% (Tabela 19).

Tabela 19. Peshat specifike të elementeve/kritereve të vlerësimit

	Elementët / Kriteret e vlerësimit	Pesha %	Pikët e vlerësimit (në varësi të nivelit të ndikimit)		
1	Mundësia e shfaqjes	10%	PO	JO	E pasigurt
	Pikët		0	10	0.1-9.9
2	Kohëzgjatja	20%	E menjëhershme & qëndrueshme	E vogël, e papërfillshme	Afatshkurtër, ose afatgjatë
	Pikët		0	10	0.1-9.9
3	Natyra e ndikimit	20%	Shkatërron habitat	Neutrale	Dëmton shërbime të caktuara të ekosistemit
	Pikët		0	10	0.1-9.9
4	Mundësia e riaftësimit të ndikimit	10%	Kthim i plotë	Nuk ka kthim të ndikimit	E pjesshme
	Pikët		0	10	0.1-9.9
5	Natyra kumulative	20%	PO	JO	E pasigurt
	Pikët		0	10	0.1-9.9
6	Madhësia/Shtrirja	20%	Sipërfaqe e madhe & popullsi	Pikësore, e kufizuar dhe jo popullsi	E ndërmjetme
	Pikët		0	10	0.1-9.9

Më poshtë, në tabelën 20, paraqitet një shembull konkret i vlerësimit të ndikimit të elementëve të vlerësimit për Objektin Mjedisor – Ajër për zbatimin e një projekti 'Ndërtimi i Kanalizimeve të Ujërave të zeza në fshatin X'. Këtu paraqitet vlerësimi me pikë dhe llogaritja e mesatares së vlerësimit duke integruar peshën e secilit kriter vlerësues.

Tabela 20. Pikët e grumbulluara nga 6 elementët/kriteret për ndikimin e projektit për OM2 (Ajër)(Shembull)

Pesha (%)	Kriteri i Vlerësimit	Shpërndarja e pikëve të vlerësimit për çdo element të ndikimit		
		Vlerësimi numerik	Pesha specifike	Totali i pikëve
10	Mundësia e shfaqjes	7	0.1	0.7
20	Kohëzgjatja	6	0.2	1.2
20	Natyra e ndikimit	8	0.2	1.6
10	Mundësia e riaftësimit të ndikimit	7.5	0.1	0.75
20	Natyra kumulative	5.5	0.2	1.1
20	Madhësia/Shtrirja	6	0.2	1.2
Totali (Vlerësimi numerik x Peshë specifike = Totalin e pikëve të ndikimit)				6.55
Shuma e pikëve të grumbulluara për vlerësimin e elementëve të ndikimit për një OM: = 6.55 pikë				

Në këtë tabelë, 6.55 është numri i pikëve që shpreh ndikimin e projektit në fjalë vetëm për një OM që në këtë rast është AJRI. E njëjta procedurë kryhet për çdo OM.

- ☐ **Konvertimi i pikëve në vlerësim simbolik e cilësor:** Në varësi të pikëve që grumbullon secili projekt, jepet vlerësimi përfundimtar sipas tabelës (matricës) së vlerësimit të ndikimit në mjedis të paraqitur si vijon. Për këtë qëllim, pikët e grumbulluara përkthehen në shenja konvencionale, dhe në vlerësim cilësor që shprehet në vlerësim të papërfillshëm, të ulët, mesatar, të lartë dhe të paaplikueshëm (Tabela 21).

Tabela 21. Vlerësimi sasior, konvencional e cilësor i ndikimit në mjedis

Pikët e Vlerësimit	Simbolika e matricës së vlerësimit dhe kuptimi përkatës
0.1 – 3 pikë	Ndikim i lartë/shumë i lartë (shkatërrues mbi shëndetin dhe mjedisin)
3.1 – 6 pikë	Ndikim mesatar (pa garanci për shëndetin dhe mjedisin, pavarësisht masave zbutëse)
6.1 – 8.5 pikë	Ndikim i ulët (në rast se masat zbutëse dhe parandaluese rrespektohen)
8.6 – 10 pikë	Ndikim i papërfillshëm (nëse zbatohen masat, dhe nuk cenohet ekuilibri natyror)
Vlerësimi i Pa Aplikueshëm	Ndikim neutral ose pa ndikim (ndikime të mundshme janë të përkohshme, afatshkurtra dhe mjedisi vetripërtërihet pa ndërhyrje)

Vlerësimi numerik (sasior) tregon ndikimin e projektit në mjedis në rastin kur parashikohet marrja e masave që zbutin ndikimin e projekteve në mjedis, domethënë në skenarin kur realizohen ndërhyrje mjedisore përmirësuese.

6.4.2. Vlerësimi i përputhshmërisë

Përputhshmëria e objektivave të Planit është vlerësuar duke i kombinuar ato me objektivat mjedisore. Gjatë vlerësimit të këtij treguesi janë ndjekur disa hapa të cilët janë shtjelluar më tej. Konvertimi pasqyrohet në tabelën e mëposhtme (Tabela 22).

- ☐ Konvertimi i vlerave numerike të ndikimit të projekteve në sistemin numerik konvencional të përputhshmërisë

Tabela 22. Konvertimi i pikëve të ndikimit të projektit në pikë përputhshmërie

Pikët e vlerësimit të ndikimit	Pikët e vlerësimit të përputhshmërisë
8.6 – 10 pikë	3
6.1 – 8.5 pike	2
3.1 – 6 pikë	1
0 pikë	0
0.1 – 3 pikë	-1

- ☐ Vlerësimi mesatar i përputhshmërisë së një projekti

Vlerësimi i përputhshmërisë kryhet duke u bazuar në vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve. Pikët e grumbulluara nga vlerësimi i 6 kriterëve të ndikimit për çdo OM, mbledhen dhe më tej pjesëtohen me numrin e OM-ve (që në rastin në fjalë është 12) me qëllim llogaritjen e vlerës mesatar të përputhshmërisë i cili jepet vetëm në rang projekti dhe ndihmon për të kuptuar shkallën që objektivat e një plani përputhen me objektivat mjedisore.

Përputhshmëria e Objektivave të Planit me Objektivat Mjedisore është shprehur në 5 nivele (Tabela 23). Çdo nivel përputhshmërie shprehet me vlerat numerike të caktuara në tabelën e mëposhtme dhe me nivel përputhshmërie cilësore.

Tabela 23. Përputhshmëria e shprehur në vlera numerike dhe vlerësimi përkatës

Pikët e vlerësimit të përputhshmërisë	Niveli i përputhshmërisë	Përshkrimi
2.50 – 3	Përputhen plotësisht	Objektivat/ programet/ projektet përputhen plotësisht me OM-të
1.50 – 2.49	Përputhen pjesërisht	Objektivat/ programet/ projektet përputhen pjesërisht me OM-të. Përputhja është e pjesshme edhe pse zbatohen masa mjedisore
0.01 – 1.49	Lidhja/ përputhshmëri, është e zbehtë	Përputhshmëri, është e dobët, edhe pse realizohen masat mjedisore. Kjo nënkupton që ndikimi neutralizohet pjesërisht ose minimalisht
0	Nuk ka lidhje (neutrale)	Objektivat, programet, projektet nuk tregojnë përputhje në pamje të parë, por njëkohësisht, nuk tregojnë as përplasje. Pra nuk nuk kanë ndikim negativ të ndërsjelltë e, veçanërisht, objektivat e Planit në objektivat e VSM-së.
Negativ	Nuk përputhen	Objektivat/ programet/ projektet nuk përputhen me OM-të janë në kundërshtim të plotë, pavarësisht masave zbatuese që mund të merren.

- ☐ Llogaritja e përputhshmërisë së Objektivave të projektit me objektivat mjedisore (secilin OM më vete)

Ky vlerësim arrihet nëpërmjet vlerësimit të përqindjes (%) së objektivave të planit që përputhet me objektivat mjedisore në nivel projektsh dhe nivelin e Objektivave të Planit. Në këtë mënyrë matim jo vetëm përputhshmërinë e çdo projekti me të gjitha objektivat njëherësh, por kuptojmë, për çdo projekt, se në cilat OM dhe në çfarë mase (e matur në % ndaj totalit prej 12 OM-ve) arrihet, ose cënohet përputhshmëria e lartë. Një shembull i këtij lloji vlerësimi është dhënë në tabelën e mëposhtme (Tabela 24).

Tabela 24. Shembull i vlerësimit të përputhshmërisë së OP-ve me OM-të

Bashkia Këlcyre: Përputhshmëria					
Objektivat Mjedisore	% e OM me PL/Projekt	% e OM me PP/projekt	% e OM me PZ/projekt	% e OM me PN/projekt	% e OM me PG/projekt
O1: Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale, si dhe turizmit	44,6%	45,8%	9,6%	0,0%	0,0%

Vlerësimi i përputhshmërisë me objektivat mjedisore (OM) të objektivës 1 (O.1) të PPV-së "Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale, si dhe turizmit" (Tabela 24), e cila përmbledh në vetëvetë një grup prej 28 projektsh rezultojnë se:

- ☐ 46.6% e të gjithë projekteve kanë përputhshmëri të lartë me OM, thënë ndryshe, në qoftë se ndiqen masat e nevojshme ndikimi në mjedis është i papërfillshëm.
- ☐ 45.8% e projekteve kanë përputhshmëri të pjesshme me OM të cilët me marrjen e masave të duhura do të kenë një ndikim shumë të ulët në mjedis.
- ☐ 9.6% e projekteve kanë përputhshmëri të zbehtë që edhe pasi të jenë marrë masat e nevojshme gjurma e ndikimit do të jetë e dukshme.

Vlen të përmendet që një projekt në këtë grup (projektet e O.1) nuk është pa përputhshmëri me objektivat mjedisore, pra këto projekte do të kenë një ndikim relativisht të ulët në mjedis.



VII. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË OBJEKTIVAVE TË PLANIT DHE PROJEKTEVE STRATEGJIKE ME OBJEKTIVAT MJEDISORË

7.1. PRIORITIZIMI I PROJEKTEVE PËR ZBATIMIN E PLANIT

Duke u njohur nga afër me situatën në terren dhe duke mbajtur parasysh informacionet e marra lidhur me nevojat prioritare të banorëve të bashkisë, nga konsultimet e hapura me komunitetin, grupi i ekspertëve ka orientuar dhe zbërthyer programe të strategjisë në projekte konkrete të mirë përcaktuara në Strategjinë Territoriale sipas prioriteteve. Këto projekte të evidentuara në hartat përkatëse janë detajuar në kapitujt në vijim të lidhura me kostimin, si dhe me Projekt Buxhetin Afatmesëm. Këto projekte strategjike ndahen në:

- ☐ Projekte në nivel politikash në të cilën përfshihen objektiva dhe orientime të rëndësishme strategjike, si në zhvillimin ekonomik, ashtu edhe në atë turistik.
- ☐ Projekte reale në terren, ku i jepet prioritet zhvillimit infrastrukturor (rrugë, ndriçimi rrugor, ujësjellës-kanalizime, telekomunikacion) zhvillimit të shërbimeve në funksion të komunitetit (rikonstruktim i shkollave, ndërtim i shesheve dhe parqeve, ndërtim i qendrave komunitare, etj.), si dhe aplikimi i rregullave arkitektonike dhe strukturore, si rehabilitimi i vendbanimeve, ndërtimi me një gjuhë arkitektonike dhe tradicionale, etj.

Në bazë të zbatimit të tyre në mënyrën e duhur, duke siguruar një zhvillim sa më të qëndrueshëm për bashkinë, këto projekte janë ndarë në tre faza zbatimi:



Faza e parë e zbatimit

Në fazën e parë të zbatimit janë listuar të gjitha projektet, të cilat janë të nevojshme për t'u realizuar në një afat kohor të afërt, duke u cilësuar si ndërhyrje të rëndësishme për komunitetin, të cilat shihen si nevojat më të domosdoshme për komunitetin. Në këtë fazë i është dhënë prioritet ndërhyrjeve të kategorizuara më poshtë dhe të detajuara në hartën e fazave të projekteve prioritare për bashkinë.

- ☐ Përmirësimi i strukturave në ndihmë të bujqësisë dhe blegtorisë (ngritja e një thetoreje, struktura magazinimi dhe përpunimi, serra);
- ☐ Strukturimi i ofrimit të shërbimeve turistike në zonë (ngritja e qendrave të informimit turistik dhe guidave turistike);
- ☐ Strukturimi dhe rigjallërimi i vendbanimeve duke plotësuar kërkesat e banorëve për shërbime dhe përmirësim të cilësisë së jetesës (kthimi i ambienteve të shkollave në qendra polifunkionale, rikonstruksion i qendrave shëndetësore, krijimi i qendrave të strukturuar të fshatrave, ngritja e tregut të produkteve bujqësore dhe blegtorale);
- ☐ Përmirësimi dhe rikonstruksioni i shërbimeve infrastrukturore (ndërtimi i akseve lidhës të fshatrave me njëri-tjetrin; ndërtimi i terminalit multimodal, përmirësimi i shërbimeve në furnizim me ujë, ndërtimi i rrjetit dhe impiantit të trajtimit të kanalizimeve, pastrime të kanaleve ujitës, rikonstruksion i stacionit elektrik, përmirësimi i ndriçimit publik dhe rrjetit të telekomunikacionit).

Faza e dytë e zbatimit

Në fazën e dytë të projekteve janë cilësuar projektet si në vijim:


- ☐ Përmirësimi i strukturave në ndihmë të bujqësisë dhe blegtorisë (ngritja e sipërfaqeve me vreshta; magazina dhe ruajtje e rrushit, ngritja e pikave dhe linjave të përpunimit);
- ☐ Strukturimi dhe rigjallërimi i vendbanimeve duke plotësuar kërkesat e banorëve për shërbime dhe përmirësim të cilësisë së jetesës (rikualifikim i fshatrave me interes për vizitorët, krijimi i tregut artizanal, ndërtimi i bashkisë, rikonstruksion i ambienteve sportive të shkollave në fshatra, krijimi i klasave profesionale, qendra sociale ditore);
- ☐ Përmirësimi dhe rikonstruksioni i shërbimeve infrastrukturore (ndërtimi i rrjetit të furnizim me ujë për të gjithë fshatrat malor, pastrimi i kanalit ujitës në zonat e fshatrave kodrinor dhe malor, ndërtimi i landfill rajonal).

Faza e tretë e zbatimit

Në fazën e tretë të projekteve përfshihen ndërtimi i stadiumit dhe strukturimi i muzeut për qytetin e Këlcyrës.

Gjithashtu, është e rëndësishme të përmendet që duke u bazuar në kohëzgjatjen e hartimit të projekteve, ato mund të zgjasin në disa faza siç janë projektet për ndërtimin e askeve rrugore, për ndriçimin e fshatrave, përmirësimi rrjetit të telekomunikacionit apo masat mbrojtëse mjedisore.

Të gjitha projektet prioritare dhe me shtrirjen e tyre në fazat përkatëse janë të paraqitura në figurën e mëposhtme (Figura 33).





ELIOT STUDIO AFTERNOON



7.2. VLERËSIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS NGA ZBATIMI I PLANIT

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Këlcyrë i cili është hartuar pas një vlerësimi të kujdesshëm të tipologjive hapsinore dhe ndërveprimeve ekzistuese propozon zhvillimin turistik duke patur mbështetje në mënyrë indirekte të bujqësisë. Tipologjitë e këtyre zonave janë kryesisht rurale por njëkohësisht mbartin dhe vlera të shumta natyrore, kulturore dhe peizazhiste. Qëllimi i këtij propozimi është nxjerrja në pah e këtyre vlerave, mbrojtjen dhe rigjenerimin e tyre duke investuar në struktura akomoduese, shërbime dhe infrastrukturë mbështetëse. Në këtë mënyrë këto zona do të jenë joshëse si për banorët vendas të cilët do të kenë hapësira punësimi, shërbime dhe infrastrukturë e domosdoshme ashtu edhe për vizitorët të cilët do të gjejnë atraksionet turistike natyrore e kulturore, shërbimet dhe akomodimin e dëshiruar. Një tjetër hallkë e këtij skenari do të jetë edhe bujqësia me mbështetjen e saj në drejtimin turistik duke furnizuar këto zona me produkte bujqësore e blegtorale cilësore. Por roli i saj nuk do të jetë vetëm mbështetës pasi përbën potencial për të prodhuar, përpunuar dhe tregëtuar këto produkte i cili është i rëndësishëm për tregun rajonal.

Projektet e parashikuara në Planin e Përgjithshëm Vendor për zhvillimin e territorit të Bashkisë Këlcyrë kanë synuar zhvillimin e përgjithshëm të tij dhe në veçanti arrijen e tre objektivave specifike (O.S-ve) që janë renditur më poshtë (Tabela 25):

Tabela 25. Objektivat dhe programet e Planit (Burimi: Bashkia Këlcyrë dhe Atelier4)

Objektivi strategjik/ Grupi i projekteve	Përshkrim i Objektivave të Planit
O.S. 1	Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale, si dhe turizmit
O.S. 2	Ristrukturimi dhe profilizimi i vendbanimeve
O.S. 3	Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit dhe peizazhit

Në seksionet në vijim, paraqitet vlerësimi i ndikimit në mjedis i çdo projekti të PPV-së. Vlerësimi i ndikimit në vetvete është kryer në nivel projekti, objektivi specifik (O.S.) dhe Plani. Për lehtësi vlerësimi, siç edhe u theksua më sipër, projektet janë grupuar sipas Objektivave të Planit (O.S.).

7.2.1. Vlerësimi i projekteve të O.S.1: Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale, si dhe turizmit

Ky objektivi përfshin 28 projekte që synojnë kryesisht zhvillimin e politikave nxitëse dhe mbështetjen infrastrukturale për rritjen e performancës së zonave bujqësore të bashkisë, rritjen e performancës së sektorëve ekonomikë në Bashkinë Këlcyrë (shërbime, bujqësi dhe tregti të produkteve bujqësore), nxitjen e procesit të zgjerimit dhe densifikimit për të gjithë qendrat e njësive administrative, si dhe për disa fshatra me potencial urbanizimi, etj.

Vlerësimi i ndikimit të projekteve të këtij Objektivi të parë të Planit paraqitet më poshtë (Tabela 26): Me qëllim thjeshtëzimin e të kuptuarit të rezultateve, për çdo objektivi mjedisor, shkalla e ndikimit të projektit është paraqitur me vlera numerike dhe me ngjyra.

Në bazë të vlerësimit të projekteve të O.S.1, nga projektet që kanë lidhje me këtë objektiv (te listuara më poshtë janë vetëm projektet e fazës së parë dhe një projekt i cili shtrihet në tre faza) rezultojnë se:

- ☐ Ndikimi në tokë është i ulët, me vetëm 1 projekt që ka ndikim mesatar, me 4 projekte që kanë të ulët, ndërkohë që të tjerët kanë ndikim shumë të ulët ose nuk kanë ndikim në faktorin tokë.
- ☐ Ndikimi i projekteve në ajër është i ulët. Nga 7 projekte, 6 prej tyre kanë ndikim të ulët ose të papërfillshëm dhe vetëm 1 projekt ka ndikim mesatar.
- ☐ Ndikimi në ujë është i ulët. Bëjnë përjashtim 3 projekte që nuk kanë ndikim në mjedis dhe 3 projekte të tjera që kanë ndikim mesatar.
- ☐ OM-ja në të cilën projektet do të kenë ndikim më të lartë, pra ndikim mesatar, janë mbetjet me 2 projekte që do të kenë ndikim mesatar dhe 5 të tjerë që kanë ndikim të ulët.
- ☐ Ndikimi më i ulët vihet re në faktorët klimë dhe socio-ekonomikë (popullsia dhe asetet materiale)

Si përfundim, në bazë të vlerësimit të 7 projekteve të O.1, rezultojnë se ndikim të ulët projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë në përbërësit e tokës, ajrit, ujit, ndërsa lexohet një ndikim mesatar në komponentët mbetje, ndotje akustike dhe peizazhit. Ndikimi i projekteve në klimë, trashëgiminë kulturore dhe aspektet socio-ekonomike është i papërfillshëm.

Tabela 26. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.S. 1: Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale, si dhe turizmit

Nr. Projektit	Objektivat Mjedisore	Bashkia Këlcyrë: Ndikimi									
		OM1 + OM2	OM3	OM4	OM5	OM6 + OM7	OM8	OM9	OM10	OM11	OM12
	Objektivat/Projektet e Programet e Planit	Toka	Ajri	Klima	Uji	Biodiv	Mbetij	Ndotja akustike	Popull + asetet	Trashëg Kultur	Peizazhi
O.S. 1: Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale, si dhe turizmit											
P.1	Ngritja e nje thertoreje	4,70	5,80	6,75	6,40	7,60	4,55	5,75	8,50	6,40	5,50
P.2	Ngritja e nje sere per prodhim Fidane perimore	7,10	6,30	6,20	6,45	6,95	6,70	7,00	7,95	7,55	7,65
P.3	Ngritja e nje pike magazinimi dhe tregimi per perimet	6,10	6,05	6,30	4,35	7,80	5,25	6,55	7,85	6,40	7,55
P.4	Krijimi i pikave panoramike turistike pergjate akseve mugore, bazuar ne kodin rugor dhe te pajisura me infrastrukture mbështetëse.	8,70	8,00	8,60	8,25	7,60	8,70	8,65	9,25	9,45	9,05
P.5	Ngritja e nje Strukture te Menaxhimit te Destinacionit (DMO) ne shkalle bashke.	7,75	8,65	8,60	8,40	8,70	7,70	7,25	8,55	8,70	9,10
P.6	Ngritja e qendrave te informimit turistik (te nderlidhura me DMO).	7,85	8,65	8,65	8,35	8,70	7,70	7,30	8,55	8,98	8,90
P.1+P.2+P.3+P.4+P.5+P.6	Identifikimi i shqigjeve natyrore ne terren, krijimi i hartave dhe pajisja e tyre me sinjalistike	8,70	8,00	7,95	8,25	8,70	7,70	7,00	8,10	7,55	8,65

Projekt i fazës së parë.

Projekt i fazës së parë, të dytë dhe të tretë.

P.1

P.1+P.2+P.3+P.4+P.5+P.6





7.2.2. Vlerësimi i projekteve të O.S.2: Ristrukturimi dhe profilizimi i vendbanimeve si dhe turizmit

Qyteti i Këlcyrës dhe fshatrat e territorit të bashkisë, bazuar në vendndodhjen e tyre në territor kanë karakteristika të ndryshme, cka sjell edhe ndryshime në drejtimet e zhvillimeve bujqësore apo blegtorale pranë tyre.

Është e rëndësishme që kushtet e këtyre vendbanimeve të përmirësohen, duke i sistemuar këto struktura dhe vendosur rregulla specifike bazuar në zonën ku gjenden. Qyteti - me rëndësi të fuqizohet dhe përmirësohen kushtet e vendbanimeve dhe shërbimeve duke i strukturuar vendbanimet, zhvilluar infrastrukturën e transportit rrugor dhe sigurimin e lëvizshmërisë për të gjithë qytetarët. Fshatrat - zona të mirëfillta rurale ku nxitet projektimi i hapësirave publike dhe objekteve bazuar në elemente të traditës për të theksuar karakterin dhe për t'u orientuar drejt një turizmi rural e agri turizmi. Në fshatra do të aplikohen programe mbështetëse për të nxitur rimëkëmbjen e ekonomisë. Lidhjet infrastrukturore ekzistuese do të përmirësohen dhe do të krijohen të reja, në shërbim të zhvillimit ku orientohen.

Ky seksion përfshin 6 projekte që synojnë zhvillimi i infrastrukturës për profilizimin e vendbanimeve, rikonstruksionin e rrugëve me vlera historiko-kulturore, zhvillimin dhe nxitjen e turizmit nëpërmjet rindërtimit/rehabilitimit të qendres së fshatrave, etj.

Vlerësimi i ndikimit të projekteve të këtij Objektivit të dytë të Planit paraqitet më poshtë (Tabela 27). Siç u veprua më sipër, për çdo objektiv mjedisor, shkalla e ndikimit të projektit është paraqitur me vlera numerike dhe me ngjyra.

Sipas vlerësimit të 6 projekteve në lidhje me O.S. 2 rezultojnë se:

- ☐ Ndikimi i projekteve në gjenerimin e mbetjeve është mesatarisht i ulët. Nga 6 projekte, 4-projekte kanë ndikim mesatar ndërsa 2 projekte të tjera kanë ndikim të ulët. Përsëritet situata e ngjashme dhe tek vlerësimi i ndikimit në ndotjen akustike.
- ☐ Ndikimi në tokë është po ashtu relativisht i ulët. Nga 6 projekte, 3-projekte kanë ndikim mesatar ndërsa 3 projekte të tjera kanë ndikim të ulët deri pothuajse te paperfillshëm.
- ☐ Ndikimi shfaqet i papërfillshëm deri pozitiv në trashëgimime kulturore, peizazh, faktorët klimatikë dhe socio-ekonomikë (popullsia dhe asetet materiale).

Si përfundim, në bazë të vlerësimit të 6 projekteve të O.2, rezultojnë se ndikim të ulët projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë në përbërësit e ajrit, biodiversitetit dhe peizazhit ndërsa lexohet një ndikim mesatar në mbetet që mund të gjenerohen dhe zhurmat.




Tabela 27. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.S.2: Ristrukturimi dhe profilizimi i vendbanimeve si dhe turizmit.

Bashkia Këlcyrë: Ndikimi												
	Objektivat Mjedisore	OM1 + OM2	OM3	OM4	OM5	OM6 + OM7	OM8	OM9	OM10	OM11	OM12	
	Objektivat/Projektet e Programet e Planit	Toka	Ajri	Klima	Uji	Biodiv	Mbetj	Ndodja akustike	Popull. + asetet	Trashëg. Kultur	Peizazhi	
Nr. Projektit	O.S. 2: Ristrukturimi dhe profilizimi i vendbanimeve si dhe turizmit											
P.7	Ndërtimi i banesave sociale	4,65	5,20	8,30	4,35	5,80	4,55	5,85	9,30	6,30		7,65
P.8	Ndërtimi i tregut të frutave dhe perimeve në qytetin e Këlcyrës	5,30	6,05	8,20	5,05	6,80	4,30	4,55	9,40	6,25		6,75
P.9	Krijimi i qendrës së informimit për territorin e luginës së Vjosës	6,10	7,30	8,20	7,45	7,95	7,05	6,10	8,75	8,55		7,75
P.10	Rikualifikimi i sheshit pranë lapidarit të fshatit	5,10	6,05	8,20	6,45	7,95	5,35	5,25	8,85	8,60		8,60
P.11	Transformimi i shkollave në qendra polifunksionale me bibliotekë, laboratore, etj.	6,10	6,05	8,20	6,45	7,95	5,35	5,25	8,85	7,40		7,65
P.12	Rikonstrukcioni i qendrës shëndetësore	6,10	6,05	6,30	4,35	7,80	5,25	6,05	7,85	6,40		7,55

Projekt i fazës së parë.



4

STUDIU ARHITEKTURIC

7.2.3. Vlerësimi i projekteve të O.S.3: Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit e peizazhit

Vlerësimi i ndikimit të projekteve të këtij Objektivit të tretë të Planit paraqitet më poshtë (Tabela 28). Me qëllim thjeshtëzimin e të kuptuarit të rezultateve, për çdo objektiv mjedisor, shkalla e ndikimit të projektit është paraqitur me vlera numerike dhe me ngjyra.

Ky seksion përfshin 16 projekte te fazës së parë, 3 projekte të cilët do zhvillohen përgjate fazës së parë dhe të dytë dhe 3 projekte që shtrihen përgjatë 3 fazave. Projektet synojnë zhvillimin e infrastrukturës, rikonstruksionin e rrugëve me vlera historiko-kulturore, zhvillimin ekonomik të zonave dhe riparimin e dëmeve mjedisore, etj. Sipas vlerësimit të 22 projekteve në lidhje me O.3 rezultojnë se:

- ☐ Ndikimi kryesor i këtyre projekteve është në tokë. Nga 22 projekte, 8 prej tyre kanë ndikim mesatar në tokë, ndikimi i 10 projekteve është i ulët ndërsa 4 prej tyre kanë ndikim të papërfillshëm.
- ☐ Përsa i përket ndikimeve në ajër, zhurma dhe biodiversitet, ndikimi është mesatar nga 6 projekte, është i ulët nga 8-10 prej tyre ndërsa 4-6 te tjere kanë ndikim të papërfillshëm.
- ☐ Nga 22 projekte përbërës të këtij objektivit, 3 projekte kanë ndikim të papërfillshëm ose pozitiv në të gjithë komponentët (objektivat) mjedisorë, 1 ka ndikim të papërfillshëm në 10 prej tyre dhe të ulët në dy komponentë.
- ☐ Ndikimi shfaqet i papërfillshëm ose tejet pozitiv në komponentin socio-ekonomik (popullsia dhe asetet materiale).




Tabela 28. Vlerësimi i ndikimit në mjedis të O.S.3: Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit e peizazhit.

Bashkia Këlcyre: Ndikimi											
Nr. Projektit	Objektivat Mjedisore	OM1 + OM2	OM3	OM4	OM5	OM6 + OM7	OM8	OM9	OM10	OM11	OM12
		Objektivat/Projektet e Programet e Planit	Toka	Ajri	Klima	Uji	Biodiv	Mbetij	Ndodja akustike	Popull. + asetet	Trasheg. Kultur
O.S. 3 : Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit e peizazhit											
P13	Indërtimi i aksit Këlcyre - Katundishtë	4,65	4,75	8,20	5,05	4,85	4,85	5,35	9,35	8,10	5,35
P14	Indërtimi i aksit Grabovë - Malëshovë	4,65	4,75	8,20	5,05	4,85	4,85	5,35	9,35	8,10	5,35
P15	Indërtimi i Terminalit Multimodal	7,10	5,30	6,20	6,45	5,95	5,05	5,00	8,75	7,40	5,75
P16	Rrjeti i brendshëm i furnizimit me ujë për qytetin e Këlcyres	6,10	6,05	6,30	9,15	7,80	6,70	7,00	8,85	6,40	7,25
P17	Zgjerimi i zonës së shërbimit në Rrjetin e furnizimit me ujë për qytetin e Këlcyres	6,10	6,30	6,20	8,55	6,95	6,70	7,00	9,95	7,55	7,65
P18	Indërtimi i impiantit të trajtimit	5,10	8,85	6,30	8,55	7,80	8,55	7,85	9,15	6,40	6,65
P19	Indërtimi i rrjetit të trajtimit të kanalizimeve	6,85	8,85	7,85	8,45	7,75	8,45	6,50	9,05	8,00	7,95
P20	Rrjeti i furnizimit me ujë për fshatrat	5,10	8,30	6,20	6,45	8,05	8,50	8,05	8,90	7,65	7,60
P21	Indërtimi i rrjetit të kanalizimeve	6,85	8,85	7,85	8,45	7,75	8,45	6,50	9,05	7,65	7,60
P22	Pastrimi i kanalit ujëtar të parë, të dytë dhe të tretë në fshatrat pranë qytetit të Këlcyres	8,10	8,30	7,15	8,65	8,55	7,50	8,05	8,99	7,65	7,60
P23	Rikonstruksion i nënstacionit të Këlcyres Zhvendësimi transformatorit ekzistues me një të ri me nivele tensioni 110/20/10 KV	7,25	8,30	6,20	8,00	8,00	7,50	8,05	9,05	7,65	7,60
P24	Rikonstruksion i fidentit Këlcyre. Ndërtimi i nivelit të tensionit nga 10 KV në 20 KV	7,15	8,30	8,20	8,00	8,00	7,50	8,05	9,15	7,65	7,60
P25	Ndërtimi i të gjitha rrugëve brenda qytetit të Këlcyres	7,95	8,30	8,20	8,20	8,00	7,50	8,55	9,05	7,65	8,60





AKTERE STUDIO ARKITEKTURE



P.26	Ndërtimi i rrugëve hyrëse dhe dalje në qytetin e Këlcyres	7.95	8.30	8.20	8.20	8.00	7.50	8.55	9.05	7.65	8.60
P.27	Shtimi i fibrës optike në të gjitha zonat e populluara të qytetit	7.40	8.30	6.20	8.00	8.00	7.50	8.05	9.35	7.65	7.60
P.28	Shpallja e Parkut Kombëtar të Vjosës - Parku i parë i një lumi të egër (i padëmtuar) Europian - duke përfshirë lumin për gjatë gjithë gjatësisë së tij nga malet deri në grykëderdhjen e tij në Adriatik. Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Parkut	8.95	9.40	9.35	9.35	9.55	9.50	9.00	9.50	9.05	9.60
P.29	Ndërtimi i Unazës Jugore	4.65	4.75	8.20	8.20	4.85	4.85	5.35	9.35	6.10	6.35
P.30	Ndërtimi i aksit Ballaban - Gorovode	5.10	6.05	8.20	8.20	7.75	5.85	5.85	9.55	8.25	5.85
P.31	Ndërtimi i aksit Ballaban - Berat	5.10	6.05	8.20	8.20	7.75	5.85	5.85	9.55	8.25	5.85
P.32	Sisteme malore (ndërtim pritash)	8.60	8.65	8.70	8.75	8.80	8.80	7.85	8.65	8.85	6.20
P.33	Pëllëzime me akacie për mbrojtjen e tokës nga rreshqitjet dhe erozioni	8.60	8.65	8.70	8.75	8.80	8.80	8.85	9.05	9.05	9.45
P.34	Pëllëzime në ish kanirat e qurorëve	8.60	8.65	8.70	8.75	8.80	8.80	8.85	9.05	9.05	9.45

P.1

Projekt i fazës së parë.

P.1.1

Projekt i fazës së parë dhe të dytë.

P.1.1.1

Projekt i fazës së parë, dytë dhe të tretë.



7.3. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË PROPOZIMEVE TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR

Objektivat e përcaktuara mjedisore duhet të jenë në përputhje me Ligjin Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", objektivat e përcaktuara në SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE. Për të vlerësuar politikat dhe projektet që parashikon Plani për të arritur objektivat e tij dhe për të përcaktuar rëndësinë e objektivave mjedisore, duhet të vlerësohet përputhshmëria e objektivave dhe politikave të Planit me objektivat e përcaktuara mjedisore.

Përputhshmëria është tregues i shkallës së përshatshmërisë së objektivave të Planit me objektivat mjedisorë që mund të ndikohen gjatë fazës së zbatimit të projekteve dhe në një periudhë afatgjatë. Siç është shpjeguar në seksionet e mësipërme, vlerësimi numerik i nivelit të përputhshmërisë është bazuar në vlerat numerike të nxjerra nga vlerësimi i ndikimit të projekteve në mjedis. Vlerësimi i përputhshmërisë është bërë njëkohësisht edhe duke përdorur përafrimin standard në formë matrice.

Vlerësimi i përputhshmërisë ofron mundësinë për të evidentuar konflikte apo veprime të ndërsjellta mes objektivave dhe politikave të ndryshme, si dhe konflikte të theksuara interesi mes objektivave. Të gjitha këto duhen vënë në dukje veçanërisht në pjesën e Vlerësimit të projekteve specifike të Planit.

Më poshtë paraqitet vlerësimi i përputhshmërisë së projekteve të planit me objektivat mjedisorë (Tabela 29). Treguesi i përputhshmërisë mundëson të vlerësojmë jo vetëm përputhshmërinë e çdo projekti me të gjitha objektivat njëherësh, por edhe kuptojmë, për çdo projekt, se në cilat Objektiva Mjedisorë dhe në çfarë mase (e shprehur në % ndaj totalit prej 12 OM-ve) arrihet, ose cënohet përputhshmëria maksimale.

Përputhshmëria e politikave të Planit është vlerësuar duke i kombinuar këto politika me objektivat mjedisore të kësaj VSM-je. Vlerësimi është bërë duke përdorur përafrimin standard në forme matrice. Për të kryer Vlerësimin numerik të nivelit të përputhshmërisë është përdorur Vlerësimi që jepet në tabelën më lart.

Rezultatet e Vlerësimit të përputhshmërisë së politikave dhe programit të Planit me objektivat mjedisore janë paraqitur në tabelën më poshtë. Tabela tregon se, në parim, të gjitha politikat e Planit janë në përputhje me objektivat mjedisore.






Tabela 29. Përputhshmëria e objektivave mjedisore me Objektivat e Planit

Objektivat Mjedisore	OM 1	OM 2	OM 3	OM 4	OM 5	OM 6	OM 7	OM 8	OM 9	OM 10	OM 11	OM 12	Vlerësimi mesatar	
Objektivat e Programeve te Planit	Toka			Ajri	Klima	Uji	Biodiversiteti		Mbetje	Ndodja e akustike	Popullsi + asetet	Trashëgimia kulturore	Pelazhi	
O.S.1: Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale dhe turizmit														
O1.P1: Zhvillimi i filierës së vreshtarisë	2	3	3	3	3	3	2	2	2	1	3	1	3	2.50
O1.P2: Zhvillimi i filierës së perimeve	2	3	3	3	3	3	2	2	2	1	3	1	3	2.50
O1.P3: Zhvillimi i blegtorisë dhe produkteve blegtorale	2	3	2	3	3	2	2	2	2	2	3	1	2	2.50
O1.P4: Zhvillimi i bimeve medicinale	2	3	3	3	3	2	2	2	2	1	3	1	3	2.50
O1.P5: Evidentimi i potencialit turistik	0	0	0	0	1	2	2	2	1	0	3	1	3	1.08
O1.P6: Marketimi (promovimi) i vlerave, traditave dhe produkteve (brand lokal)	0	0	1	0	1	1	3	1	0	3	3	0	0	1.08
O.S.2: Ristrukturimi dhe profilizimi i vendbanimeve														
O2.P1. Sistemimi i qendrave të vend-banimeve	3	3	3	3	3	1	1	3	3	3	3	3	3	2.67
O2.P2. Struktura dhe shërbime administrative cilësore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	2	0	0	0.42
O2.P3. Struktura dhe shërbime në funksion të arsimit, kulturës, sportit	0	0	0	0	0	0	0	0	1	3	3	0	0	0.58

O2.P4. Struktura dhe shërbime në funksion të shëndetësisë dhe përkrahjes sociale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	3	3	0	0.58
O2.P5. Rritja e kapaciteteve njerëzore	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	3	3	0	0.67
O.3. Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit e peizazhit																
O3.P1. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore	2	3	3	3	3	1	0	0	2	3	3	1	3	3	3	2.00
O3.P2. Sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimi i ujërave të ndotura	0	2	3	2	3	0	0	0	2	2	3	0	3	3	3	1.66
O3.P3. Sistemet e ujit për bujqësi, bletëtori	2	2	2	1	3	0	2	2	2	2	2	3	1	3	1	1.82
O3.P4. Furnizimi me energji elektrike dhe burime alternative energjie	0	0	3	3	2	0	0	0	0	0	3	0	0	3	0	0.92
O3.P5. Ndërcimi publik	0	0	3	3	0	0	0	0	0	0	3	0	1	3	0	0.83
O3.P6. Përmirësimi i shërbimeve të telekomunikacionit	0	0	2	3	0	0	0	0	0	0	3	0	1	3	0	0.75
O3.P7. Trajtimi i mbetjeve urbane	1	3	3	3	3	0	0	3	1	3	3	0	3	3	3	1.92
O3.P8. Infrastruktura e mbrojtjes mjedisore	3	3	2	3	3	2	3	3	2	2	3	1	3	3	3	2.50
O3.P9. Minimizimi i impakteve negative në mjedis	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	3	3	2	2.88

Në përgjithësi, në këndvështrimin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore, objektivat dhe politikat e Planit, janë si me poshtë:

- ☐ objektivat përputhen plotësisht (7 objektiva)
- ☐ objektivat përputhen pjesërisht (4 objektiva)
- ☐ lidhja mes objektivave është e zbehte (9 objektiva)

Në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një riverifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore. Konkreisht:

- ☐ Secila prej objektivave të Planit është në përputhshmëri të plotë me të paktën 1 objektiv mjedisor;
- ☐ Secila prej objektivave të Planit (përveç 1 objektivi "Sruktura dhe shërbime administrative cilësore") është në përputhshmëri të plotë me të paktën 2 objektiva mjedisore
- ☐ Gjashtë objektiva të planit janë në përputhshmëri të plotë me të paktën gjysmen (6) objektiva mjedisore
- ☐ Pesë objektiva të planit kanë një lidhje të pjesshme me të paktën një objektiv mjedisor;
- ☐ Gjashtë objektiva të planit kanë një lidhje të zbehte ose nuk kanë lidhje me të paktën 1 objektiv mjedisor;

Edhe në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore diversifikimi i përputhshmërisë është i lartë. Sidoqoftë, objektivi mjedisor OM 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme, është objektivi me nivelin me të lartë të përputhshmërisë me objektivat mjedisore.



VIII. VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE

8.1. VLERËSIMI I PASOJAVE NGA ZBATIMI I PLANIT DHE NDIKIMI TYRE NË REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE MJEDISORE TË PLANIT

8.1.1. Toka

Objekti Mjedisor 1: Mbrojtja e formave të relievit, proceseve dhe sistemeve natyrore

Format e ndryshme të relievit janë karakteristika natyrore të çdo peizazhi dhe që mund të jenë luginat, rrafshinat, malet, fushat, kodrat dhe akullnajat. Këto karakteristika fizike e bëjnë planetin tonë një vend më të mirë. Mbrojtja e tyre është përgjegjësia jonë, por me ndryshimin e klimës dhe sasinë e dëmeve të bëra nga njerëzit, këto formacione nuk janë të njëjta me ato që kanë qenë.

Midis formave natyrore të tokës, shpatet e pjerrëta janë gjithmonë të rrezikuara për shkak të forcave erozive. Pavarësisht nëse është një shpat që është formuar kohët e fundit ose është natyrisht atje, të gjithë kanë nevojë për mbrojtje nga erozioni. Qëllimi duhet të jetë rritja e rezistencës së tokës ndaj erozionit dhe shpati të bëhet më i qëndrueshëm.

Mbrojtja e brigjeve të lumenjve. Brigjet e lumenjve (riverbanks) janë të rëndësishme për ekosistemin pasi mbështesin një shumëllojshmëri kafshësh. Erozioni natyror i lumenjve është pjesë e natyrës, por njerëzit e kanë përshpejtuar procesin duke e rritur atë në një nivel të panatyrshëm. Një mënyrë e mirë për të mbrojtur brigjet e lumenjve është që në këto brigje të gjendet bimësi e mjaftueshme. Barërat, mbulesa vegjetative tokësore, shkurret dhe drurët e mbrojnë tokën nga gërryerja.

Ndikimi më i madh gjatë fazës së ndërtimit pritet në zhvillimet e infrastrukturës, sidomos asaj rrugore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj., ndërkohe që nga fusha të tjera do të jenë të kufizuara në një territor më të ngushtë lokal.

Objekti Mjedisor 2: Mbrojtja, menaxhimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i tokës

Ndikimi më i madh gjatë fazës së zbatimit të PPV-së pritet nga zhvillimet në infrastrukturë, sidomos asaj rrugore, të mbetjeve, të qendrave të shërbimeve, etj., ndërkohe që nga fusha të tjera do të jenë të kufizuara në një territor më të ngushtë lokal. Nuk priten ndikime në ato sektorë ose nën sektorë ku përqendrimi më i madh i aktiviteteve do të ketë të bëjë me plotësimin e boshllëqeve ligjore dhe të strukturës (aktivitete soft) ku gjithë detyrat dhe angazhimet do të jenë të natyrës institucionale dhe organizative.

Përmes zënies së tokës, ndërtimet infrastrukturore prodhojnë ndikime të pakthyeshme, që reflektohen më pas si ndryshime në përdorimin e tokës. Toka bujqësore dhe pyjet do të pësonin shkatërrim të pakthyeshëm në pjesët e zëna nga ndërtimet e reja ose ato të rindërtuara mbi





seksionet e vjetra. Shpesh ndërtimet e reja krijojnë edhe fragmentime të tokës bujqësore. Ndikimet afatshkurtër (të riparueshme) që mund të ndodhin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë lidhjet përmes tokave bujqësore ose pyjore, dëmtimet ose zëniet e tokave ose dëmtimin e produkteve për shkak të afërsisë me sheshet e ndërtimit, ndotjet e tokës etj.

Për shkak të zhvillimeve të reja në infrastrukturë dhe vendosjes së tyre, përdorimi ekzistues i tokës bujqësore pëson ndryshim nga ana e pozicionimit të lidhjeve të reja infrastrukturore. Masat që zbatohen mund të sjellin rënien e përhershme të potencialit dhe prodhimtarisë së tokës bujqësore që nënkupton humbjen e përhershme të funksionimit të tokës për prodhimtarinë bujqësore. Nëse ndërtimet në infrastrukturë shtrihen edhe përtej territoreve aktuale të zhvillimit, fragmentimi i tokës bujqësore do të rritet dhe kushtet për prodhimtarinë bujqësore do të përkeqësohen edhe më tej.

Sipas PPK, Kelcyra hyn në grupin e qendrave terciare urbane. Ajo duhet të promovojnë vlerat arkitektonike, monumentale, tradicionale e natyrore të lokaliteteve.

Për të realizuar këtë objektiv është e nevojshme të merren në konsideratë dhe të zbatohen udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse të paraqitura në Seksionin 9.

8.1.2. Ajri

Objekti Mjedisor 3: Ulja e nivelit të konsumit të energjisë dhe arritja e objektivave afatgjata për sasi të vjetore të shkarkimeve të ndotësve, në përputhje me vlerat e lejuara nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

Shkarkimet e ndotësve janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit të infrastrukturës dhe atë të operimit në një sërë aktivitetesh nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, por në lidhje direkte me Planin ndikimi kryesor vjen nga sektori I transportit dhe konsumi i energjisë për djegie.

Gjatë fazës së ndërtimit ose të rindërtimit të infrastrukturës, shkarkimi i ndotësve krijon impakt afatshkurtër në mjedis, kështu që shumica e efekteve të tyre janë të kthyeshme.

Gjatë fazës së operimit të infrastrukturës, shumica e shkarkimeve janë të pranishme si në ajër edhe në ujë e tokë, në varësi të proceseve të aktiviteteve që krijohen nga operimi i infrastrukturës përkatëse.

Zbatimi i masave specifike që synojnë arritjen e qëllimeve të Planit pritet të kenë një impakt pozitiv për shkak të pakësimit të shkarkimeve të ndotësve, së pari për shkak të masave të parashikuara lidhur me sistemet e transportit. Masa të tjera nga sektorët që emetojnë shkarkime të ndotësve në ajër priten gjithashtu të kontribuojnë me efekte pozitive për shkak të pakësimit të ndotësve të shkarkuar nga djegia e drurëve për ngrohje, si edhe kontrollit të shkarkimeve në ajër nga industria agro-ushqimore dhe promovimit të mëtejshëm të energjive të gjelbra.

Megjithatë, ekziston edhe rreziku që përmirësimi i mëtejshëm i rrjetit rrugor do të prodhojë të ashtuquajturin "kërkesë e detyruar" për shkak të pakësimit të ngjeshjes, i cili nga ana tjetër mund të rrisë sasinë e shkarkimeve të ndotësve, veçanërisht në zona ku nuk kishte ndotje para së të zbatoheshin masat e Planit. Gjithsesi, impaktet negative me përmirësimin e rrjetit rrugor mund të



pakësohen dhe madje të parandalohen përmes marrjes njëkohësisht të masave të përgjithshme për promovimin e përdorimit të rrjetit publik të transportit të pasagjereve dhe biçikletave.

Sfidat kryesore dhe prioritetet të prezantuara në SKZHI II që pasqyrohen edhe në Plan janë: (1) kompletimi i adoptimit dhe zbatimit të standardeve Europiane mbi cilësinë e ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër; (2) konsolidimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit sipas standardeve Europiane; dhe (3) adoptimi i zbatimit i planeve të veprimit mbi cilësinë e ajrit si në nivel Qendror dhe atë lokal.

Duke konsideruar që sektori i transportit prodhon sasira të konsiderueshme shkarkimesh të ndotësve të ajrit brenda sasisë së lejuar tavan të shkarkimeve në ajër të përcaktuara/syruara për Shqipërinë, mund të ishte me e përshtatshme të supozohej për vlera më të ulta të përcaktuara/syruara për shkarkimin total të ndotësve në Shqipëri në mënyrë që të pakësohen shkarkimet e ndotësve nga transporti.

Objektivi strategjik është arritja e përmirësimeve të matshme në 2020 për cilësinë e ajrit përmes:

- ✚ Objektivi prej 40% pakësim në nivelin e ndotësve në zonat urbane;
- ✚ Arritja e niveleve objektiv të ndotësve të ajrit duke u bazuar në shëndetin human, sipas vlerave respektive: për NOX - 40 μm^3 , për PM10 - 40 μm^3 , për PM2.5 - 25 g/m^3 dhe SO2 - 125 μm^3 .

Vlerat limit të shkarkimit për NOx dhe PM2.5 që janë ndotësit kryesorë prej transportit rrugor janë përcaktuar në bazë të pakësimit indikativ në shkarkimet ndotëse.


Rinovimi i mjeteve motorike kontribuon së tepërmi në pakësimin e shkarkuesve ndotës, si edhe zhvillimi i standardeve sipas tipologjisë së aprovuar për mjetet respektive siguron arritjen e vlerave të syruara për shumicën e shkarkimeve të ndotësve nga transporti. Masat për promovimin e transportit publik të pasagjereve kontribuojnë gjithashtu në pakësimin e shkarkimit të ndotësve.

Plani nuk mund të adresojë specifikisht promovimin e rinovimit të mjeteve, por me anë të të gjitha masave/veprimeve, veçanërisht atyre që promovojnë transportin publik të pasagjereve, pritet të ketë ndikim pozitiv në mjedis duke kontribuar në arritjen e synimeve për nivelin e emetimeve në rang kombëtar.

Përsa i takon emetimeve të grimcave pezull në ajër, ato do të pësojnë rritje të përkohshme në zonat ku do të zbatohen masat e rindërtimit të infrastrukturës sipas sektorëve (impakte të kthyeshme). Në përputhje me rregullat që rregullojnë masat për pakësimin e shkarkimeve të grimcave nga sheshet e ndërtimit, zbatimi i punimeve në ndërtim garanton që rritjet e përkohshme lokale të ndotësve të mjedisit në ajër të jenë ende të pranueshme për mjedisin dhe njerëzit.

Transporti është burimi kryesor ndotës i ajrit përmes grimcave pezull. Grimcat mund të japin një sërë impaktesh negative mbi shëndetin: ato shkaktojnë dhe rendojnë astmat, krijojnë arterosklerozë, përkeqësojnë përvijimin e sëmundjeve të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare, shkaktojnë kancer, etj. Raporti i mortalitetit në zonat ku ndotja me grimca pezull është i lartë, është 15 – 20 % më i lartë në krahasim me zonat me ajër relativisht të pastër.

Pritet që nga zbatimi i masave të Planit shkarkimet e grimcave nga transporti rrugor të ulen në mënyrë permanente, së pari për shkak të eliminimit të bllokimeve të trafikut, menaxhimit më të mirë të shtresave sipërfaqësore të rrugëve dhe përdorimit të më shumë mjeteve rrugore me efience



energjie. Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 9 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

8.1.3. Faktorët klimatike

Objektivi Mjedisor 4: Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara.

Republika e Shqipërisë miratoi dokumentin e INDC me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 762, datë 16.09.2015 dhe e paraqiti atë në Sekretariatit e UNFCCC më 24 shtator 2015. Shqipëria gjithashtu nënshkroi Marrëveshjen e Parisit më 22 prill 2016. INDC i Shqipërisë është një objektiv i skenarit bazë; vendi angazhohet për reduktimin e emetimeve të CO₂ me 11.5% në krahasim me skenarin bazë për periudhën 2016-2030. Kjo ulje është e barabartë me një reduktim të emetimeve të CO₂ prej 708 Gg deri në vitin 2030. Trajektorja e emetimeve për Shqipërinë tregon një tendencë të butë për arritjen e 2 ton emetimeve të GHG për banori deri në vitin 2050, e cila mund të përdoret si një objektiv për tkurrjen globale dhe konvergjencën e emetimeve të gazrave serrë.

- ☐ Një sërë aktivitetesh ndërtimore të infrastrukturës dhe praktika sektoriale kanë impakt permanent (të kthyeshëm) mbi shkarkimet e gazeve serë (GHG), që janë ndër faktorët kryesor të ndryshimeve klimatike. Kjo për shkakun që karburantet fosile (nafta dhe derivatet) çlirojnë GHG në ajër gjatë përdorimit dhe përfaqësojnë në këto momente burimin më të rëndësishëm të energjisë në sektorin e transportit. Në këtë mënyrë sot ky sektor përbën burimin kryesor të emetimeve të gazeve serë në Shqipëri. Një tjetër pasojë e ndryshimeve klimatike janë ndryshimet në modelimet e fenomeneve mesatare klimatike dhe ngjarjet më të shpeshta të kushteve ekstreme të motit (thatësira, përmytje, erozione, stuhi me breshër, vale të nxehta, temperatura të ulëta me ngrica, etj.).

Shqipëria ende nuk ka bërë transpozimin e këtij vendimi, që planifikohet të ndodhe në 2018. Kjo periudhë është brenda kohës së zbatimit të Planit, prandaj parashikimet e këtij vendimi në lidhje me faktorët klimatike duhet të adresohen në avance. Për më tepër, SKZHI II vendos synimin për shkarkimet e gazeve serë në 2020 si vijon:

- ☐ Një reduktim prej 8% të GHG siç krahasohet me skenarin baze dhe
- ☐ Një reduktim prej 40% në sasinë e HCFC-s (hidroklorofluorokarbon).

Shkarkimet e gazeve serë nga sektorë të tilla si transporti rrugor, bujqësia, energjia, etj., përfaqësojnë një rrezik të konsiderueshëm për masat zbutëse të ndryshimeve klimatike. Në vijim veç shkarkimeve të përkohshme të gazeve serë gjatë fazës së ndërtimit të veprave infrastrukturore të parashikuara në Plan, shkarkimet e gazeve serë priten të rriten edhe pse do të merren masa për të eliminuar mjaft pengesa. Zbatimi i masave specifike duhet të garantojnë përdorim më të madh të transportit publik, teknologjive të reja bujqësore për kultivimin dhe vaditjen, energjisë së rinovueshme, etj. Promovimi i këtyre masave dhe përdorimi i mjeteve të reja të energjisë eficiente do të kontribuojë në parandalimin e shkarkimeve nga sektorët kontribues në GHG në fazën afatmesme dhe ndoshta një rënie pas 2020.

Transporti ngelet sektori kyç në arritjen e objektivave kombëtare mbi masat për ndryshimet klimatike i vijuar nga sektori bujqësor dhe përdorimi i tokës. Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 9 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

8.1.4. Uji


Objekti Mjedisor 5: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit ujor, duke përfshirë lumenjtë dhe burimet e ujit të pijshëm.

Impaktet më të mëdha për arritjen e këtij objekti mjedisor pritet nga zhvillimet e sektorëve kyç të lidhur me ujin si edhe ato që mund të ndikojnë në cilësinë dhe funksionimin natyror të baseneve ujore (ujësjellës/kanalizimet, vaditja dhe bujqësia e blegtoria në përgjithësi, industria ushqimore dhe përpunuese, shërbimet dhe turizmi, shëndetësia, etj.).

Impaktet mbi ujërat sipërfaqësore, nëntokësore, dhe burimet e ujit të pijshëm janë karakteristike të periudhës së ndërtimeve ose rindërtimeve të infrastrukturës dhe gjithashtu në vijim të operimit të strukturave. Kjo në varësi të sektorëve përkatës dhe sipas nevojës për përdorimin e ujit ose ndërveprimet me burimet dhe trupat natyrore ujore. Në shumicën e rasteve këto impakte janë të limituara në mjedisin lokal, megjithatë në disa raste ndodh efekti kumulativ i impaktit dhe krijohen ngarkesa të mëdha ndotëse që ngrihen në nivel rajonal dhe disa herë edhe ndërkufitar përtej kufijve. Impaktet ndërtimore të infrastrukturës ngelen në përgjithësi afat- shkurtër dhe të rikthyeshme (rasti p.sh. i cilësisë së ujërave). Pas fazës ndërtimore, impaktet janë kryesisht më pak të përhapura, por të pakthyeshme permanente (rasti p.sh. i impaktit të morfologjisë së vijës ujore natyrore, kushteve hidrologjike, ruajtja e zonave). Impaktet e mësipërme mund të prodhojnë ndryshime në elementet cilësore për krijimin e statusit ekologjik të ujërave sipërfaqësore, që janë elementet biologjik, hidromorfologjik, mbështetës, kimik dhe fiziko-kimik dhe në statusin kimik të ujërave. Nëse udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse vëzhgohen, ndryshimet në elementet cilësore nuk do të kapërcejnë së tepërmi që të kërcënojnë arritjen e objektivave mjedisore.

Veprimet e sektorëve që ndikojnë në ujërat dhe objektivat mjedisore mbi ujërat përmbledhen si me poshtë:

- Pozicionimi i veprave infrastrukturore mund të ndikojë në mënyrë permanente të drejtpërdrejtë ose indirekt situatën hidrologjike në një zone të caktuar.
- Rrjedhja e vazhdueshme e substancave të rrezikshme që rezultojnë nga burime të ndryshme ndotëse (impakt në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe ato nëntokësore, impakt potencial mbi ujërat balneare);
- Derdhja e substancave të rrezikshme për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (impakt potencial direkt, në distance të largët deri ndërkufitar mbi cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, impakt potencial mbi ujërat balneare);
- Rrezik i lartë ekzistent nga përmblytjet (aplikimi i zgjidhjeve ndërtimore me këtë kriter si rrezik i lartë) në zonat që përmblyten ose masa rregulluese në rrjedhën e ujërave; ndryshime në situatën hidrologjike në një zone të caktuar, përfshirë pakësimin në zonat mbajtëse (direkt ose në distance);
- Ndryshimet në regjimin ujor të ujërave nëntokësore për shkak të ujërave të ndërhyrjeve të veprave infrastrukturore (p.sh. tunelet);
- Pozicionimi i strukturave infrastrukturore në akuiferët me ndjeshmëri të lartë ose shumë të lartë mund të kenë impakt negativ mbi burimet ujore ekzistuese dhe potenciale (direkt, indirekt, ndërkufitar);
- Pozicionimi në zonat e ujërave të mbrojtur të burimeve ujore (ndikim lokal, potencialisht rajonal dhe ndërkufitar).





4

ATELIER STUDIO ARCHITECTURE

Shqipëria ka aprovuar Ligjin Nr. 111/2012 "Menaxhimi i Integrues i Burimeve Ujor" dhe "Strategjinë Kombëtare Sektoriale për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet 2014-2040", "Strategjinë Ndërsektoriale për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2020" dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2010-2020". Midis të tjerave, këto dokumente përcaktojnë që aktivitete në trupat ujorë dhe tokat anash ujërave mund të kryhen vetëm nëse ato janë bazuar mbi planet e zhvillimit hapësinor dhe nuk mund të pozicionohen diku tjetër pa gjeneruar kosto të larta disproporcionale. Pozicionimi i këtyre aktiviteteve mund të ndikojnë thellësisht mbi statusin ekologjik të rrjedhave ujore dhe të pakësojnë zonat e mbajtjes dhe impaktet kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 9 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.


8.1.5. Mjedis i Natyrës- Biodiversiteti dhe hapësirat e gjelbra

Objekti i Mjedisit 6: Mbrojtja e specieve (specifike), popullatave dhe habitateve dhe krijimi dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra të rëndësishme për rekreacion dhe biodiversitet

Impaktet që kanë të bëjnë me fragmentimin e habitateve dhe biodiversitetin janë karakteristike gjatë fazës së ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës dhe më tej. Ato vërehen më tepër në mjedisin lokal, ndërsa në rastin e projekteve me shtrirje të gjerë impaktet ndihen edhe në nivelin rajonal dhe përgjatë kufijve (p.sh. në migrimin e karnivoreve të mëdhenj, rrugët e migrimit të shpendëve, vijat ujore të kalimit ndërkuftar etj.). Gjatë ndërtimit ose rindërtimit të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afat-shkurtër dhe të ktheshme (p.sh. si rezultat i ndotjes akustike- zhurmat në sheshin e ndërtimit- kafshët largohen). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të paktheshme për shkak të ndryshimeve në përdorimin e tokës (p.sh. ndërprerja e rrugëve të migrimit, rritja e zhurmës nga strukturat e zhvilluara në vend, pengesa në mjedis – linja elektrike, etj.).

Ndërtimi i strukturave të reja apo rindërtimi ose modernizimi i infrastrukturës ekzistuese mund të rezultojë në:

- ☐ Humbje të llojeve të caktuara të habitateve apo përfaqësuesve individuale të llojeve të bimëve dhe kafshëve (impakt direkt, i përhershëm);
- ☐ Impakt direkt, permanent mbi funksionimin e disa habitateve për shkak të fragmentimit të habitatit;
- ☐ Në rastin e aktiviteteve me shtrirje të gjere në një habitat më të rrezikuar, një impakt direkt është i mundshëm mbi biodiversitetin e zonës më të ngushtë ose të gjerë (impakt permanent);
- ☐ Kalimet e reja shpesh fragmentojnë habitatet e kafshëve të egra dhe ndërpresin rrugët migratore dhe rrugetat e fluturimit ose pengojnë migrimin e disa grupeve të kafshëve (veçanërisht të gjitarëve dhe amfibeve, nëse një rrugë kryqëzohet me një korridor migrimi ose fluturimi, konflikte me shpendët dhe lakuriqet e natës janë gjithashtu të mundshme). Këto mund të pengojnë në mënyrë permanente migrimin e kafshëve individuale midis popullatave individuale dhe të shkaktojnë një rënie të biodiversitetit në disa zona (impakt direkt, kumulativ, i largët);
- ☐ Shumica e problemeve të migrimit ndodhin në fazat e ndërtimit të infrastrukturave të mëdha ku nuk ka përkujdesje për rindërtimin e kalimeve dhe komunikimeve të shkëputura të



habitatëve (p.sh. ndërtimi i urave të gjelbra). Kjo duhet të merret parasysh kur projektohet dhe ndërtohet (impakt direkt, në distancë);

- Ndotja akustike (zhurma) ka impakt negativ veçanërisht për shpendët dhe gjitarët. Ky ndikim shpeshherë është i pranishëm jo vetëm në afërsi të aktivitetit, por përhapet mjaft më gjerë (impakt në distancë).

SKZHI II prezanton sfidat kryesore lidhur me mbrojtjen e mjedisit, të cilat janë: (1) nevoja për të krijuar rrjetin ekologjik Natura 2000 për Shqipërinë dhe Komunitetin Evropian; (2) ristrukturimin dhe forcimin organizativ të strukturave menaxhuese të zonave të mbrojtura; dhe (3) nevoja për të garantuar zbatim me efektiv të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura dhe planet e veprimit për llojet dhe habitatet.

Gjatë fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve migratore të kafshëve dhe në këtë mënyrë të arrihet objektivi i SKZHI II "Përmirësimi dhe forcimi i mbrojtjes së natyrës".

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 9 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

Objekti Mjedisor 7: Mbrojtja nga veprimtaritë me ndikime të konsiderueshme e zonave që gëzojnë status të veçantë.

Zhvillimet infrastrukturore në mjediset natyrore mund të shkaktojnë humbje permanente të habitateve dhe në këtë mënyrë ndikojnë negativisht në përhapjen natyrore të tipeve të habitateve apo të llojeve të bimëve dhe kafshëve. Nëse zhvillimi vendoset në zona me status natyror të mbrojtur, impaktet mund të jenë veçanërisht të zgjeruara dhe shkatërruese, pasi ato mund të degradojnë në mënyrë permanente nivelin e konservimit të mjedisit natyror dhe objektivat e mbrojtjes për zonat e mbrojtura, siç janë ato për zonat e Natura 2000, Zonat me Rëndësi Ekologjike (IEAs) dhe veçoritë e vlerave natyrore. Vëmendje e veçantë duhet të kushtohet nëse strukturat e infrastrukturës pozicionohen në zonat e mbrojtura ku mund të ndodhin humbje permanente të sipërfaqeve të kualifikuara, të habitateve kyçe, llojeve indikatore, apo që mund të kenë impakte mbi integritetin, funksionalitetin dhe kohezionin e zonave. Këtu janë të mundshme edhe impaktet permanente dhe direkte mbi cilësinë e vlerave të vecanta që ato mbartin dhe për shkak të të cilave i është dhënë edhe statusi i vecantë. Duke qenë se një pjesë e mirë e territorit të Shqipërisë (rreth 16,6%) janë zona që gëzojnë statusin e zonave të mbrojtura (sipas kategorive të ndryshme të IUCN), ka mjaft mundësi që ndërtimet e reja të kalojnë pranë ose hyjnë në territoret e këtyre zonave.

Impaktet në zonat me status natyror të mbrojtur janë të mundshme gjatë periudhës së ndërtimit të reja ose rindërtimit të sistemeve të infrastrukturës dhe në vijim. Ato janë me të dukshme në mjedisin lokal, ndërkohe që për aktivitete të zgjeruara, ato mund të ndjehen në nivel rajonal dhe përtej kufirit (p.sh. impakti mbi kohezionin dhe integritetin e rrjetit të Natura 2000). Gjatë periudhës së ndërtimit të reja ose rindërtimit të sistemeve të infrastrukturës, impaktet janë kryesisht afatshkurtër dhe të kthyeshëm (p.sh. ndotje nga zhurma në kantierin e ndërtimit, turbullimi i vijave ujore). Pas ndërtimit, impaktet janë kryesisht permanente dhe të pakthyeshme për shkak të



ndryshimeve në përdorimin e tokës (p.sh. rritje e ndotjes nga zhurmat prej transportit, pengesat në mjedis, shkatërrimi i habitateve), etj.

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që paraqiten në Seksionin 9 duhet të merren parasysh për të realizuar këtë objektiv.

8.1.6. Mbetjet

Objektivi Mjedisor 8: Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe reduktimi i sasisë së mbetjeve të gjeneruara duke rritur riciklimin dhe ripërdorimin e tyre.

Problemet/shqetësimet kryesore që lidhen me këtë sektor janë listuar me poshtë:

- Prania e vend-depozitimeve të hapura (të ligjshme dhe të paligjshme) të hedhjes së mbetjeve;
- Kapacitet i pamjaftueshëm i landfilleve ekzistues/mungesa e tyre;
- Menaxhimi i mbetjeve është akoma në nivele të ulta, sisteme grumbullimi miks ka vetëm në qytete;
- Me përjashtim të njësisë administrative Këlcyre, njësitë e tjera nuk e ofrojnë fare shërbimin e mbledhjes së mbetjeve.
- Mbetjet inerte, mbetjet e rrezikshme, mbetjet spitalore dhe mbetjet e kafshëve nuk trajtohen sipas kërkesave ligjore, mungesa e landfilleve për mbetjet e rrezikshme. Nuk ka landfille të veçanta, trajtim i veçuar behet vetëm nga sektori privat.
- Ndarja në burim e mbetjeve/riciklimi, e cila megjithëse është kërkesë ligjore që prej vitit 2011, nuk realizohet në praktike.
- Kuadri ligjor i përgjigjet kërkesave të BE-së, por nuk mund të ndryshojë realitetin për shkak të mungesës në investime.

Zhvillimi i zonave të caktuara mund të çojë në integritetin e shtresave të ujërave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore dhe në këtë mënyrë mund të shkaktojë sëmundje kancerogjene deri në largësi të mëdha prej zonave në fjalë.

Djegia e mbetjeve në fushë të hapur, përhapja e ndotësve nëpërmjet ajrit konsiderohet si një rrezik serioz për shëndetin, gjë që krijon rreziqe potenciale për shëndetin e banoreve lokale. Rrjedhjet e mbetjeve nga fusha ndotin ujerat sipërfaqësore të lumenjve që kalojnë pranë. Pamje e shëmtuar vizive e territorit që ndikon në imazhin e tij të përgjithshëm dhe tërheqës për aktivitetet, vizitoret dhe banoret.

Plani synon eliminimin e vend-depozitimeve të mbetjeve në vendin aktual dhe përgjatë lumenjve Vjosa dhe Dëshnica si dhe mbulimin e vend-depozitimeve të hapura dhe përdorimin e tyre si hapësira të gjelbra.

Keto do kenë efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Ka dhe një efekt të drejtpërdrejtë në aktivitetet turistike dhe ekonomike të vendit.

Nga zonat rurale që nuk mbulohen me shërbim një sasi e konsiderueshme mbetjesh qarkullojnë në rrjetin hidrik duke krijuar një potencial ndotës. Keto mund të ndikojnë negativisht edhe në rrjedhën e lumit Vjosa apo Dëshnica. Ndikim tjetër negativ është edhe degradimi i peizazhit dhe mjedisit.

Plani parashikon ngritjen e infrastrukturës së duhur për trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe bashkitë duhet ta konsiderojnë këtë një prioritet me nisjen e planeve të përgjithshme vendore. Strategjitë në infrastrukturë dhe përpunim të mbetjeve duhet të ndërmerren nga ministrinë e linjës dhe NjQV- të.

Strategjia e menaxhimit të mbetjeve duhet të përfshijë dhe mundësitë e incentivimit të riciklimit nga konsumatorët si dhe krijimin e zonave të dekompozimit të mbetjeve organike në çdo zone rurale për të krijuar lënde të parë për industrinë bujqësore për një ekonomi ciklike.

Në Seksionin 9 janë dhënë udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që duhet të merren në konsideratë për të realizuar këtë objektiv.

8.1.7. Ndotja akustike/ zhurmat

Objekti Mjedisor 9: Reduktimi i ndotjes akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH.

Në zona individuale pritet një nivel më i lartë ndotjeje mjedisore gjatë fazës së ndërtimit dhe me tej gjatë fazës së operimit. Për këtë, do të duhet që gjatë fazës së ndërtimit të ndërmerren masat zbutëse, veçanërisht mbikëqyrja e shkarkimeve nga makineritë e ndërtimit, vendosja e një kohe të limituar për ndërtimin dhe nëse nevojitet zbatimi i masave për të parandaluar përhapjen e zhurmës në mjedis.

Impaktet gjatë fazës operacionale do të jenë afat-gjatë. Si rregull, projektet me shtrirje të gjere ose korridoret e ndryshme (rruge, linja tubacionesh, shtylla elektrike, etj.) kanë impakt më të madh mbi mjedis dhe në mënyrë direkte përgjatë korridoreve. Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen nga zhurmat, kushtet e mëposhtme mund të aplikohen gjatë fazës së operimit të strukturave të reja në infrastrukturë:

- ☐ Një burim i ri zhurme nuk duhet të prodhojë ndotje përtej kufirit të lejuar të zhurmës në mjedis;
- ☐ Një burim i ri zhurme nuk duhet të rris ndotjen nga zhurma, në një zone ku zhurma ishte tashmë përtej kufirit të lejuar, përpara se të vendosej ky aktiviteti i burimit të ri;
- ☐ Masat e mbrojtjes nga zhurma duhet të garantojnë parandalimin dhe pakësimin e zhurmës që vjen nga përdorimi ose operimi i një burimi në mjedis.

Këto masa mbrojtëse të referuara në legjislacion duhet të përdoren për të pakësuar ndotjen nga zhurmat në të gjitha aktivitetet e pritshme dhe mbajtur me poshtë se niveli ligjor i përcaktuar. Zbatimi i masave të mëtejshme shtese për mbrojtjen nga zhurmat do të jete i nevojshëm në qendrat urbane dhe korridoret e lidhjeve të infrastrukturës.

SKZHI-II jep edhe masat zbutëse që burojnë nga legjislacioni dhe synimet përse I përket nivelit të zhurmave.

Në Seksionin 9 janë dhënë udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që duhet të merren në konsideratë për të realizuar këtë objektiv.



8.1.8. Popullata dhe asetet materiale

Objektivi Mjedisor 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

Në vijim të impakteve mbi shëndetin, arritja e këtyre objektivave influencon gjithashtu situatën ekonomike të popullsisë dhe asetet materiale që ata zotërojnë. Përsa i takon problemeve kryesore që lidhen me çështjet e mirëqenies, sigurisë dhe shëndetit, në mënyrë të përmblodhur ato kanë të bëjnë me aksesimin e trafikut dhe transportit në zonat urbane dhe rurale, lidhur ngushtë me lëvizshmërinë drejt tregjeve dhe ruajtjen e lidhjeve në komunitet. Ndërkohë komunitetet lokale sfidën me të madhe e kanë me ruajtjen e situatës social-ekonomike (përfshirë bujqësinë, hortikulturën, akuakulturën, pyjet, shërbimet utilitare, edukimin etj.).

Zhvillimet e parashikuara në Plan detyrimisht që do të shkaktojnë me shume trafik, më shumë emetime, më shumë zhurmë dhe më shumë trysni mbi burimet natyrore. Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm Plani parashikon, ndër të tjera edhe zhvillimin e sistemeve të trajtimit të mbetjeve dhe të ujerave të zeza. Në këtë këndvështrim problemet që shkaktohen nga menaxhimi i dobët i këtyre sistemeve ka gjasa të zvogëlohen.


Fokusimi në zhvillimet infrastrukturore që i përgjigjen realizimit të qëllimeve dhe objektivave përkatëse, kryesisht për t'i shërbyer rritjes së pritshme të numrit të vizitorëve në zonat përkatëse, mbart me vete rrezikun që komunitetet dhe vend-banimet ekzistuese mund të neglizhohen nga pikëpamja e shërbimeve komunitare. Ndërkohë që zhvillimi i përgjithshëm social-ekonomik pritet që të kontribuojë në rritjen e mirëqenies së njerëzve, ekziston rreziku që rritja ekonomike të ketë një shpërndarje të disbalancuar.

Ndërgjegjësimi i njerëzve mbi problemet mjedisore duhet të jetë një proces i vazhdueshëm. Dhënia e informacioneve, rritja e ndërgjegjësisë, dialogimi me të gjitha palët e interesuara dhe përfshirja e publikut në proceset vendimmarrëse për politikën e propozuara do të kontribuojë së tepërmi në ndryshimin e modeleve të sjelljes përsa i takon zgjidhjeve të qëndrueshme, gjë që është theksuar së tepërmi edhe në udhëzimet strategjike të Planit Kombëtar Mjedisor të Veprimit.

Plani ofron zgjidhje që kanë të bëjnë me mobilitete të qëndrueshme alternative. Krijimi i rrugëve të biçikletave dhe rrugicave të marshimeve me anë të aksesimit të përshtatshëm në qendrat e rekreacionit do të kishte një impakt pozitiv në shëndetin human (impakt lokal).

Sa i takon përhapjes gjeografike të zonave të banuara në Bashkinë Këlcyre, propozimet e paraqitura në PPV-në do të sjellin zonat e largëta më afër (në kohë dhe hapësirë) me qendrat kryesore dhe veçanërisht me tregjet dhe shërbimet. Ky është impakt pozitiv për të gjithë territorin.

Në Seksionin 9 janë dhënë udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që duhet të merren në konsideratë për të realizuar këtë objektiv.



8.1.9. Trashëgimia kulturore

Objekti Mjedisor 11: Mbrojtja e veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore, përmirësimi dhe, sipas rastit, rivendosja dhe rristurimi i mjedisit historik.

Zhvillimet e infrastrukturës mund të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në objekte apo zona të trashëgimisë kulturore gjatë fazës së ndërtimit dhe më tej të funksionimit të tyre. Këto ndikime përfshijnë:

- ☐ Degradimi i veçorive të peizazhit përreth njësive të trashëgimisë kulturore (impakt indirekt, i pakthyesëm);
- ☐ Dëmtimi i strukturave të trashëgimisë kulturore (impakt direkt, i pakthyesëm);
- ☐ Shkatërrim i mbetjeve arkeologjike gjatë fazës së ndërtimit (impakt direkt, lokal, i pakthyesëm);
- ☐ Vibime që mund të shkaktojnë dëmtime të strukturave të trashëgimisë kulturore (impakt indirekt, i pakthyesëm);
- ☐ Çlirime gazrash ndotës që ndikojnë në formimin e shirave acid dhe që shkaktojnë dëmtime të strukturave të trashëgimisë (impakt indirekt, kumulativ, në distance).

Pozicionimi i infrastrukturës sipas sektorëve do të ndryshojë në mënyrë permanente përdorimin e hapësirës në këto zona. Për të ruajtur veçoritë e zonës së trashëgimisë kulturore, duhet të ndërmerren masa të përshtatshme. Nga aspekti i ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte destruktive (p.sh. gërmimet). Nëse do të duhet të kryhen kërkime arkeologjike në plan të gjere, përpara se të behet pozicionimi i strukturave infrastrukturore do të duhet të merren në konsideratë edhe mundësia e gjetjeve dhe do të duhet të zbatohen masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike.

Në vijim të impakteve direkte të përhershme, zbatimi i veprimeve të Planit mund të ndikojë gjithashtu në trashëgiminë kulturore në mënyrë indirekte, dmth, duke përkeqësuar veçoritë e peizazhit në mjedisin përreth njësive të trashëgimisë kulturore.

Gjatë fazës së operimit, këto veprime mund të kenë një impakt të drejtpërdrejtë pozitiv mbi trashëgiminë kulturore. Aksesimi më i shpejtë tek zonat me rëndësi historike dhe kulturore do të rezultojë në rritjen e numrit të vizitoreve. Nga ana tjetër, një impakt pozitiv i drejtpërdrejtë mund të kthehet shpejt në impakt negativ. Me shumë vizitorë mund të prodhohen më shumë mbetje dhe të rriten ndotjet akustike.

Në Seksionin 9 janë dhënë udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që duhet të merren në konsideratë për të realizuar këtë objekt.

8.1.10. Peizazhi

Objekti Mjedisor 12: Mbrojtja dhe përmirësimi peizazheve dhe zonave të veçanta me veçori dalluese në nivel kombëtar dhe, kur është e nevojshme, rivendosja e karakterit të peizazhit dhe vlerave skenike.

Përcaktimi i impaktit mbi cilësinë e peizazhit, buron kryesisht nga veçoritë vizive të hapësirës dhe nga elementet karakteristike të peizazhit që janë të pranishme në këtë hapësirë. Peizazhi çënohet me shume nga infrastruktura që shtrihet në zona të hapura, ku impaktet janë më të dukshme për shkak të një niveli të lartë shtrirjeje (impakte të përhershme, të pakthyeshme. Ndikimi është



veçanërisht i lartë në rastin e një ndërhyrjeje infrastrukturore në zona me peizazh të jashtëzakonshëm, apo me tipare të veçanta, si dhe në zona peizazhistike me elemente natyrore të mbrojtur, të cilët mbartin një kuptim të rëndësishëm simbolik. Impaktet mbi veçoritë peizazhistike të zonave mund të përkufizohen si direkte, kumulative, indirekte dhe të dobëta. Strukturat infrastrukturore në hapësirë, bëhen elemente të peizazhit dhe pjesë përbërëse e tij. Kështu që, sistemi i këtyre strukturave duhet të behet në përputhje me tipologjinë ekzistuese të peizazhit. Marrja në konsideratë e veçorive natyrore dhe topografise së zonës ku parashikohet të zhvillohet projekti, do të reduktojë fragmentimin e peizazhit.

Në Seksionin 9 janë dhënë udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse që duhet të merren në konsideratë për të realizuar këtë objektiv.

8.1.11. ërfundime mbi Vlerësimin e Ndikimeve

Në seksionet e mësipërme, u përshkruan shkurtimisht disa nga ndikimet më të rëndësishme në realizimin e objektivave mjedisorë, që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit të propozuar. Në përgjithësi, nëpërmjet pozicionimit të përshtatshëm të aktiviteteve hapësinore dhe duke ndërmarrë masat zbutëse përkatëse, të gjithë grupet e veprimeve janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor. Në përputhje me gjetjet, janë propozuar masa zbutëse të përgjithshme dhe specifike në Seksionin 9.

Gjatë zbatimit të projekteve, priten të ndodhin impakte pozitive dhe negative. Impaktet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullatat dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatike duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe me tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave. Për më tepër, zbatimi i projekteve të infrastrukturës në përgjithësi do të bëjë të mundur pakësimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në lëvizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi duke patur një ndikim pozitiv mbi popullatën dhe asetet materiale.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukturës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme). Kjo pasi bashkia e Këlcyrës ka veçori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peizazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukturës, sidomos atyre me shtrirje të gjere dhe korridoreve sipas sektorëve (transport, energji, ujë, etj.). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në trupat ujore, natyre (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgiminë kulturore dhe peizazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave.

Impakte negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe perkeqesimit në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqendrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

8.2. IMPAKTET KUMULATIVE

Impaktet mjedisore kumulative përcaktohen në këtë raport si një kombinim i impakteve të zbatimit të veprimeve të Planit në aspekte të ndryshme të mjedisit.

Në zbatimin e veprimeve të Planit, impaktet mjedisore kumulative variojnë sipas aspekteve individuale të mjedisit.

Kur vlerësohen impaktet mbi tokën, ajrin dhe faktorët klimatikë, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si shuma e impakteve të të gjitha masave, si të tilla në Vlerësimin e impakteve kumulative mbi:

- ☐ tokën, zona tokë bujqësore dhe e pyjeve e fragmentuar për shkak të integritetit të strukturave të infrastrukturës së re që kombinohen;
- ☐ asetet minerale, shkalla e riciklimit të gjenerimit të mbetjeve ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit dhe rindërtimit që kombinohen;
- ☐ ajrin, shkarkimet e ndotësve që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen; dhe
- ☐ faktorët klimatikë, shkarkimet e gazeve serë që pasojnë zbatimin e masave që kombinohen.

Nga aspekti i impakteve mbi ajrin dhe faktorët klimatikë, impaktet kumulative si shume e impakteve të të gjithë veprimeve të Planit janë të rëndësishme për realizimin e objektivave mjedisore të përcaktuar për sektorët e Bashkisë Këlcyrë për 2030 në lidhje me:

- ☐ menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit;
- ☐ shkarkimet limit të ndotësve
- ☐ sasia vjetore me e larte e shkarkimit të gazeve serë.

Kur vlerësohen impaktet mbi ujin, natyrën, trashëgiminë kulturore dhe peizazhin, impaktet kumulative zakonisht nuk mund të shprehen si një shumë e impakteve të të gjithë veprimeve për të arritur synimet e Planit. Kur vlerësohen impaktet kumulative në aspektet e përmendura më sipër, karakteristikat e një impakti individual që kontribuon në impaktet kumulative janë shume të rëndësishme. Këto janë përgjithësisht karakteristika në të cilat impaktet ndryshojnë njëri nga tjetri sipas vendit (impakt direkt dhe në distancë) dhe kohës (afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat- gjatë, përkohësisht dhe permanent) të impaktit.

Kur vlerësohen impaktet mbi shëndetin human, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve të Planit shprehen si një kombinim i impakteve që kontribuojnë në shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve dhe zakonisht i referohen:

- ☐ reduktimit të ekspozimit në nivele zhurme mbi ato të lejuara të zhurmës;
- ☐ reduktimit të ekspozimit në nivelet e tejkaluara të ajrit të ndotur në mjedis;
- ☐ masave që lehtësojnë veprimtari shlodhëse dhe rekreative në një mjedis të shëndetshëm për distanca të shkurtër, veçanërisht gjatë shkëmbimeve ditore (impaktet u vlerësuan midis popullatës).

Kur vlerësohen impaktet mbi popullatën dhe asetet materiale, impaktet kumulative të zbatimit të veprimeve në Plan shprehen si një kombinim i impakteve të ndryshme që ndikojnë në hapësirën e tyre të jetesës dhe në jetën e tyre. Masat për të arritur synimet e Planit janë pozitive nga aspekti i impakteve mbi popullsinë dhe asetet materiale, nëse impaktet kumulative të tyre kontribuojnë në arritjen e kohezionit social, sigurinë dhe qëndrueshmërinë.

26/06/2018

ATLIER STUDIO ARCHITECTURE

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SE TIRANË
SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SE TIRANË
SEKRETARIA



IX. UDHËZIME DHE MASAT ZBUTËSE

Në këtë kapitull përshkruhen disa nga udhëzimet dhe masat mbrojtëse të domosdoshme për të siguruar arritjen e objektivave të rëndësishëm mjedisore në fushat e veçanta. Duke zbatuar udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse, ndikimet negative të përshkruara në seksionet më sipër do të parandalohen dhe do të sigurohet arritja e objektivave mjedisore.

Për më tepër, ky seksion ofron disa masa specifike zbutëse të zbatueshme për projektet specifike të përshkruara në Plan. Është e rëndësishme të theksohet se lista e masave specifike zbutëse e dhëne më poshtë nuk është shteruese. Masa me të detajuara në aspektin e përmbajtjes dhe analizës do të duhet të përgatiten si pjese e VNM-ve individuale për çdo projekt specifik të Planit.

9.1. TOKA

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat Mjedisore 1 dhe 2

Duke zënë një territor të caktuar, ndërtimi i infrastrukturës së parashikuar do të shkaktojë ndikime të gjera të përhershme, të cilat do të pasqyrohen si një ndryshim në strukturën e përdorimit të tokës. Prandaj, kur planifikohet integrimi i infrastrukturës së parashikuar në mjedis, duhet të garantohet menaxhimi i qëndrueshëm i tokës dhe mbrojtja e saj.

Aktivitetet në token bujqësore dhe pyjore duhet të reduktohet në nivelin më të ulët të mundshëm, dhe duhet të jepet prioritet i lartë planifikimit të aktiviteteve në toke me potencial më të varfër të prodhimit, dhe toke jashtë zonave të dendura pyjore apo zonave pyjore me funksione të rëndësishme të prodhimit të lëndës së parë të drurit. Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja. Infrastruktura e parashikuar duhet të planifikohet në atë mënyrë që mos të rritë probabilitetin e rrëzqitjeve të tokës në zonën përreth aktiviteteve.

Për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, do të duhet që projektet specifike të plotësohen me udhëzime për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve të ndërtimit në ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës së re, dhe me e rëndësishmja, përdorimin e materialeve të certifikuar të ndërtimit, prodhuar nga riciklimi i post-produkteve ose mbetjeve nga sektorët e tjerë.

Masa Zbutëse Specifike

9.1.1. Punimet në dhera të ndotura

- ☐ Gjatë punimeve mund të zbulohen dhera të ndotura. Këto dhera duhen larguar. Pastaj duhet vendosur toke artificiale me gjeomembrane, argjile dhe shtrese plehu, mbi të cilën duhet të mbillet bar dhe peme. Kjo toke artificiale duhet të mbulojë edhe sipërfaqet e ndotura që nuk do të lëvizin.
- ☐ Të gjithë materialet ndotës (dherat dhe mbetjet) që do të largohen, duhet të depozitohen dhe groposen në vende të caktuara ku duhet të jenë të izoluar nga ujërat nëntokësore.

9.1.2. Ndotja e Tokës

- ☐ Toka që shtrihet nën rrugë mund të jete në rrezik gjatë ndërtimit, pasi mund të ndotet nga derdhjet e hidrokarbureve dhe ato kimike. Pastaj toka mund të shërbejë si një burim ndotjeje kur përshkohet nga ujërat nëntokësore.



- ☐ Në zonat ku kërkohen prerje të mëdha, do të ndeshen shkëmbinjë, të cilët mund të kërkojnë zhvendosje. Metoda e zhvendosjes mund të variojë nga gërmimi me një ekskavator, deri tek shpërthimi, i cili do të sjellë zhurme të konsiderueshme dhe dridhje që lidhen me te.

9.1.3. Ripërdorimi i materialit të gërmuar

- ☐ Materiali, i cili gërmohet nga prerja e seksioneve është një burim natyral dhe përdorimi i tij në baze të një skeme do të maksimizohet duke përdorur teknika konstruktive të cilat intensifikojnë ngjeshjen e materialeve për t'u përdorur si mbushje inxhinierike.
- ☐ Për materialin, i cili, për shkak të veçorive të tij fizike dhe strukturore, nuk është i përshtatshëm për t'u përdorur si mbushje inxhinierike brenda skemës, të shikohet përshtatshmëria për aktivitete të tjera, siç është krijimi i peizazhit, ku nuk aplikohen kërkesa kaq të rrepta strukturore.
- ☐ Materiali i gërmuar i parashikuar për ripërdorim do të trajtohet dhe transportohet në minimum, dhe o të depozitohet në mënyrë të tillë që të minimizojë ndikimet e gërryerjes. Koha midis gërmimit dhe ripërdorimit gjatë periudhës së lagësht duhet të jete sa më e vogël.

9.1.4. Erozioni

- ☐ Duhet ndërmarrë mbrojtja e argjinaturës nga erozioni, me qëllim që të sigurohet stabilizimi i argjinaturës, përfshirë edhe përzgjedhjen e materialeve më pak të korodueshëm, përdorimin e gabioneve dhe gurëve të thyer, si dhe një ngjeshje të mire, veçanërisht përreth urave.
- ☐ Mbjellja duhet përfunduar sa më shpejt të jete e mundur, menjëherë pas mbushjes, për të lehtësuar rigjenerimin e një mbulose stabilizuese të tokës. Aty ku është e nevojshme do të kërkohet hapje e kanaleve për të siguruar mbjelljen e suksesshme të bimëve.
- ☐ Aty ku është e nevojshme, zonat e shkarkimit prej strukturave kulluese do të pajisen me gurë të thyer, për të reduktuar erozionin, veçanërisht në rastet kur janë instaluar strukturat e kullimit dhe/ose nivelet e formacioneve të rrugës janë ngritur dhe krijojnë shpatë të zhveshura, të cilat kërkojnë stabilizim, përpara fillimit të sezonit të shirave.


9.2. AJRI

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 3

Në planifikimin e politikave dhe aktiviteteve të Planit duhet të merren parasysh objektivat e SKZH II dhe standardet e lejuara të emetimeve, të përcaktuara nga BE, OBSH dhe legjislacioni përkatës shqiptar.

Prioritet në procedurën e përzgjedhjes duhet t'i jepet varianteve të cilat ofrojnë përmirësimin më të madh të cilësisë së ajrit të ambientit. Gjatë përgatitjes së politikave dhe projekteve të reja në infrastrukture, duhet të respektohen udhëzimet dhe masat në vijim, në mënyrë që të arrihen objektivat e reduktimit të ndotjes së ajrit të ambientit në zonat e ndikimit të aktiviteteve përkatëse:

- ☐ Përdorim i mjeteve të transporti publik me emetime të gazeve në nivele të ulëta ose me filtra ajri të reduktimit maksimal
- ☐ Përcaktimi i zonave industriale me teknologji të lartë dhe me emetime të gazeve në sasi të ulët
- ☐ Identifikimi dhe monitorimi i burimeve të gazeve që shkaktojnë shiun acid
- ☐ Komunikim ndërkufitar institucional për të shmangur incidentet mjedisore të qarkullimit të ajrit si dhe përcaktimi i masave konkrete të veprimit në raste të incidenteve ndërkufitare
- ☐ Përcaktimi i kriterëve të tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës dhe qëllimit të përdorimit të saj që në fazat e projektimit
- ☐ Shtimi i sipërfaqeve me pyje dhe bimësi





- ☐ Strukturimi i kërkesave për lende drusore
- ☐ Përcaktimi i masave të emergjencave në rastet e aksidenteve industriale për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis dhe në cilësinë e tij

Masa Zbutëse Specifike

- ☐ Monitorimi i cilësisë së ajrit në të gjithë territorin e Bashkise duke vendosur stacione automatike të monitorimit si në zonat urbane dhe ato rurale.
- ☐ Koordinimi midis institucioneve Qendrore dhe vendore për Vlerësimin e kushteve mjedisore që lidhen me cilësinë e ajrit dhe me masat ndaj ndryshimeve klimatike

9.3. FAKTORËT KLIMATIKË

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 4

Zbatimi i masave për të arritur objektivat e Planit duhet të marrë parasysh të ashtuquajturat objektiva indikative për të reduktuar emetimet e gazit, të cilat janë të përcaktuara deri në vitin 2020 në SKZHI II për reduktimin e emetimeve të gazit serre. Në këtë kuadër duhet mbajtur në vëmendje si me poshtë:

- ☐ përcaktimi i protokolleve dhe monitorimi i rasteve të trajtimit të sëmundjeve që vijnë si pasojë e ngjarjeve të motit;
- ☐ përcaktimi i masave të emergjencave civile për të shmangur/zbutur ndikimet nga kushtet ekstreme të motit
- ☐ Përcaktimi i kriterëve dhe politikave për futjen e teknologjive bashkëkohore në bujqësi si dhe praktikave me të mira të bujqësisë organike
- ☐ zbatimi i një politike parkimi kufizuese në zonat urbane;
- ☐ Integrimi i çështjeve të ndryshimeve klimatike në kuadrin politik dhe ligjor duke specifikuar institucionet dhe përgjegjësitë për identifikimin, zbatimin dhe monitorimin e masave zbutëse/përshtatësi ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

9.3.1. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Projektet specifike të Planit duhet të hartohen në një mënyrë të tillë që të sigurojnë një përdorim efektiv të burimeve, që do të thotë se ndjeshmëria e infrastrukturës së parashikuar ndaj ndryshimeve klimatike, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive antropogjenike duhet të vërehet siç duhet. Kjo do të thotë se kur planifikohet infrastruktura, duhet të merren në konsideratë masa nga vlerësimet e rreziqeve, të cilat do të rrisnin elasticitetin e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike në mënyrën e duhur, veçanërisht në lidhje me reshjet, përmbajtjet, temperaturat e larta dhe valët e të nxehtë, thatësi, rritjet e nivelit të detit dhe stuhitë.

Për të arritur objektivin mjedisor në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duhet të sigurohen si me poshtë:

- ☐ në terma afatgjatë, infrastruktura duhet të jetë më pak e ndjeshme ndaj pasojave të reshjeve ekstreme (shirave, dëborës, apo edhe ngricave);
- ☐ gjatë planifikimit të çdo ndërtimi të ri apo zgjerimi të strukturave ekzistuese, duhet të kryhet një analize ndjeshmerie e infrastrukturës së parashikuar në kushtet ekstreme të motit, dhe në baze të rezultateve të saj, duhet të përgatitet një plan masash për të reduktuar në mënyrë të përhershme pasojat e këtyre fenomeneve;
- ☐ zbatimi i masave për të reduktuar ndjeshmërinë e infrastrukturës ndaj kushteve ekstreme të motit duhet të bëhet një detyrë qendrore e menaxhimit të çdo lloj infrastrukture. Qëllimi i



- zbatimit të këtyre masave duhet të bazohet sidomos në reduktimin e demit të shkaktuar për përdoruesit e infrastrukturës së ndjeshme ndaj motit, nëse ata nuk mund ta përdorin atë;
- ☐ duhet të përcaktohen qarte udhëzimet për metodologjinë, procedurat dhe realizimin e mbledhjes së informacionit mbi kushtet ekstreme të motit, si dhe për planifikimin dhe zbatimin e masave për të reduktuar ndjeshmërinë e infrastrukturës së parashikuar ndaj kushtet ekstreme të motit.

9.4. UJI

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 5

Në mënyrë që të kufizohen efektet e presionit që do të ushtroje infrastruktura e parashikuar në burimet ujore dhe kështu të parandalohen ndikimet negative në cilësinë e ujit (sidomos ujit të pijshëm), duhet të shmanget integrimi hapësor i infrastrukturës së re në zonat e mbrojtura ujore. Në integrimin hapësor të infrastrukturës së re, është e nevojshme që të shmanget integrimi i objekteve në zonat në rrezik nga përmbytjet dhe erozioni si pasoje e tyre. Në rast të ndërhyrjeve në këto zona, duhet të provohet se niveli ekzistues i rrezikut nga përmbytjet në zonën përreth nuk do të rritet. Udhëzimi i lartpërmendur duhet të merret parasysh në mënyrë që të reduktoje presionin e infrastrukturës së re në zonat në rrezik nga përmbytjet, dhe për të siguruar se niveli i rrezikut nga përmbytjet në zona të veçanta nuk do të rritet.

Kur planifikohen ndërhyrjet në zonat me rrezik jashtëzakonisht të lartë, shume të lartë dhe të lartë të akuifereve, është e nevojshme që të studiohen dhe planifikohen zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit, si dhe në rastin e ngjarjeve të jashtëzakonshme (p.sh. rrjedhjet e substancave të rrezikshme). Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të reduktojë probabilitetin e ndotjes nëntokësore, duke siguruar ndikime të kufizuara të presionit të infrastrukturës së re në ujërat nëntokësore.

Aktivitetet e tilla mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në statusin ekologjik të rrjedhave ujore, të zvogëlojnë basenat mbrojtëse ujore, dhe të prodhojnë ndikime kumulative mbi biodiversitetin e zonës dhe shërbimet e ekosistemeve të zonës. Në rastet e përjashtimit të kësaj mase, kjo duhet të bëhet e mundur vetëm në baze të argumentimit të ekspertëve, duke deklaruar se elementi i infrastrukturës nuk mund të integrohet në vende të tjera pa shpenzime jashtëzakonisht të larta. Në llogaritjen e këtyre shpenzimeve duhet të përfshihen edhe kostot që vijnë si pasoje e pakësimit të shërbimeve që vijnë nga ekosistemi. Shqyrtimi i udhëzimit të lartpërmendur do të beje llogaritjen e kostove me të sakte dhe të balancuar. Kjo do të parandalonte ndikime të rëndësishme negative në gjendjen ekologjike të rrjedhave ujore.

Masa Zbutëse Specifike

- ☐ Në rast se zbatimi i një projekti specifik do të ndikojë ndjeshëm në ndonjë akuifer, gjatë hartimit të dokumentacionit të projektit duhet bërë edhe një vlerësim i demit ndaj ujërave nëntokësore. Vlerësimi duhet të përfshijë gjithashtu edhe një mënyrë për ta kaluar këtë zone (si p.sh. ndërtimin e një ure) për të garantuar mbrojtjen e ujit nëntokësor.
- ☐ Duhet bërë përcaktimi i zonave me specifike për qëllime të përdorimit të ujërave për HEC-e, rezervuare, për bujqësinë.





STUDIO ARKITEKTURALE

- ☐ Duhet planifikuar zgjidhjet e duhura teknike për të parandaluar ndikimet negative mbi ujërat e larjes, gjatë fazave të ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës, si dhe në rastet e ndodhjeve të jashtëzakonshme (p.sh. derdhjet e substancave të rrezikshme).
- ☐ Nuk do të autorizohet depozitimi i produkteve të dëmshme në një distance më pak se 50 m nga brigjet e lumenjve si dhe do të kufizohet pranë rrjedhave të tjera ujore siç janë kanalet kulluese;
- ☐ Ambientet e magazinimit duhet të rrethohen dhe mbulohen për të parandaluar derdhje të ndryshme;
- ☐ Kanalet anësore do të ndërtohen përpara ndërtimit të rrugës, për të parandaluar derdhjen e rrjedhjeve të rrugës gjatë ndërtimit, në lume, apo kanalet kulluese;

9.5. MJEDISI NATYROR

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivat Mjedisore 6 dhe 7

Hartimi i PPV-së ka synuar Planifikimin e Zhvillimit të Territorit në mënyrë të tillë që të sigurojë mbrojtjen e biodiversitetit në territorin e Bashkisë Këlcyrë. Në PPV, Bashkia ka marrë disa masa specifike (ka hartuar projekte) për përmirësimin e gjendjes dhe krijimin e mundësinë për një biodiversitet sa më të qëndrueshëm. Këto masa janë përkthyer në projekte specifike të cilat synojnë shtimin e sipërfaqeve të gjelbra natyrore që shërbejnë si habitat për florën e faunën dhe rehabilitimin e zonave ripariane të lumenjve Vjosa dhe Dëshnica.

Për të ruajtur në mënyrë të përhershme mjedisin natyror dhe biodiversitetin, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:

- ☐ Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese ka përparësi mbi ndërtimin e infrastrukturës së re;
- ☐ Nëse aktivitetet në mjedisin e paprekur nuk mund të shmangen, duhet të shmangen aktivitetet në zonat e mbrojtura, zonat me rendësi mjedisore dhe zonat me karakteristika të çmuara natyrore;
- ☐ Prioritet duhet t'i jepet varianteve me më pak ndikim në rrugët e migrimit të kafshëve të egra (varianete të cilat kalojnë më shumë neper tunele dhe variante të cilat ndërpresin më pak rrugët e migrimit);
- ☐ Duhet të sigurohen pasazhe të përshtatshme për kafshët e egra, gjë që është në përputhje me praktikën me të mira evropiane. Para se të planifikohet çdo ndërtim i ri, duhet të kryhet një studim apo të përmblidhen rezultatet e studimeve ekzistuese, të cilat do të lehtësojnë integrimin në mënyrë të përshtatshme të një strukture të caktuar në një vend (formën, madhësinë, dhe sistemimin e objektit dhe rrethinave të tij). Planet duhet gjithashtu të parashikojnë pasazhe për kafshët e vogla (amfibet, gjitarët e vegjël, zvarranikeve) në baze të studimeve ekzistuese ose, nëse është e nevojshme, hulumtimeve shtesë.
- ☐ Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, duhet të shmangen ndërhyrja e projekteve në zonat me karakteristika të çmuara natyrore. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë ruajtjen e llojeve dhe karakteristikave të vlefshme natyrore.
- ☐ Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, duhet të shmangen ndërhyrja e projekteve në zonat e mbrojtura. Nëse aktivitetet në zona të tilla nuk mund të shmangen, dhe nëse kjo është e lejuar në baze të aktit për mbrojtjen e një zone të caktuar, duhet të merren parasysh udhëzimet, bazat dhe kushtet për ruajtjen e zonave të mbrojtura të natyrës të cilat janë në regjim mbrojtjeje, të miratuar me aktet për mbrojtjen. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë mbrojtjen e zonave të mbrojtura.



- Në integrimin hapësinor të infrastrukturës së parashikuar, ndërhyrja e projekteve në zonat e Natura 2000 duhet të shmanget. Shqyrtimi i udhëzimit do të lehtësojë mbrojtjen e lidhjes dhe integritetit të zonave të Natura 2000.

Masa Zbutëse Specifike

Projektet specifike duhet të plotësohen me detyrën për të mbrojtur në mënyrë me adekuate llojet e veçanta të kafshëve prej rreziqeve që vijnë si pasoje e ndërtimit të infrastrukturës së re. Duhet të zbatohet masa zbutëse specifike: Sigurimi i korridoreve të migrimit dhe siguria e kafshëve. Përmbajtja e kësaj mase duhet të jete si më poshtë:

- Të ulet fragmentimi i habitateve të flojeve, duke krijuar pasazhe për kafshët e egra në linjat ekzistuese të lëvizjes (veçanërisht për gjitarët dhe amfibet). Për këtë qëllim, fillimisht, duhet të kryhet një studim apo të përmbledhen të dhënat nga monitorimet ekzistuese rreth vdekshmërisë së kafshëve të egra në rrugë. Pastaj, bazuar në gjetjet e studimit, do të krijohen lehtësira për migrimin e kafshëve të egra. Në kuadër të kësaj mase, do të përgatitet një liste prioritare e njollave të zeza, ku kafshët rrezikohen me shume dhe në këto zona do të zbatohen masat zbutëse përkatëse (sistemim të vendkalimeve, gardhe anësore etj.). Gjithashtu kjo gjë ndikon pozitivisht në përmirësimin e sigurisë së trafikut.
- Në zonat ku planifikohet infrastruktura e re, duhet të sigurohet ruajtja e rrugëve ekzistuese të migrimit, duke ndërtuar strukturat e duhura dhe duke kryer gjithë sistemimet e tjera për të parandaluar lëvizjen e kafshëve të egra (sidomos mishngrënësve, lakuriqëve të natës dhe amfibeve).
- Meqënëse brënda territorit të kësaj bashkie nuk ka zona të mbrojtura, por vetëm 5 monumente natyre, të respektohet neni 17 i ligjit Nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura". Sipas këtij ligji: Monument natyror - Janë kategoria e III-të e zonave të mbrojtura, por gëzojnë shkallën e parë të mbrojtjes e njëjtë me zonën strikte natyrore, prandaj të mbahet parasysh që gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme ekonomike të merret në konsideratë zona buferike (deri në 200 m të perimetrit të monumentit natyror).
- Hartimi i Planit të Menaxhimit/Veprimit të Biodiversitetit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i tij në brendësi të territorit të bashkisë, kryesisht për zonat të cilat shihen prioritare për ruajtjen e specieve të mbrojtura. Në këtë rast, Bashkisë i nevojitet bashkëpunimi me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucione të tjera lokale e qendrore (AKM, ARM, etj.). Ky rekomandim vjen edhe si detyrim ligjor në zbatim të ligjit Nr.587, datë 20.7.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit".
- Inventarizimi i specieve dhe përditësimi i tij i vazhdueshëm për territorin e bashkisë (në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet të tjera vendore dhe qendrore, AKM, ARM-Gjirokastrë, AKZM, AdZM Gjirokastrë). Inventarizimi përbën bazën mbi të cilën duhet hartuar plani i menaxhimit të biodiversitetit, përcaktohen zonat që spikaten për larmishmëri flore dhe faune dhe zonat që strehojnë speciet e rrezikuara. Inventarizimi i shërben Bashkisë për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit nga ndërhyrjet e njeriut dhe nga elementet natyrore, detyrim ky që rrjedh nga Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe VKM Nr. 84, datë 27.1.2009 "Për Caktimin e kritereve për ngritjen e rrejtit të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit".
- Hartimi i Planit të Mbarështimit të Fondit Kullosor, në mënyrë që të dihet kapaciteti i territorit për kullotje dhe shfrytëzim të pyjeve, të ndërmerren masa për ndalimin e kullotjes/shfrytëzimit aty ku vlerësohet e nevojshme.



- ☐ Hartimi i Planit të Mbarështimit të Bimeve Mjekëore dhe Aromatike, në mënyrë që të njihet kapaciteti i lejuar i shfrytëzimit të këtyre bimeve duke ruajtur balancat e tyre (në bashkëpunim me institucionet vendore dhe qendrore, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ARM, AKM, etj.).
- ☐ Kontrolli i zbatimit të moratoriumit të ndalimit të gjuetisë dhe prerjeve të pyjeve (duhet theksuar që për zbatimin e moratoriumit të pyjeve Bashkia është e ngarkuar drejtpërsëdrejti për kontrollin dhe zbatimin e tij, ndërsa për atë të gjuetisë bashkisë i lind detyrim nga ligji për mbrojtjen e faunës dhe ligji për mbrojtjen e biodiversitetit).

Këto masa do të lehtësojnë lidhjet mes habitateve (rivendosin apo ruajnë rrugët e migrimit) të specieve dhe arrijnë e objektivat mjedisore që lidhen me mbrojtjen e natyrës.

Prandaj, ndërhyrja hapësinore e infrastrukturës së parashikuar në zonat e propozuara për mbrojtje duhet të shmangët për të parandaluar konfliktet e mundshme dhe ndikimet negative në arritjen e objektivave mjedisore të ruajtjes së natyrës.

9.6. MBETJET

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 8

Zhvillimet e parashikuara padyshim që mbartin pasojën e gjenerimit të shtuar të sasisë së mbetjeve, të cilat mund të cenojnë integritetin e shtresave të ujërave nëntokësore dhe ndotja me kimikate të rrezikshme mund të kalojë në shtresat nëntokësore. Gjenerimi i mbetjeve ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit si dhe në integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore.

Gjatë hartimit të PPV për Bashkinë Këlcyrë janë marrë në konsideratë të gjitha ndikimet mjedisore që hartimi i këtij plani ka në territorin e bashkisë. Një ndër çështjet më shqetësuese, me ndikim të lartë mjedisor është çështja e trajtimit të mbetjeve urbane në territorin e bashkisë, duke konsideruar faktin se është edhe ndër problematikat e ngritura nga banorët e zonës. Në këtë mënyrë është e domosdoshme të jepen sugjerime nga PPV për Bashkinë Këlcyrë për trajtimin e mbetjeve urbane.

Siç janë parashtruar edhe në objektivat e raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, menaxhimi i mbetjeve dhe minimizimi i rreziqeve është objektiv parësor për ndikimin e lartë që keqmenaxhimi i tyre ka në ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, tokë dhe peizazh.

Bashkia Këlcyrë nuk zotëron Landfill sanitar të vetin. Në mungesë të një territori të përshtatshëm për depozitimin e mbetjeve brenda vijës së verdhë të qytetit, Bashkia Këlcyrë i depoziton mbetjet në një fushë në breg të lumit në lindje të qytetit i quajtur "Arat e Lira". Vend-depozitimi aktual i mbetjeve (Fusha e Brackovës) është i parrethuar dhe nuk ka porta hyrëse/dalëse dhe është jashtë standarteve duke përbërë një burim kryesor ndotje për mjedisin.

Alternativat, kostot dhe planet e veprimit për trajtimin e mbetjeve për Bashkinë Këlcyrë (pjesë e qarkut Gjirokastrë) janë detajuar në studimin e "Grontmij" (2014), "Plani për menaxhimin e mbetjeve për Qarkun e Gjirokastrës". Ky plan rekomandon Tërbuqin (koordinatat: 40°12'32.18"N gjerësi gjeografike veriore dhe 20°6'1.16"E gjatësi gjeografike lindore) si pikë për ndërtimin e landfillit rajonal. Sipas këtij studimi, rekomandohet mbyllja e venddepozitimit "Arat e Lira" dhe rehabilitimi i venddepozitimit. Për mbetjet e Bashkisë Këlcyrë është paraparë që të përdoret "Fusha e Brackovës" (Njësia Administrative Piskovë, Përmet). Ky vend shërben si venddepozitim i mbetjeve për Bashkinë Përmet, e cila duhet të garantojë rrethimin dhe vendosjen e portës hyrëse, si dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore hyrëse/dalëse në venddepozitim. Rekomandohet që pas rehabilitimit ky

venddepozitim të përdoret si stacion transferimi dhe pas një marrëveshje ndërmjet Bashkisë Këlcyrë dhe Bashkisë Përmet të përdoret nga të dy bashkitë.

Por kjo do të shtonte kostot për Bashkinë Këlcyrë e cila do duhej të paguajë për transportin për në "Fushën e Brackovës" (rreth 8 km) dhe pastaj për transportin në drejtimin e kundërt për në Tërbuq (rreth 30 km). Së dyti, parë nga prioritetet e zhvillimit të Bashkisë Përmet, sipas PPV, kjo do binte ndesh me Objektivin strategjik 1: "Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale, si dhe turizmit". Venddepozitimi është pothuajse në fushë të hapur ndërkohë që fshatrat përballë propozohen të rivitalizohen me prioritet turizmin.

Propozohet që pasi të bëhet një studim i hollësishëm i fizibilitetit, ky venddepozitim të mbyllet, të rehabilitohet dhe mbetjet urbane të Bashkisë Këlcyrë të transferohen direkt në landfillin e Tërbuqit. Në rastin kur si vend për ndërtimin e Landfill-it rajonal në vend të Tërbuqit do të zgjidhej Bakaj në bashkinë e Sarandës atëherë, duke analizuar përbërjen gjeologjike të tokës dhe nga një analizë e zonës përreth, është sugjeruar krijimi i një landfill-i rajonal në afërsi të fshatrave Varibop dhe Kuqal. Sugjerimi për ndërtimin e landfill-it do të ndikojë në konvertimin e tokës nga sistem natyror në sistem infrastrukturor.

Bashkia Këlcyrë ndërkohë duhet të përqendrohet kryesisht në realizimin e objektivave sikurse është arritura e afateve të VKM Nr. 418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" të rrymave të mbetjeve për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të depozitohen përmes:

- ☐ Optimizimit të grumbullimit të mbetjeve;
- ☐ sigurimit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim;
- ☐ promovimit të ripërdorimit të produkteve;
- ☐ përgatitjes së veprimtarive të ripërdorimit;
- ☐ përmirësimit të cilësisë së riciklimit të mbetjeve.

Progresi drejt sistemit të grumbullimit të ndarë të mbetjeve është një domosdoshmëri për t'u zbatuar në Bashkinë Këlcyrë.

Fillimisht, rekomandohet aplikimi në nivel pilot i sistemit të grumbullimit të mbetjeve me 3 kosha, për mbetjet e riciklueshme të thata, mbetjet organike dhe mbetjet e tjera (të përzjera). Pas pilotimit, fillimisht në zonat urbane, do të vijojë gradualisht shtrirja e këtij sistemi në të gjithë zonat e shërbimit sipas përcaktimeve në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Sistemi i grumbullimit me tre kosha është i koduar sipas ngjyrave më poshtë:

- ☐ Lënda organike e kompostueshme do të grumbullohet në koshin me ngjyrë të gjelbër,
- ☐ Materialet e riciklueshme të thata do të grumbullohen në koshin me ngjyrë blu, dhe
- ☐ Mbetjet e tjera urbane në koshin me ngjyrë të zezë

Mbetjet e riciklueshme dhe/apo të kompostueshme do të grumbullohen në burim sipas njërit apo disa prej varianteve, nga ofruesit e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve (publik/privat), operatorët specifikë të grumbullimit të mbetjeve specifike, apo nga vetë bizneset e riciklimit, etj. Janë konceptuar tre alternativa për organizimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve, sikurse tregohet në Tabelën 30, në vijim:



Tabela 30. Opsionet e grumbullimit dhe transportimit të ndarë të mbetjeve (GTN)


OPSIONET	OPERATORI I GRUMBULLIMIT TË DIFERENCUAR TË MBETJEVE	PËRSHKRIM I OPSIONIT
Grumbullimi-Transportimi i Ndarë 1 (GTN1)	Operatorët publik/ privat të ngarkuar për grumbullimin e mbetjeve	Grumbullimi në mënyrë të diferencuar i mbetjeve, nëpërmjet sistemit me 3 kosha në pikat publike, direkt nga gjeneruesit e mëdhenj të mbetjeve, dyqanet e rikuperimit në qytet, etj.
Grumbullimi-Transportimi i Ndarë 2 (GTN2)	Operatorët specifike për grumbullimin e mbetjeve specifike (të autorizuar nga NjQV- të)	Grumbullimi në mënyrë të diferencuar vetëm të koshave të specifike të mbetjeve (riciklimit dhe/ apo organike), grumbullimi i materialeve të riciklueshme nga gjeneruesit e mëdhenj të mbetjeve, dyqanet e rikuperimit në qytet, etj.
Grumbullimi - Transportimi i Ndarë 1 (GTN3)	Spektori privat i rikuperimit dhe riciklimit	Kompanitë e riciklimit apo kompostimit autorizohen të organizojnë vetë grumbullimin e diferencuar në burim të mbetjeve grumbullojnë në mënyrë të ndarë vetëm koshat publik të mbetjeve. Spektori privat ose grumbulluesit e materialeve të riciklueshme, rekuperojnë materialet, sipas parimit të ekonomisë së tregut

Për momentin asnjë prej alternativave të mësipërme nuk është e zbatueshme në formën e saj të plotë në Bashkinë Këlcyrë. Për këtë arsye, rekomandohet fillimisht projektimi, zbatimi dhe monitorimi i skemave pilot në nivelin e 30% të sistemit total ekzistues, për ndarjen e mbetjeve të riciklueshme dhe organike në qytetin e Këlcyrë. Pilotimi i skemave të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve do të shoqërohet me rritjen e interesit të sektorit privat (që për momentin është i dobët), si dhe do të përmirësojë njohuritë e konsumatorëve për të ndarë mbetjet sipas rrymave të dëshiruara.

Zgjerimi dhe modernizimi i sistemeve për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve do të bëjë paralelisht me krijimin e sistemeve për rikuperimin, riciklimin apo kompostimin e mbetjeve. Roli dhe interesi i sektorit privat (rikuperimit, riciklimit dhe kompostimit) është shumë i rëndësishëm për modernizimin e sistemit të grumbullimit të diferencuar të mbetjeve. Kjo do të kërkojë lidhjen e marrëveshjeve me kompanitë e riciklimit që operojnë në qarkun e Gjirokastrës, ose në mungesë të kompanive rajonale, me kompanitë e riciklimit që operojnë në nivel kombëtar.

Masat zbutëse që duhen parashikuar dhe zbatuar lidhur me administrimin e mbetjeve janë si me poshtë:

- ☐ Zhvillimi i infrastrukturës dhe përfshirja në planet rajonale e vendore të menaxhimit të mbetjeve
- ☐ Janë të domosdoshëm buxhete të mjaftueshme për menaxhimin e mbetjeve, që përfshijnë gjithashtu dhe sektorin privat
- ☐ Të shihet mundësia e ngritjes së një landfilli industrial qendror për depozitimin e mbetjeve të ngurta industriale mbas trajtimit të tyre me metodat e përcaktuara nga Konventa e Bazelit, duke shmangur depozitimin e tyre në landfillet urbane
- ☐ Duhet planifikuar zonat e përshtatshme për vendndodhjen e zonës së riciklimit, kompostimit, duke konsideruar me përparësi ndikimin në mjedis.
- ☐ Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombëtarë (veçanërisht për fondet e BE-se) për të financuar infrastrukturën e nevojshme.
- ☐ Mobilizimi i një instrumenti financues nga niveli kombëtar, rajonal dhe lokal, me qëllim që të plotësohen funksionet e tij në fushën e menaxhimit të mbetjeve.



9.7. NDOTJA AKUSTIKE (ZHURMAT)

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 9

Kur të planifikohen politikat për zhvillimin e infrastrukturës së parashikuar, në mënyrë që të zvogëlohet ndotja akustike në mjedis në përputhje me objektivat e përcaktuara në SKZHI II, është e nevojshme të sigurohen masa që kontribuojnë në reduktimin e ekspozimit të zonave urbane ndaj ndikimeve negative dhe në mbrojtjen e mjedisit.


Ndotja akustike është veçanërisht e lartë në qendrat urbane dhe në zonat e qendrave më të rëndësishme me zhvillime infrastrukturore. Prandaj është e domosdoshme që të merren masa për të zvogëluar ndotjen e mjedisit. Zbatimi i masave është i nevojshëm në zonat me ndotje të tepruar akustike në situatën aktuale, ndërsa duhet gjithashtu të merren masa zbutëse në të gjitha zonat ku Plani parashikon infrastrukture të re.

Gjatë përgatitjes së projekteve të infrastrukturës, për të arritur objektivin e reduktimit të ndotjes nga zhurma duhet të respektohen keto udhëzime:

- ☐ duhet të sigurohen për aq sa të jete e mundur, masa për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim (masa në rrjetin apo strukturën përkatëse infrastrukturore, automjetet në përdorim, masa logjistike, riorganizimin e përkohshëm ose të përhershëm të lëvizjeve tranzite, reduktimi i orareve të punës apo zvogëlimi i shpejtësinë në zonat e ekspozuara ndaj zhurmës);
- ☐ në zonat ku tejkalohen tavanet e ndotjes, duhet të merren masa për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis (nëpërmjet barrierave të zhurmës dhe argjinaturave, galerive të mbuluara, etj.) dhe për të siguruar kushte të mira jetese në ndërtesa (mbrojtja pasive);
- ☐ duhet të shmangët sa më shumë që të jete e mundur ndërhyrja në zonat e qeta të banuara dhe/ose në zona të cilat janë të përcaktuara në baze të legjisllacionit për mbrojtjen nga zhurma si veçanërisht të ndjeshme ndaj zhurmës (ndërtesat e banimit, objektet e kujdesit shëndetësor, etj.);
- ☐ duhet të shmangët sa më shumë që të jete e mundur ndërhyrja në zonat e qeta në natyrë.

Masat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma në duhet të përqendrohet kryesisht në: (a) masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim; (b) masat për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis; dhe (c) nëse është e nevojshme, masa për krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës në ndërtesat e mbiekspozuara.

Masat për të reduktuar emetimet e zhurmës në burim janë me të efektshme. Emetimet e reduktuara të zhurmës nga burimet e saj mund të arrihet kryesisht përmes modernizimit të logjistikës në përdorim, riorganizimit të flukseve të trafikut dhe orareve të kryerjes së ndërhyrjeve infrastrukturore, etj. Qëllimi i SKZHI II në lidhje me vlerat e zhurmës në vitin 2020 është të arrije objektivin e 56 dB/ditë dhe 45 dB/natë.





9.8. POPULLLSIA DHE ASETET MATERIALE

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 10

Zhvillimet e reja infrastrukturore (sidomos qendrat multimodale të transportit) pritet që të shkaktojnë një rritje të niveleve të zhurmës në mjedisin përreth tyre. Për të shmangur një përkeqësim të mjedisit ku jetohet në zonën përreth këtyre zhvillimeve, ky fakt duhet të mbahet në vëmendje kur të behet verifikimi i mundësive për zhvillim në fazat e mëvonshme, në kuadër të sigurimit të një lidhje multimodale në rajonin përreth.

Projektet specifike duhet të kenë në fokus edhe garantimin që infrastruktura e re vihet në dispozicion të të gjithë përdoruesve. Kjo pritet të inkurajojë përfshirjen me aktive të komunitetit në kuadër të sistemeve infrastrukturore, në mënyrë që ta bëjë atë më të arritshme për të gjitha shtresat dhe kategoritë sociale.


Kur planifikohen politikat dhe projektet e reja, prioritet duhet t'i jepet përmirësimit të lidhjeve dhe zhvillimit në zonat më pak të zhvilluara. Zbatimi i projekteve të kësaj natyre do të përmirësojë aksesin, dhe kështu do të kontribuojnë në zhvillimin më të shpejtë ekonomik në zonat më pak të zhvilluara.

9.9. TRASHËGIMIA KULTURORE

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 11

Zhvillimi i infrastrukturës së parashikuar mund të ndikojë të njëjtit dhe zonat kulturore, veçanërisht në aspektin e degradimit të karakteristikave të peizazhit të rrethinave të njëjtit të trashëgimisë kulturore, dëmtimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, si dhe shkatërrimit të mbetjeve arkeologjike nga vibrimet gjatë ndërtimit të objekteve të cilat mund të shkaktojnë dëme në objektet e trashëgimisë kulturore. Për të shmangur këto ndikime, duhet të merren parasysh si më poshtë:

- ☐ Prioritet është shmangia e vendosjes së infrastrukturës së re në zonat e trashëgimisë kulturore. Duhet të ruhet sidomos integriteti dhe tiparet e peizazheve kulturore, zonave të ndikimit të trashëgimisë arkitektonike dhe mbetjeve arkeologjike.
- ☐ Në kuadër të ruajtjes së mbetjeve arkeologjike, aktivitetet në mjedis konsiderohen akte destruktive (p.sh. gërmimi). Do të duhet të kryhen hulumtime të shumta paraprake arkeologjike, rezultatet e të cilave do të duhet të merren parasysh kur të përcaktohet vendosja e infrastrukturës së re. Gjithashtu do të duhet të zbatohen masat për të ruajtur mbetjet arkeologjike.
- ☐ Zbulimet e një rëndësie të madhe mund të kërkojnë ndryshimin e punëve përgatitore (projektit) për një detyrë të veçantë. Në rast të zbulimit të gjetjeve apo mbetjeve arkeologjike, do të njoftohet menjëherë autoriteti përkatës. Zona më pas do të studiohet dhe mundësisht do të rrethohet; duke mos lejuar asnjë zhvillim të mëtejshëm në atë zone derisa çështja të zgjidhet sipas procedurave të përcaktuara.
- ☐ Në rastet kur vendet arkeologjike mund të rrezikohen nga aktivitetet e ndërtimit, vendi do të jetë i mbrojtur nga rrethimi për të parandaluar dëmtimin e paqëllimshëm ose si pasojë e neglizhencës ndaj arkeologjisë.
- ☐ Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja.
- ☐ E gjithë puna e ndërtimit do të jetë e kufizuar brenda korridorit të punimeve. Në rast se nevojiten më shumë hapësira ose aktivite të lidhura me ndërtimin jashtë korridorit të punimeve, do të informohen paraprakisht autoritetet kombëtare përkatëse.



9.10. PEIZASHI

Udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse për të arritur Objektivin Mjedisor 12

Për të siguruar ruajtjen e peizazheve të jashtëzakonshme, zonave të peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar dhe një imazh të cilësisë së larte të peizazhit, duhet të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

- ☐ Ndërhyrjet e infrastrukturës së re nuk duhet të integrohen në zonat e veçanta të peizazhit apo peizazheve me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
- ☐ Në integrimin hapësinor të projekteve specifike duhet të kërkohen vende jashtë zonave me peizazhe të veçantë apo zonave me peizazhe me karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
- ☐ Duhet të zbatohen masat e duhura teknike për të siguruar një imazh të cilësisë së larte të peizazhit, veçanërisht në rastin e aktiviteteve në njësitë e ruajtura apo të pasura kulturore të natyrës;
- ☐ Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja.


Bashkia Këlcyrë shquhet për larmishmërinë e peizazheve; nga lumore, bujqësore, kodrinore e deri në ato malore. Zona përbehet nga një territor tepër i larmishëm i cili zbërthehet në elemente të ndryshme natyrore, shumë prej të cilave janë monumente natyre.

Për efekt të karakterizimit më të plotë të peizazhit, por edhe të propozimit të masave më të detajuara të mbrojtjes së vlerave peizazhore, peizazhi i Bashkisë Këlcyrë do të ndahet në disa kategori kryesore, përfshirë peizazhin: (i) natyror (malor dhe ujor) (iii) rural urban (peri urban) dhe (iv) qytetar urban. Në funksion të mbrojtjes dhe përmirësimit të peizazhit, në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV), Bashkia Këlcyrë ka parashikuar marrjen e disa masave. Në vijim janë përshkruar disa nga këto masa të ndara sipas tipologjive të peizazhit.

Peizazhi natyror. synohet mbrojtja dhe përmirësimi i peizazhit natyror nëpërmjet shtimit të zonave të pyllëzuara dhe uljes së fragmentimit të zonave natyrore. Masa specifike për përmirësimin dhe mbrojtjen e peizazhit natyror fokusohen në:

- ☐ Ruajtjen dhe krijimin, aty ku mungojnë, të zonave ripariane të lumenjëve, të cilat janë përbërës të rëndësishëm të plotësisë të peizazhit të territorit të Bashkisë. Zonat ripariane luajnë rol të shumëfishtë. Së pari kanë funksion mbrojtës të tokës nga erozioni; së dyti, luajnë rolin e brezit buferik (zbutës) të ndalimit të ndotjes nga sipërfaqet bujqësore në drejtim të lumit; së treti, shërbejnë si korridor lidhës për habitatet, për strehimin dhe levizjen e specieve të ndryshme, dhe së katërti kanë ndikim pozitiv në përmirësimin e cilësisë së ajrit, zbutjen e klimës, etj.
- ☐ Ripyllëzimin e zonave të shpyllëzuara dhe të degraduara nga shkaqe të ndryshme që do të sillte një ndikim pozitiv në ruajtjen e njëtrajtshmërisë dhe të bashkimit të pjesëve të copëtuara të pyjeve, duke krijuar një peizazh pyjor të vazhdueshëm. Gjatë kësaj ndërhyrje duhet treguar kujdes i veçantë që drurët e përzgjedhur të jenë të njëjtit lloj që kanë qenë më parë ose të jenë lloje të cilat janë karakteristike për peizashin e zonës dhe që e kanë këtë territor habitatin e tyre.
- ☐ Mbjelljen e drurëve të cilat, karahas rregullimit të peizazhit, përshtaten me tokën dhe që mund të shërbejnë si mbrojtëse të tokës nga erozioni dhe që nuk përbëjnë rrezik për të prishur balancat me bimët e tjera (nuk janë invazive).
- ☐ Ndërtim shtegu për këmbësorë dhe biçikleta që lidh qytetin e Këlcyrës me Monumentin e Natyrës "Uji i Zi" në Grykën e Këlcyrës.

Peizashi rural dhe peri-urban. Synohet mbrojtja e peizazhit rural dhe përmirësimi i cilësisë së tij, duke e konsideruar si pjesë të pandashme të peizazhit natyror. Kjo do të arrihet nëpërmjet marrjes së masave specifike për rregullimin e elementëve të caktuar si:





- ☐ Përfshirja e elementëve të peizazhit gjatë hartimeve të planeve të zhvillimit të bujqësisë në mënyrë që, aty ku është e mundur, sektori i bujqësisë të përshtatet me përbërësit e tjerë të peizazhit apo të krijojë një peizazh, i cili nuk fragmenton në vijshmërinë vizive (edhe fizike aty ku është e mundur) të peizazhit.
- ☐ Rikualifikimet e qendrave të fshatrave Sukë, Katundishtë dhe Ballaban dhe rikualifikimi i hapësirave të shkollave të fshatrave Katundishtë, Sukë dhe Ballaban. Kujdes duhet të tregohet që të përfshihen sa me shumë elementë të peizazhit, por gjithmonë duke ruajtur karakteristikat e zonës dhe duke krijuar në këtë mënyrë një peizazh të ndërthurur dhe të pëlqyeshëm për banorët.
- ☐ Ruajtja mirëmbajtja e kanaleve vaditës/kultues dhe mbjellja e brigjeve të tyre me gjelbërim, duke krijuar "damarë" të gjelbër përgjatë parcelave bujqësore (kryesisht bimësi e ulët, barishtore dhe shkurre te vogla).

Peizazhi Urban. Synohet përmirësimi i këtij peizazhi dhe futja dhe ndërthurja e përbërësve të peizazhit natyror në brendësi të zonave urbane (sipërfaqe të gjelbra, dru, shkurre, sipërfaqe ujore). Kjo kërkon studime të hollësishme për qytetin e Këlcyrës, në mënyrë që peizazhi urban të ndërthuret me atë natyror dhe ky i fundit të mund të shërbejë, krahas të mirave mjedisore, si dekor urban. Masa specifike për përmirësimin e peizazhit urban në territorin e bashkisë janë:

- ☐ Ndërtimi i godinës së re për Bashkinë Këlcyrë dhe ndërtimi i Stadiumit të qytetit. Gjatë fazës së projektimit duhet të bëhet një analizë e thelluar të gjithë komponentët që e formojnë atë (arkitektura, historia, kultura, natyra, bimësia lokale) dhe duhet të gjendet mundësia që keto elementë të kombinohen me njeri tjetrin për të krijuar një peizazh të pëlqyeshëm dhe funksional
- ☐ Ruajtja e strukturës së pemëve përgjatë rrugëve, pra nëse aksi rrugor karakterizohet nga drurë bliri, që ka rezistuar në kohë dhe i është përshtatur klimës dhe tokës, rekomandohet që të ruhet kjo lloj bimësie, si dhe mundësisht të së njejtës madhësi dhe distancë nga njëra-tjetra, deri në fund të aksit për të ruajtur "formalitetin" që karakterizon këtë peizazh.
- ☐ Përzgjedhja e llojeve për tu mbjellë përgjatë akteve rrugore urban duhet të bëhet me kujdes. Mund të përzgjidhet vetëm një lloj, ose një kombinim 2-4 llojesh por sipas një tendence të përsëritur, që krijon elementin estetik dhe të rregullsisë në dizajnin e peizazhit rrugor. Si parim, diversiteti në ngjyrë, formë dhe lloj mund të arrihet në akset e tjera, por brenda të njëjtit aks bimët, forma, distanca dhe lloji i tyre rekomandohet të qëndrojnë të pa ndryshuara, ose në formacione të projektuara paraprakisht.
- ☐ Në hapësira të tjera publike ku do të mbillen pemë, karakteri formal i këtij peizazhi mund të thyhet nga pemë të mbjella rresht e të të njëjtit lloj, me pemë të së njejtës familje (gjetshore, halore, shkurre), por të mbjella në grupe, pra grupe me nga 3 apo 5 drurë në varësi të hapësirës.
- ☐ Ti kushtohet vëmendje "Xhepave Urbanë", ose thënë ndryshe hapësirat boshe, të patrajtuara mes pallateve apo ndërtesave të ndryshme të qytetit, të cilat fshehin një potencial të madh në trajtimin e peizazhit urban. Këto hapësira vërtetojnë se peizazhi nuk ka përmasë standarde dhe se është vetë elementi i përdorur në të, i cili nëpërmjet funksionit që ofron edhe në një hapësirë relativisht të vogël, sërisht ofron një shumëllojshmëri aktiviteteve e mjedisesh.
- ☐ Përfitime të tjera nga ruajtja e peizazhit: Ruajtja dhe konservimi i peizazhit natyror gjithashtu ka një sërë përfitimesh mjedisore, kryesisht në mbrojtjen e tokës, uljen e ndotjes, habitatit për specie e deri tek përfitimet ekonomik të drejtpërdrejta. Ndaj rekomandohet që gjatë zbatimit të projekteve nga PPV të merren në konsideratë të gjithë masat që janë dhënë për ruajtjen e peizazhit dhe përmirësimin e tij.



X. MONITORIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Monitorimi i mjedisit përshkruan proceset dhe aktivitetet që duhet të realizohen për të karakterizuar dhe monitoruar cilësinë e mjedisit. Monitorimi i mjedisit përdoret në përgatitjen e raporteve të vlerësimeve strategjike mjedisore të planeve apo programeve, si dhe në shumë rrethana në të cilat aktivitetet njerëzore mbartin rrezikun e efekteve të dëmshme në mjedisin natyror. Të gjitha strategjitë dhe programet e monitorimit kanë arsye dhe justifikime të cilat shpesh janë të dizajnuara për të përcaktuar statusin aktual të një mjedisi ose për të parashikuar tendencat e ardhshme në parametrat mjedisorë. Cilësia e programeve të monitorimit është kritikuar prej kohësh në shumë vende, së pari nisur nga zbatimi i pjesshëm i tij dhe, së dyti, nga dështimi për "ta përkthyer" atë në ndihmë të vendim-marrjes më të mirë mjedisore (da Silva Dias, 2017).

Pavarësisht debateve mbi cilësinë e tyre, monitorimi i ndikimeve në mjedis është jashtëzakonisht i rëndësishëm për zbatimin e Planit. Nga pikëpamja ligjore, në përputhje me Ligjin 91/2013 dhe Direktivën 2001/42/EC, zbatimi i një programi duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim të hershëm ndaj këtyre efekteve duke u paraprirë adaptime të mundshme.

10.1. KUADRI INSTITUCIONAL DHE LIGJOR DHE INSTRUMENTE QË LIDHEN ME MONITORIMIN E MJEDISIT

Monitorimi i mjedisit në vendin tonë bazohet në Ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", neni 19 "Mbrojtja e natyrës"; neni 41 "Monitorimi i gjendjes së mjedisit"; neni 45 "Qëllimi dhe funksionimi i sistemit të informacionit mjedisor dhe, neni 60 mbi "Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit". Proçedurat dhe rregullat e monitorimit përcaktohen në VKM nr.1189 të datës 18/11/2009 "Për rregullat dhe proçedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit" dhe në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (që përgatitet cdo vit). Monitorimi kryhet edhe në kuadër të detyrimeve që i lindin vendit tonë si rrjedhojë e marrjes së statusit të vendit kandidat në Bashkimin Europian, konkretisht, zbatimit të nenit 108 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) për "Zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër degradimit mjedisor" në zbatim të të cilit, Ministria e Mjedisit ka krijuar Sistemin e Integruar të Monitorimit të Mjedisit (SIMM).

Mbështetur në elementët e këtij sistemi është hartuar edhe Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit. Objektivi primar i Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit është të ndihmojë autoritetet kombëtare dhe vendimmarresit në arritjen e qëllimeve të politikës për një zhvillim të qëndrueshëm. Sistemi i monitorimit është përbërë nga stacionet e monitorimit që i përkasin rrjetit të monitorimit në mënyrë të specifikuar të krijuar për cdo komponent mjedisor sic janë, ajri, ujrati, toka, biodiversiteti dhe pyjet (Figura 34). Rrjeti ka qënë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislationit të BE-së. Stacionet dhe treguesit kanë qënë përzgjedhur në funksion të burimeve të disponueshme por dhe duke përmbyllur nevojat e politik-bërësve dhe informimin e publikut duke qënë në përputhje me kërkesat e legjislationit të BE-së.

Secili nga stacionet e monitorimit është i lidhur me një grup të parametrave që maten dhe analizohen, në bazën e të cilave llogariten, vlerësohen dhe përcaktohen treguesit mjedisorë të



cilësisë, presionit dhe ndikimit. Përcaktimi i treguesve mjedisorë është bërë në bazë të vlerësimit të fizibilitetit të tyre, rëndësisë për kushtet specifike të vendit dhe në radhë të parë për rëndësinë e dhënë nga Direktivat dhe legjislacioni i BE-së.




Figura 34. Rrjeti i treguesve të monitoruar për vitin 2017 (Burimi: AKM, 2016)

Qëllimi është që të krijohet një lidhje ndërmjet asaj çfarë do të monitorohet me atë se si do ti përdoren këto rezultate. Kjo lidhje realizohet me së miri duke përdorur kornizën DPSIR. Kjo kornizë (e miratuar si model kryesor të monitorimit të mjedisit nga EEA që nga viti 1999) lidh zhvillimet sociale - ekonomike me transmetimin (d) e ndryshimeve që ushtrojnë presion (P) në gjendjen (S) e mjedisit, të cilat çojnë në ndikimet (I) në shëndetin e njeriut, funksionimin e ekosistemit dhe ekonomisë. Së fundi, përgjigjet shoqërore dhe politike (R) ndikojnë në pjesët e mëparshme të sistemit, direkt ose indirekt.




10.2. PLANI I VEPRIMIT: MONITORIMI, TREGUESIT E VLERËSIMIT DHE INSTITUCIONE MONITORUESE

Plani i Monitorimit të zbatimit të PPV-së përcakton treguesit mjedisor mbi të cilët do të bazohet monitorimi, shpeshësia e monitorimit sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe institutet përgjegjëse për monitorimin e gjendjes në mjedis. Sipas legjislacionit në fuqi, treguesit mjedisorë janë *"ndryshorja që jep në mënyrë të përmbledhur dhe të thjeshtë, të dhëna për një dukuri mjedisore duke e bërë atë të perceptueshme nëpërmjet vlerësimit numerik nga matjet përkatëse"*. Dukuritë mjedisore lidhen me cilësinë e mjedisit, konkretisht të përbërësve të tij, shkarkimet në mjedis, ndotjen aktive, shkallën e dëmtimit dhe ruajtjes apo edhe masave të marra. Monitorimi i treguesve të mjedisit kryhet veçanërisht gjatë zbatimit të projekteve të parashikuara në Planin e Përgjithshëm Vendor

Në këtë kuadër, është hartuar edhe sistemi i monitorimit të ndikimeve kryesore në mjedis, të cilat pritet që të shkaktohen nga zbatimi i Planit. Këto ndikime janë identifikuar gjatë vlerësimit të ndikimeve mjedisore të Planit të Përgjithshëm vendor të Bashkisë së Këlcyrës. Sistemi i monitorimit përfshin të gjithë indikatorët përkatës për çdo sektor mjedisor (toka, cilësia e ajrit, ndryshimet klimatike, uji, biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura, trashëgimia kulturore, peizazhi, etj.) dhe identifikon autoritetin dhe përgjegjësinë për matjen apo vlerësimin e çdo indikatorit mjedisor të propozuar.

Nisur nga sa mësipër, në hartimin e programit të monitorimit, jemi bazuar në eksperiencën dhe në sistemet e monitorimit që përdoren nga strukturat e tjera. Programi i monitorimit, nga njëra anë vë në dukje, monitorimin e zbatimit të standardeve të nevojshme të matjeve nga strukturat e tjera, dhe kryesisht nga operatorët përkatës (përmes përfshirjes së tyre në procesin e nxjerrjes së lejeve përkatëse mjedisore), dhe nga ana tjetër, përqendrohet tek procesi i grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave.

Plani i Monitorimit të zbatimit të PPV-së Këlcyrë ka përcaktuar edhe institucionet përgjegjëse të cilat do të duhet të monitorojnë treguesit mjedisorë për vlerësimin dhe zbatimin e masave të parashikuara në VSM sipas fushave të përgjegjësisë përkatëse. Institucionet përgjegjëse përfshijnë "institutet, laboratorët e qendrat kërkimore-shkencore private e publike të kontraktuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të kryer monitorimin e treguesve konkretë të dukurive natyrore të cilësisë". Institucionet shtetërore, qoftë në nivel kombëtar apo edhe rajonal si Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Inspektoritati Mjedisor, Drejtoria e Mjedisit në Bashkinë Këlcyrë do të nevojitet të bashkërendojnë punën në mënyrë që të realizojnë inspektimet në terren për mbarëvajtjen dhe respektimin e kushteve të pëlqimeve apo lejeve mjedisore të projekteve. Më poshtë është paraqitur Plani i veprimit, monitorimi dhe treguesit e vlerësimit për PPV-në e Bashkisë Këlcyrë (Tabela 31).





4
STUDIO ARHITEKTUR

STUDIO ARHITEKTUR
SHKËRIMET
DHE
PROJEKTET
DHE
DOKUMENTET
DOKUMENTET



ATL
Café

Gejfe



Tabela 31. Programi i monitorimit të mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së Këlcyrë

Nr.	Objekti i Mjedisit	Treguesi i Mjedisit	Autoriteti i Monitorimit	Parametrat Fizik	Frekuenca e Monitorimit
1.	Toka	- Përbajtja në lëndë ushqyese e tokës - Ndodja (metalet e rënda dhe përbërësit organikë) - Sipërfaqja bujqësore/ natyrore/ kullimore e humbur nga fondi bujqësor, për shkak të ndryshimit të përdorimit të saj (për ndërtim, infrastrukturë, etj.) - Sipërfaqja e tokës së trazuar/ degraduar (gërryer, rrëshqitur) - Niveli/shkalla e erozionit - Burimet ujore që preken drejtpërdrejt nga erozioni i tokës ku zbatohet një projekt - Shkarkimet industriale në tokë nga mjetet e rënda.	- Universiteti Bujqësor - Instituti i Shëndetit Publik - Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit - Inspektoriati i Mjedisit - SHGJSH - Dr. Rajonale e Bujqësisë - Minitria e Bujqësisë - Min. e Transporteve - Bashkia (Dep. Mjedisit) - AKM dhe ARM - Fakulteti i Shkencave të Natyrës, - Universiteti Politeknik - IGJEUM - QTTB	- Na, Cl, SO₄, trashësia humurore, raporti Mg/Cl, aciditeti, raporti N/C, metalet e rënda - Sasia e tokës së humbur (ton/ha) - Sasia e naftës në mjedis - Nr. dhe lloji i fragmentimit - Vlera e tokës djerr - Përqëndrimi i kimikateve dhe pesticideve në tokat bujqësore - Shkalla e pjelloris në raport me të dhënat kombëtare	10 vende, 2 herë /vit - Raportim 12 herë / vit - Analizat biologjike dhe kimike të tokës, 4 herë / vit
2	Ajri	- Sasitë vjetore të shkarkimeve në qendrat urbane - Shpërndarja e shkarkimeve (trëndafil i erës) - Sasia vjetore e elementëve të rëndë - Niveli i grimcave PM në ajër - Niveli i gazit sulfurik në ajër - Gilësia e ajrit në qendrat e NJA-ve - Shkarkimet nga transporti - Gjendja e filtrave dhe sistemeve të shkarkimit nga industria e rëndë dhe sektori privat.	- Instituti i Shëndetit Publik - Agjencia Kombëtare e Mjedisit - Inspektoriati i Mjedisit - Shërbimi Gjeologjik - Min. e Transporteve - Bashkia (Dep. Mjedisit) - AKM dhe ARM - Fakulteti i Shkencave të Natyrës, - Universiteti Politeknik – Inzhinieria e Mjedisit, IGJEUM	- PM_{2.5} dhe PM₁₀ - SO_x - NO_x - GHG - Pb - CO dhe CO₂ - CFCs - Vizibiliteti - Shkalla e erësimit - Dioksina dhe furanet - Benzenet C₆H₆ - Ozoni O₃	10 vende, 2 herë /vit - Raportim 12 herë / vit - Analizat biologjike dhe kimike të tokës, 4 herë / vit
3	Faktorët klimatike	- Shkarkimet e Gazeve Sere - Shkarkimet sipas burimit (%) - Zhvillimi i kërkesës për energji	- Agjencia Kombëtare e Mjedisit - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	SO_x, NO_x, PM₁₀, gazet sere, Pb, CO	Çdo vit

Geoffrey

STUDIO ARCHITECTURE

STUDIO ARCHITECTURE
ARCHITECTURE
DESIGN
CONSULTING
ENGINEERING
LANDSCAPE ARCHITECTURE
INTERIOR DESIGN
CONSTRUCTION MANAGEMENT



4 Ujërat	- Allokimi i prodhimit të energjisë sipas burimit - Përqindja e BER26 (%) - Evoluimi i numrit të automjeteve të udhëtarëve - Cilësia ujrave sipërfaqësore - Cilësia e ujërave nëntokësore - Cilësia e ujërave për ujtje - Pikat e shkakimit të ujërave të ndotura industriale. - Pikat e shkakimit të ujërave të ndotura urbane - Cilësia e ujit për konsum publik - Koeficienti i shfrytëzimit të ujit - Niveli i trajtimit të ujërave të ndotura - Popullsia e lidhur me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura - Disiplinimi i ujërave të larta	- Enti Rregullator i Energjisë - Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor - Autoriteti i Menaxhimit të Baseneve Ujore - IGJEU - Fakulteti i Shkencave të Natyrës - Këshilli Teknik i Ujit - Ajencia Kombëtare e Mjedisit - Shërbimi Gjeologjik Shqiptar - Instituti i Shëndetit Publik - IGJEU - Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	- Përqindja e Energjisë nga BER (%) - Numri i automjeteve të udhëtarëve - NBO5 dhe NKO - Metalet e rënda (Pb, Zn, Cu, Ni, Co, Cr, Cd) - Aciditeti dhe pH - Koeficienti i shfrytëzimit të ujërave të ëmbla - Temperatura - Fortësia - Mbajtjet e thata - Përmbajtja e Na, Ca, Mg, Cl dhe sulfatave - Prania e nitriteve dhe nitrateve - Prania e pesticideve - Niveli statik dhe dinamik i ujërave nëntokësore - Përgjellshmëria - HCO3 dhe CO3 - Sipërfaqja e zonave të mbrojtura - Sipërfaqja e mbuluar me bimësi natyrore dhe pyje. - Numri i habitateve të identifikuar - Numri i specieve në rrezik dhe atyre të kërcënuara - Numri i llojeve të rralla dhe endemike. - Ndërhyrjet në popullatat e	- Ngritja e 4 stacioneve shtesë të monitorimit për lumin Vjosa dhe Dëshnicë - Monitorim 2 herë në muaj të rezervuarëve të ujërave të ëmbla - Monitorim 2 herë në muaj për depot e ujit të pjishëm 12 herë në vit për ujërat nëntokësore 4 herë në vit mbi cilësinë e ujërave për bujqësi Çdo muaj 12 herë / vit
5 Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura	- Statusi i habitateve të rëndësishme dhe prioritare - Numri dhe sipërfaqja e zonave të mbrojtura - Lamia e ekosistemeve - Identifikimi i specieve në territorin e Bashkisë - Xhapat natyrorë në sipërfaqet ujore - Shtigjet natyrore - Inventarizimi (të gjitha kategoritë) - Specifikimi i standardeve sipas trajtimit të BE-së	- Ajencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura - Administrata e Zonave të Mbrojtura - Drejtoria e Zhvillimit Rajonal dhe Integrimit - Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve - Ojft - Ministria e Mjedisit		



AGJENCIA E SHQIPËRE
E PLANIMIT TERRITORIAL
DHE URBANITETI
TIRANE

	Identifikimi i specive të rrezikuara, të kërcënuara dhe të zhdukura Shqetësimi nga zhurmat		Drejtoria e Punëve Publike në Bashki Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve Njësitë Administrative Ministria e Infrastrukturës, Energjisë dhe Zhvillimit Urban Oj-të	Gitarëve, zogjve dhe të, Jovetebrore	Çdo muja
6	Mbetjet	Sasia totale mbetjeje Volumi total i mbetjeje të ngurta Volumi total i mbetjeje familjare Sasia që arrihet të grumbullohet nga Bashkia. Mbetjet inorganike dhe të rrezikshme Mbetjet spitalore Vend-depozitimet			
	Zhurmat	Niveli i zhurmave Lloji i zhurmave Burimi i zhurmave Tendanca e zhurmave Shqetësimi nga zhurmat	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore Enti Rregullator i Energjisë Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor	Sipërfaqet në ndërtim, Numri i makinave në trafik, Numri i makinave mbi 5, 10, 15 apo 20 vjet	Çdo vit
8.	Popullata dhe asetet materiale	Jetëgjatësia mesatare e popullsisë Përbajtja e hidrokarbureve në ajër Aksidentet në punë dhe në rrugë Familjet nën minimumin jetik Disponueshmëria e shërbimit shëndetësor Niveli i trajtimit të urgjencave Disponueshmëria e ilaçeve farmaceutike Numri i banesave dhe pronësia e tyre	Ministria e Shëndetësisë Instituti i Shëndetit Publik Inspektorati Mjedisor Inspektorati i Punës AKM-ARM Bashkia Këlyre	Mosha mesatare vjet/muaj Nr. i aksidenteve Nr. i të sëmurëve (kardio-respirator-toksik) Statusi dhe niveli i shërbimit shëndetësor Numri i NIEF Numri i banesave të reja Banesa në pronesi	Monitorim mujor Raportim 4 herë në vit
9.	Trashëgimi Kulturore	Objektet e kultit fetar Objektet e trashëgimisë kulturore Objektet e trashëgimisë historike Pasuritë arkeologjike Sitet arkeologjike Trashëgimia arkitektonike dhe mjedisore	Ministria e Kulturës Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë Shërbimi Arkeologjik Shqiptar Drejtoria Rajonale e Kulturës IKMT Bashkia Këlyre	Gjendja e objekteve të kultit Gjendja e objekteve dhe vendeve të trashëgimisë historike e kulturore Numri i vizitorëve në keto objekte	Monitorim mujor Raportim 4 here ne vit

10. Peizazhi	• Godina dhe vepra me vlera të larta historike e arkitektonike. • Siperfaqet e gjelbërta urbane • Gjendja e parqeve të bashkisë • Sip. me gjelbërim të infrastrukturës Rrugore • Ripullezimi i hapësirave të parashikuara në PPV. • Zonat ripariane përgjatë brigjeve të lumit Vjosa • Korsitë e biçikletave dhe stëngjet e gjelbërta • Dëmtimet nga karrierat dhe guroret • Dëmtimet nga erozioni, zjarret, shpyllëzimet	• Instituti i Monumenteve të Kulturës. • Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit • Inspektorati i Mjedisit • Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit • Ministria e Turizmit dhe Mjedisit • Bashkia (Dep. Mjedisit dhe Pyjeve) • ARM • OJF-të • Policia Bashkiake/ Policia e Shtetit	• Siperfaqe e gjelber për banor në qytet • Sip. e pyllëzuar/park për banor në Bashki • Sip. e dëmtuara nga guroret dhe karrierat • Sip. e rehabilituara të zonave ripariane • Brezat e gjelbërimit përgjatë infrastrukturës rrugore	• Monitorim në terren. • Vazhdueshëm dhe përditshëm • Raportimi 1 herë në muaj
--------------	---	---	---	--



10.3. PROBLEMATIKA TË MONITORIMIT TË MJEDISIT QË DUHET TË MERREN NË KONSIDERATË

Vitet e fundit, vendi ynë ka bërë hapa të rëndësishëm për monitorimin e mjedisit. Programi Kombëtar i monitorimit i jep rëndësi identifikimit të problematikave të përbërësve fizikë të mjedisit, me qëllim përmirësimin e gjendjes së tij. Në bazë të tij kryhen monitorime me një frekuencë të caktuar kryesisht vjetore në bazë të të cilave përgatitet edhe Raporti i Gjendjes në Mjedis, i cili është instrumenti kryesor që paraqet gjendjen reale të mjedisit.

Monitorimi i mjedisit gjatë zbatimit të PPV-së së Bashkisë Këlcyrë, do të tregojë ndikimin në shkallë të gjerë të zbatimit të PPV-së në mjedis. Megjithatë, duke patur parasysh se monitorimi i mjedisit ka kufizimet e tij, supozohet që matja e ndikimit real të projekteve të PPV-së në territorin gjatë fazës së zbatimit, mund të mos jetë e plotë. Kjo për disa arsye të cilat janë shpjeguar në vijim.

Numri i kufizuar i pikave të monitorimit. pothuajse për të gjithë përbërësit fizikë mjedisorë si ajri, ujërat sipërfaqësorë e nëntokësorë, toka, etj. Kështu, në rastin e ujërave sipërfaqësorë, baseni i lumit Vjosa (Vjosa dhe Drinosi) monitorohet vetëm në 8 pika, ndërkohë, që pellgu ujqor vetëm i lumit Vjosa është 3060 km² dhe e kryqëzon vendin tonë nga jug-lindja deri në perëndim. Duke qenë se lumi kalon në zona të ndryshme me aktivitete të shumëllojshme, numri i pikave duket i pamjaftueshëm për paraqitjen e gjendjes reale të këtij lumi.

Ajri monitorohet në 51 stacione monitorimit të vendosura në 14 qytete, por në Bashkinë e Këlcyrës nuk ka stacione monitorimi fikse. Monitorimi ndodh rutinë në qytetet me stacione të përhershme dhe në qytetet kryesore ku janë vërejtur tejkallime (Tiranë, Korçë, Shkodër, Vlorë, Durrës, dhe Elbasan). Në Bashkinë Këlcyrë nuk parashikohen monitorime të tilla. Parametrat që synohet të monitorohen gjatë viti 2018 sipas Programit të Monitorimit të Mjedisit 2015 (PMM) janë SO₂, NO₂ (NO_x), CO, O₃, Benzene, PM₁₀ (PM_{2.5}) dhe metalet e rënda.

Mungesa e laboratorëve të specializuar për monitorimin e përbërësve klorurë, PCB-ve, pesticideve dhe PAHs. parametra të tillë janë të pranishëm në vendet ku vepron industria e rëndë. Si rrjedhojë, lind nevoja e monitorimit të vazhdueshëm, sidomos në ujërat nëntokësorë, për të patur një pasqyrë të gjendjes së tyre si dhe për të kuptuar ndikimin e ndotësve në shëndetin e njeriut. Duke qenë se shumë nga këto ndotës janë të rrezikshëm për shëndetin e njeriut, monitorimi i tyre është i domosdoshëm. Megjithatë, me gjithë rëndësinë që parametrat në fjalë kanë si tregues të gjendjes së ujërave nëntokësorë, nuk monitorohen për shkak të mungesës së kapaciteteve të laboratorëve për të kryer matje të tilla. Në këtë mënyrë, është pothuajse e pamundur të kuptohet se cili është ndikimi i shumë industrive që shkarkojnë ndotës të tillë në shëndetin e popullsisë të zonave përreth.

Frekuenca e kufizuar e monitorimit të ujërave. sipas PKM-së, ujërat e lumenjve monitorohen zakonisht 4 herë në vit për ushqyesit e ujit, 1 herë në vit për kampionët dhe parametrat e tjerë, dhe 2 herë në tre vite për sedimente. Duke patur parasysh gjendjen jo të mirë në të cilën ndodhen lumenjtë tanë, shpeshësia e monitorimit të parametrave të përbërësve fizikë të mjedisit duket e pamjaftueshme.

Mungesa e laboratorëve në institucionet përgjegjëse për monitorimin e mjedisit: Institucionet përgjegjëse për monitorimin e mjedisit në vendin tonë janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministër i Infrastrukturs dhe Energjisë si dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (VKM nr. 1189, datë 18.11.2009). Një mangësi që vihet re është fakti se institucionet e ngarkuara me ligj për monitorimin e mjedisit nuk janë të pajisura me laboratorë dhe shpeshherë, monitorimi i treguesve të dukurive natyrore të cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe të biodiversitetit kryhet nga institucione monitoruese të specializuara jashtë tyre, të cilat kanë marrëdhënie kontraktuale me institutet e monitorimit. Në këtë mënyrë krijohen hapësira për vonesa apo mangësi të ndryshme në monitorimin e mjedisit për shkak të procedurave të tenderimit.

Prandaj, për përmirësimin e monitorimit të mjedisit gjatë zbatimit të projekteve të PPV-së dhe projekteve të tjera që zbatohen në Bashkinë Këlcyrë, është e nevojshme që të merren masa për eliminimin e problematikave të lart-përmendura.

XI. BIBLIOGRAFIA

1. Agolli, M., Terpo, M., Terpo, D., & Meçi, E. (2014). Tourist-environmental assessment of Përmet District, traditional food processing and the typical products of the area. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 5(13), 36.AKM (2009).
2. Akademia e Shkencave të Shqipërisë. (1984). Klima e Shqipërisë. Instituti i Hidrometeorologjisë, Tiranës
3. AKM (2011). Raporti i Gjëndjes së Mjedisit 2010. 220 pp.
4. AKM (2013). Raporti i Gjëndjes së Mjedisit 2012. 252 pp.
5. AKM (2015). Raporti i Gjëndjes së Mjedisit 2014. 130 pp.
6. AKM (2016). Programi Kombëtar I Monitorimit të Mjedisit për Vitin 2017. 108 pp.
7. AKM (2017). Programi Kombëtar I Monitorimit të Mjedisit për Vitin 2018. 104 pp.
8. AKM (2017). Raporti i Gjëndjes së Mjedisit 2016. 368 pp.
9. Aliaj, S., Koçiu, S., Muço, B., & Sulstarova, E. (2010). The seismicity, seismotectonics and seismic hazard assessment in Albania. Akademia e Shkencave të Shqipërisë. 312 pp.
10. Aliaj, Sh., Baldassarre, G., & Shkupi, D. (2001). Quaternary subsidence zones in Albania: Some case studies. *Bull. Eng. Geol. Env.* 59, pp. 313-318.
11. Aliu, S., & Bejko, L. (2005). Fibulat e varrezave të Kolonjës/The Fibulae of the Kolonjë Cemeteries. *Iliria*, 32(1), 59-103.
12. Avramoski, E., Erg, B., & Pezold, T. (2016). Initial Assessment of Protected Areas in Albania using the Management Effectiveness Tracking Tool. IUCN Regional Office for Eastern Europe and Central Asia. [https://www.iucn.org/sites/dev/files/content/documents/2016/analysis_of_mett_results_final.pdf]
13. Bardhi, N., Stefkov, G., Karapandzova, M., Cvetkovikj, L., & Kulevanova, S. (2015). Essential oil composition of indigenous populations of *Hypericum perforatum* L. from southern Albania. *Macedonian Journal of Chemistry and Chemical Engineering*, 34(2), 333-341.
14. Barina, Z., Rakaj, M., Somogyi, G., Erős-Honti, Z., & Pifkó, D. (2014). The alien flora of Albania: history, current status and future trends. *Weed research*, 54(2), 196-215.
15. Bashkia Këlcyrë. (2016). Plani Operacional i Zhvillimit Lokal. Përgatitur nga: Instituti i Kërkimeve Urbane. 36 pp
16. Bego, F. (2005). On the status and distribution of the large carnivores (Mammalia: Carnivora: brown bear, wolf and lynx) in Albania. *Albanian J. Nat. Tech. Sci.* 1, 41-53.
17. Bego, F., & Hysaj, E. (2013). Influence of the artificial water reservoirs in the feeding strategy and distribution of the otter (*Lutra lutra*) along the Drinos river valley, Albania. In: *International Conference of Ecosystems (ICE)* Tirana, Albania. Proceeding Book (pp. 156-163).
18. Bidaj, F., Bako, A., & Hoxha, A. (2016). Finding balance between HPP of Vjosa river and sustainable development of Albania. In: *The Vjosa Science Conference. The Vjosa – A unique opportunity for European River Science. Faculty of Natural Sciences.* University of Tirana, June 8th, 2016.
19. Cfarku, F., Xhixha, G., Bylyku, E., Zdruli, P., Mantovani, F., Përpunja, F., Callegari, I., Guastaldi, E., Kaçeli, M.X. and Thoma, H. (2014). A preliminary study of gross alpha/beta activity






- concentrations in drinking waters from Albania. *Journal of Radioanalytical and Nuclear Chemistry*, 301(2), 435-442.
20. Ciavola, P., Tessari, U., Mantovani, F., Marzotto, M., & Simeoni, U. (2000). Coastal Zone Geomorphological Mapping Using Landsat TM Imagery: An Application in Central Albania. *Remote Sensing for Environmental Data in Albania. A Strategy for Integrated Management*, 153-163.
 21. Çomo, E., Nuro, A., Murtaj, B., Marku, E., Shehu, E., & Emiri, A. (2013). Study of Some Organic Pollutants in Water Samples of Shkumbini River, Albania. *Journal of International Environmental Application and Science*, 8(4), 573.
 22. Cullaj, A., Hasko, A., Miho, A., Schanz, F., Brandl, H., & Bachofen, R. (2005). The quality of Albanian natural waters and the human impact. *Environment International*, 31(1), 133-146.
 23. da Silva Dias, A. M., Fonseca, A., & Paglia, A. P. (2017). Biodiversity monitoring in the environmental impact assessment of mining projects: a (persistent) waste of time and money?. *Perspectives in Ecology and Conservation*, 15(3), 206-208.
 24. Dida, M., Ducci, F., & Zeneli, G. (2001). Black pine (*Pinus nigra* Arn.) resources in Albania. *Forest Genetic Resources* (FAO). 29:43-46
 25. Dinaj, V. D. (2013). Terrestrial Photogrammetry in Albania and Its Contribution in Geophysical Researches. In: *7th Congress of the Balkan Geophysical Society*.
 26. Dragoti, N. (2015). "Treva e Përmetit në Periudhën e Viteve 1912-1944". Disertacion në kërkim të gradës "Doktor i Shkencave". Universiteti i Tiranës. (<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/04/Doktoratura-Nuri-Dragoti-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Historise1.pdf>)
 27. Duri, V. (2017). The Albanian Family Characteristics (Socio-Geographic) during the Transition Period (in the Southwest Region of Albania). *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 5(351), 487.
 28. Eftimi, R. (2010). Hydrogeological characteristics of Albania. *AQUA mundi*, 1, 79-92.
 29. Eftimi, R., & Frashëri, A. (2016). Thermal Waters of Albania. In *Mineral and Thermal Waters of Southeastern Europe* (pp. 115-130). Springer International Publishing.
 30. Elsie, R. (1998). *Dendronymica Albanica: A survey of Albanian tree and shrub names*. Zeitschrift für Balkanologie, 34, 163-200. European Commission (2007). Interpretation Manual of European Union Habitats. DG Environment. 144 pp.
 31. Eröss, Z. P., Fehér, Z., & Szekeres, M. (1999). Seven new taxa of the subfamily Aloiinae (Gastropoda: Pulmonata: Clausiliidae) from the Balkans. *Annalen des Naturhistorischen Museums in Wien. Serie B für Botanik und Zoologie*, 445-452.
 32. Ferraj, B., Susaj, L., Novaku, R., Skendaj, E., & Terpollari, A. (2011). The reconstruction of cultivare Lutz Golden apple grafted on M9 rootstock. *Research Journal of Agricultural Science*, 43(2), 174-181.
 33. Fortlage, C. A. (2017). Environmental assessment: a practical guide. Taylor & Francis.
 34. Fouache, E., Gruda, G., Mucaj, S., & Nikolli, P. (2001). Recent geomorphological evolution of the deltas of the rivers Seman and Vjosa, Albania. *Earth Surface Processes and Landforms*, 26(7), 793-802.




35. Frasheri, A., & Pano, N. (2003). Impact of climate change on Adriatic Sea hydrology. *Elsevier Oceanography Series*, 69, 92-96.
36. Frasheri, A., Bushati, S., & Bare, V. (2009). Geophysical outlook on structure of the Albanides. *Journal of the Balkan Geophysical Society*, 12(1), 9-30.
37. Frasheri, A., Bushati, S., & Pano, N. (2005). Geophysical features of the Alpine Mediterranean Folded Belt, in the Albanides framework. In *SEG Technical Program Expanded Abstracts 2005* (pp. 735-738). Society of Exploration Geophysicists.
38. Frashëri, A., et al. (2004). Atlasi i Burimeve të Energjisë Gjeotermale në Shqipëri. Universiteti Politeknik i Tiranës. (<http://itc.upt.al/~nfra/projects/geothermal/AlbanianGeothermalAtlasSmall.pdf>)
39. Gjeçi, E., Karaja, T., Xhixha, G., & Shyti, M. (2015). Characterization of natural radioactivity in building materials. *PROCEEDINGS BOOK*, 144.
40. Haxhiu, I. (1998). The Reptilia of Albania: Species composition, distribution, habitats. *Bonner Zoologische Beitrage*, 48, 35-58.
41. Hoxha, V., Diamanti, F., Milushi, I., & Mekshiqi, N. (2013). Some Features of the Evaporite Formation of Albania. *Journal of International Environmental Application and Science*, 8(2), 174.
42. Hysaj, E., Bego, F., Prigioni, C., & Balestrieri, A. (2013). Distribution and marking intensity of the Eurasian otter, *Lutra lutra*, on the River Drinos (southern Albania). *Folia Zoologica*, 62(2), 115-120.
43. INCA (2017). Vlerësimi i gjëndjes së problematikave mjedisore dhe të zonave të mbrojtura në Shqipëri. REC. 38 pp.
44. Jahn, T., Aschemann, R., Sadler, B., Partidario, M., & Verheem, R. (2012). Handbook of strategic environmental assessment. Routledge.
45. Jallo, C. (2015). Medicinal and Aromatic Plant Production and Use in Albania: Historic and Modern Effects on Trade Policy, Poverty & Culture (Doctoral dissertation, University of California, Davis).
46. Jata, I., Reci, H., & Kavaja, V. (2012). Detection of Hazard Zones over Abandoned Mines of Albania through Geophysical Methods. *Journal of Earth Science and Engineering*, 2(12), 704.
47. Kabo, M. (ed). (1990-91). Gjeografia Fizike e Shqipërisë, Vol. I (400 pp.) dhe II (590 pp.). Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Qendra e Studimeve Gjeografike, Tiranë
48. Kamberi, Z., Kodhelaj, N., Bozgo, Sh., Frashëri, A., Çela, B., Aleti, R., Thodhorjani, S., & Zeqiraj, D. (2014). Potential of Bënja Geothermal Springs for Direct Utilization. *Journal of Earth Science and Engineering*, 4, 684-692.
49. Karydas, C. G., Zdruli, P., Koci, S., & Sallaku, F. (2015). Monthly Time-Step Erosion Risk Monitoring of Ishmi-Erzeni Watershed, Albania, Using the G2 Model. *Environmental Modeling & Assessment*, 20(6), 657-672.
50. Kashta, L., & Shuka, L. (2016). Riparian landscape structure and vegetation ecology of the Vjosa river. In: The Vjosa Science Conference. *The Vjosa – A unique opportunity for European River Science*. Faculty of Natural Sciences. University of Tirana, June 8th, 2016.





51. Kaza, Gj. (2012). "Struktura e mineralizimit kuarc sulfur të lokalizuar në shkëmbinjtë gabror të masivit të Kaptinës dhe perspektiva e mëtejshme e kërkimit". Disertacion në kërkim të gradës "Doktor i Shkencave". Universiteti Politeknik i Tiranës. (<http://dibmin-fqim.org/doktorata/DisertacioniGjKaza.pdf>)
52. Kellezi, L., Allkja, S., & Hansen, P. B. (2005). Landslide FE stability analysis. Proceedings of the IACMAG. Italy, 545-553.
53. Kociaj, S., & Pitarka, A. (1990). A check-up on seismic hazard assessment: Tirana case study. *Natural Hazards*, 3(3), 293-303.
54. Kolaneci, M., Mato, Xh. (2015). Raport i Shpejtë Vlerësimi pas Përmbytjes së shkaktuar nga Lumi Vjosë REC. 26pp
55. Kopali, A., Teqja, Z., & Rota, E. (2013). The influence of conventional and biological systems cultivation of plants on edafic biodiversity. In *Fourth International Scientific Symposium "Agrosym 2013", Jahorina, Bosnia and Herzegovina, 3-6 October, 2013. Book of Proceedings* (pp. 750-753). Faculty of Agriculture, University of East Sarajevo.
56. Kosho, P., Dema, S., Ballushi, S., & Papaqako, M. (2005, October). Some Results Of Magnetic Regional Survey, Carried Out In Rehova-Erseka Area. In *4th Congress of the Balkan Geophysical Society*.
57. Kuçaj, S., & Strati, B. (2014). The Use of High Resolution Satellite MTI for Detecting and Monitoring Landslide and Subsidence Hazards in Tirana. *Sat*, 3, 2007.
58. Lazo, P., Marku, E., & Kumanova, Xh. (2016). Quality of waters in the Vjosa catchment – physical chemistry, nutrients, heavy metals and organic pollutants. In *The Vjosa Science Conference. The Vjosa – A unique opportunity for European River Science. Faculty of Natural Sciences*. University of Tirana, June 8th, 2016.
59. Leopold, L. B. (1971). A procedure for evaluating environmental impact (Vol. 28, No. 2). US Dept. of the Interior.
60. Lipo, S., & Hoxha, E. (2003). Environment and Infrastructure Mining Damages Rehabilitation. In *3rd International Scientific Conference-SGEM2003* (pp. 343-365). SGEM Scientific GeoConference.
61. Mahmutaj, E. (2015). "Studimi dhe kartografimi i habitateve dhe florës së Parkut Kombëtar Tomorr-Kulmak, me fokus kryesor ata prioritarë (sipas Natura 2000), të rrallë e të kërcënuar". Disertacion në kërkim të gradës "Doktor i Shkencave". Universiteti i Tiranës. (<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2015/09/Doktoratura-Ermelinda-Mahmutaj-Fakulteti-i-Shkencave-i-Natyrore-Departamenti-i-Biologjise.pdf>)
62. Mahmutaj, E., Hoda, P., & Shuka, L. (2013). On the flora and habitat types of the western part of National Park of Tomori. *Bulletin of Natural Sciences (Tirana University)*, 15, 156-173.
63. Mahmutaj, E., Hoda, P., & Shuka, L. (2014). Rare plants and their conservation status in Tomorri National Park. *Journal of Endocytobiosis and Cell Research*, 25, 27-32.
64. Mahmutaj, E., Shuka, L., Xhulaj, M., Hoda, P., & Mersinllari, M. (2015). Rare and endemic plants in the southern mountain ecosystems of Albania, their threats and diversity. *Albanian Journal of Agricultural Sciences*, 14(1), 1-10.







65. Marka, J., Papp, B., Erzberger, P., Colacino, C., & Sabovljević, M. (2012). Towards Red List of the Albanian bryophytes. *Studia Botanica Hungarica*, 43, 13-25.
66. Merkohasanaj, M., Bogdani-Ndini, M., Demiraj-Bruçi, E., Lushaj, B. M., Lushaj, A., Lushaj, A., Isufaj, E., Sina, K., Isufaj, S., Kodra, E. and Sopaj, E. (2013). Climate Changes and the Expected Impact to the Transboundary Water Resources in Vjosa River Catchment, Albania. *Journal of Environmental Science*, 2(3), 501-505.
67. Mersinllari, M. (1988) Vështrim gjeobotanik i ahishteve të vendit tonë. Universiteti I Tiranës (Disertacion)
68. Mersinllari, M. (1994): Karakteristika të përgjithëshme të ahishteve dhe klasifikimi gjeobotanik i tyre. Buletini i Shkencave të Natyrës (1-4)
69. Mersinllari, M., Shuka, L., Xhulaj, M., Draçi, B., Miho, A., Hasko, A., & Liçaj, A. (2009). Vegetation and Land Cover in the Bovilla Watershed. Bovilla (Albania) Limnological Study/Studim Limnologjik.–Faculty of Natural Sciences, University of Tirana, 203-330.
70. Mesiti, A., & Dinga, L. (2016). Floristic Investigation of the "Grand Park of Tirana" with regard to urban indicators. *Biologica Nyssana*, 7(2).
71. Miho, A., Shuka, L., Çullaj, A., Bachofen, R. (2009). Environmental Analyses of Bovilla watershed (Albania) –An Overview. Bovilla (Albania) Limnological Study/Studim Limnologjik.–Faculty of Natural Sciences, University of Tirana, 12-46
72. Miho, A., Paparisto, A., Beqiraj, S., Hamzaraj, E., Hysko, M., & Puto, K. (2016). Biological quality of waters in the Vjosa catchment. *In: The Vjosa Science Conference. The Vjosa – A unique opportunity for European River Science. Faculty of Natural Sciences. University of Tirana, June 8th, 2016.*
73. Ministria e Mjedisit. (2016). Third National Communication of the Republic of Albania under the United Nations Framework Convention on Climate Change. [https://unfccc.int/files/national_reports/non-annex_i_natcom/application/pdf/albania_nc3_13_october_2016.pdf]
74. Muka, E., Panariti, N., Baca, P. (2014). Plani i Menaxhimit të Mbetjeve për Qarkun Gjirokastrë. Përgatitur nga: Grotmij. 130 pp.
75. Mullaj, A., Shehu, J., Tan, K., & Imeraj, A. (2010). New records for the Albanian flora. *Botanica serbica*, 34(2), 163-167.
76. Neziri, A., Marku, E., & Nuro, A. (2010). Identification of Polychlorinated Biphenyls in Shkodra Lake Water using Bottle Sampling and Passive Sampling Technology. *Asian Journal of Chemistry*, 22(10), 7850.
77. Noble, B., & Nwanekezie, K. (2017). Conceptualizing strategic environmental assessment: Principles, approaches and research directions. *Environmental Impact Assessment Review*, 62, 165-173.
78. NRDP. (2009). Plani i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave për Komunën Çarshovë- Përmet. Përgatitur nga: EuroFlorex Trade shpk
79. NRDP. (2009). Plani i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave për Komunën Dëshnicë- Përmet. Përgatitur nga: EuroFlorex Trade shpk
80. NRDP. (2009). Plani i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave për Komunën Piskovë- Përmet. Përgatitur nga: EuroFlorex Trade shpk






81. NRDP. (2010). Plani i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave për Komunën Sukë. Përgatitur nga EuroFlores Trade shpk.
82. Nuro, A., Marku, E., & Murtagj, B. (2017). Organic pollutants in water samples of Vjosa river: Albania. *Zaštita materijala*, 58(3), 385-393.
83. Paparisto, A., Halimi, E., Keçi, E., Hamzaraj, E., & Laknori, O. (2009). Using insects as bio-indicators to assess water quality of Albanian rivers. *Journal of International Environmental Application & Science*, 4(3), 246-252.
84. Papazachos, B. C. (1990). Seismicity of the Aegean and surrounding area. *Tectonophysics*, 178(2-4), 287-308.
85. Papp, B., Erzberger, P., & Marka, J. (2010). Contributions to the bryophyte flora of eastern Albania (Korça and Kolonja Districts). *Studia bot. hung.*, 41, 61-88.
86. Peza, L. H., & Theodhori, P. (1993). Cretaceous shallow marine clastic and brackish to freshwater deposits in Albania. *Cretaceous research*, 14(2), 191-197.
87. Proko, A., & Vangjeli, J. (2009). Eco-Phytosociological Study of Albania's Main South-Eastern Ecosystems. *Albanian Journal of Natural & Technical Sciences*, 26(2).
88. Qarri, F., Lazo, P., Bektashi, L., Stafilov, T., Frontasyeva, M., & Harmens, H. (2015). The effect of sampling scheme in the survey of atmospheric deposition of heavy metals in Albania by using moss biomonitoring. *Environmental Science and Pollution Research*, 22(3), 2258-2271.
89. Robertson, A., & Shallo, M. (2000). Mesozoic-Tertiary tectonic evolution of Albania in its regional Eastern Mediterranean context. *Tectonophysics*, 316(3), 197-254.
90. Rogozi, E., Bego, F., Papa, A., Mersini, K., & Bino, S. (2013). Distribution and ecology of small mammals in Albania. *International journal of environmental health research*, 23(3), 258-268.
91. Rozas-Vásquez, D., Fürst, C., Geneletti, D., & Muñoz, F. (2017). Multi-actor involvement for integrating ecosystem services in strategic environmental assessment of spatial plans. *Environmental Impact Assessment Review*, 62, 135-146.
92. Sadler, B., & Dalal-Clayton, D. B. (2012). Strategic environmental assessment: a sourcebook and reference guide to international experience. Earthscan.
93. Sala, S., & Qiriaz, P. (2016). Geographical framework conditions of the Vjosa catchment. In: *The Vjosa Science Conference. The Vjosa – A unique opportunity for European River Science. Faculty of Natural Sciences. University of Tirana, June 8th, 2016.*
94. Šašić, M., Popović, M., Cuvelier, S., Đurić, M., Franeta, F., Gascoigne-Pees, M., Koren, T., Maes, D., Micevski, B., Micevski, N., & Mølgaard, M. S. (2015). Contribution to the knowledge of the butterfly fauna of Albania. *Nota Lepidopterologica*, 38, 29.
95. Seferlis, M., T. Lako, N. Panariti, E. Demiraj and D. Papadimos, 2008. Proposed management guidelines for the Vjosa watershed. The Gouladris Natural History Museum - Greek Biotope/Wetland Centre. Thermi, Greece. 22pp
96. Selenica, A., & Bektashi, V. (2016). Quantitative management of water resources and pressures in Vjosa river basin. In: *The Vjosa Science Conference. The Vjosa – A unique opportunity for European River Science. Faculty of Natural Sciences. University of Tirana, June 8th, 2016.*
97. Shallo, M., Gjeçi, K., & Hoxha, V. (2013). Synophiolitic metamorphic rocks of Albania. *Journal of International Environmental Application and Science*, 8(1), 53.



98. Shuka, L., & Malo, S. (2010). The transboundary important plant areas as conservation units of European green belt (Eastern Albanian zone). *Journal of Environmental Protection and Ecology*, 11(3), 866-874.
99. Shuka, L., Xhulaj, M., Kashta, L., & Casper, S. J. (2007). The genus *Pinguicula* (Lentibulariaceae) in Albania—a critical review. *Wulfenia*, 14, 15-65.
100. Shumka, S. (2016). Riverscape biodiversity of the Vjosa river. *In: The Vjosa Science Conference. The Vjosa – A unique opportunity for European River Science. Faculty of Natural Sciences.* University of Tirana, June 8th, 2016.
101. Shumka, S., Bego, F., Beqiraj, S., Paparisto, A., Kashta, L., & Miho, A. (2016). Current knowledge of biodiversity in Vjosa river system counting threats that jeopardize species and ecosystems survival. *In: The Vjosa Science Conference. The Vjosa – A unique opportunity for European River Science. Faculty of Natural Sciences.* University of Tirana, June 8th, 2016.
102. Shumka, S., Shuka, L., & Mali S. (2010). Rivers Water Life and the Responses of Possible Hydropower's to be Constructed in the Water Courses of Vjosa, Semani and Drini in Albania. *Proceedings of BALWOIS*, 2010
103. Silo, V., Nishani, P., & Silo, E. (2010). Hydrocarbon exploration under Kruja zone in Tirana-Rodon area, Albania. *Journal of the Balkan Geophysical Society*, 13(1), 9-16.
104. Sinani, A., & Dhimitri, J. (2015). Effects of Irrigation and Drainage on Rural Landscapes of Gjirokastra Region in South of Albania. *Agriculture and Agricultural Science Procedia*, 4, 175-185.
105. Sulstarova E., Koçaj S. & Aliaj Sh. (1980). Rajonizimi sizmik i Shqipërisë. Shtypshkronja. "Mihal Duri" Tiranë, *Monografi*, Arkivi i Institutit të Sizmologjisë, p. 297.
106. Terpo, M. (2013). "Vlerësimi i gjëndjes mjedisore të zonave Gjirokastrë – Tepelenë – Përmet – Sarandë nëpërmjet monitorimit të ajrit duke përdorur myshqet si bioindikatore". Disertacion në kërkim të gradës "Doktor i Shkencave". Universiteti i Tiranës. (<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/10/Doktoratura-Majlinda-Terpo-Fakulteti-i-Shkencave-i-Natyrore-Departamenti-i-Kimise.pdf>)
107. van Helsdingen, P. J., & Iland, S. (2015). A quick scan of the spider fauna in the surroundings of Përmet, Albania (Arachnida, Araneae)—Preliminary report. *Nieuwsbrief SPINED*, 35, 15-33.
108. Vinçani, F. V., Leka, P. L., Kosho, P. K., & Dara, F. D. (2011, October). Integration of Geophysical Studies at the Tirana-Durres-Kavaja Region, Albania with Technology GIS. *In 6th Congress of the Balkan Geophysical Society.*
109. Voci, F., & Korro, K. (2012). Collection of Various Medicinal and Spice Crops from Wild Genetic Diversity in Albania. *Journal of International Environmental Application and Science*, 7(1), 128.
110. Williams, A., & Dupuy, K. (2017). Deciding over nature: Corruption and environmental impact assessments. *Environmental Impact Assessment Review*, 65, 118-124.
111. Zdruli, P., Eswaran, H., & Kimble, J. (1995). Organic carbon content and rates of sequestration in soils of Albania. *Soil Science Society of America Journal*, 59(6), 1684-1687.
112. Zeneli, G., Dida, M., Ducci, F., & Habili, D. (2004). Silver fir (*Abies alba*) resources in Albania and their conservation. *Forest Genetic Resources No. 31*, 44.






113. Zeneli, G., Loca, S., Diku, A., & Lila, A. (2017). On-Site and Off-Site Effects of Land Degradation in Albania. *ECOPERSIA*, 5(2), 1787-1797.

Websites:

1. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar: (<http://www.gsa.gov.al/en/home/Maps.html>)
2. Air quality Standard: (<http://ec.europa.eu/environment/air/quality/standards.htm>)
3. Climate Data for Cities Worldwide (<http://en.climate-data.org/>)
4. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG). (<http://geoportal.asig.gov.al/Map.aspx?lang=AL>)
5. Agjensia Kombëtare e Mjedisit- (AKM) (<http://akm.gov.al>)
6. UNECE: Protocol on Strategic Environmental Assessment (<http://www.unece.org/env/eia/documents/legaltexts/protocolenglish.pdf>)
7. Strategic Environmental Assessment: (<http://ec.europa.eu/environment/eia/sea-legalcontext.htm>)



Rr. e Kosovareve, Nd.35, H. e Ap.4/1, Njësia Administrative Nr.5, 1019, Tirane, Shqipëri • Tel. +3554 222 804 / 2430195, e-mail



Konsultimet publike, veçanërisht në procesin e krijimit të Strategjive për Zhvillimin e ardhshëm janë mjeti më efikas, në mundësimin e mekanizmit të zhvillimit të qëndrueshëm të zonave. Suksesi i tyre varet nga struktura e mekanizmit të konsultimeve publike – atë që do të inkurajojë publikun të marrë pjesë në to në mënyrë të lirë dhe demokratike. Pjesëmarrja publike dhe konsultimi janë kthyer në procesin demokratik më të pranuar në zhvillimin e politikave dhe strategjisë së zhvillimit. Sot, sipas kësaj përjasjeje, roli i Qeverisjes Vendore të mirëpërcaktuar dhe të mbështetur ligjërisht është një mjet i rëndësishëm në të gjitha vendimet planifikuese dhe zhvilluese. Kjo përjasje e lejon publikun të kuptojë qartësisht çfarë ndodh me çdo projekt apo propozim dhe si të veprojnë përpara çdo vendimarrjeje dhe të jenë aktor në procesin e vendimarrjes. Një komunitet pjesëmarrës e aktiv është baza për zhvillimin e një sistemi administrativ-publik efikas. Një sistem i mirë i qeverisjes urbane u lejon njerëzve të drejtën ligjore dhe demokratike për të marrë pjesë në vendimarrjet e zhvillimit të territorit, përpara vendimarrjes duke i dhënë publikut rol aktiv së bashku me grupet e tjera të interesit.

DËGJESAT PUBLIKE DHE FORUMET E BASHKËRENDIMIT TË PLANIFIKIMIT VENDOR


1. DËGJESË PUBLIKE, 21 SHTATOR 2017

Më datë 21 Shtator 2017 pranë ambienteve të një lokali publik të qytetit Këlcyre u organizua Dëgjesa e Parë Publike për Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Këlcyre. Në takim ishin pjesëmarrës kryetari i Bashkisë Këlcyre Z. Klement Ndoni, përfaqësues të bashkisë, përfaqësues të institucioneve që veprojnë në territorin bashkiak, përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, banorët, si dhe përfaqësues të kompanisë konsulente "Atelier-4", organizues të takimit. Ky takim synonte të mundësonte një prezantim të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Këlcyre për të gjithë banorët e bashkisë. Para nisjes së diskutimit, të pranishmëve ju shpërndanë Pyetësorë. Mbi prioritetet e zhvillimit të Bashkisë Këlcyre, ku u shqyrtuan nevojat më primare në lehtësi të zhvillimit të sektorëve të ekonomisë, nevojat urgjente infrastrukturore, përmirësimet në zonat e banimit, zhvillimet parësore për turizmin, etj.

Kryetari i Bashkisë Këlcyre, gjatë diskutimit theksoi rëndësinë e veçantë që ky plan ka për Bashkinë Këlcyre, duke ndihmuar në orientimin e zhvillimeve në territor për 15 vitet e ardhshme. Gjithashtu, hartimi sa më i përshtatshëm i këtij plani dhe në përputhje me nevojat e banorëve dhe të bashkisë do të ndodhë vetëm në rastin kur do të ketë bashkëpunim të ngushtë të banorëve, me stafin e bashkisë dhe me kompaninë konsulente.

Hartimi i këtij plani do të ofrojë mundësi për zhvillimin e territorit të Bashkisë Këlcyre, si dhe diskutimet për zhvillimet e mundshme në territor.

Gjatë prezantimit pjesëmarrësit u njohën me përgjegjësitë dhe qëllimet e PPV- Këlcyre, ku mund të përmenden analiza dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese, në bazë të të cilës parashtrihen kërkesat, nevojat dhe mundësitë e zhvillimit të të gjithë territorit të bashkisë. Në këtë mënyrë bëhet i mundur vlerësimi dhe përgatitja për hartimin e një plani sa më të përshtatshëm me karakterin e bashkisë. Një ndër çështjet më të rëndësishme për hartimin e një plani në përputhje me nevojat e territorit bashkiak dhe të banorëve, e cila u theksua gjatë takimit, është bashkëpunimi me banorët e zonës. Prandaj, takimi u



organizua në formën e një bashkëbisedimi për të bërë sa më të qartë qëllimet PPV-së, si dhe nevojat reale të banorëve dhe të territorit.



Figura 35. Foto gjatë Dëgjësës Publike për Planin e Përgjithshëm Vendor. Bashkia Këlcyrë, 21 Shtator 2017



ATELIER STUDIO ARCHITETURALE



PYETËSOR MBI PRIORITETET E ZHVILLIMIT TË BASHKISË KËLCYRË

Njësia Administrative: _____ Fshat/Lagjia: _____

Profesioni: _____ Moshë: _____

1. *Cili është sektori i ekonomisë që duhet mbështetur me prioritet?

- ☐ Bujqësi/Blegtori/Peshkim;
- ☐ Turizmi;
- ☐ Tregtia / Shërbime / Magazinin;
- ☐ Industri;
- ☐ Tjetër _____

*Në sektorin e konsideruar prioritar, ku mendoni se duhet të investohet?

2. Cili janë nevojat urgjente që dëshironi të zhvillonin?

- ☐ Sistemi rrugor dhe i transportit;
- ☐ Sistemi ujësjellës – kanalizimeve;
- ☐ Sistemi i energjisë elektrike dhe ndriçimit publik;
- ☐ Sistemi vaditës dhe kullimi;
- ☐ Tjetër _____

3. Cili janë nevojat sociale urgjente për Bashkinë Këlcyrë?

- ☐ Sistemi arsimor;
- ☐ Qendrat socio-kulturore/ komunitare;
- ☐ Qendrat shëndetësore/ambulancat;
- ☐ Banesat sociale/ strehim social;
- ☐ Barazia gjinore;
- ☐ Grupet vulnerabël.
- ☐ Tjetër _____

4. Cilat përmirësime dëshironi në zonën tuaj të banimit?

- ☐ Rrugë / Parkime;
- ☐ Lulishte / Kënde lojtrash;
- ☐ Treg urban;
- ☐ Zona sportive.
- ☐ Tjetër _____

5. Në cilat zona do të dëshironit të zhvillonin më parë turizmin?

- ☐ Pranë liqenit;
- ☐ Zonat fushore;
- ☐ Zonat malore;
- ☐ Vendbanimet aktuale.
- ☐ Tjetër _____

6. Cilat pika do të dëshironit të promovonit më shumë?

- ☐ Turizmin;
- ☐ Traditën;
- ☐ Produktet vendase.
- ☐ Tjetër _____

Propozoni dhe ju projekte për zhvillimin e ardhshëm!

Ju Faleminderit!

Figura 36. Model i pyetësorit të shpërndarë



Çështjet e diskutuara gjatë Dëgjësës Publike janë të përmbledhura në vijim:

- ☐ Braktisja e industrisë dhe prishja e fabrikave të ndërtuara para viteve '90, Sugjerohet të ringrihen ndërmarjet e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve ushqimore.
- ☐ Mungesat e theksuara të infrastrukturës vecanërisht në fshat
- ☐ Mungesa e një tregu të strukturuar për produktet bujqësore e blegtorale si në Ballaban ashtu edhe në Këlcyrë.
- ☐ Mungesat e shkollave dhe e mjekut në zonat rurale.
- ☐ Të zgjidhet aksesimi për bagetinë në të gjithë zonat e bashkisë në mënyrë që të mos kalojnë në zonat urbane
- ☐ Problem furnizimi me ujë të pijshëm në pjesën më të madhe të zonave rurale ashtu edhe në zonat Trebeshinë-Dhembel. Gjithashtu problem është dhe mungesa e ujit për blegtorinë si dhe akses më të mirë për në stane.
- ☐ Këlcyra si qytet duhet të evitojë kalimin e rrugës kombëtare në zonën urbane dhe sugjerojnë ndërtimin e një uaze.
- ☐ Paisja e zonave urbane me kënde lojrash dhe ambiente sportive si dhe ndërtimi i një stadiumi ishin disa nga sugjerimet e tjera të përmendura në dëgjësë.
- ☐ Turizmi është një nga aktivitetet më me prioritet të përmendura në zonë dhe për këtë arsye duhen vlerësuar potencialet natyrore dhe kulturore.

DËGJËSË PUBLIKE BASHKIA KËLCYRË
PLANI PËRQYRTËSËM VËNDOR BASHKISË KËLCYRË, DËGJËSË, PËRMAT
21092017

NR.	EMRI I PËRSONËS	ADRESA	NR. TELEFONIT	NR. EPOSTËS
1	Jonas Hoxha	B. Këlcyrë	069 274 1056	jos.hoxha@gmail.com
2	Bujar Bishanani	B. Këlcyrë	069 51 38 016	bujar.bishanani@gmail.com
3	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 340 30816	enxhet.pashaj@gmail.com
4	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 307 0278	enxhet.pashaj@gmail.com
5	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 50 80 300	enxhet.pashaj@gmail.com
6	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
7	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
8	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
9	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
10	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
11	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
12	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
13	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
14	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
15	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
16	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
17	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
18	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
19	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
20	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
21	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
22	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
23	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
24	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
25	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
26	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
27	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
28	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
29	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
30	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
31	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com
32	Enxhet Pashaj	Atalher 4	069 59 318	enxhet.pashaj@gmail.com

Figura 37. Listë e pjesëmarrësve në dëgjësën publike në Bashkinë Këlcyrë. 21/09/2017





2. FORUMI I BASHKËRENDIMIT TË PLANIFIKIMIT VENDOR, 7 DHJETOR 2017

Në vazhdimësinë e procesit të hartimit të PPV-së Kolonjë, Këlcyrës dhe Përmetit, më 7 Dhjetor 2017, u organizua Forumi i Bashkërendimit të Planifikimit Vendor, nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të Bashkive, Kolonjë, Këlcyrë, Përmet, Tepelenë, Korçë, si dhe përfaqësues të organeve përgjegjëse për të diskutuar mbi problematikat gjatë procesit të hartimit të planeve.

Forumit u hap nga Znj. Adelina Greca, Drejtore e Përgjithshme, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, e cila theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ekspertëve për secilën bashki, për të arrirë një produkt përfundimtar sa më të suksesshëm.

Programi i forumit i parashikuar në dy pjesë, nisi me prezantimet përkatëse të Strategjive Territoriale të bashkive pjesëmarrëse. Pjesa e dytë, e organizuar në bashkëbisedim ndërmjet ekspertëve, krijoi mundësinë për të diskutuar për çështjet më problematike për secilën bashki. Çështjet të cilat u diskutuan, vijnë si më poshtë:

- ☐ Në territorin e Bashkisë Këlcyrë dhe Përmet kanë potencial bimët medicinale - Është marrë në konsideratë edhe gjatë procesit të hartimit të Strategjisë Territoriale të PPV-ve duke propozuar zgjerimin e agro-turizmit.
- ☐ HEC-et, çfarë është parashikuar? Projektet në zhvillim? – Të identifikuar në raport. Ndërtimi i HEC-eve, ndikon negativisht në mjedis dhe turizem.
- ☐ Sugjerim për rristurimin e skenareve, ndarë në: me HEC-e dhe pa HEC-e, ose të konsiderohen energjitë alternative.
- ☐ A janë analizuar fshatrat? - E reflektuar në raportet dhe dokumentet specifike për çdo bashki.
- ☐ A është marrë në konsideratë lumi Vjosa dhe luginat në hartimin e vizionit, dhe nqs po të dali më në pah në studim. Bashkëpunim me Rajonet dhe bashkitë fqinje.
- ☐ Projektet e infrastrukturës rrugore të kordinohen me projektet e bashkisë.
- ☐ Gjatë procesit të hartimit të PPV, a janë identifikuar produktet që kanë potencial në zhvillimin ekonomik dhe turizmit? E reflektuar në raportin dhe dokumentat specifik për çdo bashki.



Figura 38. Foto gjatë Forumit të Bashkërendimit të Planifikimit Vendor, 07 Dhjetor 2017



3. DËGJESË PUBLIKE, 15 DHJETOR 2017

Kjo dëgjese publike në qytetin e Këlcyrës u organizua për t'i prezantuar banorëve të bashkisë dhe të gjithë aktorëve të interesuar, propozimet strategjike për territorin e bashkisë, të hartuara në fazën e dytë të planit. Gjithashtu, të pranishëm në këtë takim ishin edhe përfaqësues të kompanisë konsulente 'Atelier-4', së bashku me ekspertët për hartimin e planit, si dhe kryetari i bashkisë Z. Klement Ndoni. Kryetari hapi edhe takimin, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me kompaninë konsulente për patur një hartim sa më të përshtatshëm të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë e Këlcyrës, siç ka ndodhur gjatë dy fazave të para të planit.

Përfaqësues të kompanisë konsulente, njohën të pranishmit me gjetjet e rëndësishme të territorit të bashkisë, të cilat shërbejnë si mundësi zhvillimi strategjik për bashkinë. Në këtë mënyrë u përmendën rëndësia e elementëve të fortë territorialë, si prania e lumenjve Vjosa dhe Dishnicë, lugina e Zagorisë, mali i Trebeshinës, për t'i kthyer në elementë zhvillimi të territorit. Gjatë prezantimit u theksua se zhvillimi i ardhshëm i bashkisë do të parashikohet i bazuar në trendet aktuale, duke përfshirë bujqësinë, blegtorinë, si dhe turizmin natyror. Këto orientime strategjike, janë të detajuara në skemat e projekteve prioritare, për t'i dhënë udhëzimet e nevojshme bashkisë për buxhetin e nevojshëm për hartimin e këtyre projekteve.



Figura 39. Foto gjatë Dëgjësës Publike për Planin e Përgjithshëm Vendor, 15 Dhjetor 2017

Më tej takimi vazhdoi në një diskutim me të pranishmit, për ndryshimet, sugjerimet dhe çështjet e nevojshme për ndërhyrjet prioritare për bashkinë. Më poshtë renditen disa çështjet të cilave duhet t'i kushtohet rëndësi, sipas banorëve të zonës:

- ☐ Ndërtimi i një landfill-i rajonal;

- ☐ Rrjeti i kanalizimeve për qytetin e Këlcyrës: çështje shumë problematike pasi aktualisht derdhja e tyre bëhet në lumenjtë e Vjosës dhe Dishnicës
- ☐ Trajtimi dhe rëndësia që ka laguna e Vjosës gjatë hartimit të planit;
- ☐ Ndërtimi i tregut të qytetit;
- ☐ Rëndësia e pikave të përpunimit dhe grumbullimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- ☐ Parkimi i automjeteve në territorin e bashkisë;
- ☐ Propozimet për Rezervuarin e Këlcyrës.

Këto çështje, ndonëse të hartuara si orientime strategjike nga kompania konsulente, shërbyen për të krijuar një bashkëbisedim dhe sugjerime për organizmin e këtyre projekteve.

DËGJESË PUBLIKE BASHKIA KËLCYRË				
LISTA E DËGJESËVE PUBLIKE				
PLANI PËRQINDHËM VENDOR BASHKËTËKËSHË E KËLCYRËS PËR VITE 2017-2027				
NR. SHTRESHES	EMRI I DËGJESËS	ADRESA	NUMERI I TELEFONIT	EMAIL
1	GEORGI DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
2	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
3	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
4	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
5	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
6	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
7	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
8	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
9	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
10	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
11	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
12	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
13	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
14	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
15	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
16	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
17	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
18	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
19	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
20	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
21	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
22	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
23	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
24	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
25	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
26	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
27	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
28	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
29	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
30	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
31	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
32	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al
33	Edi DEDAJ	AKT	069221553	g.dedaj@kshqiperia.gov.al

Figura 40. Listë e pjesëmarrësve në dëgjuesën publike në Bashkinë Këlcyrë. 15 Dhjetor 2017

4. DËGJESË PUBLIKE: PREZANTIMI I PLANIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE PREZANTIMI I RAPORTIT TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR. 12 SHKURT 2018

Në datën 12 shkurt, në qytetin e Këlcyrës u organizua Dëgjesa publike për të prezantuar punë e fazës së tretë të PPV-Bashkia Këlcyre, hartiminn e Planit të Zhvillimit të Territorit dhe Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor [VSM]. Të pranishmit në sallë u njohën me ndërhyrjet e propozuara për 15 vitet e ardhshme për territorin e Bashkisë Këlcyrë. Prezantimi u realizua nga konsulentët, duke theksuar që hartimi i PPV-Bashkia Këlcyrë, është pjesë e një procesi të vazhdueshëm, i cili ka nisur me analizën e gjendjes ekzistuese, për të vijuar me propozimet strategjike, të cilat kanë dhënë mundësinë për të kuptuar nevojat dhe kërkesat e banorëve për zhvillimin e territorit të bashkisë.

Për t'i paraprirë fazës së hartimit të Zhvillimit të Territorit, janë hartuar Skenarët e mundshëm të Zhvillimit, duke theksuar sektorët primarë të ekonomisë për territorin, bujqësinë, blegtorinë, turizmin, bimët medicinale, etj. Kjo fazë tregon për rëndësinë e hartimit të mundësive për ofrim të shërbimeve dhe përmirësim të cilësisë së jetesës së banorëve për 15 vitet e ardhshme.

Më pas u vazhdua me prezantimin e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor [VSM] për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Këlcyrë. nga eksperti i mjedisit, Dr. Gazmend Zeneli,

Pjesa e parë e prezantimit u përqëndrua në shpjegimin e procesit nëpër të cilin kalon hartimi i VSM-së, legjislacionit ku bazohen hapat e ndërmarra për krijimin e dokumentit të VSM-së, përshkrimin e metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të VSM-së, përshkrimin e alternativave të konsideruara gjatë hartimit të planit përfshirë edhe alternativën e mosplanifikimit (alternativa zero); objektivat për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në nivel kombëtar dhe rajonal të cilat lidhen me planin; përshkrimin e përbërësve të mjedisit në zonën e shtrirjes të planit; dhe paraqitjen e rezultateve të perfituara nga analizat mjedisore kryer për të gjithë territorin e bashkisë.

Në pjesën e dytë të prezantimit u trajtua vlerësimi i ndikimit në mjedis i zbatimit të gjithë projekteve parashikuara në PPV. Projektet e planifikuara në kuadër të PPV-së për Bashkinë Këlcyrë janë strukturuar/grupuar në Objektiva të Planit. Në këtë seksion fillimisht u prezantuan ndërveprimet e mundshme me mjedisin të planit dhe pasojat e mundshme negative në mjedis. Elementët e trajtuar në këto analiza janë Toka, Ajri, Mbetjet, Ujërat Sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, Biodiversiteti/ zonat e mbrojtura, Faktorët klimatike, Zhurmat, popullsia dhe asetet materiale, trashëgimia kulturore, etj., apo dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve.

Në pjesën e tretë, prezantimi u fokusua në paraqitjen e masave konkrete për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet që do të rrjedhin si rezultat i implementimit të projekteve të parashikuara nga PPV-ja. Krahas masave konkrete mjedisore u paraqiten edhe projekte specifike të cilat kanë karakter rehabilitimi të zonave të nxeha mjedisore.

Ndikimi në mjedis nga zbatimi i PPV-Bashkia Këlcyrë do të jetë i ulët nëse respektohen masat e parashikuara, ky ndikim kompleks mund të minimizohet dhe mjedisi mund të ripërtërihet normalisht duke adresuar si duhet masat për çdo objektiv mjedisor, si edhe duke ushtruar në mënyrë profesionale monitorimin e indikatorëve përkatës.



Figura 41. Prezantimi i Raportit te Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Bashkinë Këlcyrë

DEGJESË PUBLIKE BASHKËA KËLCYRË					
PLANI PËRCJFTËSH I VENDOS BASHKËTË KËLCYRË, KËLCYRË, PIRRA					
12/2017					
NR	EMRI I PERSONIT	ADRESA	POSICIONI	NUMERI I TELEFONIT	ADRESA E EMAILIT
1	Adriano Ismaili	Drejtori		0655265421	adriano.ismaili@kancelaria.com
2	MARCEL ADAMI			0692276445	marcel.adami@kancelaria.com
3	Dorian Hopeni	Inspektor		0655265421	dorian.hopeni@kancelaria.com
4	Indira Ismaili	Asistenti		0655265421	indira.ismaili@kancelaria.com
5	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
6	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
7	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
8	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
9	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
10	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
11	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
12	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
13	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
14	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
15	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
16	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
17	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
18	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
19	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
20	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
21	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
22	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
23	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
24	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
25	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
26	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
27	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
28	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
29	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
30	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
31	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
32	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com
33	Enxhel Ismaili	Asistenti		0655265421	enxhel.ismaili@kancelaria.com

DEGJESË PUBLIKE BASHKËA KËLCYRË					
PLANI PËRCJFTËSH I VENDOS BASHKËTË KËLCYRË, KËLCYRË, PIRRA					
12/2017					
NR	EMRI I PERSONIT	ADRESA	POSICIONI	NUMERI I TELEFONIT	ADRESA E EMAILIT
34	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
35	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
36	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
37	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
38	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
39	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
40	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
41	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
42	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
43	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
44	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
45	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
46	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
47	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
48	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
49	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
50	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
51	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
52	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
53	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
54	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
55	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
56	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
57	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
58	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
59	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
60	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
61	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
62	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
63	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
64	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
65	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com
66	MARCEL ADAMI	Drejtori		0655265421	marcel.adami@kancelaria.com

Figura 42. Listë e pjesëmarrësve në prezantimin e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Bashkinë Këlcyrë. 12 Shkurt 2018

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE E RAPORTIT TË VSM-SË

I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Bashkia e Këlcyrës bën pjesë në Qarkun e Gjirokastrës dhe kufizohet në veri me bashkinë Poliçan, në lindje me bashkinë Skrapar, në jug me bashkinë Përmet dhe Libohovë dhe në perëndim me bashkinë Tepelenë dhe Memaliaj. Territori i bashkisë Këlcyrë është kryesisht me karakter kodrinor-malor ndërsa sipërfaqja e bashkisë është 304.6 km².

Reforma territoriale synon fuqizimin e bashkisë, duke rritur kapacitetin për të ofruar shërbime të një cilësie të lartë për qytetarët dhe duke rritur efikasitetin e menaxhimit të burimeve të tyre. Bazuar në nevojën për orientim të zhvillimit të Bashkisë së zgjeruar të Këlcyrës, Këshilli Bashkiak vendosi të miratojë nismën për hartimin e planit të përgjithshëm vendor (PPV) të Bashkisë Këlcyrë.

Nisur nga ndikimet e pritshme në mjedis dhe në burimet natyrore, Ligji Nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", përcakton qartë që ky proces duhet të nënshtrohet Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

"Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një proces sistematik, i cili vlerëson pasojat mjedisore të një plani të propozuar për zbatim, në mënyrë që të sigurohet se këto pasojat mjedisore janë adresuar plotësisht nga fazat e hershme të vendimmarrjes, përveç konsideratave ekonomike dhe sociale. VSM-ja në planifikimin hapësinor duhet të paraqesë informacion mbi këto ndikime mjedisore, ekzistenca dhe pasojat e të cilit nuk janë definuar në mënyrë specifike.

Bazuar në Ligjin Nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" dhe aktet e tjera nënligjore, ky dokument është hartuar paralelisht me procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, proces i cili ka filluar në gusht 2017. Në këtë raport janë marrë parasysh të gjitha ndikimet që mund të kenë në mjedis propozimet e bëra nga Planit i Përgjithshëm Vendor (PPV) për të gjithë territorin që administron kjo bashki. Procesi i VNM-së ka kaluar nëpër 5 etapa. Këto etapa janë paraqitur në detaje në figurën e mëposhtme (Figura 42).




Figura 43. Etapat e procesit të VNM-së.

II. VIZIONI I ZHVILLIMIT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË PPV-së TË BASHKISË KËLCYRË

Vizioni i zhvillimit të Bashkisë është bazuar në potencialet që ofron kjo Bashki. Ky vizion synon evidentimin, ruajtje dhe shfrytëzimi në mënyrën më të mirë të këtyre potencialeve, duke i kthyer këto asete në gjenerim të ardhurash dhe bazë për ekonominë lokale të 15 viteve të ardhshme.

"Bashkia e Këlcyrës do të formohet me shërbime publike cilësore dhe infrastrukturë bashkëkohore, që mundëson cilësi të lartë jetese për banorët, duke ngjallur të popullsia e larguar nga zonat rurale dëshirën për t'u kthyer e jetuar mire".

Realizimi i vizionit të bashkisë kalon në disa halika, të cilat për të mos humbur fokusin duhet të jenë të mirë strukturuara, si në renditje ashtu dhe në shtrirjen kohore. Kështu, vizioni bëhet i zbatueshëm duke përcaktuar objektiva, të cilat detajohen në programe dhe në projekte. Detajimi i vizionit të Bashkisë Këlcyrë bazohet në objektivat e mëposhtëm:

0.1. *Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale dhe turizmit.*

Bashkia e Këlcyrës e bazon zhvillimin e saj ekonomik në disa shtylla të cilat krijojnë edhe të ardhurat kryesore për banorët e saj. Këto shtylla duhet të promovohen dhe mbështeten që të krijohet një mirëfunksionim dhe zinxhir ekonomik në të gjithë territorin e saj. Një ndër këto shtylla është dhe zhvillimi i bujqësisë.

0.2. *Ristrukturimi dhe profilizimi i vendbanimeve*

Qyteti i Këlcyrës dhe fshatrat e territorit të bashkisë, bazuar në vendndodhjen e tyre në territor kanë karakteristika të ndryshme, vendbanimet e gjendura në zonat fushore apo malore, duke ndryshuar edhe nga zhvillimet bujqësore apo blegtorale pranë tyre. Është e rëndësishme që kushtet e këtyre vendbanimeve të përmirësohen, duke i sistemuar këto struktura dhe vendosur rregulla specifike bazuar në zonën ku gjenden.

0.3. *Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit e peizazhit*

Objektivi i tretë do të orientojë zhvillimin drejt përmirësimit të infrastrukturës si asaj rrugore ashtu edhe asaj inxhinjerie si sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm, largimit të ujrave të ndotur, sistemet e ujit për bujqësi e blegtori, furnizimit me energji elektrike, përmirësimit të shërbimeve të telekomunikacionit si dhe infrastrukturës së mbrojtjes mjedisore.

Infrastruktura është një element tepër i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik e territorial. Për rrjedhojë tërësia e këtyre përmirësimeve pritet të sjellë aksesueshmëri më të mirë për lokalitetet e specializuara turistike e bujqësore, ofrimin e shërbimeve të sipërpërmendura duke rritur cilësinë e jetesës në të gjithë bashkinë e Këlcyrës.





4
STUDIO ARHITEKTURE

III. PËRSHKRIMI I KUSHTEVE BAZË TË MJEDISIT

Për të bërë një vlerësim të saktë të ndikimeve në mjedis që rrjedhin nga zbatimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Këlcyrë, është e rëndësishme që të njihet gjendja eksistuese e mjedisit të zonës ku do shtrihet kjo PPV. Ky seksion përshkruan kushtet bazë mjedisore në zonë duke u ndalur në mjedisin fizik (klima, gjeologjia dhe gjeomorfologjia, ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, sizmiciteti), biologjik (sipërfaqet pyjore, biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura), problemet mjedisore në nivelin aktual të menaxhimit të mbetjeve dhe ujerave të ndotura, si edhe problemet mjedisore nga rreziqet natyrore (zjarret, përmytjet).


3.1. MJEDISI FIZIK

Klima përbën një element shumë të rëndësishëm si në formimin e zhvillimin e bimesise, ashtu edhe për fenomenin e erozionit. Bashkia e Këlcyrës shtrihet në zonën klimatike mesdhetare paramalore, nënzona jugore dhe zonën klimatike mesdhetare malore, nënzona juglindore. Këlcyra ka një klimë të ngrohtë dhe të temperuar (Csa në klasifikimin e klimës sipas Köppen and Geiger).

Topografia - Bashkia e Këlcyrës ndodhet në juglindje të Shqipërisë, me qendër qytetin e Këlcyrës. Bashkia ka një sipërfaqe totale prej rreth 304.6 km². Zona e bashkisë Këlcyrë është një territor me karakter kodrinor-malor e cila shtrihet në lartësinë 230m deri në 1100m mbi nivelin e detit. Bashkia Këlcyrë shtrihet midis vargmaleve Trebeshinë-Dhëmbel dhe malit të Qarrishtës dhe përshkohet nga dy lumenj ai i Vjosës dhe i Dëshnicës duke krijuar dy lugina të ngushta.

Lumenjtë dhe Luginat Kryesore - Krahina e Këlcyrës është mjaft e copëzuar dhe përshkruhet nga lumi i Vjosës dhe i Dëshnicës. Lugina e Vjosës shtrihet nga Mesareja (vendi ku Vjosa hyn në territorin tonë) deri në Poçëm, ku ajo del përfundimisht në Ulëtirën Bregdetare. Brenda Krahinës Malore Jugore përfshihet tërë rrjedhja e mesme e Vjosës me gjatësi 166 km dhe gjerësi nga 600-800 m deri në 1000-1500 m. Ajo është një nga luginat më të mëdha e më të rëndësishme të vendit tonë dhe njëkohësisht lugina kryesore e Krahinës Malore Jugore.

Kushtet gjeologjike - Përshkrimi gjeologjik është bazuar në Hartën Gjeologjike të Shqipërisë në shkallë 1:200.000, botimi vitit 2004, në tekstin sqarues të saj si dhe Hartat gjeologjike Shkallë 1:100.000 të qarqeve të botuara nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar. Në pikëpamje gjeologjike në



territorin e Bashkisë Këlcyrë dallohen dy sektorë me ndërtim gjeologjik të ndryshëm, sektori perendimor dhe sektori lindor. Sektori perendimor përfshin gjithë pjesën e lartë malore ku hyjnë mali i Trebeshinës dhe ai i Dhëmbelit. Sektori lindor i Bashkisë Këlcyrë, fillon që nga mezi i lartësisë së shpatit lindor të sektorit malor, dhe mbulon krejt territorin e bashkisë deri në ujëndarësin me Qarkun e Beratit.

Cilësia e Ajrit- Në zonën e bashkisë së Këlcyrës nuk vërehet ndotje e ajrit, edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare të cilat të bazohen në kërkime dhe informacione zyrtare. Mungesa e ndotjes lidhet ngushtë, së pari me karakteristikat e Bashkisë dhe në mënyrë të veçantë me praninë e madhe të zonave malore, pyjore dhe bujqesore pa burime kryesore të ndotjes atmosferike, dhe së dyti me mungesën e qendrave të mëdha urbane dhe zonave industriale. Djegia e drurit për ngrohje përbën një faktor tjetër të ndotjes nëpërmjet emetimit të mikrogrimeve, por përsëri, për shkak të shkallës së vendbanimeve, ky fenomen është relativisht i kufizuar, siç janë gjithashtu edhe pasojat e tij.

Ndotja akustike- i detyrohet kryesisht trafikut rrugor, ku nivelet e presionit akustik gjatë 24 orëve mund të arrijnë 75-80 dBA (në zonat të dendura të trafikut rrugor). Gjithnjë e më shumë ndotja akustike është duke u rritur dhe duke u shfaqur si një rrezik mjedisor "i dukshëm". Efektet e zhurmave grumbullohen tek individit si ngjarje zhurme, me efekte negative në dëgjim, psikikë dhe mënyrën e jetesës.

Rreziku sizmik në Bashkinë Këlcyrë - Mbështetur në hartën e rajonizimit sizmik të Shqipërisë, Bashkia e Këlcyrës ka intensitetin e pritshëm sizmik për kushte mesatare trualli IO = 6 ballë MSK-64.

3.2. MJEDISI BIOLOGJIK

Biodiversiteti përbën një komponent shumë të rëndësishëm të pasurive natyrore të një vendi, hapësirë apo rajoni. Vecoritë morfogjenetike të relievit të Këlcyrës kanë ndryshime të dukshme gjatë shtrirjes së saj. Bashkia e Këlcyrës ofron shumëllojshmëri formacionesh amësore dhe mikroklima të favoshme për specie të ndryshme. Kjo larmishmëri e mjedisit fizik ka ndikuar në instalimin e habitateve të florës e faunës mjaft të pasur.

Duke u shtrirë vertikalisht nga lugina e Vjosës (ca. 250 m) deri në malin e Trebeshinës (ca. 1950 m), në Bashkinë e Këlcyrës takohen të katër brezat / zonat fitoklimatike që hasen në vendin tonë 1) Brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare 2) Brezi i dushkajave 3) Brezi i ahishteve dhe 4) Brezi i kullotave alpine. Prania e këtyre brezave është një pasqyrim i madh i vlerave të florës, bimësisë dhe habitateve në këtë zonë. Gjithësesi, dominues mbeten Brezi i pyjeve dhe shkurreve mesdhetare dhe Brezi i dushkajave. Prania e këtyre brezave është një pasqyrim i madh i vlerave të florës, bimësisë dhe habitateve në këtë zonë.

Fauna- E gjendur midis dy vargmaleve, atij Trebeshinë-Dhëmbel dhe malit të Qarrishtës (Malësia e Dangëllisë) dhe e përshkruar nga dy lumenj, ai i Vjosës dhe i Deshnicës, Bashkia e Këlcyrës është e njohur gjithashtu dhe për pasuritë e saj faunistike. Këtu gjinden nga specie të rralla të habitateve ujore deri te gjitarë të mëdhenj. Zona shquhet për praninë e shumë taksonëve të kafshëve dhe disa nga llojet invertebrore dhe vertebrore janë, gjithashtu të shumtë në numer. Vertebroret janë përfaqësuar nga të gjitha grupet, si amfibet, zvarraniket, zogjtë dhe gjitarët. Pyjet gjethegjërë janë një habitat i përshtatshëm për gjitarët e mëdhenj si: ariu i murrme (Ursus arctos) dhe ujku (Canis



lupus) të cilët kane përhapje të gjerë brenda zonës në varësi të habitatit të gjahut. Ndër gjitarët e tjerë të mëdhenj në zonë gjenden edhe derri i egër (*Sus scrofa*), kunadhja gushebardhe (*Martes foina*), Baldosa (*Meles Meles*), dhelpira (*Vulpes Vulpes*) dhe macja e egër (*Felis sylvestris*). Për më tepër gjitarët përfaqësohen edhe nga ketri (*Sciurus vulgaris*), gjumashi i majme i pyllit (*Glis Glis*), gjumashi i lajthive (*Muscardinus avellanarius*),

Trashëgimia Arkeologjike dhe Kulturore. Vrojtimet në terren, të shoqëruara me gërmime sistematike shumëvjeçare gjatë këtyre 35 vjetëve të fundit, kanë lokalizuar me dhjetra vendbanime të hapura e të fortifikuara, të ngritura kryesisht mbi kodra dominuese përgjatë rrugëkalimeve kryesore.

3.3. NDARJA E TERRITORIT NË SISTEME

Bashkia Këlcyrë si të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, për qëllime planifikimi, ndahet në sisteme territoriale të cilat listohen si më poshtë:

- ☐ Sistemi Urban
- ☐ Sistemi Natyror
- ☐ Sistemi Bujqësor
- ☐ Sistemi Urban
- ☐ Sistemi Infrastruktural


Sistemi natyror: është sistemi mbizotërues në të gjithë territorin e bashkisë, duke qenë i pranishëm në të gjithë territorin, kryesisht në zonat malore, duke zënë një sipërfaqe totale prej 23088.9 Ha, përbën rreth 2/3 të territorit të Bashkisë Këlcyrë. Në këtë sistem përfshihen peizazhe, fushat, pyjet me drurë gjethegjërë, halorë, etj.

Sistemi bujqësor: gjendet i shpërndarë në territor, por kryesisht në zonën fushore të njësive administrative përgjatë luginës së lumit Dishnicë. Duke qenë se bujqësia është ndër sektorët prioritar të zhvillimit ekonomik në bashki, zë rreth 7787.44 Ha.

Sistemi urban: Zë një sipërfaqe totale prej 328.65 Ha. Ndryshimet më të mëdha të këtij sistemi kanë ndodhur në qytetin e Këlcyrës dhe në afërsi të fshatrave të tij. Gjithashtu, ndërtime të reja kanë ndodhur në edhe në qendrat e fshatrave të njësive administrative Sukë, Ballaban e Katundishtë.

Sistemi ujor: në përbërjen e territorit të bashkisë përfshihen, lumenj, përrenj dhe rezervuarë. Prania e lumit të Vjosës, lumit të Dishnicës, si dhe përrenjve të ndryshëm janë disa nga elementët e sistemit ujor që formojnë 178.1 ha sipërfaqe ujore në territor.

Sistemi infrastrukturor: Ndër elementët kryesor të sistemit infrastrukturor renditet transporti rrugor, rrjeti i furnizimit me ujë dhe kanalizime, rrjetin e kanaleve të kullimit dhe vaditjes, rrjetin elektrik, atë të telekomunikacionit, sikurse dhe strukturat ndihmëse dhe të shërbimit në funksion të këtyre sistemeve, duke zënë rreth 204.22 ha në territor. Pjesë e infrastrukturës rrugore është aksi më i rëndësishëm që kalon në territorin e Bashkisë Këlcyrë për ta lidhur me Përmetin. Furnizimi me ujë funksionon në disa mënyra në zona të ndryshme, me rrjet furnizimi, me puse shpimi ose me depo uji, kjo ndodh në varësi të pozicionimit në territor. Rrjeti i kanaleve të kullimit dhe vaditjes është i pranishëm në të gjithë territorin e bashkisë, në shumicën e rasteve është në funksionim, por ka nevojë për punime mirëmbajtje, pastrime e thellime sikurse gjenden edhe raste të bllokimit apo prishjes së këtij rrjeti.



IV. TENDENCAT E MUNDSHME NË TË ARDHMEN, PA PLANIN (ALTERNATIVA "0")

Alternativa zero – ("no action alternative") shpeshherë barazohet me ruajtjen e situatës ekzistuese ose baseline. Në fakt, alternativa zero ose mos-ndërrhyrje, është situata e ardhshme pa zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, por që merr parasysh evoluimin e kushteve bazë, përfshirë projektet e tjera, të miratuara ose të parashikuara në mënyrë të arsyeshme në të ardhmen. Shpeshherë kjo alternativë përmendet, ndoshta edhe pa të drejtë, sidomos në rastet kur ajo nuk është një alternativë realiste.

Në paragrafët e mëposhtëm përshkruhet zhvillimi i mundshëm i treguesve mjedisorë në të ardhmen, në kushtet e mungesës së zbatimit të PPV-së (alternativa zero) për Bashkinë Këlcyrë.

Zonimi, Përdorimi i Tokës dhe Politikat Publike. Skenari I mos-ndërrhyrjes (alternativa zero), do të përputhej shumë pak me qëllimet dhe objektivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar pasi nuk do të mbështesë qëllimet e PPK për të rritur qëndrueshmërinë dhe elasticitetin e resurseve natyrore në territorin e Bashkisë dhe do të siguronte qasje më të vogël në resurset unike të hapësirës së kësaj Bashkie. Kështu, alternativa zero, do të kishte si rezultat degradimin e mundshëm (të mëtejshëm) të zones.

Toka. Në mungesë të ndërrhyrjes (alternative zero) ekziston rreziku i degradimit të mëtejshëm të tokës. Kjo së pari lidhet me intensifikimin e kulturave dhe përdorimin në sasi të tepërt të plehrave dhe pesticideve për të maksimizuar rritjen e prodhimit. Së dyti, në mungesë të veprimeve të parashikuara në PPV e Bashkisë Këlcyrë, kryesisht ndërrhyrjeve në përmbrojtjen e tokës (të tilla si ndërtimi i pritave malore apo pyllëzimet e sipërfaqeve të zhveshura), përmytjet në sipërfaqet e kultivuara mund të jenë më të shpeshta dhe me dëme shumë më të mëdha. Kjo do të sjellë edhe reduktim të cilësisë së këtyre tokave si rezultat i shpëlarjes së shtesës më prodhuese të tokës dhe t'i mbulojë ato me materiale të sjella nga përrenjtë që mund të përbëhen nga dhera dhe gurë të



4
ATELIERI STUDIO ARCHITECTURE

madhësive të ndryshme, trungje pemësh, mbetje, etj. Probleme të ngjashme të degradimit të tokës mund të lindin për shkak të erozionit të zonave malore që nuk janë të mbuluara me bimësi, nga rrëshqitjet e tokës apo ndotjet. Rrezik potencial paraqet edhe vendosja apo ndërtimi i pakontrolluar i veprave të infrastrukturës apo aktiviteteve të tjera të zhvillimit.

Airi. Faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e ajrit janë lëvizja e automjeteve, kryesisht në qytetin e Këlcyrës, dhe djegia jo e plotë e materialeve të ndryshme në soba për ngrohje në dimër. Në alternativën zero, të gjitha sa përmenden më lart ekzistojnë ende, dmth rreziqet e degradimit të mjedisit atmosferik do të mbeten të dukshme dhe mund të intensifikohen, sepse me intensifikimin e mëtejshëm të prodhimit primar dhe përpunimit të produkteve bujqësore, ruajtjen dhe rritjen e popullsisë së bashkisë do të rritet lëvizja e automjeteve brenda dhe jashtë qytetit, do të rritet trafiku i automjeteve të rënda dhe si pasojë problemet e ndotjes së ajrit do të intensifikohenit.


Uji. Në alternativën zero, presioni që do të ushtrohet në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore do të rritet, ndërsa cilësia e tyre ka të ngjarë të përkeqësohet nëse do të rritet më tej ndotja e tyre nga të gjithë faktorët e mësipërm. Rritja ekonomike në të ardhmen, që do të bazohet kryesisht në sektorin primar dhe sekondar, me shërbime trampolinë do të jetë një faktor i rëndësishëm që do të shtonte tryshinë mbi ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura. Në mungesë të ndërhyrjes (alternativa zero) rreziku i dëmtimit dhe humbjes së një pjese të pasurisë floristike dhe faunistike është më i lartë si pasojë e presioneve antropogjene. Prerja e pakontrolluar e pyjeve do të shkaktonte dëmtime të habitateve të rëndësishme për specie me vlerë të faunës, por njëkohësisht edhe do të rriste rrezikun e ndryshimit të statutit të llojeve të kërcënuara apo të rrezikuara të florës barishtore të pyjeve. Gjuetia e paligjshme do të ndikonte negativisht në reduktimin e popullatave të gjitarëve të mëdhenj dhe në rritjen e rrezikut të zhdukjes së llojeve të rrezikuara. Kështu, nëse zbatohet alternativa zero, ekziston rreziku që brenda një periudhe afat-mesme të ketë humbje të vlerave të biodiversitetit dhe degradim të disa habitateve kyçe.

Mbetjet. Sipas skenarit të mos-veprimit (alternativa zero) dhe pa ndonjë program për zhvillimin e rrjetit të menaxhimit të mbetjeve dhe minimizimin e emetimeve të lëndëve të dëmshme, shëndeti i njeriut është në rrezik konstant. Stacioni i transferimit në Mollas do zgjidhte pjesërisht problemin, por nuk do të mjaftonte.

Një problem të madh sanitar do të përbëjë rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza, që do të rezultojë i pamjaftueshëm siç është ende sot. Nëse nuk do të kushtohet vëmendje mirëmbajtjes në kohë, nuk do të zëvendësohen pjesët e rrjetit të vjetëruara dhe nuk do të implementohen masat e nevojshme për të menaxhuar rritjen e fluksit të ujërave të zeza komunale, do të shohin një përkeqësim të mëtejshëm të cilësisë së ujit dhe tokës.

Peizazhi. Skenari i mos-veprimit (alternativa zero) mbart rreziqe për peizazhin. Së pari, duke pasur parasysh se nuk do të ketë asnjë kufizim për zonimin lidhur me përdorimin e tokës, ekziston mundësia e zhvillimit të aktiviteteve (si psh ato të infrastrukturës) që ndikojnë negativisht në peizazh. Së dyti, vazhdimi i karierave të gurorëve apo shtimi i numrit të tyre, do të ndikojë negativisht në peizazh.





4

ATLIER STUDIO ARCHITECTURE

V. BAZA PËR PËRGATITJEN E VLERËSIMIT MJEDISOR

5.1. PËRCAKTIMI I OBJEKTIVAVE MJEDISORE

Ligji Nr. 91/2013, datë 28.02.2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" dhe aktet e tjera nënligjore përcaktojnë një sërë faktorësh që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit. Bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese të mjedisit, në ndikimet potenciale që mund të shkaktohen në mjedis nga aktivitetet e parashikuara në PPV dhe detyrimeve të specifikuar në konventat e ratifikuara dhe në direktivat respektive të BE-së, raporti i VSM-së përcakton sektorët më të rëndësishëm mjedisore dhe objektivat mjedisore si më poshtë:

Toka	Biodiversiteti	Uji
Ajri	Peizazhi	Faktorët klimatikë
Popullsia dhe Asetet materiale	Shëndeti i Njeriut	Mbetjet
Trashëgimia kulturore (duke përfshirë trashëgiminë arkitektonike dhe arkeologjike)		

Objektivat për mbrojtjen e mjedisit:

☐ Toka

Objektivi Mjedisor 1: Mbrojtja e formave të relievit, proceseve dhe sistemeve natyrore.

Objektivi Mjedisor 2: Mbrojtja, menaxhimi dhe përdorimi i qëndrueshëm të tokës

☐ Ajri

Objektivi Mjedisor 3: Ulja e nivelit të konsumit të energjisë dhe arritja e objektivave afatgjata për sasisë vjetore të shkarkimeve të ndotësve, në përputhje me vlerat e lejuara nga BE për shkarkimet e ndotësve atmosferike.

☐ Faktorët klimatikë

Objektivi Mjedisor 4: Adoptimi i infrastrukturës në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe reduktimi i sasive vjetore të emetimeve të gazeve serë në nivelet e përcaktuara në SKZHI II.

☐ Uji

Objektivi Mjedisor 5: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit ujor, duke përfshirë sistemet e lumenjve.

☐ Mjedi natyror- Biodiversiteti dhe hapësirat e gjelbra

Objektivi Mjedisor 6: Mbrojtja e specieve (specifike), popullatave dhe habitateve dhe krijimi dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbra të rëndësishme për rekreacion dhe biodiversitet

Objektivi Mjedisor 7: Mbrojtja nga veprimtaritë me ndikime të konsiderueshme e zonave që gëzojnë status të veçantë.

☐ Mbetjet

Objektivi Mjedisor 8: Mbrojtja e mjedisit nga ndotja dhe reduktimi i sasisë së mbetjeve të gjeneruara duke rritur riciklimin dhe ripërdorimin e tyre


☐ Ndotja akustike

Objektivi Mjedisor 9: Reduktimi i ndotjes akustike dhe përafrimi me nivelet e rekomanduara nga BE dhe OBSH

☐ Popullata dhe asetet materiale

Objektivi Mjedisor 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme.

☐ Trashëgimia kulturore



Objekti Mjedisor 11: Mbrojtja e veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore, përmirësimi dhe, sipas rastit, rivendosja dhe ristrukturimi i mjedisit historik.

☐ Peizazhi

Objekti Mjedisor 12: Mbrojtja e veçorive të zonave dhe strukturave të trashëgimisë kulturore, përmirësimi dhe, sipas rastit, rivendosja dhe ristrukturimi i mjedisit historik.

5.2. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NDIKIMEVE TË PLANIT DHE PROJEKTEVE

Ndikimet mjedisore që mund të shkaktohen nga veprimtaritë e parashikuara në Planin e Përgjithshëm Vendor janë të natyrave të ndryshme dhe pesha apo rëndësia e tyre është e ndryshme. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kalon nëpër dy faza të cilat janë përshkruar në seksionet e mëposhtme:

Vlerësimi i ndikimit

Kjo është faza kur vlerësohet ndikimi që çdo projekt i Planit ka në mjedis. Me synim vlerësimin e ndikimeve mjedisore të planit të propozuar, ndiqet metodologjia që është propozuar nga Jahn et al, (2012) e cila bazohet Direktivën 42/2001/CE, Annex II, e përshtatur për nevojat dhe karakteristikat specifike të PPV të Bashkisë dhe të propozimeve të tij. Për këtë qëllim, fillimisht, vendosen **6 elementë** (kritere, përbërës) që kanë lidhje me ndikimin e mundshëm të propozimeve të PPV të Bashkisë në mjedis. Këto 6 elementë janë

1. Probabiliteti i shfaqjes (së ndikimit): element i cili shqyrton mundësinë e shfaqjes së ndikimit mjedisor të një projekti specifik në një objektiv mjedisor,
2. Kohëzgjatja (e ndikimit): vlerëson shtrirjen kohore të ndërhyrjes në mjedis që është parashikuar për një projekt,
3. Ndikimi (i projektit): shpreh me vlerë numerike shkallën e ndikimit të një projekti të Planit për çdo objektiv mjedisor (ujë, ajër, tokë, etj.),
4. Rikthimi (i ndikimit): ky tregues shpreh mundësinë e rikthimit të ndikimit në mjedis të një projekti mbas zbatimit të tij,
5. Ndërveprimi (aspekti kumulativ i ndikimit): potenciali që bart ndërhyrja në mjedis gjatë realizimit të projektit për të shtuar dhe prodhuar efekt të akumuluar në fazën e operimit dhe shfrytëzimit,
6. Shtrirja (e ndikimit): tregon hapësirën fizike (sipërfaqen) në të cilën shtrihet ndikimi në mjedis i një projekti.

Përsa i përket mjedisit, në kontekstin e vlerësimit mjedisor të PPV-së, mjedisi është zbërthyer në 10 sektorë (elementë) që supozohet se janë pësuesit e pasojave që vijnë nga ndërhyrjet në mjedis gjatë zbatimit të projekteve. Këto 10 sektorë janë toka, ajri, klima, uji, biodiversiteti, mbetjet, ndotja akustike, popullsia dhe asset materiale, trashëgimia kulturore dhe peizazhi të cilët gjatë gjithë procesit të vlerësimit në mjedis janë quajtur objektiva mjedisore ose OM. Pra, çdo element i mjedisit që është marrë për bazë për vlerësimin e ndikimit të projekteve në mjedis, përbën një objektiv mjedisor më vete. Për shembull, toka, është objektivi mjedisor numër 1, ajri është objektivi mjedisor numër 2 e kështu me radhë.

Numri i objektivit mjedisor ka thjesht funksion renditës dhe nuk ndikon në vlerësimin e projektit. Objektivat mjedisore të marrë si bazë për vlerësimin mjedisor të projekteve të PPV-së janë përcaktuar në Ligjin 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", objektivat e përcaktuara në

SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE, të cilat janë të rëndësishme për të vlerësuar politikat dhe projektet që parashikon Plani i Përgjithshëm Vendor për të arritur objektivat e tij. Për vlerësimin e ndikimit të çdo elementi (kriteri) të ndikimit në një OM janë përdorur vlerat numerike ndërmjet [0-10] ku është ndjekur logjika e mëposhtme:

- Vlera numerike 0: është përdorur për të shënuar projekte dhe objektiva ndikimi i të cilëve në mjedis nuk është i matshëm dhe i vlerësueshëm,

- Vlerat numerike 0.1-10: janë vlerat numerike që i jepen projekteve në varësi të ndikimit të tyre specifik në objektivat e mjedisit. Në parim, madhësia e ndikimit të një projekti në mjedis dhe vlerësimi numerik lidhen ndërmjet tyre në përpjestim të zhdrejtë. Sa më i lartë që të jetë numri i pikëve që merren në vlerësim, aq më i ulët është ndikimi i një projekti në mjedis dhe anasjelltas. Për shembull, vlera "1" tregon ndikim të lartë të projektit në mjedis ndërsa vlera numerike "10" tregon mungesë ndikimi ose ndikim të papërfillshëm. *Kjo vlen si në nivel elementi të ndikimit (kriteri), ashtu edhe në nivel projekti.* Për vlerësimin e ndikimit ndiqet procesi i mëposhtëm:

- ☐ Vlerësimi me vlera numerike i ndikimit në një OM: Fillimisht kryhet vlerësimi në pikë i ndikimit të çdo elementi/kriteri të ndikimit në një OM.
- ☐ Logaritja e peshës specifike të një kriteri të vlerësimit në raport me totalin: Si hap i dytë llogaritet pesha specifike e elementeve/kritereve të ndikimit në raport me totalin. Për çdo element (kriter) të vlerësimit, është përcaktuar pesha specifike (e shprehur me %) që ky element ka në raport me ndikimin total të projektit në mjedis. Për shembull, pesha e kriterit "Natyra e ndikimit" është 20% në raport me shumën totale të ndikimit që është 100%.
- ☐ Konvertimi i pikëve në vlerësim simbolik e cilësor: Në varësi të pikëve që grumbullon secili projekt, jepet vlerësimi përfundimtar sipas tabelës (matricës) së vlerësimit të ndikimit në mjedis të paraqitur si në vijim (Tabela 15). Për këtë qëllim, pikët e grumbulluara përkthehen në shenja konvencionale, dhe në vlerësim cilësor që shprehet në vlerësim të papërfillshëm, të ulët, mesatar, të lartë dhe të paaplikueshëm.

Vlerësimi numerik (sasior) tregon ndikimin e projektit në mjedis në rastin kur parashikohet marrja e masave që zbutin ndikimin e projekteve në mjedis, domethënë në skenarin kur realizohen ndërhyrje mjedisore përmirësuese.

Vlerësimi i përputhshmërisë

Përputhshmëria e objektivave të Planit është vlerësuar duke i kombinuar ato me objektivat mjedisore. Gjatë vlerësimit të këtij treguesi janë ndjekur disa hapa të cilët janë shtjelluar më tej. Vlerësimi i përputhshmërisë kryhet duke u bazuar në vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve. Pikët e grumbulluara nga vlerësimi i 6 kritereve të ndikimit për çdo OM, mbledhen dhe më tej pjesëtohen me numrin e OM-ve (që në rastin në fjalë është 12) me qëllim llogaritjen e vlerësimit mesatar të përputhshmërisë i cili jepet vetëm në rang projekti dhe ndihmon për të kuptuar shkallën që objektivat e një plani përputhen me objektivat mjedisore. Përputhshmëria e Objektivave të Planit me Objektivat Mjedisore është shprehur në 5 nivele. Çdo nivel përputhshmërie shprehet me vlerat numerike të caktuara dhe me nivel përputhshmërie cilësore.



VI. VLERËSIMI I PËRPUTSHMËRISË SË OBJEKTIVAVE TË PLANIT DHE PROJEKTEVE STRATEGJIKE ME OBJEKTIVAT MJEDISORË

6.1. PRIORITIZIMI I PROJEKTEVE PËR ZBATIMIN E PLANIT

Duke u njohur nga afër me situatën në terren dhe duke mbajtur parasysh informacionet e marra lidhur me nevojat prioritare të banorëve të bashkisë, nga konsultimet e hapura me komunitetin, grupi i ekspertëve ka orientuar dhe zbërthyer programe të strategjisë në projekte konkrete të mirë përcaktuara në Strategjinë Territoriale sipas prioriteteve. Këto projekte të evidentuara në hartat përkatëse janë detajuar në kapitujt në vijim të lidhura me kostimin, si dhe me Projekt Buxhetin Afatmesëm. Këto projekte strategjike ndahen në:

- ☐ Projekte në nivel politikash në të cilën përfshihen objektiva dhe orientime të rëndësishme strategjike, si në zhvillimin ekonomik, ashtu edhe në atë turistik.
- ☐ Projekte reale në terren, ku i jepet prioritet zhvillimit infrastrukturor (rrugë, ndriçimi rrugor, ujësjellës-kanalizime, telekomunikacion) zhvillimit të shërbimeve në funksion të komunitetit (rikonstruktiv i shkollave, ndërtim i shesheve dhe parqeve, ndërtim i qendrave komunitare, etj.), si dhe aplikimi i rregullave arkitektonike dhe strukturore, si rehabilitimi i vendbanimeve dhe ndërtimi me një gjuhë arkitektonike dhe tradicionale etj.

Në bazë të zbatimit të tyre në mënyrën e duhur, duke siguruar një zhvillim sa më të qëndrueshëm për bashkinë, këto projekte janë ndarë në tre faza zbatimi.

6.2. VLERËSIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS NGA ZBATIMI I PLANIT PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE MJEDISORE TË PLANIT

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Këlcyre i cili është hartuar pas një vlerësimi të kujdesshëm të tipologjive hapsinore dhe ndërveprimeve ekzistuese, propozon zhvillimin turistik duke patur mbështetje në mënyrë indirekte të bujqësisë. Tipologjitë e këtyre zonave janë kryesisht rurale por njëkohësisht mbartin dhe vlera të shumta natyrore, kulturore dhe peizazhistike. Qëllimi i këtij propozimi është nxjerrja në pah e këtyre vlerave, mbrojtjen dhe rigjenerimin e tyre duke investuar në struktura akomoduese, shërbime dhe infrastrukturë mbështetëse. Në këtë mënyrë këto zona do të jenë joshëse si për banorët vendas të cilët do të kenë hapësira punësimi, shërbime dhe infrastrukturë e domosdoshme ashtu edhe për vizitorët të cilët do të gjejnë atraksionet turistike natyrore e kulturore, shërbimet dhe akomodimin e dëshiruar. Një tjetër hallkë e këtij skenari do të jetë edhe bujqësia me mbështetjen e saj në drejtimin turistik duke furnizuar këto zona me produkte bujqësore e blegtorale cilësore. Por roli i saj nuk do të jetë vetëm mbështetës pasi përbën potencial për të prodhuar, përpunuar dhe tregëtuar këto produkte i cili është i rëndësishëm për tregun rajonal.

Vlerësimi i projekteve të O.S.1: Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale, si dhe turizmit

Ky objektiv përfshin projekte që synojnë kryesisht zhvillimin e politikave nxitëse dhe mbështetjen infrastrukturale për rritjen e performancës së zonave bujqësore të bashkisë, rritjen e performancës së sektorëve ekonomikë në Bashkinë Këlcyre, nxitjen e turizmit, etj.



Vlerësimi i ndikimit të projekteve të këtij Objektivit të parë të Planit paraqitet më poshtë. Në bazë të vlerësimit të projekteve të O.S.1, nga projektet që kanë lidhje me këtë objektiv (te listuara më poshtë janë vetëm projektet e fazës së parë dhe një projekt i cili shtrihet në tre faza) rezultojnë se:

- ☐ Ndikimi në faktorin tokë është i ulët, me vetëm 1 projekt që ka ndikim mesatar, 4 projekte që kanë të ulët, ndërkohë që të tjerët kanë ndikim shumë të ulët ose nuk kanë ndikim në faktorin tokë.
- ☐ Ndikimi i projekteve në ajër është i ulët. Nga 7 projekte, 6 prej tyre kanë ndikim të ulët ose të papërfillshëm dhe vetëm 1 projekt ka ndikim mesatar.
- ☐ Ndikimi në ujë është i ulët. Bëjnë përjashtim 3 projekte që nuk kanë ndikim në mjedis dhe 3 projekte të tjera që kanë ndikim mesatar.
- ☐ OM-ja në të cilën projektet do të kenë ndikim më të lartë, pra ndikim mesatar, janë mbetjet me 2 projekte që do të kenë ndikim mesatar dhe 5 të tjerë që kanë ndikim të ulët.
- ☐ Ndikimi më i ulët vihet re në faktorët klimë dhe socio-ekonomikë (popullsia dhe asetet materiale)

Si përfundim, në bazë të vlerësimit të 7 projekteve të O.1, rezultojnë se ndikim të ulët projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë në përbërësit e tokës, ajrit, ujit, ndërsa lexohet një ndikim mesatar në komponentët mbetje, ndotje akustike dhe peizazhit. Ndikimi i projekteve në klimë, trashëgiminë kulturore dhe aspektet socio-ekonomike është i papërfillshëm.

Vlerësimi i projekteve të O.S.2: Ristrukturimi dhe profilizimi i vendbanimeve si dhe turizmit

Qyteti i Këlcyrës dhe fshatrat e territorit të bashkisë, bazuar në vendndodhjen e tyre në territor kanë karakteristika të ndryshme, cka sjell edhe ndryshime në drejtimet e zhvillimeve bujqësore apo blegtorale pranë tyre.

Ky seksion përfshin 6 projekte të fazës së parë. Projektet synojnë zhvillimin e infrastrukturës për profilizimin e vendbanimeve, rikonstruksionin e rrugëve me vlera historiko-kulturore, nxitjen e turizmit nëpërmjet rindërtimit/rehabilitimit të qendres së fshatrave, etj. Sipas vlerësimit të 6 projekteve në lidhje me O.S. 2 rezultojnë se:

- ☐ Ndikimi i projekteve në gjenerimin e mbetjeve është mesatarisht i ulët. Nga 6 projekte, 4-projekte kanë ndikim mesatar ndërsa 2 projekte të tjera kanë ndikim të ulët. Përsëritet situata e ngjashme dhe tek vlerësimi i ndikimit në ndotjen akustike.
- ☐ Ndikimi në tokë është po ashtu relativisht i ulët. Nga 6 projekte, 3-projekte kanë ndikim mesatar ndërsa 3 projekte të tjera kanë ndikim të ulët deri pothuajse të papërfillshëm.
- ☐ Ndikimi shfaqet i papërfillshëm deri pozitiv në trashëgiminë kulturore, peizazh, faktorët klimatikë dhe socio-ekonomikë (popullsia dhe asetet materiale).

Si përfundim, në bazë të vlerësimit të 6 projekteve të O.2, rezultojnë se ndikim të ulët projektet, programet dhe objektivat e Planit do të kenë në përbërësit e ajrit, biodiversitetit dhe peizazhit ndërsa lexohet një ndikim mesatar në mbetje që mund të gjenerohen dhe zhurat.

Vlerësimi i projekteve të O.S.3: Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit

Vlerësimi i ndikimit të projekteve të këtij Objektivit të tretë të Planit paraqitet më poshtë. Ky seksion përfshin 10 projekte të fazës së parë, dhe 5 projekte që shtrihen përgjatë 3 fazave. Projektet synojnë zhvillimin e infrastrukturës, rikonstruksionin e rrugëve me vlera historiko-kulturore, zhvillimin

ekonomik të zonave dhe riparimin e dëmeve mjedisore, etj. Sipas vlerësimit të 15 projekteve në lidhje me O.3 rezulton se:

- ☐ Ndikimi kryesor I këtyre projekteve është në komponentin tokë. Nga 22 projekte, 8 prej tyre kanë ndikim mesatar në tokë, ndikimi i 10 projekteve është i ulët ndërsa 4 prej tyre kanë ndikim të papërfillshëm.
- ☐ Përsa i përket ndikimeve në ajër, zhurma dhe biodiversitet, ndikimi është mesatar nga 6 projekte, është i ulët nga 8-10 prej tyre ndërsa 4-6 te tjere kanë ndikim të papërfillshëm.
- ☐ Nga 22 projekte përbërës të këtij objekti, 3 projekte kanë ndikim të papërfillshëm ose pozitiv në të gjithë komponentët (objektivat) mjedisorë, 1 ka ndikim të papërfillshëm në 10 prej tyre dhe të ulët në dy komponentë.
- ☐ Ndikimi shfaqet i papërfillshëm ose tejet pozitiv në komponentin socio-ekonomik (popullsia dhe asetet materiale).

6.3. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË PROPOZIMEVE TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR

Objektivat e përcaktuara mjedisore duhet të jenë në përputhje me Ligjin Nr. 91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", objektivat e përcaktuara në SKZHI II dhe Direktivën 2001/42/KE. Për të vlerësuar politikat dhe projektet që parashikon Plani për të arritur objektivat e tij dhe për të përcaktuar rëndësinë e objektivave mjedisore, duhet të vlerësohet përputhshmëria e objektivave dhe politikave të Planit me objektivat e përcaktuara mjedisore.

Përputhshmëria është tregues i shkallës së përshatshmërisë së objektivave të Planit me objektivat mjedisorë që mund të ndikohen gjatë fazës së zbatimit të projekteve dhe në një periudhë afatgjatë. Vlerësimi numerik i nivelit të përputhshmërisë është bazuar në vlerat numerike të nxjerra nga vlerësimi i ndikimit të projekteve në mjedis.

Vlerësimi i përputhshmërisë ofron mundësinë për te evidentuar konflikte apo veprime të ndërsjellta mes objektivave dhe politikave të ndryshme, si dhe konflikte të theksuara interesi mes objektivave. Të gjitha këto duhen vënë në dukje veçanërisht në pjesën e Vlerësimit të projekteve specifike të Planit.

Më poshtë paraqitet vlerësimi i përputhshmërisë së projekteve të planit me objektivat mjedisorë. Treguesi i përputhshmërisë mundëson të vlerësojmë jo vetëm përputhshmërinë e çdo projekti me të gjitha objektivat njëherësh, por edhe kuptojmë, për çdo projekt, se në cilat Objektiva Mjedisore dhe në çfarë mase (e shprehur në % ndaj totalit prej 12 OM-ve) arrihet, ose cënohet përputhshmëria maksimale.

Përputhshmëria e politikave të Planit është vlerësuar duke i kombinuar këto politika me objektivat mjedisore të kësaj VSM-je. Vlerësimi është bere duke përdorur përafrimin standard në forme matrice. për të kryer Vlerësimin numerik të nivelit të përputhshmërisë është përdorur disa kriterë vlerësimi.

Rezultatet e Vlerësimit të përputhshmërisë së politikave dhe programit të Planit me objektivat mjedisore janë paraqitur në Tabelën 32 më poshtë. Tabela tregon se, në parim, të gjitha politikat e Planit janë në përputhje me objektivat mjedisore.



Tabela 32. Përpqutshmëria e objektivave mjdisore me Objektivat e Planit

Objektivat Mjedisore	OM 1	OM 2	OM 3	OM 4	OM 5	OM 6	OM 7	OM 8	OM 9	OM 10	OM 11	OM 12	Vlerësimi mesatar
Objektivat e Programeve të Planit	Toka			Klima	Uji	Biodiversiteti	Mbetjet		Ndodhja e akustike	Popullsi + asetet	Trashëgimia kulturore	Pelazhi	
O.S1: Orientimi i ekonomisë drejt flierave bujqësore, blegtorale dhe turizmit													
O1.P1: Zhvillimi i flierës së vreshtarisë	2	3	3	3	3	2	2	2	1	3	1	3	2.50
O1.P2: Zhvillimi i flierës së perimeve	2	3	3	3	3	2	2	2	1	3	1	3	2.50
O1.P3: Zhvillimi i blegtorisë dhe produkteve blegtorale	2	3	2	3	3	2	2	2	2	3	1	2	2.50
O1.P4: Zhvillimi i bimeve medicinale	2	3	3	3	3	2	2	2	1	3	1	3	2.50
O1.P5: Evidentimi i potencialit turistik	0	0	0	0	1	2	2	1	0	3	1	3	1.08
O1.P6: Marketimi (promovimi) i vlerave, traditave dhe produkteve (brand lokal)	0	0	1	0	1	1	3	1	0	3	3	0	1.08
O.S2: Rigjistrimi dhe profilimi i vendbanimeve													
O2.P1: Sistemimi i qendrave të vend-banimeve	3	3	3	3	3	1	1	3	3	3	3	3	2.67
O2.P2: Struktura dhe shërbime administrative cilësore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	2	0	0.42
O2.P3: Struktura dhe shërbime në funksion të arsimit, kulturës, sportit	0	0	0	0	0	0	0	0	1	3	3	0	0.58
O2.P4: Struktura dhe shërbime në funksion të shëndetësisë dhe përkrahjes sociale	0	0	0	0	0	0	0	0	1	3	3	0	0.58
O2.P5: Rritja e kapaciteteve njerëzore	0	1	0	0	0	0	0	0	1	3	3	0	0.67



ATELIER STUDIO ARCHITECTURE

4
KODI I
PROJEKTIT
KODI I
KATEGORIS
KODI I
KATEGORIS

03. Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisitë përrethit														
O3.P1. Përmirësimi i infrastrukturës rurale	2	3	3	3	1	0	0	2	3	3	1	3	2.00	
O3.P2. Sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimi i ujërave të ndotura	0	2	3	2	3	0	0	2	2	3	0	3	1.66	
O3.P3. Sistemet e ujit për bujqësi, blegtori	2	2	2	1	3	0	2	2	2	2	3	1	1.82	
O3.P4. Furnizimi me energji elektrike dhe burime alternative energjie	0	0	3	3	2	0	0	0	0	3	0	0	0.92	
O3.P5. Ndricimi publik	0	0	3	3	0	0	0	0	0	3	0	1	0.83	
O3.P6. Përmirësimi i shërbimeve të telekomunikacionit	0	0	2	3	0	0	0	0	0	3	0	1	0.75	
O3.P7. Trajtimi i mbetjeve urbane	1	3	3	3	3	0	0	3	1	3	0	3	1.92	
O3.P8. Infrastruktura e mbrojtjes mjedisore	3	3	2	3	3	2	3	2	2	3	1	3	2.50	
O3.P9. Minimizimi i impakteve negative në mjedis	3	3	3	3	3	3	3	3	3	3	1	2	2.83	

Në përgjithësi, në këndvështrimin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore, objektivat dhe politikat e Planit, janë si me poshtë:

- ☐ objektivat përputhen plotësisht (7 objektiva)
- ☐ objektivat përputhen pjesërisht (4 objektiva)
- ☐ lidhja mes objektivave është e zbehte (9 objektiva)

Në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një riverifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore. Koncretisht:

- ☐ Secila prej objektivave të Planit është në përputhshmëri të plotë me të paktën 1 objektiv mjedisor;
- ☐ Secila prej objektivave të Planit (përveç 1 objekti "Sruktura dhe shërbime administrative cilësore") është në përputhshmëri të plotë me të paktën 2 objektiva mjedisore
- ☐ Gjashtë objektiva të planit janë në përputhshmëri të plotë me të paktën gjysmen (6) objektiva mjedisore
- ☐ Pesë objektiva të planit kanë një lidhje të pjesshme me të paktën një objektiv mjedisor;
- ☐ Gjashtë objektiva të planit kanë një lidhje të zbehte ose nuk kanë lidhje me të paktën 1 objektiv mjedisor;

Edhe në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore diversifikimi i përputhshmërisë është i lartë. Sidoqoftë, objektivi mjedisor OM 10: Përmirësimi i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme, është objektivi me nivelin më të lartë të përputhshmërisë me objektivat mjedisore.






VII. VLERËSIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE DHE MASAT ZBUTESE

Në seksionet e mësipërme, u përshkruan shkurtimisht disa nga ndikimet më të rëndësishme në realizimin e objektivave mjedisore, që mund të rezultojnë nga zbatimi i Planit të propozuar. Në përgjithësi, nëpërmjet pozicionimit të përshtatshëm të aktiviteteve hapësinore dhe duke ndërmarrë masat zbutëse përkatëse, të gjithë grupet e veprimeve janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Në këtë kapitull përshkruhen disa nga udhëzimet dhe masat mbrojtëse të domosdoshme për të siguruar arritjen e objektivave të rëndësishëm mjedisore në fushat e veçanta. Duke zbatuar udhëzimet e përgjithshme dhe masat zbutëse, ndikimet negative të përshkruara në seksionet më sipër do të parandalohen dhe do të sigurohet arritja e objektivave mjedisore.

Për më tepër, ky seksion ofron disa masa specifike zbutëse të zbatueshme për projektet specifike të përshkruara në Plan. Është e rëndësishme të theksohet se lista e masave specifike zbutëse e dhënë më poshtë nuk është shteruese. Masa me të detajuara në aspektin e përmbajtjes dhe analizës do të duhet të përgatiten si pjesë e VNM-ve individuale për çdo projekt specifik të Planit.




VIII. MONITORIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Monitorimi i mjedisit përshkruan proceset dhe aktivitetet që duhet të realizohen për të karakterizuar dhe monitoruar cilësinë e mjedisit. Pavarësisht debateve mbi cilësinë e tyre, monitorimi i ndikimeve në mjedis është jashtëzakonisht i rëndësishëm për zbatimin e Planit. Nga pikëpamja ligjore, në përputhje me Ligjin Nr. 91/2013 dhe Direktivën 2001/42/EC, zbatimi i një programi duhet të monitorohet, me qëllim që të identifikohen efektet negative të paparashikuara, në mënyrë që të krijohet mundësia për një reagim të hershëm ndaj këtyre efekteve duke u paraprirë adaptime të mundshme.

Mbështetur në elementët e këtij sistemi është hartuar edhe Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit. Objektivi primar i Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit është të ndihmojë autoritetet kombëtare dhe vendimmarresit në arritjen e qëllimeve të politikës për një zhvillim të qëndrueshëm. Sistemi i monitorimit është përbërë nga stacionet e monitorimit që i përkasin rrjetit të monitorimit në mënyrë të specifikuar të krijuar për çdo komponent mjedisor sic janë, ajri, ujrë, toka, biodiversiteti dhe pyjet.

Plani i Monitorimit të zbatimit të PPV-së përcakton treguesit mjedisor mbi të cilët do të bazohet monitorimi, shpeshësia e monitorimit sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe institutet përgjegjëse për monitorimin e gjendjes në mjedis.

Plani i Monitorimit të zbatimit të PPV-së Këlcyrë ka përcaktuar edhe institucionet përgjegjëse të cilat do të duhet të monitorojnë treguesit mjedisorë për vlerësimin dhe zbatimin e masave të parashikuara në VSM sipas fushave të përgjegjësisë përkatëse. Institucionet përgjegjëse përfshijnë "institutet, laboratorët e qendrat kërkimore-shkencore private e publike të kontraktuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të kryer monitorimin e treguesve konkretë të dukurive natyrore të cilësisë". Institucionet shtetërore, qoftë në nivel kombëtar apo edhe rajonal si Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit, Inspektorati Mjedisor, Drejtorja e Mjedisit në Bashkinë Këlcyrë do të nevojitet të bashkë-rendojnë punën në mënyrë që të realizojnë inspektimet në terren për mbarëvajtjen dhe respektimin e kushteve të pëlqimeve apo lejeve mjedisore të projekteve.





IX. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Këlcyrë është një instrument efikas për zhvillimin e territorit, pasi: (1) merr në konsideratë synimet ekonomiko-sociale të komunitetit në nivel strategjik; (2) evidenton veprimet strategjike që mund të realizohen në një kohë të shkurtër me anë të resurseve të disponueshme; dhe (3) përcakton objektiva konkretë dhe afatet kohore të tyre.


Zbatimi i PPV do të ketë ndikime pozitive në mjedis. Ai do të orientojë zhvillimet urbane dhe rurale në zonën e Këlcyrës nëpërmjet ndarjes së qartë të tyre: klasifikimit dhe kufizimit të zonave urbane dhe specifikimit të zonave rurale në bazë të karakteristikave të ekosistemeve dhe specializimit në prodhimin bujqësor. Nëpërmjet analizës së gjendjes, matricës SWOT dhe strategjise së zhvillimit PPV jep alternativa të zhvillimit të qëndrueshëm në planin ekonomik, peizazhit, ruajtjes dhe mbrojtjes së biodiversitetit dhe rritjes së cilësisë së jetës.

PPV përfshin tre objektiva strategjike: (i) Orientimi i ekonomisë drejt filierave bujqësore, blegtorale dhe turizmit, (ii) Ristrukturimi dhe profilizimi i vend-banimeve, dhe (iii) Infrastruktura në shërbim të banorëve, zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes të mjedisit e peizazhit; të cilët realizojnë të plotë panoramen e zhvillimit të qëndrueshëm të Këlcyrës.

Në kontekst të këtij Vlerësimi (VSM) janë përcaktuar kriteret e forta mjedisore dhe zonat e rrezikshme për zhvillim të cilat janë si referenca për përgatitjen e cdo dokumenti tjetër lokal duke preluar PPV. Në këtë VSM janë vlerësuar ndikimet potenciale nga aplikimi i PPV në: menaxhimin e mbetjeve, ujërave, cilësisë së ajrit, tokës dhe prodhimit bujqësor, biodiversitetit, ndertimeve infrastrukturore, transportit dhe energjisë. Për të siguruar vlerësimin e plotë të ndikimeve të mundshme në mjedis, në këtë VSM, veç ballafaqimit me objektiva specifike mjedisore të strategjive (strategjitë dhe politikat për mbrojtjen e mjedisit, tokës, ujit, ajrit, biodiversitetit, zhvillimit rural, mbetjet dhe ujërat e zeza, zhurmat) në nivel nacional, janë konsideruar gjithë komponentët të cilët ndikohen nga ky Plan. Matrica e përdorur për përputhshmërinë e objektivave të Planit me objektivat më të rëndësishme mjedisore, tregon se përgjithësisht ato janë të përputhshme në shkallë të lartë. Veprimet (aktivitetet) e Planit janë zhvilluar mbi bazën e një llogjike mjedisore të ndërlidhur me shumë faktore (variabla independentë) të cilët, në cdo Plan është vështirë të përfshihen pa modifikime qoftë edhe minimale.

Rekomandohet:

- ☐ Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet autoriteteve përkatëse të sektorëve të caktuar ekonomike me autoritetet e mjedisit dhe shëndetësisë;
- ☐ Plotësimi i standardeve mjedisore duhet të shoqërohet edhe me rritjen e portofolit financiar dhe investimeve në drejtim të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit;
- ☐ Rritja e transparencës për investimet e reja, kontrollin e shkarkimeve në ujë apo ajër, administrimin e zonave të mbrojtura, menaxhimin e mbetjeve, etj. ndihmon në rritjen e bashkëpunimit me publikun dhe zbatimin e politikave të parashikuara nga Plani.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 636 Rep.



PULLE TARIFE



V È R T E T I M
I NJËSISË SË KOPJES ME ORIGJINALIN
BAZA LIGJORE E VËRTETIMIT

Neni 56 i Ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar)
Udhëzimi i Ministrit të Drejtësisë nr. 6291 datë 17.8.2005 (i ndryshuar)

Në Tiranë, sot më 05.04.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje noteres publike, Natasha Xhaçka, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Rruga "Sami Frashëri", Pall. Aviacioni i vjetër, Nr.3, Ap.12, Kodi postar Nr.2081, u paraqit personalisht:

Z. Florian Bitraj, i identifikuar sipas ligjit, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili kërkoi të vërtetohet me origjinalin dokumentin:

Licensë QKB LN-6585-06-2013, certifikatë Alban Eftimi, certifikatë Gazmend Zeneli

paraqitur prej tij, unë pasi u sigurova për dokumentin se është i njëjte me origjinalin, nuk ka korrigjime, shtesa, fshirje ose shenja të tjera të veçanta, e vërtetoj një me origjinalin në bazë të ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar).

NOTERE

NATASHA XHAÇKA



MINISTRIA E ZHVILLIMIT
DHE TREGETISE
TRASHETIT DHE SËPËRBLIMIT



Qendra Kombëtare e Bëzimit
Nacional Business Center

LICENCË

Numri serial: LN-6585-06-2013
NUIS/NIPT: K31812012H

Subjekti: "ATELIER 4"

Adresa: Tiranë, Tiranë, Tiranë, Njësia Administrative nr.5, rruga e Kosovareve,
Ndërtesa 35, Hyrja 6, apartamenti 4/1, 1019.

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tregtar:

Data e lëshimit: 05/12/2017

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkruar i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Vlersim i ndikimit në mjedis dhe auditim mjedisor).

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi i sportelit

Petar Lioni

Kjo certifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Bëzimit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërprenë detyrimi ligjor për të qenë person i autorizuar.





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 162 Prot

Tirane, me 17.08. 2005

Vendimi Nr.7, Nr.154 Regj.

CERTIFIKATE

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për certifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Alban EFTIMI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem RUKA



[Handwritten signature in blue ink]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore
Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit
Sektori i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Rruga "Durrësi" Nr. 27 Tiranë, Tel. 04 2256 113 Fax. 04 2270 030 - www.moe.gov.al

Nr. 7777 Prot.

Tiranë, 11 2011

Nr. identifikues 27

CERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011
Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të
Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për
pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe
auditimin mjedisor".

Z. GAZMEND ZENELI

Certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për
të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme
mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të
ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Fatmir MEDIU



